



UBT NEWS

Gazetë e studentëve të UBT-së | Dhjetor 2023

POLITICS | ECONOMY | BUSINESS | TECHNOLOGY | EDUCATION | SCIENCE | CULTURE

2023 - VITI I SUKSESEVE TË MËDHA TË UBT-SË



UBT jep Çmimin "Leadership Excellence Award" për Universitetet e Shqipërisë Vlerësohet lart kontributi i universiteteve të Shqipërisë për arsimin në Kosovë

Faqe / 3



UBT i bashkohet rrjetit të 153 universiteteve nga 25 shtete të ndryshme të anëtarësuara në UNIMED

Faqe / 8



UBT përmbyll suksesshëm edicionin e dymbëdhjetë të Konferencës Ndërkombëtare për Shkencë, Teknologji dhe Inovacion

Faqe / 24

30 INOVACIONET e UBT-së

- | | |
|---|---|
| 1 > 5G TECHNOLOGY | 16 > UBT EDTECH |
| 2 > AUGMENTED AND VIRTUAL REALITY | 17 > UBT DIGITAL INNOVATION HUB |
| 3 > ARTIFICIAL INTELLIGENCE, INTERNET OF THINGS, ROBOTICS AND INDUSTRIAL AUTOMATION | 18 > NATIONAL PUBLIC POLICY SIMULATION LAB |
| 4 > UBT SMART CITY | 19 > UBT INTEGRATED MEDIA CENTER |
| 5 > NATIONAL CYBER SECURITY AND RESILIENCE | 20 > UBT GIS CENTER |
| 6 > UBT RESEARCH HUBS | 21 > UBT HIGH SCHOOLS |
| 7 > UBT JUNIOR HUB | 22 > UBT PROFESSIONAL SCHOOLS |
| 8 > UBT SPORT, E-SPORT & ART HUB | 23 > UBT IDEA |
| 9 > UBT INNOVATION AND TECHNOLOGY HUBS | 24 > VIRTUALIZATION BASED DELIVERY SERVICES |
| 10 > UBT KNOWLEDGE HUB | 25 > UBT COMMUNITY SERVICES |
| 11 > TAILORED MANUFACTURING SERVICES | 26 > UBT HEALTH CARE SERVICES |
| 12 > REMOTE/CONTACTLESS DELIVERY SERVICES | 27 > UBT – UNIVERSITY 4.0 |
| 13 > CREATIVITY INDUSTRY HUB | 28 > UBT GO INTERNATIONAL |
| 14 > CENTRAL TESTING HUB | 29 > UBT SCIENCE AND TECHNOLOGY PARK |
| 15 > SMART GREEN CAMPUS | 30 > IMPACT UNIVERSITY |



EFQM

EFQM Global Award 2022

5 Diamonds

presented to
University for Business and
Technology

October 2022

Russell Longmuir
CEO, EFQM



22 YEARS
LEADERSHIP and INNOVATION

Education | Research | Training | Consulting

2001/2023

IMPRESUM

UBT News – gazetë e studentëve

Botues: Edmond Hajrizi

Numrin e përgatiti: Media Grupi i UBT-së

Adresa: www.ubt-uni.net

Tel: 038 541 400, 044 541 400

Përgatitje grafike: Albert Zuka

UBT jep Çmimin “Leadership Excellence Award” për Universitetet e Shqipërisë

Vlerësohet lart kontributi i universiteteve të Shqipërisë për arsimin në Kosovë

22/02/2023. Në Parkun Shkencor Inovativ të UBT-së, në Lipjan, u bë ndarja e çmimit të përvjetshëm “Leadership Excellence Award”, i cili këtë vit u dedikua për Universitetet e Republikës së Shqipërisë, për kontributin e pamohueshëm për krijimin e kuadrove profesionale të Kosovës.

Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi në fjalën e tij theksoi së vlerësi i Universiteteve të Shqipërisë vjen si rezultat i kontributit të jashtëzakonshme të arsimit dhe edukimit të rinjve nga Kosova dhe nga trojet e tjera shqiptare jashtë Shqipërisë. “Kontributi i Shqipërisë për arsimin dhe edukimin e të rinjve nga Kosova është i pamohueshëm. Kujtojmë këtu vitin 1941, kur nga Shqipëria në Kosovë erdhën mbi 400 mësime dhe hapën shkolla shqipe e shpërndanë dituri, në një kohë kur analfabetizmi



në Kosovë ishte shumë i lartë. Në kohët më të vështira, Universitetet e Shqipërisë përgatitën kuadro profesionale për Kosovën. Ky

është një kontribut i paçmueshëm dhe që do të vlerësohet gjithmonë në Kosovë”, tha rektori Hajrizi. Për këtë vlerësim të UBT-së, në

emrin e universiteteve shqiptare, kryetari i Konferencës së rektorëve në Shqipëri, Artan Hoxha, u shpreh falënderues dhe mirën-

johës ndaj UBT-së, duke theksuar nevojën e rritjes së bashkëpunimeve të reja në mes institucioneve arsimore në Kosovë dhe Shqipëri.

“Arsimi i lartë privat në Kosovë po ecën me një ritëm të shpejtë. UBT është një nga ato rastet që mund të krenohemi, dhe që së bashku me të gjitha institucionet e tjera ndikon në zhvillimin e arsimit të lartë në Kosovë. Ne vazhdojmë të punojmë së bashku me institucionet e arsimit të lartë dhe uroj që këto bashkëpunime të vazhdojnë dhe të thellohen më shumë”, u shpreh Hoxha.

Çmimi “Leadership Excellence Award” është mirënjohja më e lartë që ndan UBT. Ai jepet çdo vit dhe u dedikohet institucioneve, organizatave apo individëve që kanë dhënë kontribut në sfera të ndryshme sociale.

UBT ndau çmimin e nderit “Leadership Excellence Award” për ish-presidentin e Bullgarisë

Grada më e lartë për Rosen Plevneliev

Në bazë të vendimit të Këshillit Akademik, Presidenti i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, ndau çmimin e nderit “Leadership Excellence Award”, për ish-presidentin e Republikës së Bullgarisë, Rosen Plevneliev.

Këshilli Akademik i UBT-së, në përputhje me propozimin e Ambasadorit të Republikës së Kosovës në Bullgari, Delfin Pllana, ka vendosur që ish-presidentit të Republikës së Bullgarisë, Rosen Plevneliev, t'i ndajë Çmimin Tradicional Honor Degree “Leadership Excellence Award” nga ana e Presidentit të UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi.

Në fjalën e tij, Rektori Hajrizi falënderoi ish-presidentin Plevneliev për kontributin e tij, lidhshimin e treguar në konsolidimin e brendshëm socio-ekonomik, si dhe në avancimin e shtetit të së drejtës.



“Kemi kënaqësinë të kemi sot, ish-presidentin e Republikës së Bullgarisë në Kosovë, në UBT, për t'i dhënë çmimin e nderit “Leadership Excellence Award”, gradën më të lartë që ka UBT. Ndarja e këtij

çmimi për ish-presidentin Plevneliev është edhe një mesazh për të nderuar kontributin e tij të jashtëzakonshëm në avancimin e shtetit të së drejtës dhe lidhshimin e treguar në konsolidimin e brendshëm so-

cio-ekonomik”, ka thënë Rektori Hajrizi.

Ish-presidenti i Bullgarisë, Rosen Plevneliev falënderoi UBT-në për nderimin me çmimin më të lartë universitar, si dhe theksoi se UBT prezanton institucionin më të mirë në Ballkan dhe më gjerë.

“Nuk i harroj ndjesitë e mia të para në Kosovë. Janë kujtime shumë të mira dhe të jashtëzakonshme. Kosova gjithmonë ka qenë në zemrën time. Një popull aq i mrekullueshëm, punëtor, pozitiv. Unë vij gjithmonë këtu me zemrën plot. Dhe këtu ndihem si në shtëpi, e dua Kosovën. Ju falënderoj për nderimin me çmimin më të lartë universitar, dhe ju prezantoni institucionin më të mirë në Ballkan”, u shpreh Plevneliev.

Zëvendësministrja e Ministrisë së Jashtme dhe Diasporës, Liza Gashi

vlerësoi lartë kontributin e ish-presidentit të Bullgarisë, Rosen Plevneliev, për Kosovën dhe mbështetjen e vazhdueshme në rrugëtimin drejt liberalizimit të vizave.

Rosen Plevneliev në cilësinë e Presidentit ka ndikuar në stabilitetin global përmes qëndrimeve të cilat ai ka mbajtur në ruajtjen e paqes globale dhe promovimit të vlerave të përcaktuara në Kartën e Kombeve të Bashkuara.

Plevneliev ka luajtur rol vendimtar në ndërtimin e marrëdhënieve ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bullgarisë, të cilat tashmë janë në nivel jashtëzakonisht të kënaqshëm dhe karakterizohen nga një vlerësim i dyanshëm i potencialit të madh që këto marrëdhënie të thellohen edhe më tej në të gjitha fushat, në veçanti në fushën e bashkëpunimit ekonomik.

UBT ndau çmimin “Leadership Excellence Award” për Damën e Luksemburgut Tessy Antony de Nassau, laureate e Çmimit më të lartë të UBT-së



Në Parkun Shkencor Inovativ të UBT-së, në Lipjan, në prani të shumë profesorëve, stafit dhe studentëve, me vendim të Këshillit Akademik të UBT-së, rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, i ndau çmimin “Leadership Excellence Award”, Damës së Luksemburgut, Tessy Antony de Nassau.

Këtë çmim rektori Hajrizi, i ndau Damës së Luksemburgut, Tessy Antony de Nassau për kontributin, përkushtimin dhe qëndrueshmërinë e madhe, si një avokate e zëshme për të drejtat e

grave dhe një ambasadore e të drejtave të njeriut.

“Përkushtimi i Tessy Antony de Nassau për kauzat humanitare shërben si një motivim i madh, duke fuqizuar të drejtat e grave dhe femijëve, si dhe duke avokuar në barazitë shoqërore. Ne vendosëm të japim dhe të shpërblejmë me gradën e nderit – çmimin e ekselencës së lidhshimit, si një mirënjohje ndaj angazhimit dhe punës së Tessy Antony de Nassau në nisma të ndryshme sociale”, ka thënë rektori Hajrizi.

Dama e Luksemburgut, Tessy Antony de Nassau u shpreh e lumtur për vlerësimin që UBT i bëri asaj dhe me këtë rast potencoi edhe rëndësinë e kultivimit të miqësisë dhe projekteve në të ardhmen.

“Jam shumë e lumtur që kam marrë çmimin UBT Excellence. Është me të vërtetë e mrekullueshme të shohësh që puna ime, ambiciet e mia dhe përkrahja ime janë pranuar aq mirë, sa frymëzojnë, dhe gjithashtu është e mrekullueshme të kthehem në Kosovë. Unë kam qenë këtu para 19 viteve kur isha këtu me trupat e KFOR-it në vitin 2004 në moshën 18 vjeçare. Por, duke u kthyer kam gjetur një rajon që po lulëzon njerëz të mrekullueshëm. Rrallë kam përjetuar një mikpritje të tillë kudo në botë realisht”, tha Dame Tessy Antony de Nassau.

Dame Tessy Antony de Nassau zhvilloi një vizitë në Parkun Shkencor Inovativ të UBT-së në Lipjan, me çrast diskutoi me studentët dhe profesorët edhe rreth rëndësisë së përshtatshmërisë në një botë që ndryshon me shpejtësi.

UBT ndan çmimin “Leadership Excellence Award” për Dr. Judithanne Scourfield Mclauchlan



Në Parkun Shkencor Inovativ të UBT-së, në Lipjan, në prani të shumë profesorëve, stafit dhe studentëve, me vendim të Këshillit Akademik të UBT-së, rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, i ndau çmimin “Leadership Excellence Award”, Dr. Judithanne Scourfield Mclauchlan.

Këtë çmim rektori Hajrizi, i ndau Dr. Judithanne Scourfield Mclauchlan, në mirënjohje të përkushtimit dhe angazhimit të jashtëzakonshëm në promovimin e shtetit të së drejtës, ndërtimit të demokracisë dhe

aktivizmit qytetar. Rektori Hajrizi vlerësoi lartë kontributin e Dr. Judithanne Scourfield Mclauchlan në fushën e shkencave politike dhe për promovimin e vlerave demokratike dhe të angazhimit qytetar.

Dr. Judithanne Scourfield Mclauchlan është profesoreshë e asociuar e Shkencave Politike dhe Drejtoreshë Themeluese e Qendrës për Përputhshmëri Qytetare në Universitetin e South Florida St. Petersburg, ku mëson lëndë të Qeverisjes Amerikane dhe Ligjit Publik.

Ajo ka punuar një periudhë edhe në Shtëpinë e Bardhë, në kohën e Presidentit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Bill Clinton dhe Hillary Clinton, gjersa ka patur edhe funksione të tjera me rëndësi. Mclauchlan është një kontribuuese aktive në fushën e shkencës. Ajo ka botuar shumë artikuj dhe kapituj librash mbi efektet e përfshirjes së përpjekshmërisë qytetare në kurikulë dhe ka paraqitur ato gjetje në konferenca rajonale, kombëtare dhe ndërkombëtare.

Në Barcelonë të Spanjës

UBT vlerësohet me çmimin “European Young Entrepreneurial University of the Year”

Në Barcelona të Spanjës, në mesin e shumë institucioneve nga mbarë bota, UBT është vlerësuar nga Triple E Awards me çmimin “European Young Entrepreneurial University of the Year”.

Me këtë rast, UBT është bërë institucioni i parë në Kosovë dhe regjion, që vlerësohet me çmimin “European Young Entrepreneurial University of the Year”, për konceptet dhe strategjinë unike që ka zhvilluar, rezultatet dhe ndikimin në shoqëri, si dhe për rolin udhëheqës dhe liderhipin në shkencë, teknologji dhe inovacion.

Përmes votimit të hapur nga i gjithë globi, UBT zuri vendin e parë për “Young Entrepreneurial University of the Year”, në kategorinë: “Community”, për përkushtimin dhe angazhimin e madh



drejt projektimit dhe krijimit të një qasje të integritetit të ndërmarrësisë në universitet. Në ceremoninë e ndarjes së çmi-

meve, Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi u shpreh i lumtur për edhe një arritje të madhe të UBT-së, në arenën ndërkombëtare.

“Ky vlerësim sot na jep një shtytje dhe një motivim shumë të madh për të ecur tutje, për të punuar me hapa edhe më të mëdhenj, pasi që UBT po dëshmon se ka fuqi dhe të gjitha mjetet e nevojshme për të garuar kudo. Edhe më të madh këtë motivim e bën fakti se këtu në Barcelonë nuk jemi duke prezantuar vetëm UBT-në, por tërë shtetin e Kosovës dhe vlerat që kemi si shoqëri”, ka thënë Rektori Hajrizi. UBT tashmë është vlerësuar nga shumë organizata prestigjioze nga Evropa dhe bota, duke dëshmuar edhe një herë liderhipin institucional dhe universitar në gjithë rajonin e Evropës Juglindore.

Në Lubjanë të Sllovenisë

Rektori Hajrizi nderohet me Pllakën e Artë të Universitetit “Nova univerza”



Për kontributin e jashtëzakonshëm në zhvillimin e punës shkencore, pedagogjike dhe edukativo-arsimore të universitetit dhe në rritje e reputacionit të tij, Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi është nderuar me Pllakën e Artë të Universitetit “Nova univerza” në Lubjanë të Sllovenisë.


Rektori Hajrizi është shquar si një udhëheqës vizionar i një institucioni lider siç është UBT në ar-

simit e lartë në Kosovë dhe rajon, duke ndihmuar në krijimin e një mjedisi të stimulueshëm për zhvillimin e njohurive dhe inovacionit. Ceremonia e ndarjes së Pllakës së Artë në Lubjanë ka qenë një moment i rëndësishëm për arritjet e Rektorit Hajrizi në arenën ndërkombëtare, si dhe në krijimin e partneriteteve institucionale duke i mundësuar të rinjve hapësira të reja veprimi në botën akademike.

UBT fitues i projektit Shape në thirrjen Erasmus+ 2023

23/11/2023. UBT është fitues në rolin e koordinatorit në projektin SHAPE, si pjesë e Projekteve të Ngritjes së Kapaciteteve Erasmus+ për vitin 2023. Ky njoftim është bërë në një ngjarje të fundit të organizuar nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI) dhe Zyra Erasmus+ në Kosovë.

Ministrja e Arsimit, Arbërie Nagavci, së bashku me Johannes Madsen nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë, kanë shpalosur rezultatet



e thirrjes së Programit Erasmus+ 2023 për Kosovën në një konferencë të përbashkët për media.

Përfaqësuesi i UBT-së, Zëvendës-rektori Prof. Dr. Visar Hoxha dhe Koordinatorja e Zyrës Ndërkombëtare, Elinda Krasniqi, ndanë njohuri për projektin SHAPE. Krasniqi shtjelloi objektivat e projektit dhe rezultatet e pritura, duke theksuar fokusin e tij në krijimin e një Rrjeti Universitar për Sportin në Ballkanin Perëndimor. Projekti synon të hartojë veprime

të përbashkëta në përputhje me standardet evropiane dhe rekomandimet e Bashkimit Evropian, duke promovuar stile jetese aktive dhe duke kontribuar në jetën e komunitetit dhe zhvillimin e qëndrueshëm në rajon.

Zyra e Projekteve në UBT tashmë është duke u përgatitur, duke grumbulluar ide inovative për të aplikuar në thirrjet e ardhshme Erasmus, duke forcuar më tej angazhimin e UBT-së.

Rektori Hajrizi prezanton UBT-në si model për Smart City në Konferencën Globale të Triple Helix dhe ACEEU



Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, ishte i ftuar në Barcelonë të Spanjës, në Konferencën Globale: “Triple Helix & ACEEU”, për të prezantuar UBT-në si model unik për Smart City, rolin e ndërmarrësisë, angazhimin e universiteteve për zhvillimin e qëndrueshëm dhe ambientin, si dhe për ndryshimet klimatike.

Në këtë konferencë, rektori Hajrizi ishte folës në kuadër të sesionit “Forward Force: insights from entrepreneurial leaders - resentations of Triple E Award”, ku edhe prezantoi modelin e UBT-së për qytetin e mençur, të zhvilluar në

Parkun Shkencor Inovativ. Tema e titulluar: “UBT - Smart Self Sustain Innovation based Ecosystem (Smart City)”, shpërfaqti idenë dhe implementimin unik të një ekosistemi që është zhvilluar për herë të parë nga një universitet, e që studentëve u ka dhënë hapësirë për të hapur diapazonet e tyre të shkencës dhe dijes.

Para shumë pjesëmarrësve nga mbarë bota, përmes UBT-së, Rektori Hajrizi prezantoi edhe Kosovën, si mundësi unike për zhvillimin e shumë veprimtarive, duke e dhënë shembull UBT-në si institucion që ka arritur të zhvillo-

het me teknologjitë më të sofistikuar të kohës.

Pjesëmarrja e Rektorit Hajrizi në këtë konferencë është e një rëndësie të madhe për krijimin e partneriteteve të reja dhe mundësive të shkëlqyeshme për të rinjtë nga Kosova dhe rajoni, si dhe për ndërkombëtarizimin e Kosovës. Forumi i Palëve të Interesit të ACEEU 2023 është një ngjarje që bashkon ekspertë nga mbarë bota dhe një nga shtytësit kryesorë për të çuar përpara kufijtë e sipërmarrjes dhe angazhimit të komunitetit në Arsimin e Lartë.

Edhe një sukses tjetër ndërkombëtar

Në Dubai rektori Hajrizi vlerësohet me çmimin “Pioneers Awards”



gjithë globi, UBT zuri vendin e parë për “Young Entrepreneurial University of the Year”, në kategorinë: “Community”, për përkushtimin dhe angazhimin e madh drejt projektimit dhe krijimit të një qasje të integritetit të ndërmarrësisë në universitet.

Në ceremoninë e ndarjes së çmimeve, Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi u shpreh i lumtur për edhe një arritje të madhe të UBT-së, në arenën ndërkombëtare.

“Ky vlerësim sot na jep një shtytje dhe një motivim shumë të madh për të ecur tutje, për të punuar me hapa edhe më të mëdhenj, pasi që UBT po dëshmon se ka fuqi dhe të gjitha mjetet e nevojshme për të garuar kudo. Edhe më të madh këtë motivim e bën fakti se këtu në Barcelonë nuk jemi duke prezantuar vetëm UBT-në, por tërë shtetin e Kosovës dhe vlerat që kemi si shoqëri”, ka thënë Rektori Hajrizi.

UBT tashmë është vlerësuar nga shumë organizata prestigjioze nga Evropa dhe bota, duke dëshmuar edhe një herë liderhipin institucional dhe universitar në gjithë rajonin e Evropës Juglindore.

Në Barcelona të Spanjës, në mesin e shumë institucioneve nga mbarë bota, UBT është vlerësuar nga Triple E Awards me çmimin “European Young Entrepreneurial University of the Year”.

Me këtë rast, UBT është bërë institucioni i parë në Kosovë dhe regjion, që vlerësohet me çmimin “European Young Entrepreneurial University of the Year”, për konceptet dhe strategjinë unike që ka zhvilluar, rezultatet dhe ndikimin në shoqëri, si dhe për rolin udhëheqës dhe liderhipin në shkencë, teknologji dhe inovacion.

Përmes votimit të hapur nga i

Delegacioni i "University of Northern Iowa" dhe i Bashkisë së Cedar Falls vizituan Qendrën e UBT-së në Ferizaj

Një delegacion i përbërë nga: Kryetari i Bashkisë së Cedar Falls në shtetin e Iowa-s, Rob Green, Presidenti i "University of Northern Iowa", Dr. Mark A. Nook, kryetari i Komunës së Ferizajt, Agim Aliu, Presidenti i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, zhvilluan një vizitë në Qendrën e UBT-së në Ferizaj.

Me këtë rast, delegacioni takoi studentë dhe profesorë të UBT-së, me të cilët diskutuan për marrëveshjen në mes UBT-së dhe "University of Northern Iowa", mundësi unike për shkëmbime studentore në mes dy institucioneve, si dhe për zhvillimin e mëtejshëm të partneritetit në shumë programe të tjera.

Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi u shpreh se si UBT në Ferizaj kemi inkorporuar shumë programe të ndryshme, përfshirë menaxhimin, biznesin, ekonominë, dizajnin dhe arkitekturën, fusha specifike të cilat kanë potencialin për të ndikuar në arsimimin e të rinjve.

"Ne kemi programe të ndryshme këtu në Ferizaj, që përfshijnë: menaxhmentin, biznesin, ekonominë, dizajnin, arkitekturën, që janë fusha specifike të cilat mund të bëjnë impaktin e tyre në edukimin e të rinjve. Ferizaj është një komunë me një mundësi të lartë të zhvillimit edhe përshkak të pozitës gjeografike, por edhe kampit "Bondsteel". Ne kemi histori suksesi të shumta të studentëve tanë në Ferizaj, të cilët veçse punojnë në shumë kompani lokale, por edhe



rajonale. Ne jemi duke punuar në zhvillimin e programeve të tjera të reja dhe unike për të rinjtë e kësaj komune", tha rektori Hajrizi.

Kryetari i Komunës së Ferizajt, Agim Aliu foli rreth binjakëzimit me Komunën e Cedar Falls, me ç'rast theksoi se kjo marrëveshje është e rëndësishme jo vetëm përshkak të besimit ndaj njëri-tjetrit dhe dëshirës për të ndërtuar lidhje të forta, por është veçanërisht e rëndësishme për shkak të historisë. Ai shprehi kënaqësinë e tij për përfshirjen e të rinjve në këtë marrëveshje, përmes sferës së arsimit dhe edukimit.

"Sot është një ditë e shënuar për Komunën e Ferizajt, një vizitë që është përgatitur gjatë është realizuar me një marrëveshje për bashkëpunim ose binjakëzim të dy komunave. Kjo është një shenjë jo vetëm për besimin që kemi ndaj njëri-tjetrit, e jo vetëm për ura më të fuqishme që

dëshirojmë të ndërtojmë mes nesh, por është një marrëveshje e veçantë për shkak të historisë që kemi. Jam shumë i lumtur që të rinjtë tanë do të jenë pjesë e kësaj marrëveshje, duke përfshirë fushën e arsimit dhe të edukimit", u shpreh Aliu.

Në fjalën e tij, kryebashkiaku i Cedar Falls, Rob Green vlerësoi bashkëpunimin ndërmjet dy institucioneve dhe njëherit u shpreh i mahnitur për binjakëzimin me Komunën e Ferizajt.

"Jam vërtetë i mahnitur nga kjo mundësi për të lidhur një bashkëpunim me Komunën e Ferizajt. Partneriteti që kemi krijuar këto tri vitet e fundit, mes kryetarit Aliu dhe mua, sot është formalizuar me nënshkrimin e marrëveshjes së binjakëzimit. Shpresoj që do të kemi një bashkëpunim me dekada në të ardhmen. Unë jam shumë i dhënë pas qytetarëve. Gjithashtu, jam shumë i lumtur edhe për



marrëveshjen në mes Universitetit të Iowa-s veriore dhe UBT-së", tha Green.

Drejtoreshë e Rekrutimit dhe Pranimeve Ndërkombëtare pranë "University of Northern Iowa", Dr. Kristi Marchesani, theksoi se bashkëpunimi ndërmjet dy universiteteve është një mundësi unike për të rinjtë e të dyja vendeve.

"Jeni me fat që studioni në UBT, sepse keni një rektor që ju mbështet dhe ju thotë gjithmonë po për të shtyrë proceset përpara. UBT dhe "University of Northern Iowa", tanimë kanë bashkëpunim dhe jam e lumtur që po prezantojmë diçka të tillë para juve. Jam shumë me fat që po shoh dëshirën e zjarrtë që keni për të studiuar dhe punuar. Disa prej studentëve që tashmë janë pjesë e Iowa-s punojnë në kampuse, punojnë në hulumtime me profesorë dhe janë bërë pjesë e komunitetit atje. Kjo është ëndrra

juaj dhe bëjeni atë të realizueshme", potencoi Marchesani.

Presidenti i "University of Northern Iowa", Dr. Mark A. Nook tha se bashkëpunimi me UBT-në është shumë i rëndësishëm për studentët të kuptojnë nga kultura, popuj dhe njerëz të ndryshëm.

"Ne e dimë që marrëveshja në mes UBT-së dhe Universitetit të Iowa-s veriore është shumë e rëndësishme për studentët tanë të kuptojnë nga kultura, popuj dhe njerëz të ndryshëm. Është një mundësi që studentët e Iowa-s të vijnë në UBT, të mësojnë dhe të marrin njohuri të reja, si dhe anasjelltas për studentët nga UBT të vijnë në Iowa dhe të përfitojnë eksperiencë të reja. Kjo ndihmon në bashkëpunimin e barabartë të të dy universiteteve", potencoi Nook.

UBT nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi me R.I. Group në Lecce të Italisë



Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me Presidentin e R.I. Group, Salvatore Tafuro, me qëllim të zhvillimit të edukimit, të projekteve inovative në fushën e ndërtimit modular me fokus në banim,

shëndetësi, siguri dhe energji. UBT do të vendos fushë të veçantë për studimin e ndërtimeve modulare dhe të parafabrikuara me përdorim në fushën e banimit, sigurisë, mjekësisë, energjisë, dhe do të ketë përkrahjen e kompanisë R.I. Group, në të cilën stu-

dentët me propozime konkrete do të kenë mundësi qëndrimi në kompani dhe bashkërisht do të krijojnë prototipe inovative në këtë fushë.

Të dy institucionet, UBT dhe R.I. Group, pretendojnë të ndërtojnë një qendër të përbashkët të inovacionit për këtë fushë.

Gjatë qëndrimit të tij në Itali, Rektori Hajrizi me ftesë të veçantë ka vizituar Kompaninë Globale për ndërtime modulare R.I. Group në Lecce të Italisë, me ç'rast ka parë nga afër punën, si dhe inovacionet dhe zhvillimet e fundit në këtë sektor të rëndësishëm.

Kjo marrëveshje shënon një hap të rëndësishëm në forcimin e lidhjeve ndërkombëtare të UBT-së dhe kontribuon në promovimin e bashkëpunimit për avancimin e njohurive dhe praktikave të reja në fushën e ndërtimit dhe zhvillimit të projekteve të qëndrueshme.

UBT ka nënshkruar memorandum mirëkuptimi me "University of Seoul" nga Koreja e Jugut.



Me këtë marrëveshje, UBT do të bashkëpunojë me universitetin nga Seoul nëpërmjet tre departamenteve: Instituti i Studimeve Metropolitan, Qendra për Gjeoinformatikë, si dhe Qendra për Hulumtim të Integruar Urban.

Kjo marrëveshje bashkëpunimi synon promovimin e lidhjeve të mëtejshme akademike ndërmjet dy institucioneve, përmes shkëmbimit të stafit shkencor, shkëmbim të studentëve, aktiviteteve të përbashkëta kërkimore, shkëmbim të materialeve akademike, publikime

dhe aktivitete të tjera. Këto departamente do të punojnë së bashku në zhvillimin e programeve të përbashkëta studimore dhe kërkimore, si dhe në organizimin e konferencave dhe seminareve të përbashkëta. Ky memorandum mirëkuptimi është një hap i rëndësishëm drejt krijimit të një bashkëpunimi afatgjatë midis UBT dhe "University of Seoul", duke krijuar mundësi të reja për studentët, stafin akademik dhe përfituesit e tjerë të dy institucioneve.

UBT thëllon bashkëpunimin ndërkombëtar me Fakultetin e Ndërtimit në Universitetin e Maltës

Bashkëpunimi ndërkombëtar i UBT-së po vazhdon të thellohet. Së fundmi, një nga bashkëpunimet është ai me Fakultetin e Ndërtimit në Universitetin e Maltës, përkatesisht të vetmit universitet, një vend shumë i interesant dhe atraktiv.

Kjo është zhvilluar nga takimet e COST Action në Milano dhe në Riga, nga Dekani i Fakultetit të Inxhinierisë Ndërtimore dhe Infras-

strukturës në UBT, Prof. Muhamet Ahmeti dhe prodekani i fakultetit, Prof. Visar Krelani, duke vazhduar me ligjëratat e Prof. Ruben Paul Borg, për studentët e UBT-së rreth qëndrueshmërisë së konstruksioneve.

Prof. Ruben ka qenë përgjegjës për Asociacionin e Evropian të Inxhinierëve dhe njihet për kontributin e tij në fushën e ndërtimit,

hulumtimit dhe projekteve në Evropë. Ai shprehu angazhimin e tij për të siguruar që UBT dhe Kosova të përfshihen në projekte të përbashkëta, duke përfshirë ftesën për aplikim në COST Action. Po ashtu, pritet që të vazhdojë bashkëpunimi në kuadër të programit Erasmus + dhe të ndihmojë në hyrjen e Kosovës në Asociacionin Evropian të Inxhinierëve.

Vizitat e rëndësishme u realizuan me zyrën ndërkombëtare për të krijuar bashkëpunim direkt me atë në Kosovë. Takime u mbajtën me studentët që zhvillojnë temat e tyre Master, duke ndërmarrë një bashkëpunim midis relatorëve kosovarë dhe maltezë.

U vizitua rehabilitimi i strukturave të dëmtuara nga ambienti dhe aspekti sizmik. Kjo eksperi-

encë mund të sjellë njohuri dhe mundësi për zhvillim të modeleve me materiale të reja në Kosovë. Objekti i vetëqëndrueshëm për kafshët në Malta ishte gjithashtu një pikë interesante.

Takime u zhvilluan me përfaqësues institucionale të cilët shprehën angazhimin për të ndihmuar UBT-në dhe Kosovën me projekte dhe investime në të ardhmen.

Midis UBT-së dhe UNWE-s nga Bullgaria

Nënshkruhet marrëveshja për programin e dyfishtë bachelor “Ekonomia në anglisht”

Në qytetin e mençur të UBT-së në Lipjan është nënshkruar marrëveshja për programin e dyfishtë bachelor “Ekonomia në anglisht” nga Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi dhe nga Rektori i “University of National and World Economy” (UNWE) në Bullgari, Prof. Dr. Dimitar Dimitrov, në prani të ambasadorit bullgar në Kosovë, Hristo Gudzhhev.

Në ceremoninë e nënshkrimit të marrëveshjes nga ana e UBT-së morën pjesë profesori Bekim Mar-mullaku, dekani i Fakultetit Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi në UBT, Prof. Muhamet Gërvalla dhe koordinatoresha e programit, Asoc. Dr. Kamelia Asenova.

Marrëveshja e nënshkruar mes UBT-së dhe UNWE-s konfirmon vlerësimin e lartë për cilësinë e programeve dhe kurseve të ligjruara në UBT. Programi i ri i dyfishtë bachelor “Ekonomia në anglisht” korrespondon me synimet e UBT-së për të përhapur në Kosovë praktikën më të mira ndërkombëtare dhe standardet e cilësisë në arsim.

Programi i ri i dyfishtë bachelor ndërmjet UBT-së, dhe UNWE-s



do t'u ofrojë studentëve nga të dyja vendet njohuri dhe shkathësi moderne që do t'u japin kompetenca shtesë studentëve të diplomuar. Ata do të marrin një diplomë të dyfishtë – nga UBT

dhe UNWE, e cila do t'u japë mundësinë e përfshirjes në tregun e përbashkët evropian.

“Ekosistemi UBT ndërthur arsimin, kërkimin dhe industrinë. Universiteti punon në mënyrë

aktive edhe me arsimin parauniversitar, do të thotë me shkollat. Marrëveshja e nënshkruar ofron mundësi të reja për studentët tanë nga Fakulteti i Menaxhmentit, Biznesit dhe Ekonomisë”, tha rek-

tori Hairizi. Rektori i UNWE-s, Prof. Dimitar Dimitrov, shpjegoi se universiteti me kënaqësi do të transferojë përvojën në UBT dhe anasjelltas, duke ofruar zgjidhje të problemeve ekonomike në të dyja vendet.

“Në të njëjtën kohë, ne gjithashtu kemi shumë për të mësuar nga ajo që ka arritur UBT. Bullgaria dhe Kosova kanë afërsisht të njëjtat probleme ekonomike. Dhe njohja e mirë e dy ekonomive, marrëdhëniet e mira mes kolegëve nga të dy vendet, do të lejojnë gjetjen e zgjidhjeve optimale ekonomike”, u deklarua rektori Dimitrov.

UBT është një institucion modern dhe lider i arsimit të lartë në Kosovë, i përkushtuar për të aplikuar metodologjitë dhe teknikat më të fundit të mësimdhënies, qasjet bashkëkohore të mësimdhënies dhe kërkimit në një mjedis gjithëpërfshirës, të orientuar drejt studentëve, duke aplikuar një qasje multidisiplinare që do të kontribuojë në aspektin ekonomik, social dhe zhvillimin kulturor të Kosovës.

Në UBT u zhvillua një diskutim i hapur me Shefen e Zyrës Ndërlidhëse të Greqisë në Kosovë, Heleni Vakali, dhe profesorin Dr. Nikos Panagiotou



Në Parkun Shkencor Inovativ të UBT-së në Lipjan, u zhvillua një diskutim i hapur me Ambasadorën – Shefen e Zyrës Ndërlidhëse të Greqisë në Kosovë, Heleni Vakali, dhe profesorin e mirënjohur të gazetarisë, në Universitetin “Aristotle” në Selanik, Dr. Nikos Panagiotou.

Diskutimi u përqendrua në temën: “Diplomacia dhe gazetaria paqëndruesë”, ku studentë, profesorë, profesionistë dhe të interesuar të tjerë, ndanë mendime dhe

përvoja lidhur me ndërveprimin midis diplomacisë dhe gazetarisë, dhe si këto dy fusha mund të promovojnë paqen dhe stabilitetin në kontekstin aktual global.

Ambasadorja Heleni Vakali ndau perspektivën e saj mbi rolin e diplomacisë në promovimin e dialogut dhe marrëdhënies të mira ndërkombëtare. Ambasadorja Vakali gjithashtu vuri në dukje rëndësinë e transparencës dhe komunikimit të efektshëm për të ndërtuar besimin dhe për të pro-

movuar marrëdhëniet e mira në mes vendeve.

Profesori Nikos Panagiotou, i cili është një ekspert i njohur në fushën e gazetarisë, ndau vëzhgimet e tij mbi rolin e medias në formimin e opinionit publik dhe në ndikimin e saj në politikën diplomatike. Ai theksoi se gazetarët duhet të kenë një qasje të pavarur dhe të lirë për të transmetuar informacionin në mënyrë objektive dhe të denoncojnë abuzimet apo shkeljet e të drejtave njerëzore.

UBT dhe “Sapienza University of Rome” ofrojnë diplomë të dyfishtë studimi në fushën e Agrikulturës



Studentët e programit Inxhinieria e Agrikulturës në UBT, prej tash e tutje do të kenë mundësinë që të marrin diplomë të dyfishtë edhe nga “Sapienza University of Rome”, kjo si rrjedhojë e lidhjes së bashkëpunimit ndërmjet këtyre dy universiteteve, me qëllim të ofrimit të mundësisë për studime të përbashkëta.

Programi “Dual Degree” ndërmjet UBT-së dhe “Sapienza University of Rome”, ndihmon studentët dhe stafin në ngritjen e kapaciteteve në infrastrukturë, praktikave të mira profesionale dhe në zhvillimin e

projekteve të përbashkëta të stafit në sferën e hulumtimit.

Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi dhe prorektori nga “Sapienza University of Rome”, Prof. Dr. Giuseppe Bonifazi, promovuan programin duke ftuar studentët dhe stafin që të jenë pjesë e këtij programi.

“Sapienza University of Rome” është një universitet kërkimor me seli në Romë të Italisë, si dhe është një nga universitetet më të mëdha evropiane për nga numri i studentëve dhe një nga më të vjetrit në histori, i themeluar në vitin 1303.

UBT nënshkruan memorandum bashkëpunimi me “Széchenyi István University Győr” të Hungarisë

Në vazhden e krijimit të partneriteteve të shumta vendore dhe ndërkombëtare, UBT ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me Universitetin “Széchenyi István University Győr” të Hungarisë, duke krijuar mundësi të reja në fushën e arsimit, kërkimit dhe trajnimeve.

Kjo marrëveshje synon të promovojë marrëdhëniet dhe bashkëpunim të vazhdueshëm në fushat e nxitjes së talenteve, zhvillimit të sistemeve arsimore, mësimdhënies dhe menaxhimit me ndihmën e shkëmbimeve ak-

ademike dypalëshe për të arritur përmirësimin e nivelit të arsimit dhe mësimdhënies në të dyja anët.

Qëllimi kryesor i marrëveshjes është të zhvillojë një frymë bashkëpunimi nëpërmjet programeve të studimeve afatshkurtra të studentëve jashtë vendit, shkëmbimeve të mësuesve dhe studentëve, shkëmbimeve kulturore dhe vizitave të lider-shipit nga të dyja palët kur të krijohen mundësi, për të eksploruar mundësitë për të ndarë burimet dhe materialet mësimore.

Ambasadori i Francës në Kosovë, Olivier Guérot në eventin “Meeting Diplomats” në UBT



Në kuadër të eventit të përmuajshëm “Meeting Diplomats”, në Parkun Shkencor Inovativ të UBT-së në Lipjan, qëndroi për vizitë Ambasadori i Francës në Kosovë, Olivier Guérot, me të cilin u organizua një diskutim i hapur rreth shumë çështjeve që ndërlidhen me

diplomacinë dhe angazhimin e tij në jetën politike.

Ambasadori Guérot ndau mendimet dhe përvojat e tij në fushën e diplomacisë dhe tregoi se si është angazhuar në mënyrë aktive në zhvillimin e marrëdhënies ndërkombëtare në Kosovë.

Pjesëmarrësit në takim patën mundësinë të bisedonin me ambasadorin për tema të ndryshme dhe të mësonin më shumë rreth praktikave dhe strategjive të diplomacisë moderne. Diskutimi u fokusua në lidhjet e Francës me Kosovën, ndihmën e tyre në zhvillimin e institucioneve dhe perspektivat e bashkëpunimit të ardhshëm. Takimi u zhvillua në një atmosferë të hapur dhe miqësore, duke krijuar një platformë për shkëmbim të mendimeve dhe për të pasur njohuri të reja rreth diplomacisë, kulturës, sistemit arsimor, zhvillimit të qëndrueshëm, si dhe historisë së Francës.

Falë UBT-së, Kosova vendoset në rrjetin më të rëndësishëm të Organizatës Botërore të Laboratorëve dhe Shkencës së Ndërtimitarisë - RILEM




International Union of Laboratories and Experts in Construction Materials, Systems and Structures

About Committees Publications RILEM worldwide Events MEMBERSHIP

Home > Events

Events calendar



Falë punës së pa ndalur të bashkëpunimeve dhe njohjes ndërkombëtare dhe punës shkencore ndërkombëtare të stafit të Ndërtimitarisë dhe UBT-së sukseset vazhdojnë edhe në arenën e mirëfilltë shkencore ndërkombëtare.

Në mënyrë specifike Fakulteti Inxhinieri e Ndërtimit (Ndërtimtari) dhe Infrastruktura në UBT ka arritur të vendosë Konferencën Ndër-

kombëtare të Ndërtimitarisë UBT dhe Kosovën në hartat botërore të RILEM (Unionit Ndërkombëtar të Laboratorëve dhe Ekspertëve në Materiale, Sisteme dhe Strukturat e Ndërtimit Botëror).

Tashmë RILEM ka shpërndarë thirrjen në anëtarët e saj në mbarë botën: Japonia, Australia, Brazili, Amerika, Evropa, Azia e Afrika, duke pritur pjesëmarrje ndërkombëtare

që të jetë edhe më e lartë edhe me të ftuarit që UBT tashmë ka traditë edhe në pritjen e tyre dhe vazhdimin e zhvillimit të shkencës dhe arsimin, jo vetëm në Kosovë, por edhe në rajon.

Datat e pranimit të abstrakteve do të vazhdojnë deri më 15 shtator 2023. Kosova ka arritur edhe një sukses tjetër në arenën ndërkombëtare duke u renditur në listën e shteteve

kontribuuese në RILEM, që do të ofrojë kontribut dhe ndihmë në zhvillim të fushës së ndërtimit dhe në Komitete specifike Teknike (Technical Committee), kjo me mbështetjen e Rektorit të UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, të Drejtorit dhe Dekanit, Prof. Muhamet Ahmeti, dhe me iniciativën e prodekanit të Inxhinierisë së Ndërtimit dhe Infrastruktura, Dr. Visar Krelani.

Kontribut të padiskutuar kanë dhënë të gjithë pjesëmarrësit në Konferencën e Ndërtimitarisë në UBT, duke filluar nga Prof. Liberato Ferrara (Itali), Prof. Jorge Isidoro (Portugali), Prof. Martins Vilintis (Letoni), Prof. Bruno Dal Lago (Itali), Prof. Marco Breccolotti (Itali), Prof. Romildo Toledo (Brazil), Prof. Peter Kopacek (Austri), si dhe të gjitha rrjetet dhe partnerët ndërkombëtarë të UBT-së.

RILEM njihet si Unioni Ndërkombëtar i Laboratorëve dhe Ekspertëve në Materiale, Sistemet dhe Strukturat e Ndërtimit, u themelua në qershor të vitit 1947, me qëllim të promovimit të bashkëpunimit shkencor në fushën e materialeve dhe strukturave të ndërtimit. Sot, kuptimi i ri i akronimit RILEM (Réunion Internationale des Laboratoires et Experts des Matériaux, systèmes de construction et ouvrages) ka fokusin e tij dhe favorizojnë dhe promovojnë bashkëpunimin në

shkallë ndërkombëtare me qasje të përgjithshme në njohuri të avancuara si:

- të stimulojë drejtime të reja të kërkimit dhe hulumtimit, duke promovuar përsosmërinë në ndërtim;
- të promovojë ndërtim të qëndrueshëm dhe të sigurt, dhe
- performanca të përmirësuar dhe përfitim në kosto për shoqërinë.

Misioni i unionit është të avancojë njohuritë shkencore me qasje të lirë në lidhje me materialet, sistemet dhe strukturat e ndërtimit dhe të inkurajojë transferimin dhe zbatimin e kësaj njohurie në mbarë botën.

Sa i përket temës specifike që merret me betonin e armuar atëherë Komiteti Teknik 87-CCS merret me Analizën e gjerësisë së plasaritjeve të hershme dhe afatgjatë në strukturat e betonit të armuar. Anëtarët e këtij komiteti janë nga vende, si: Amerika, Kina, Australia, Franca, Britania e Madhe, Austria, Italia, Portugalia, ku tanimë edhe Kosova është anëtar dhe UBT njihet edhe si pjesë zyrtare duke përfaqësuar Kosovën.

Vazhdimësia e investimit të UBT-së dhe udhëheqjes së saj në ndërkombëtarizim po ashtu ka ndikim të lartë pasi që tashmë konsiderohet partner i besueshëm në bazë të punës së saj në fushën e Inxhinierisë në përgjithësi dhe në Inxhinierinë e Ndërtimit në veçanti.

Rektori Hajrizi prezanton në Romë projektet e fundit inovative të UBT Smart City

Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, po merr pjesë në Forumin e 16-të të ENSA - Rrjetit të Universiteteve Evropiane për Shkencat e Sportit, me ftesë të Presidentit të Asociacionit për Edukimin në Shkencat Sportive, Prof. Antonio Tessitore.

Rektori Hajrizi prezantoi disa prej projekteve inovative që po zhvillohen në UBT, në bashkëpunim edhe me partnerë të njohur ndërkombëtar, lidhur me përdorimin e inteligjencës artificiale për edukim, analizat shëndetësore, si dhe trajtimin e plakjes.

Për zgjidhjen e problemeve të sotme komplekse njerëzit e kanë mëse të nevojshme të bashkëprojnë me teknologjinë. UBT

Smart City si një ekosistem inovativ i mençur dhe i vetqëndrueshëm prezanton një laborator real të çështjeve komplekse dhe të konvergencës, duke testuar në kohë reale dhe me teknologjitë më bashkëkohore, duke përfshirë këtu edhe inteligjencën artificiale në impaktin në përmirësimin e cilësisë së jetës dhe të ambientit në përgjithësi. Këto projekte janë vetëm disa prej qindra projekteve zhvillimore që po ndodhin paralel në UBT Smart City duke shtuar besimin se cilësia e jetës do të përmirësohet.

UBT është modeli i parë i një qyteti të mençur i kompletuar në Kosovë dhe në rajon dhe një prej të parëve në botë. Modeli i konceptuar dhe zhvilluar nga Rektori Hajrizi me



ekipin e tij ka hasur në një interesim dhe vlerësim të madh në botë. Rektori Hajrizi është ftuar në më

shumë se njëzetë vende të botës për të prezantuar idetë dhe modelin e UBT-së, i cili deri më tani

ka marrur çmimet dhe rangimet në Evropë dhe botë për inovacion, teknologji, ekselencë, ndërmarrësi, edukim dhe zhvillim të qëndrueshëm.

UBT Smart City i cili reprezenton ndërlidhjen e teknologjive moderne, njeriut nga të gjitha gjeneratat dhe infrastrukturën me funksionet e një qyteti të mençur, po konfirmim se si jetohej në një qytet modern dhe të mençur, ku qytetarit i plotësohen nevojat e veta jetësore në një hapësirë që mbulon dhjetë minuta ecje.

Me këtë UBT tenton të krijojë dije dhe praktika të mira për të vazhduar në përkrahjen e qyteteve në implementimin e modeleve të tilla në Kosovë dhe në botë.

Rektori Hajrizi prezantoi ekosistemin inovativ UBT Smart City në Konferencën Ndërkombëtare - ICONSR 2023 në Budva

Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi mori pjesë si folës kryesor i edicionit të gjashtë të Konferencës Ndërkombëtare "International Conference on Social Science Research - ICONSR 2023", në Budva të Malit të Zi, në të cilën morën pjesë një audiencë e gjerë akademikësh, shkencëtarësh dhe profesionistësh nga rajoni dhe bota.

Rektori Hajrizi ka prezantuar një temë të veçantë që lidhet ngushtë me vizionin e tij për inovacionin dhe zhvillimin në teknologji, e titulluar: "Small Scale smart self-sustainable innovation based ecosystem as platform for future education, research and development. Case UBT Smart City".

Në prezantimin e tij, Rektori Hajrizi shpalosi konceptin e një qyteti të mençur, si dhe ka shpjeguar detajisht vizionin e tij rreth krijimit të një ekosistemi inovativ që



përdor teknologjinë e mençur për të mbështetur arsimin.

Përmes rastit konkret të projektit UBT Smart City, ai ka ilustruar se si teknologjia e avancuar dhe inovacioni mund të shërbejnë si

themele për zhvillimin e qyteteve të mençura, ku teknologjia ndikon në përmirësimin e cilësisë së jetës dhe ndryshimin e dinamikave të arsimin.

Avancim edhe një hap në fushën e sigurisë kibernetike

UBT akreditohet nga organi më i madh në botë i certifikimit për siguri kibernetike "EC-Council"



Si institucion lider i zhvillimeve të teknologjisë dhe inovacionit - UBT edhe zyrtarisht është institucion partner akademik i organit më të madh të certifikimit teknik të sigurisë kibernetike në botë "EC-Council".

Të gjithë studentët e UBT-së do të kenë një mundësi unike për

të avancuar njohuritë e tyre në fushën e sigurisë kibernetike, përmes UBT-së dhe EC-Council, institucion ky që operon globalisht në më shumë se 145 vende, duke certifikuar mbi 300 mijë profesionistë të sigurisë së informacionit në mbarë botën. Partneriteti i UBT-së dhe EC-Council do t'i ofrojë studentëve trajnimet dhe certifikimet më të avancuara të fushës së sigurisë kibernetike, siç janë: Certified Ethical Hacker (C|EH), Certified Penetration Testing Professional (C|PENT), Certified Cloud Security Engineer (C|CSE) dhe Certified DevSecOps (E|CDE).

Anëtarësimet në organizata dhe institucione ndërkombëtare të arsimit

UBT i bashkohet rrjetit të 153 universiteteve nga 25 shtete të ndryshme të anëtarësuara në UNIMED

28/03/2023. Në vazhden e shumë anëtarësimeve në organizata dhe institucione ndërkombëtare të arsimit dhe jo vetëm, UBT së fundmi i është bashkuar rrjetit të 153 universiteteve nga 25 shtete të ndryshme të botës, si anëtar i më i ri i Unionit të Universiteteve Mesdhetare (UNIMED – Mediterranean Universities Union).

Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, me rastin e anëtarësimit të UBT-së në Unionin e Universiteteve Mesdhetare të cilat vijnë nga shtete të ndryshme të Evropës, ka thënë se institucioni të cilin ai e udhëheq fuqishëm po dëshmon promovim



in e Kosovës në arenën ndërkombëtare në organizata të ndryshme të arsimit dhe shkencës.

“Anëtarësimi i UBT-së në Unionin e Universiteteve Mesdhetare –

UNIMED, është një lajm shumë i mirë për të gjithë ne, mbi të gjitha për Kosovën. Kjo pasiqë përmes këtij anëtarësimi po dëshmojmë se Kosova ka mekanizma dhe se UBT

ka cilësinë e nevojshme për të qenë krahë institucioneve më prestigjioze evropiane mesdhetare”, ka thënë rektori Hajrizi. Ky anëtarësim mundëson bash-

këpunimin e UBT-së me institucione dhe universitete të tjera në fusha të ndryshme në zonën euro-mesdhetare, duke përfshirë fushën shkencore, kulturore, sociale dhe ekonomike.

Unioni i Universiteteve Mesdhetare (UNIMED – Mediterranean Universities Union) i themeluar që nga vitet e 90-ta, numëron mbi 150 universitete nga 24 vende të ndryshme të Evropës dhe Mesdheut, e që ka për synim kërkimin dhe edukimin universitar në zonën euro-mesdhetare për të kontribuar në bashkëpunimin shkencor, kulturor, social dhe ekonomik.

Për Kosovën në Vatikan

Përmbyll punimet Konferenca “Kosova - Past, Present and the Future”



Me një koncert në “Saint Stephen of the Abyssinians Church” në Vatikan, kori Kardinal Bartolucci dhe Sopranoja nga Kosova, Adelina Palloja, përmbylli suksesshëm punimet Konferenca “Kosova - Past, Present and the Future”, ku u bën bashkë figura të shquara nga Kosova, diaspora dhe bota.

Gjatë punimeve të konferencës, u diskutuan temat e rëndësishme që lidhen me të kaluarën e Kosovës,

duke përfshirë ngjarjet historike, kulturën, trashëgiminë, si dhe u trajtuan çështjet aktuale si integrimi në strukturat ndërkombëtare, zhvillimi ekonomik, e drejta dhe përfaqësimi politik i popullit kosovar.

Pjesëmarrja e personaliteteve të shquara nga Kosova dhe diaspora, si dhe përfshirja e komunitetit ndërkombëtar, dha një ndjenjë të fuqishme bashkëpunimi dhe solidariteti për të ardhmen e Kosovës.

Punimet e Konferencës “Kosova - Past, Present and the Future” shfaqin një hap të rëndësishëm drejt promovimit të Kosovës dhe zgjerimit të rolit të saj në skenën ndërkombëtare.

Në Konferencë u prezantua Kosova dhe vlerat e saj në relacion me paqen dhe vlerat humane, teksa u bë thirrje që Vatikanin të njeh Kosovën.

Ky eveniment i suksesshëm shënon një moment të rëndësishëm për Kosovën dhe frymëzon shpresë për të ardhmen e ndritur të vendit.

Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi dhe pjesëmarrësit e tjerë të kësaj konference vizituan arkivin e Vatikanit, me çrast patën rastin të njihet për së afërmi me punën dhe potencialin e arkivit, e cila paraqet një vëllim mbi 80 km të gjatë. Ata u njoftuan me dokumente të rëndësishme në të cilat kishte edhe nga to që shkruanin për Gjergj Kastriot Skënderbeun dhe Nënë Terezën.

UBT CERT - organizata e parë nga Kosova në “Trusted Introducer”



27/02/2023. Ekipi i reagimit emergjent kompjuterik i UBT-së “UBT CERT”, është rikonfirmuar si organizata e parë nga Kosova që është e akredituar në organizatën

ndërkombëtare “Trusted Introducer”.

Kjo organizatë koordinon dhe menaxhon ekipet e CERT në gjithë botën, dhe UBT CERT është një prej organizatave që është akredituar në IT si rezultat i plotësimit të kriterëve të kërkuara në aspektin administrativ dhe në infrastrukturën ligjore e teknike.

UBT CERT funksionon në kuadër të UBT-së dhe Qendrës për Siguri Kibernetike dhe Privatësi (QSP) dhe ka për synim zhvillimin e ekipit të ekspertëve të sigurisë kibernetike, që do të jenë të gatshëm në përballje, trajtim, analizë dhe dhënie të rekomandimeve për incidentet, rastet e sigurisë kibernetike për sektorin akademik, privat dhe publik.

UBT ndau rreth 200 bursa për studentët e dalluar dhe thirrjet akademike në shënim të Ditës së Pavarësisë

21/02/2023. Në Parkun Shkencor Inovativ të UBT-së në Lipjan, u bë ndarja e bursave për rreth 200 studentë të dalluar të të gjitha drejtimeve në UBT, si dhe u bë ndarja e thirrjeve akademike në shënim të pesëmbëdhjetë vjetorit të Pavarësisë së Kosovës.

Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi uroi studentët për Ditën e Pavarësisë së Kosovës, njëherit i përgëzoi ata për suksesin e arritur përgjatë studimeve.

“Ju jeni ambasadorët e rinj të UBT-së dhe ardhmëria e Kosovës. Duhet të vazhdoni të punoni dhe angazhoheni për t'i arritur qëllimet tuaja. Ne filluam rrugëtimin tonë akademik për të bërë diçka ndryshe, për të kontribuar në krijimin e një brezi të ri, të shkolluar e akademik, që Kosovës do t'i dalin zot, e do e udhëheqin në të ardhmen në procese dhe fusha të ndryshme”, u shpreh rektori Hajrizi. Drejtori për Çështje Akademike në



UBT, Muhamet Ahmeti, përgëzoi studentët për arritjet e tyre përgjatë studimeve duke iu dëshiruar atyre një rrugëtim të suksesshëm akademik dhe profesional.

Me vendim të Këshillit Akademik të UBT-së, rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi në konfirmoi edhe thirrjet akademike për profesorë të UBT-së, të cilët me kontributin e tyre po edukojnë gjeneratën të tëra të profesionistëve të rinj në më shumë se 50 fusha të studimit.

Vazhdon bashkëpunimi i UBT-së me University of Cambridge



UBT është duke vazhduar bashkëpunimin e frytshëm me University of Cambridge, në kuadër të Qendrës për Simulimin e Politikave Publike, ku si rezultat i këtij bashkëpunimi me Centre for Resilience and Sustainable Development, University of Cambridge, është arritur kristalizimi i simulimit bazuar në studimin me temë: “Cambridge Pol-

icy Boot Camp (CPBC) on Feeding Children Nutritiously for Kosovo”. Realizuar nga grupi punues, stafi akademik i UBT-së, së bashku me grupin punues të Cambridge International, parashihet që në muajin nëntor të përfundohet simulimi i këtij studimi, përpara target grupeve të ndryshme të politik bërjes në Kosovë.

Qendra “Cambridge Public Policy Simulation Lab” përdorë një qasje sistematike dhe gjithëpërfshirëse, duke qenë kështu e para e këtij lloji, jo vetëm në Kosovë apo në rajonin e Ballkanit, por në të gjithë Evropën Juglindore.

Duke kombinuar metodologjitë, platformat dhe njohuritë që janë zhvilluar ndër vite nga University of Cambridge, si dhe sistemet inovative me një ekspertizë të lartë dhe ndërdisiplinore që ka ndërtuar UBT, me fokus në rolin e qeverisë në Kosovë, kjo qendër synon ngritjen e vlerave, cilësisë së politikave publike, cilësinë e jetesës, konkurrencën, vendet e punës, inovacionin, teknologjinë, digjitalizimin, si dhe të gjitha kompetencat kryesore të politikave publike.



Kosova anëtarësohet në Federatën Ndërkombëtare të Mjekësisë Sportive

Kosova ka arritur të anëtarësohet në Federatën më të madhe Ndërkombëtare të Mjekësisë Sportive. Me përkrahjen e mbështetjen e UBT-së është themeluar “Association of Sports and Exercise Medicine”, e cila është e vetmja organizatë nga Kosova e cila është anëtarësuar në Federatën Ndërkombëtare të Mjekësisë Sportive, duke e radhitur kështu Kosovën në mesin e më shumë se 117 vendeve që bëhen pjesë e kësaj shoqate.

Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, ka thënë se anëtarësimi i “Kosovo Association of Sports and Exercise Medicine” në Federatën Ndërkombëtare të Mjekësisë Sportive (FIMS) është një vlerë e shtuar dhe tejet e madhe për gjithë vendin. “Mjekësia Sportive është një fushë shumë e rëndësishme që luan një

rol kyç në aftësinë fizike, trajtimin dhe parandalimin e lëndimeve që lidhen me sportin dhe stërvitjen. Ky anëtarësim në Federatën Ndërkombëtare të Mjekësisë Sportive është një hap shumë i rëndësishëm i Kosovës drejt zhvillimit të mjekësisë sportive në Kosovë, dhe UBT përmes Fakultetit të Shkencave Sportive do të jap kontribut të vazhdueshëm për promovimin e saj”, ka thënë rektori Hajrizi.

Federata Ndërkombëtare e Mjekësisë Sportive (FIMS) është shtëpia e katër shoqatave kontinentale të Mjekësisë Sportive dhe e 117 shoqatave kombëtare të Mjekësisë Sportive në mbarë botën që ka bashkuar më shumë se 125.000 mjekë sportivë, duke u angazhuar fuqishëm në promovimin e zhvillimit të Mjekësisë Sportive.



Ish-studenti i UBT-së, Arbër Salihu fitues i vendit të parë në Festivalin e Këngës në RTK

Me një performancë të mrekullueshme, zë të bukur dhe interpretim emocional, ish-studenti i Fakultetit Muzika Moderne, Prodhimi Digjital dhe Menaxhimi në UBT, Arbër Salihu zuri vendin e parë në Festivalin e Këngës në Radio Televizionin e Kosovës.

Me këngën "Oj Kosovë", Arbër Salihu tashmë i njohur artistikisht si La Fazani, shkroi historinë e edicionit të parë të Festivalit Këngës në RTK, duke marrë trofeun me simbolin e Kosovës që shkëlqen, si dhe medaljoni me shqiponjën e flamurit kombëtar.



La Fazani fitoi njëherit edhe Çmimin e Kryeqytetit.

Në këtë edicion mori pjesë edhe studentu Auron Deva me këngën "Çmimi i dashnisë", përmes së cilës tregoi përkushtimin, pasionin dhe talentin e tij për muzikën.

Arbëri dhe Auroni janë frymëzim për të rinjtë në Kosovë, të cilët dëshirojnë të ndjekin ëndrrat e tyre në fushën e muzikës. UBT është krenar me studentët të cilët me punë dhe angazhim arrijnë të bëhen fitimtarë dhe të shkruajnë histori të jashtëzakonshme për veten dhe vendin.

Skulptura e shfaqur në Festivalin e Këngës në RTK u punua nga profesori i UBT-së, Burim Berisha dhe studentët Ndriçim Hakiu dhe Gent Ademaj

03/11/2023. Skulptura e shfaqur në Festivalin e Këngës në Radio Televizionin e Kosovës (RTK) është një krijesë artistike e punuar me pasion dhe kreativitet nga një ekip i përbërë nga profesori i UBT-së, Burim Berisha, së bashku me dy studentët e talentuar të Fakultetit Art dhe Media Digjitale në UBT, Ndriçim Hakiu dhe Gent Ademaj, si dhe Arbias Berisha.

Ky projekt është një shembull i bashkëpunimit ndërmjet profesorëve dhe studentëve në krijimin e veprave artistike të mrekullueshme. Skulptura, e cila është shfaqur në një ngjarje të rëndësishme kulturore si Festivali i Këngës, shënon



përpjekjet dhe talentin e tyre të përbashkët në botën e artit dhe kulturës. Përmes kësaj skulpture, ata kanë arritur të bëjnë një kontribut të rëndësishëm në promovimin e artit dhe kulturës në Kosovë.

Ky sukses është një shembull frymëzues për të rinjtë dhe të gjithë ata që janë të apasionuar ndaj artit dhe krijimtarisë, duke treguar se bashkëpunimi dhe pasioni mund të sjellin vepra të mrekullueshme që shpërndahen në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, duke rritur kështu ndikimin dhe promovimin e kulturës së Kosovës.

Arbër Mazrekaj punësohet në UBT

Ish-studenti i Fakultetit Shkenca Kompjuterike dhe Inxhinieri në UBT, Arbër Mazrekaj pas suksesit të arritur përgjatë studimeve në nivelin bachelor është punësuar në UBT, dega Pejë, në pozitën e IT-së.

Ish-studenti, Arbër Mazrekaj ka vlerësuar se periudha e studimeve në UBT ka qenë e shkëlqyer dhe se e ka ndihmuar në procesin e përgatitjes profesionale, gjë e cila ka bërë të mundur edhe punësimin e tij. "Gjatë studimeve në UBT kam pasur një përvojë të shkëlqyeshme dhe më ka ndihmuar shumë në procesin e përgatitjes profesionale. E veçanta e UBT-së është se pas studimeve studentët janë të gatshëm për tregun e punës dhe përkrahja e stafit akademik në këtë proces është e madhe. Personalisht në UBT kam pasur mundësi që të



rrisë njohuritë dhe aftësitë e mia në fushën e shkencave kompjuterike dhe besoj që është zgjedhje e duhur për secilin student potencial që ka për synim zhvillimin profesional", ka thënë Mazrekaj. Rreth 98 për qind e studentëve të Fakultetit Shkenca Kompjuterike dhe Inxhinieri në UBT tashmë janë të punësuar në kompani të ndryshme vendore dhe botërore, duke dëshmuar kështu arritjet e tyre profesionale dhe akademike.

Studentja Anita Havolli punësohet në "TEB Bank"



Njihuni me Anita Havollin, një Alumni e dalluar nga programi ynë i Menaxhimit të Patundshmërive në UBT, tani duke

korrur suksese si Specialiste e Vlerësimit të Kolateralit në TEB Bank në Kosovë! "Zgjedhja e programit të patundshmërive ishte një vendim personal për një mundësi të re në sektorin privat, konkretisht në patundshmëri. Sot me krenari them se studimet në këtë program më ndihmuan të vazhdoj karrierën time në TEB Bank. Unë rekomandoj programin Menaxhim i Patundshmërive dhe Infrastruktura për të gjithë sepse ka qenë zgjedhja më e mirë për mua dhe jam e sigurt se do të jetë edhe për të tjerët, pasi fokusi kryesor i programit është fuqizimi ynë!", shprehet Anita.

Studentja Sihana Metrama punësohet në studion e arkitekturës "Maden Group"



Studentja e nivelit master në programin Arkitekturë dhe Planifikim Hapësinor në UBT, Sihana Metrama pas suksesit të arritur përgjatë studimeve në nivelin bachelor është punësuar në cilësinë e arkitektes në studion e arkitekturës, ndërtimit dhe diza-

nit të enterierit "Maden Group". Mbështetja dhe angazhimi i profesorëve, infrastruktura moderne e UBT-së, si dhe kurrikula e veçantë e programit Arkitekturë dhe Planifikim Hapësinor, sipas studentes Sihana Metrama, kanë qenë ndër pikat kryesore të formimit të saj si arkitekte.

"Rrugëtimi i përbashkët me studentët e tjerë të të njëjtit program, si dhe ndikimi dhe mbështetja e profesorëve të kualifikuar përgjatë studimeve të mia akademike, më kanë ndihmuar në zgjerimin e njohurive përmes bashkëpunimit konstruktiv, teknikave dhe përvojës së tyre shumëvjeçare", ka thënë Metrama.

Sihana ka vlerësuar se ka përfutur shumë nga eksperiencat e ndryshme përgjatë studimeve bachelor, sikurse vizitat studimore, punëtoritë në kuadër të lëndëve praktike, ligjëratat tematike nga profesorë ndërkombëtarë, si dhe pjesëmarrja në konferenca e forume të ndryshme rreth fushës së arkitekturës.

"Përveç ngritjes akademike, UBT më ka ofruar eksperiencë nga më të ndryshmet, të cilat i kanë karakterizuar studimet e mia akademike dhe i kanë bërë ato të rëndësishme për rrugëtimin tim si arkitekte", është shprehur ajo.

Studentja Kosovare Brahimi punësohet në kompaninë "Vintage Architecture"



Ditën Ndërkombëtare të Gruas e shënojmë me një histori suksesi të studentes së Fakultetit Arkitekturë dhe Planifikim Hapësinor në UBT, Kosovare Brahimi, e cila falë rezultateve të arritura përgjatë studimeve është punësuar në kompaninë "Vintage Architecture", ku merret me projekte për

partnerët e kësaj kompanie në Zvicër. Studentja Kosovare Brahimi ka vlerësuar se të studiosh në UBT është krenari dhe përgjegjësi e veçantë, teksa ka theksuar se mbështetja e stafit akademik për arritjen e qëllimeve profesionale nuk ka munguar asnjëherë. "Studimet dhe infrastruktura me

standardet evropiane në UBT më kanë rritur profesionalisht në atë nivel sa për të përfaqësuar denjësisht, jo vetëm kompaninë ku punoj, por edhe Kosovën, me projekte të ndryshme në shtetin zvicerian. U jam përzemërsisht falënderuese profesorëve dhe UBT-së në përgjithësi si institucion për mbështetjen e rezervë", ka thënë Brahimi. Shumica e studentëve të programit Arkitekturë dhe Planifikim Hapësinor në UBT, tashmë janë të punësuar në kompani dhe institucione të ndryshme në nivel vendi dhe rajoni, duke dëshmuar kështu cilësinë dhe mbështetjen e UBT-së.

Studentja Engji Goga është punësuar në kompaninë "Shpik"

Studentja e Fakultetit Sisteme të Informacionit dhe Menaxhment në UBT, Engji Goga, është punësuar në cilësinë e "Office Manager" në kompaninë "Shpik", ku ofron ndihmën për menaxhimin e operacioneve të përditshme, organizimin dhe mbikëqyrjen e ngjarjeve dhe trajtimeve, si dhe detyra administrative.

Studentja Engji Goga ka vlerësuar se në UBT përmes mbështetjes së stafit akademik dhe administrativ, por edhe bashkëpunimit me studentët e tjerë, ka arritur të avancohet profesionalisht dhe kjo i ka ndihmuar që të jetë e gatshme për punësim dhe për karrierë. "Në përvojën time personale, të

studiosh në UBT ka qenë një vendim fantastik. Si studente e Sistemeve të Informacionit, kam pasur mundësinë të mësoj nga profesorë dhe ekspertë të lëndës së tyre. Ata më kanë sfiduar të mendoj në mënyrë kritike dhe krijuese për problemet komplekse dhe më kanë inkurajuar të ndjek interesat dhe idetë e mia", ka thënë ajo. Ndër të tjera, studentja Goga ka theksuar se UBT i ka dhënë mundësinë të marr pjesë në një sërë aktiviteteve jashtë-kurrikulare, në ngjarje verore për t'u lidhur me profesionistë të fushës, si dhe për të mësuar rreth tendencave dhe praktikave më të fundit të industrisë.

Ish-studenti Blendi Haziri është punësuar në kompaninë “Digitnest LLC”



Ish-studenti i Fakultetit të Sistemeve të Informacionit në UBT, Blendi Haziri falë përgatitjes profesionale dhe akademike në UBT është punësuar në kompaninë

“Digitnest LLC”, në pozitën e kontabilistit.

“UBT ka ofruar kushte bashkëkohore të studimit, trajtim dinjitoz kolegial, qasje në informacionet më të reja të shkencës përmes një infrastrukture moderne dhe zhvillim të mëtutjeshëm përmes mbështetjes së stafit akademik dhe administrativ”, ka thënë ish-studenti Haziri.

Ndër të tjera, ai ka theksuar se mënyra e ligjërimit të profesorëve ekspertë të fushës, si dhe

lidhja e teorisë me praktikën kanë bërë që të përgatitet profesionalisht dhe të jetë i gatshëm për tregun e punës.

Shumica e studentëve të UBT-së, përkatesisht studentët e programit Sisteme të Informacionit, janë të punësuar në institucione publike dhe private brenda dhe jashtë vendit, duke dëshmuar cilësinë dhe vlerat arsimore dhe edukative të marra përmes UBT-së.

Studenti Muhamet Azizi themelues i “M Real Estate”



Njihuni me Muhamet Azizin, CEO i “M Real Estate”, dhe një student i dalluar i programit tonë Menaxhim i Patundshmërive dhe Infra-

strukturë! “Programi Menaxhim i Patundshmërive dhe Infrastrukture më ndihmoi shumë në zhvillimin tim profesional në industrinë e patundshmërive. Mësimet praktike dhe të kuptueshme, si dhe aktivitetet e kryera gjatë studimeve të mia, ishin kyçe në formësimin e karrierës sime. Tani, si CEO e shoh vlerën e vërtetë të arsimit tim”, ka thënë Muhameti.

Studenti Erion Mecini koordinator në Fakultetin e Infermierisë

Studenti i Fakultetit Shkenca Politike në UBT, Erion Mecini është punësuar në UBT, si koordinator në Fakultetin e Infermierisë, me ç’rast angazhohet në mbështetjen e studentëve në zhvillimin e tyre akademik, udhëzimin në projektet e tyre dhe koordinimin e lëndëve.

Studenti Erion Mecini ka theksuar se UBT i ka ofruar një ambient përkrahës dhe motivues. Për të, ky ambient ka qenë katalizatori që e ka ndihmuar në kalimin nga ambienti uni-

versitar në botën e punës. Ai ka shprehur se ka pasur shumë mundësi për zhvillim personal dhe profesional, duke theksuar se UBT ka qenë një platformë e pasur në ofrimin e këtyre mundësive.

“UBT më ka ofruar një ambient përkrahës dhe motivues, dhe me këtë rast më ka ndihmuar për t’u bërë pjesë e botës së punës. Gjithashtu, ka pasur shumë mundësi për zhvillim personal dhe profesional”, ka thënë Mecini.

Studentja Kaltrina Hoxha është punësuar në Fabrikën “Flota”



Studentja e nivelit master në Fakultetin e Shkenca dhe Teknologjia e Ushqimit në UBT, Kaltrina Hoxha, pas rezultateve të suksesshme të arritura përgjatë studimeve si në nivelin bachelor edhe atë master,

është punësuar në Fabrikën për Përpunimin dhe Konservimin e Frutave dhe Perimeve “Flota Sh.P.K”, në pozitën e udhëheqëses së procesit të prodhimit të turshive.

Kaltrina Hoxha ka vlerësuar se studimet në UBT kanë qenë të dobishme dhe e kanë ndihmuar atë të formësohet profesionalisht, falë edhe përkrahjes dhe mbështetjes së rezervës të stafit akademik dhe atij administrativ.

“Përzgjedhja e studimeve të nivelit bachelor dhe tani në vazhdim në nivelin master në UBT ka qenë një ndër hapat më të rëndësishëm që kam ndër-

marrë për të arritur në profesionin tim si teknologe e Ushqimit. Njohuritë arsimore që mora nga profesorë profesionistë të fushës, praktikat e shumta të aplikuara në laboratorët e UBT-së, më kanë ndihmuar që unë sot të jem një profesioniste në drejtimin tim”, ka thënë ajo. Përgjatë studimeve bachelor, studentja Kaltrina Hoxha ka treguar se ka përfunduar edhe praktikën profesionale në Berlin, gjegjësisht në Institutin “IASP”, i cili merret me hulumtime dhe analiza të produkteve ushqimore.

Nga UBT në Amerikë, Ish-studentja Marigona Gashi punësohet në “James Madison University”

Ish-studentja e Fakultetit Arkitekturë dhe Planifikim Hapësinor në UBT, Marigona Gashi është punësuar si asistente në departamentin e mjedisit dhe qëndrueshmërisë në Universitetin “James Madison” në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Pozicioni si asistente i ofron mundësinë për të punuar në fushën e arsimit të lartë dhe për të ndihmuar profesorët dhe studentët në detyrat akademike. Marigona në të njëjtën kohë ka filluar punën si koordinatorë e qëndrueshmërisë në një kompani në New York.

Ish-studentja e Arkitekturës dhe Planifikimit Hapësinor në UBT, ka thënë se përvoja e saj në UBT ka qenë e frytshme dhe i ka dhënë asaj një bazë të qëndrueshme për zhvillimin profesional.

“Përvoja në UBT ishte e frytshme dhe më ofroi një bazë të qëndrueshme për zhvillimin tim personal dhe profesional. Kurdo që kam pasur nevojë për ndihmë dhe këshilla, profesorët dhe sta-



fi akademik ishin gjithmonë të gatshëm për të më ndihmuar. Njëpërmjet projekteve dhe punës së grupit, u mora me sfida akademike të cilat më ndihmuar të zhvillojë aftësitë dhe të përfitojë njohuri të reja në fushën time të interesit”, ka thënë Gashi.

Për Marigonën studimet në UBT kanë qenë të veçanta për faktin e përqendrimit të tyre në zhvillimin praktik dhe profesional të studentëve, duke përjetuar situata reale dhe duke fituar njohuri të nevojshme për tregun e punës. “Studimet në UBT janë të veçanta për shkak të përqendrimit të

tyre në zhvillimin praktik dhe profesional të studentëve. Profesorët dhe stafi akademik janë të përkushtuar në të siguruar një mjedis mësimor të stimulueshëm dhe në të ndihmuar studentët të zhvillojnë aftësitë e tyre praktike. Përmes projekteve të vërteta dhe bashkëpunimit me komunitetin dhe industrinë, studentët kanë mundësinë të përjetojnë situata reale dhe të fitojnë njohuri të nevojshme për tregun e punës”, është shprehur ajo.

Marigona ka qenë e përzgjedhur si një nga dhjetë finalistet e Fondit Madison Trust, në të cilin ka prezantuar idenë e saj “Think outside the trash”, një ide për të implementuar procesin e riciklimit në Kosovë dhe për të edukuar brezat e rinj për rëndësinë e riciklimit përmes aktiviteteve të ndryshme.

Së fundi, ajo ka qenë e ftuar të flas në një mbledhje “Morning prayers”, ku kam pasur rastin të përfaqësoj Kosovën.

Studenti Enis Buca është punësuar në firmën “RC Cola Kosova”



Studenti i nivelit master në programin Shkenca dhe Teknologjia e Ushqimit në UBT, Enis Buca pas rezultateve të suksesshme përgjatë studimeve dhe arritjen e njohurive të nevojshme, është punësuar në firmën “RC Cola Kosova”, ku e bën punën e mirëmbajtësit të procesit të prodhimit, duke filluar nga sigurimi i sigurisë së produkteve finale dhe sigurimi i kualitetit. Enis Buca ka vlerësuar se studimet akademike në UBT kanë qenë të duhura dhe të dobishme për arsye se ka përfituar bazamentin e njohurive në lidhje me shkencat e ushqimit dhe përvoja të paharrueshme me kolegë. “Studimet në UBT i bën të veçanta hapësira e madhe që u jepet

studentëve përmes një infrastrukture moderne për praktikë, si dhe kurrikula multidisiplinare që përfshin edhe teorinë. Ndër të tjera, UBT ofron edhe mundësi për praktika profesionale në kompani vendore e ndërkombëtare për të avancuar njohuritë tonë rreth fushës së studimit, duke dëshmuar kështu cilësi dhe lidhshmëri në arsim”, ka thënë ai. Shumica e studentëve të programit Shkenca dhe Teknologjia e Ushqimit janë ambientuar lehtësisht në tregun e punës, duke bërë që numri i profesionistëve dhe ekspertëve të këtij drejtimi që janë diplomuar në UBT t’i kontribuojnë Kosovës në mënyrën më të mirë të mundshme.

Studentja Sara Preniqi po punon si koordinatorë në “Autoritetin Evropian të Sigurisë Ushqimore”

Studentja e Fakultetit Arkitekturë dhe Planifikim Hapësinor në UBT, Fjolla Krasniqi pas suksesit të arritur në nivelin bachelor është punësuar në pozitën e arkitektes në kompaninë “Industria Ndërtimore e Kosovës – INK Group”. Studentja Fjolla Krasniqi tashmë është duke ndjekur studimet në nivelin master në Fakultetin Arkitekturë dhe Planifikim Hapësinor në UBT, me ç’rast ka vlerësuar se studimet në nivelin bachelor kanë qenë të avancuara në çdo aspekt, përderisa e kanë ndihmuar të zhvillohet profesionalisht. “Stafi akademik

dhe administrativ në UBT janë mbështetja më e madhe në çdo hap dhe aktivitet, i cili zhvillohet në mënyra vullnetare duke përfshirë punëtorë, forume, organizime të ndryshme, si dhe vizita me qëllim të zhvillimit profesional dhe akademik të studentëve”, ka thënë Krasniqi. Shumica e studentëve të Fakultetit Arkitekturë dhe Planifikim Hapësinor në UBT, apo rreth 98 për qind e tyre, tashmë janë të punësuar në kompani vendore dhe ndërkombëtare, duke e zhvilluar karrierën e tyre dhe dëshmuar suksesin e arritur në studimet.

Studentja e Psikologjisë Kaltrina Rrafshi përfundon suksesshëm praktikën në Klinikën “Empatia”



Programi i Psikologjisë në UBT është dëshmuar me nxjerrjen e kadrove të reja profesionale, si dhe ka luajtur një rol të rëndësishëm në zhvillimin e kësaj fushe. Në rrugën drejt krijimit të kadrove të reja profesionale, studentët e programit janë në qendër të historive të suksesit, duke sjellë ndryshime të thella dhe inovative në botën e psikologjisë. Studentja e Psikologjisë në UBT, Kaltri-

na Rrafshi ka përfunduar suksesshëm praktikën tremujore në Klinikën “Empatia”, në kuadër të së cilës ka qenë e monitoruar nga dy psikologe të kësaj klinike.

Praktika tremujore në Klinikën “Empatia” ishte një nga momentet më të rëndësishme dhe emocionale në karrierën e Kaltrinë, e cila ka përbushur detyrat me përgjegjësi duke ndihmuar në krijimin e dokumenteve të klinikës, studime të rastit dhe gjetje të diagnozës, si dhe në krijimin e materialeve punuese dhe të doracakëve informues. Studentja e Psikologjisë, Kaltrina Rrafshi ka vlerësuar se UBT është institucion që mbështet studentët në rrugëtimin

e tyre akademik dhe profesional. “Dy vitet e studimit në UBT kanë qenë sfiduese në vete mirëpo të mbushura me eksperiencë të shumta. Falë këtyre eksperiencave rrugëtimi im akademik dhe profesionalizmi në fushën e psikologjisë po avancohet. Qëllimin e vendosur për studimin e profesionit të psikologjisë, UBT veçse po më ndihmon ta përbush në plotni”, ka thënë ajo.

Në krye të departamentit të Psikologjisë, profesorët e njohur dhe të kualifikuar kanë inkurajuar studentët të eksplorojnë dhe të ndjekin pasionet e tyre duke vepruar si katalizatorë të ndryshimit të shoqërisë.

Mbi 50 për qind e stafit të kompanisë “Procurri” janë studentë të UBT së

Treguesi më i mirë i suksesit të UBT-së janë studentët e diplomuar, të cilët çdo ditë e më tepër po e gjejnë veten në tregun e punës, madje edhe krijojnë punë për të tjerët. Ideal Smajli dhe Uran Merovci janë dy ish-student të Fakultetit Shkencave Kompjuterike dhe Inxhinieri në UBT, të cilët janë përfaqësues të kompanisë së njohur ndërkombëtare e cila është lidere në shumicën e kontinenteve “Procurri” e cila operon edhe në Kosovë.

Faktin se studentët e Shkencave Kompjuterike dhe Inxhinierisë janë shumë të përgatitur për tregun e punës, e vërtetojnë edhe në këtë kompani, stafi i së cilës është i përbërë kryesisht nga studentë dhe ish-studentë të UBT-së.

Një nga përfaqësuesit e kompanisë “Procurri” për Kosovë, Ideal Smajli ka theksuar se praktika e realizuar përgjatë studimeve ndikon që studentët e UBT-së të dalin të përgatitur për tregun e punës, dhe për më tepër, të shndërrohen dhe në njerëzit më të kërkuar në tregun vendor dhe



ndërkombëtar të punës.

“Pas përfundimit të studimeve u punësua në një kompani nga Anglia, duke parë përkushtimin tim kompania vendosi që të marrë punëtorë të tjerë për tregun e Kosovës dhe natyrisht zgjidhja ime e parë ishte studentët e UBT-së, të cilët ishin më të përgatitur për tregun e IT-së. Aktualisht mbi 50% e stafit janë studentë të UBT-së”, theksoi Smajli. Ndërsa përfaqësuesi tjetër i kompanisë “Procurri” për Kosovë, Uran Merovci tha se në tregun kosovar dhe në tregun

global momentalisht kërkesa më e madhe është për profesionistë në fushën e IT-së dhe se UBT është institucioni i vetëm i arsimit të lartë në Kosovë ku për objektivi kryesor ka përgatitjen e të rinjve për tregun e punës. “Për mua si një ish-student i UBT-së ku kam diplomuar edhe studiuar para ca viteve, ndihmesa më e madhe në tregun e IT-së ose si një ish-profesionist në tregun e IT-së ka qenë puna praktike që e kemi bërë gjatë studimeve ku qysh në vitin e parë deri në përfundim të studi-

meve kemi pasur punë dhe ushtrime të ndryshme laboratorike, jo vetëm nga ana teorike, por edhe praktike”, tregoi Merovci. Dekani i Fakultetit Shkencave Kompjuterike dhe Inxhinieri, Besnik Qehaja tha se UBT në vazhdimësi përcjell arritjet e ish-studentëve të saj. Ndërsa, bashkërendimi i teorisë dhe praktikës është indikator i vlefshëm që dëshmon suksesin e studentëve të UBT-së në tregun e punës, si dhe nivelin e lartë të përkushtimit të institucionit ndaj përgatitjes profesionale të studentëve të vet.

“Studentët tanë kur i shohim në këto kompani natyrisht që është një sukses i dyanshëm, si i tyre ashtu edhe i joni, por është edhe një ndjenjë e veçantë sepse po kontribuojnë në shoqëri. Edhe këta gjithashtu po vazhdojnë kontributin e tyre duke i marrë studentët tanë në punë dhe duke besuar ende se ne si institucion vazhdojmë t’i përcjellim edhe pas studimeve dhe normalisht mbështetja jonë s’do të mungojë në asnjë formë”, u shpreh Qehaja.

Blinda Behluli është studente e vitit të dytë e Shkencave Kompjuterike dhe Inxhinierisë në UBT, e cila punon në këtë kompani. Ajo thotë se falë UBT-së, është aftësuar në profesionin që ka zgjedhur.

UBT ka qendrën më të madhe të Shkencave Kompjuterike dhe Inxhinierisë në Ballkanin Perëndimor. Programi është më i kërkuari nga studentë dhe staf vendorë dhe ndërkombëtarë dhe burim i inovacioneve kombëtare në këtë fushë.

Oreta Ibrahim realizoi shkëmbimin semestral në Universitetin “Van Hall Larenstein” në Holandë



Përmes partneriteteve të ndërtuara ndër vite me universitetet prestigjioze në Evropë dhe Amerikë, studentët e UBT-së kanë arritur të realizojnë qëllimet e tyre akademike, duke përfutur nga shkëmbimet semestrale, bursat dhe përvojat e veçanta në vende

të ndryshme. Njëra ndër to është edhe Oreta Ibrahim, studente e Fakultetit Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi në UBT, e cila ka realizuar një shkëmbim semestral në Universitetin “Van Hall Larenstein” në Holandë.

Ajo ka vlerësuar se nëpërmjet UBT-së, ka arritur që të përforcojë njohuritë e fituara përgjatë studimeve, të njihet me kultura të ndryshme dhe të krijojë eksperiencë të re në një shtet modern, siç është Holanda.

“Unë arrita që t’i zgjerojë njohuritë në fushën që studioj përmes mundësisë që më dha UBT për

shkëmbim semestral në Holandë, në Universitetin Van Hall Larenstein. Kryesisht, më ka ndihmuar në zhvillimin profesional dhe më ka mundësuar përjetimin e një eksperience të mrekullueshme në shtetin modern të Holandës”, është shprehur Ibrahim.

Oreta është shprehur tutje se profesionalizmi dhe serioziteti janë ndërgjegjërat kryesore që karakterizojnë studimet në UBT, duke krijuar kështu besueshmërinë dhe korrektësinë për zhvillimin profesional tek individët që përzgjedhin të studiojnë në këtë institucion.

Ish-studenti i UBT-së, Fat Tarku është punësuar në Spitalin Regjional të Pejës

Ish-studenti i Fakultetit Shkencave të Ushqimit dhe Bioteknologji në UBT, Fat Tarku, pas rezultateve të suksesshme të arritura përgjatë studimeve në këtë drejtim, është punësuar në Spitalin Regjional të Pejës, ku punon si nutricionist. Ai ka vlerësuar se vitet e studimit në UBT, sidomos në drejtimin Shkencave të Ushqimit dhe Bioteknologji, kanë qenë plotë sfida, por njëherit edhe të suksesshme për të arritur qëllimet profesionale dhe akademike të tij. “Studimet ak-

ademike në UBT ishin mjaft të mira dhe të mbushura me plot sfida. Gjatë viteve të studimit isha i përqendruar maksimalisht në arritjen e qëllimeve profesionale dhe akademike. Studimet në UBT janë të veçanta për shumë arsye, duke filluar prej stafit të mrekullueshëm të profesorëve, ku ishin shumë të përgatitur dhe të mbushur me informacione të reja dhe që nuk ngurronin në asnjë moment për të më ngritur edhe më shumë në nivelin akademik”, ka thënë Tarku.

Vegim Dedinca punësohet në Gjermani

Ish-studenti i Fakultetit Shkencave të Ushqimit dhe Bioteknologji në UBT, Vegim Dedinca është punësuar në firmën “Wolf Echter Essgenuss GmbH”, në Schmölln të Gjermanisë, ku bën kontrollimin e cilësisë dhe kualitetit në departamentin e produkteve. Studimet akademike në UBT për ish-studentin, Vegim Dedinca, ishin zgjedhja e duhur për zhvillimin profesional dhe për ndërtimin e një karriere të bujshme. “Studimet akademike në UBT për mua në fillim ishin pak të vështira për arsye se nuk kisha njohuri të mjaftueshme rreth zhvillimit të procesit akademik në UBT. Pasi fillova studimet mësova se kam zgjedhur

vendin e duhur, ku u zhvillova profesionalisht dhe mora njohuritë e mjaftueshme në lidhje me drejtimin si teknolog ushqimor”, ka thënë Dedinca. Ai i ka rekomanduar të rinjve që të zgjedhin UBT-në për studime, nëse dëshirojnë të bëhen më të mirët. “Të rinjtë nëse dëshirojnë të bëjnë një karrierë profesional duhet të zgjedhin UBT-në, duke u bërë kështu më të mirët në fushën që studiojnë. Në UBT është mundësia e zhvillimit të karrierës, marrja e njohurive të nevojshme profesionale nga ekspertët dhe profesionistët më të mirë vendorë dhe ndërkombëtarë”, është shprehur ai.

Ish-studenti i Arkitekturës dhe Planifikimit Hapësinor, Dren Nishliu punësohet në UBT

Ish-studenti i Fakultetit Arkitekturë dhe Planifikim Hapësinor në UBT, Dren Nishliu është punësuar në institucionin më të madh të arsimit të lartë në rajon, aty ku u zhvillua nga ana profesionale dhe akademike, në UBT.

Si asistent në UBT, ish-studenti Dren Nishliu ka përgjegjësi të ndihmojë në mësimdhënie, të përgatisë ligjëratat, ushtrimet, materialet e tjera mësimore, si dhe të ndihmojë studentët e tjerë në zhvillimin e tyre akademik. Përveç punës si asistent, ai është angazhuar edhe në themelimin e një studioje të arkitekturës, si dhe punon me bashkëpunëtorë profesionistë të fushës së arkitekturës



vendorë dhe ndërkombëtarë. Nishliu ka thënë se studimet në UBT kanë qenë një periudhë e jashtëzakonshme. Ai ka potencuar se studimet në UBT janë mundësi unike për gjithsecilin që dëshiron të ngritet profesionalisht në fushën e arkitekturës dhe planifikimit hapësinor. “Një aspekt i veçantë i studimeve në UBT ishte mundësia

për të punuar në projekte grupe dhe individuale. Kjo na dha mundësinë të zhvillojmë aftësitë tona bashkëpunuese dhe të përjetojmë sfidat e vërteta të dizajnit arkitektonik. Përmes kësaj eksperience të mahnitshme, unë njoha vlerën e bashkëpunimit dhe arrita të zhvilloj aftësinë time për të menaxhuar kohën dhe burimet me efikasitet”, u shpreh Nishliu. Ai ka vlerësuar se UBT karakterizohet me programet e studimit të specializuara, cilësinë e mësimdhënies, mundësitë e shumta për praktikë profesionale, shkëmbim ndërkombëtar, si dhe me një mjedis inkurajues.

Studentet e Dizajnit të Integruar marrin pjesë në punëtorinë “Rikrijimi i Traditës 2” në Gjirokastrë

Me ftesë të Cultural Heritage without Borders (CHwB) në Shqipëri, nga Pezana Rexha, shtatë studentë të Fakultetit Dizajn i Integruar dhe Fakulteti Dizajn i Integruar i Avancuar në UBT, Nertila Memaj, Alma Salih, Marigona Susuri – Kamberi,

Shkurte Ejupi, Anila Gashi, Engjellushe Gojnovci dhe Safete Beqiri, morën pjesë në punëtorinë “Rikrijimi i Traditës 2” në Gjirokastrë, e cila kulmoi me sfilatën finale në Festivalin Folklorik Kombëtar të Gjirokastrës. Gjatë një periudhe prej dhjetë



ditësh, studentët u angazhuan me pasion dhe entuziazëm të lartë në procesin e dizajnit dhe krijimit të veshjeve të tyre të veçanta, të frymëzuara nga pasuritë e trashëgimisë kulturore dhe tradita e veshjeve kombëtare shqiptare. Nëpërmjet kësaj përvoje të jashtëzakonshme, ato shfaqën aftësi të rralla për të kombinuar elementët tradicionale me stilin

e tyre kreativ dhe shfaqën një përfaqësim të identitetit kulturor shqiptar. Punëtoritë e tilla krijojnë një platformë unike për rritjen e potencialeve kreative të studentëve, duke u ofruar mundësinë për të eksploruar thellësisht vlerat e kulturës sonë dhe për të sjellë inovacion dhe freski në formën e tyre të artit të modës.

Studentja Vita Kasapolli, një histori e veçantë suksesi



Studimi i dijes dhe shkencës nuk është vetëm një rrugë akademike, por një sfidë emocionuese për të zbuluar potencialet dhe pasionet tona. Një histori e tillë e suksesit është e studentes Vita Kasapolli, e cila ka bërë një rrugë impresionuese në Fakultetin e Artit dhe Medias Digjitale në UBT.

Vita Kasapolli është një studente entuziaste dhe e përkushtuar, e cila shquhet për ndjekjen e pasionit të saj për industrinë kreative dhe jetën kulturore. Njëpërmjet angazhimit të saj në organizimin e aktiviteteve të Kinemasë "Jusuf Gërvalla", një qendër kulturore kryesore në qytetin e Pejës, ajo shfaq dëshirën për të shkëlqyer në këtë fushë.

Vita tregon se UBT ka qenë një vend i veçantë për të ndjekur

ëndrrën e saj. "UBT ka krijuar kushtet e zhvillimit të më shumë profesioneve se sa neve na tregohen nëpër shkollat fillore e të mesme. Si i tillë të shtynë që seriozisht të mendosh për kahjen e karrierës e zhvillimin profesional", ka thënë Kasapolli.

Vita vendosi të vijojë studimet e saj në Art dhe Media Digjitale në UBT, pasi gjeti një rrethanë të përshtatshme për të ndjekur rrugën e saj profesionale. Ajo e përshkruan zgjedhjen e këtij programi si një përputhje perfekte me vizionin e saj për të qenë aktive në industrinë kreative.

Gjatë studimeve të saj, Vita ishte pjesë e Festivalit të Animacionit Anibar, një aktivitet i rëndësishëm në fushën e artit digjital. Ajo ka shprehur se dijet dhe për-

vojat e fituara në këtë festival i ka shfrytëzuar me sukses në fakultet, ndërsa edhe anasjelltas, informacionet dhe njohuritë e reja që ka përfutur në UBT i ka aplikuar në punën e saj në festival.

Përveç zhvillimit të aftësive kreative dhe dijes në aspektin kreativ, UBT ka ndikuar edhe në zhvillimin e vlerave dhe karakterit të Vitës.

"UBT më ka mësuar edhe disa vlera që i'a vlejné në çdo punë apo situatë që mund të gjendemi. Këtu hyn rëndësia e rolit tonë në një apo shumë komunitete, këmbëngulja dhe vendosmëria për të përparuar si individ dhe si shoqëri, e dëshira për të përkrahur dhe pranuar çdo njeri për atë që është", shprehet Kasapolli.

Historia e suksesit të studentes Vita Kasapolli tregon se një përkushtimi i ndjeshëm dhe zgjedhja e një institucioni të rëndësishëm siç është UBT mund të krijojë një rrugë të ndritur drejt arritjeve të mëdha në botën e shkencës dhe kulturës. Suksesi i Vitës është një frymëzim për të gjithë studentët që janë të përkushtuar ndaj pasioneve dhe që ndjekin ëndrrat e tyre në fushën e artit dhe medias digjitale.

Studentja Doruntina Barku është punësuar në kompaninë "ArchiEDU"



Studentja e Fakultetit Arkitekturë dhe Planifikim Hapësinor në UBT, Doruntina Barku, pas rezultateve të suksesshme të arritura përgjatë studimeve në UBT, është punësuar në pozitën Junior Architect në kompaninë "ArchiEDU".

Doruntina Barku ka vlerësuar se përgjatë studimeve në UBT ka arritur që përmes përkushtimit dhe angazhimit, si dhe mbështetjes së rezervë të stafit akademik dhe administrativ të UBT-së, të zhvillojë njohuritë e saj rreth fushës dhe të avancohet drejt qëllimeve akademike dhe profesionale.

"UBT është një ndër institucionet më të mira të arsimit të lartë

në Kosovë, i zotuar për të vënë në zbatim metodat më të përparura të mësimdhënies dhe hulumtimit në një mjedis ku i jepet një rëndësi e veçantë studentit, si dhe avancimit profesional, që do të kontribuojë në ekonomi, në zhvillimin shoqëror dhe kulturor të Kosovës dhe më gjerë", ka thënë Barku.

Fakulteti Arkitekturë dhe Planifikim Hapësinor në UBT, është një nga programet unike në rajon, duke u ofruar zhvillimin profesional të rinjve dhe mundësi të shumta punësimi në vet institucionin e UBT-së, por edhe në tregun e punës brenda dhe jashtë Kosovës.

Redon Obrazhda është punësuar në institucionin mikrofinanciar "KosInvest"

Ish-studenti i Fakultetit Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi në UBT, Redon Obrazhda pas suksesit të arritur përgjatë studimeve në UBT, është punësuar në institucionin mikrofinanciar "KosInvest" në pozitën Zyrtar Kreditor Junior në degën në Prizren. Ai ka theksuar se falë mbështetjes dhe angazhimit të profesorëve, infrastrukturës moderne, laboratorëve dhe sallave të pajisura me teknologjitë më të sofistikuara të kohës, ka arritur të përfitojë njohuritë e nevojshme dhe të jetë i gatshëm për tregun e punës.

"UBT ofron kushte cilësore dhe shumë të mira për studime. Falë përgatitjes së stafit akademik

dhe administrativ, mbështetjes ndaj studentëve, si dhe falë njohurive që kam marr nga ta përgjatë studimeve, sot jam i përgatitur për punën që e bëj aktualisht", ka thënë Obrazhda. Programi i studimit Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi në UBT, ofron njohuritë më të avancuara në të gjitha dimensionet e menaxhimit, biznesit dhe ekonomisë, duke ofruar arsim akademik në një mjedis lokal me ekspertizë ndërkombëtare për të krijuar një mjedis për të rritur bashkëpunimin midis studentëve, stafit mësues, administratës dhe komunitetit.

Studenti Musa Bajmak, pjesëmarrës në Konferencën "Change the World Model United Nations - CWMUN"

Studenti i Fakultetit Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi në UBT, Musa Bajmak, ka fituar bursë nga East West European Institute për të përfaqësuar Kosovën në Organizatën e Kombeve të Bashkuara - OKB, në Konferencën "Change the World Model United Nations - CWMUN", që këtë vit do të mbahet në New York të Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Përzgjedhja e tij në mesin e 5000 studentëve në gjithë botën që do të marrin pjesë në këtë konferencë sipas Bajmak është një ndjenjë shumë e mirë për të përfaqësuar të rinjtë e Kosovës, teksa

ka inkurajuar studentët e tjerë që të vazhdojnë rrugëtimin e tyre drejt sukseseve të tjera në një institucion lider si UBT.

"Në UBT, para së gjithash, gjeta një numër të madh të kolegëve të rinj që me siguri do të jenë të shkëlqyer në të ardhmen. Në UBT, ju do të jeni një studentë ndërkombëtar dhe do të keni mundësinë që të njihni botën, por edhe bota t'ju njohë juve", ka thënë ai.

Konferenca "Change the World Model United Nations - CWMUN" përfaqëson një kongres të rinjve në zgjidhjen e ndryshimeve



klimatike dhe geopolitike në botë, dhe ka për qëllim të transformojë tek të rinjtë ndjenjën e përgjegjësisë për çështjet që ndikojnë në planetin tonë dhe t'i trajnojnë ata për të inkurajuar angazhimin e tyre konkret si udhëheqës dhe mendimtarë të së ardhmes.

Studentja Anila Selmani - lojtarja më e dalluar në Final Four të Kupës së Kosovës në basketboll

Studentja e Fakultetit Shkenca të Sportit dhe të Lëvizjes në UBT, Anila Selmani është zgjedhur lojtarja më e dalluar (MVP) në Final Four në kuadër të Kupës së Kosovës në ligën e parë në basketboll.

Këtë sukses ajo ka thënë se e ka arritur falë talentit të saj, si dhe njohurive të tjera të fituara përgjatë studimeve në UBT, duke ndikuar kështu në per-

mancën e saj pozitive në aspektet e ndryshme sportive.

"Kam përfituar në mënyra të ndryshme si në marrjen e njohurive të reja që kanë ndikuar në performancën time në sport, në kuptimin e shumë aspekteve sportive të ndërlidhura me trajnimin, ashtu edhe në avancimin e njohurive rreth kujdesit të shëndetit tim si sportiste, që në të ardhmen të kem mundësinë




që të angazhohem edhe si edukatore fizike apo trajnere", ka thënë Selmani. Fakulteti Shkenca të Sportit dhe të Lëvizjes në UBT, ju ofron studentëve mundësi të shumta të zhvillimit të tyre në karrierë, përmes profesionistëve më të mirë që ka vendi, në zhvillimin e mëtutjeshëm në fusha të ndryshme që përfshijnë sportin, shëndetin dhe aktivitetin fizik.

Nga studentët të UBT-së në sipërmarrës të suksesshëm - Betulla Rramanaj dhe Edis Mazreku hapin zyrën projektuese "Haus Project" në Prishtinë

Nga teknologjia te industria, nga inxhinieria te arti dhe kultura, ajo çfarë i bën bashkë studentët e UBT-së, janë arritjet e tyre profesionale. Duke dëshmuar zhvillimin e tyre akademik e profesional në një institucion cilësor dhe të përsosur siç është UBT, ata janë kthyer sot në pionerë të inovacionit dhe kreativitetit.

Ndër ta janë edhe Betulla Rramanaj dhe Edis Mazreku, studentët të Fakultetit Arkitekturë



dhe Planifikim Hapësinor në UBT, të cilët nga përvoja dhe arritja akademike në UBT, kanë

arritur të hapin zyrën e tyre projektuese me emrin "Haus Project" në Prishtinë, me ç'rast

ofrojnë shërbime të ndryshme të aktiviteteve të arkitekturës duke nisur nga projektimi, mbikëqyrja dhe realizimi i projekteve.

Studenti Betulla Rramanaj ka thënë se përgjatë viteve të studimit në UBT ka arritur të përfitojë njohuri rreth profesionit nga profesorët, të cilët njëherit kanë qenë mbështetës me të mëdhenj të arritjeve të tyre.

"UBT-në e kam zgjedhur për cilësinë dhe korrektësinë që ka në arsim, po ashtu edhe në zhvillim të teknologjisë. Gjatë këtyre

tre viteve të studimeve në UBT, kam arritur të përfitojë njohuri rreth profesionit të ofruara nga profesorët, të cilët më kanë bërë të aftësohem profesionalisht për nisjen dhe përfundimin e projekteve në mënyrë profesionale", ka thënë Rramanaj.

Shumica e studentëve të Fakultetit Arkitekturë dhe Planifikim Hapësinor në UBT, apo rreth 98 për qind e tyre, tashmë janë të punësuar në kompani vendore dhe ndërkombëtare, duke e zhvilluar karrierën e tyre dhe dëshmuar suksesin e arritur në studimet.

Studentja Edi Alidema fiton çmimin e dytë në garën “Elementet Urbane” të organizuar nga Instituti Space SyntaKS



Studentja e Fakultetit Arkitekturë dhe Planifikim Hapësinor në UBT, Edi Alidema ka fituar çmimin e dytë në garën “Elementet Urbane” të organizuar nga Instituti Space SyntaKS në bashkëpunim me partnerët e tjerë, si një mundësi për të gjithë entuziastët e dizajnit.

Kjo garë kishte për qëllim pro-

jektimin e ulëseve, shportave dhe mbrojtëseve urbane, si një sfidë interesante për shfaqjen e kreativitetit dhe inovacionit nga pjesëmarrësit.

Studentja Edi Alidema ka vlerësuar se kjo garë ishte një mundësi unike për të promovuar talentin dhe kreativitetin e saj, si dhe një motivim shtytës për të. Ajo ka

theksuar se në UBT bashkëpunimi i mirëfilltë me profesorët dhe kolegët e saj të fakultetit ka shërbyer si burim frymëzimi për karrierën e saj të ardhshme si arkitekte.

“Tre vite si studente në UBT në drejtimin e Arkitekturës ishin një udhëtim i mrekullueshëm për mua. Nëpërmjet projektimit të ndërtimeve të ndryshme dhe punës me ekipet e shkëlqyera të studentëve dhe profesorëve të mi të devotshëm, unë kam zhvilluar aftësi kreative dhe inovative që do të shërbejnë si burim frymëzimi për mua në karrierën time të ardhshme si arkitekte. Në një ambient bashkëpunues dhe inkurajues, unë kam filluar të kuptojë se arkitektura është shumë më shumë se sa thjesht një punë”, ka thënë Alidema.

Studenti Erik Gorani prezanton në Kongresin Ndërkombëtar të Studentëve në Austri



Studenti i Fakultetit Stomatologji në UBT, Erik Gorani, ka prezantuar punimin e tij me temë: “How often medical errors are reported by health care providers at the Emergency Center in Pristina”, në Kongresin Ndërkombëtar të Studentëve të “Medical University of Graz” në Austri.

Këtë punim, studenti Erik Gorani e ka bërë nën mentorim-

in e profesorit Genc Demjaha, dhe përmes prezantimit të tij ka marrë vlerësim të lartë nga Prof. Dr. Manuela Aschauer, e cila ishte anëtare e komisionit vlerësues të kongresit.

Qëllimi i këtij punimi ka qenë siguria në kujdesin ndaj pacientit, si dhe menaxhimi cilësor i shërbimeve të kujdesit shëndetësor në Qendrën Emergjente në Prishtinë.

Në këtë punim është vënë re nevoja e riorganizimit të orarit të punës për punëtorët e Qendrës Emergjente, si dhe është nxjerrë në konkludim se rritja e kapaciteteve të nivelit të kujdesit parësor do të ulte ngarkesën e Qendrës Emergjente nga ndërhyrjet, të cilat mund të trajtohen pa problem në nivelet më të ulëta.

Studenti nga Harvardi, Gerson Cornejo për internship në UBT



e Harvardit. Përshtypjet e tij për UBT dhe për Kosovën në përgjithësi janë të mira dhe mendon që të vijë prapë dhe t’ia rekomandojë miqve të tij.

“Do të jenë disa studentë që me shumë siguri do të vijnë këtu vitin e ardhshëm, unë padyshim kur të kthehem në Harvard do të flasë për eksperiencën time këtu. Jam i sigurt që do të mbajë kontakt me miqtë e mi këtu, kështu që po sigurisht! Mendoj që me shumë gjasa edhe unë gjithashtu do të vijë prapë këtu një ditë”, është shprehur Cornejo.

Përmes partneriteteve të shumta me institucionet më prestigjioze të arsimit në Evropë dhe Amerikë, UBT synon t’i mundësojë të rinjve shkëmbim studentor dhe përvoja unike për të fituar një këndvështrim dhe përjetim të paharrueshëm.

UBT është bërë vendi ideal për studentët ndërkombëtarë për të ardhur edhe për studime dhe për punë praktike. Gerson Cornejo nga Peruja ka ardhur në UBT për të kryer një përvojë praktike përmes Qendrës për Zhvillim Ndërkombëtar.

Ai studion master për Zhvillim Ndërkombëtar në Universitetin

Skender Radoniqi punësohet në kompaninë farmaceutike “Medical Group”



Ish-studenti i Fakultetit Farmaci në UBT, Skender Radoniqi është punësuar në kompaninë “Medical Group” si farmacist për çështjet rregullatore, përmes së cilës iu është mundësuar të ketë nga afër kontaktin me kompanitë prestigjioze farmaceutike si Pfizer, AstraZeneca dhe Merck.

Për ish-studentin Skender Radoniqi, studimet në UBT kanë

qenë thellësisht shpërblyese për faktin se programi Farmaci ka ofruar një gamë të gjerë të temave.

“Studimet e mia akademike në UBT kanë qenë stimuluese dhe thellësisht shpërblyese. Fakulteti i Farmacisë ka një kurrikulë të mirë strukturuar që mbulon një gamë të gjerë temash, duke përfshirë shkencat farmaceutike, kiminë mjekësore, farmakologjinë, praktikën e farmacisë dhe rregullativën farmaceutike. Profesorët janë ekspertë në fushat e tyre përkatëse dhe kanë qenë të dobishëm në dhënien e njohurive të tyre me përkushtim maksimal. Udhëzimet dhe mentorimi i tyre ka nxitur një mjedis të përsosmërisë akademike”, ka thënë Radoniqi.

Radoniqi ka thënë se laboratorët e avancuar, bashkëpunimi me universitetet botërore dhe

lidhja me industrinë kanë qenë faktorët që e kanë shtyrë ata të studiojë në UBT.

“Ky universitet ka një reputacion të shkëlqyer në fushën e arsimit, i njohur për përkushtimin e tij ndaj arsimit cilësor. Ndër faktorët që më tërhoqën në këtë institucion ishin laboratorët më të avancuar, bashkëpunimi me universitetet botërore dhe lidhjet me industrinë e punës që ofruan perspektiva premtuese”, është shprehur ai.

Historia e suksesit të tij ka filluar edhe nga studimet duke u përzgjedhur si bursist nga UBT si dhe nga programi CEEPUS për të kryer hulumtim shkencor në Universitetin e Grazit, falë bashkëpunimit që ka UBT dhe stafi akademik i Fakultetit të Farmacisë me këtë universitet.

Studentja e Arkitekturës Era Desku ka fituar bursë përmes programit EMJMD për vazhdimin e studimeve master jashtë vendit



dhe Mjedisit të Qëndrueshëm Urban, tekta leksionet do t’i zhvillojë në tri shtete të ndryshme: Skoci, Finlandë dhe Spanjë.

Era Desku ka vlerësuar se UBT i ka dhënë mbështetjen dhe ndihmën më të madhe në vazhdimin e studimeve jashtë vendit, duke e përgatitur profesionalisht në fushën e studimit.

Ajo ka theksuar se përzgjedhja e UBT-së për studime në nivelin bachelor ka qenë padyshim më e duhura.

“Përzgjedhja e UBT-së si institucion për rrugëtimin tim të studimeve ishte padyshim një zgjedhje e duhur pasi që kontribuoi suksesshëm në karrierën time. Ndikimi që kishte në fushën

Studentja e Fakultetit Arkitekturë dhe Planifikim Hapësinor në UBT, Era Desku ka fituar bursë të plotë përmes programit (Erasmus Mundus Joint Master Degree – EMJMD) që të vazhdojë studimet master në fushën e Arkitekturës

profesionale siç është arkitektura, ishte mjaft pozitiv duke më ofruar mundësi të shumta për të ardhmen time. Duke cilësuar këtu reputacionin e lartë akademik, UBT-ja është vendimtare në mundësitë e saj të angazhimeve dhe diversitetit të programit dhe kurrikulës”, ka thënë Desku.

Shumica e studentëve të programit Arkitekturë dhe Planifikim Hapësinor në UBT tashmë janë të punësuar në kompani vendore dhe ndërkombëtare, tekta ka prej tyre që kanë përzgjedhur të bëhen pjesë e universiteteve prestigjioze botërore në nivelin master, duke dëshmuar cilësinë e UBT-së në arsim dhe edukim.

Studenti i Arkitekturës, Ylli Simnica fillon praktikën në byronë “Tiki Design”



Studenti i Fakultetit Arkitekturë dhe Planifikim Hapësinor në UBT, Ylli Simnica ka filluar punën si praktikant në byronë projektuese “Tiki Design”.

Studenti Ylli Simnica ka vlerësuar se UBT është një institucion që ofron cilësi dhe metoda të avancuara të mësimdhënies, gjë që e kanë ndihmuar këtë të fundit të përvetësojë njohuritë rreth fushës së arkitekturës dhe plani-

fikimit hapësinor.

“UBT është një ndër institucionet më të mira të arsimit të lartë në Kosovë, duke ofruar cilësi, korrektesë, metoda të avancuara të mësimdhënies e hulumtimit. Ajo që më ka bërë të zgjedh UBT-në, është rëndësia e veçantë që i jepet studentit dhe rritjes profesionale të tij, e që më vonë do të kontribuojë në zhvillimin kulturor e shoqëror të Kosovës”, ka thënë Simnica.

Ai ka thënë se falë punës profesionale dhe angazhimit maksimal të stafit akademik, me qëllim të aftësisimit profesional të studentëve, ka arritur të përvetësojë njohuritë rreth profesionit dhe të bëhet pjesë e tregut të punës.

Ish-studenti Bardh Rushiti punësohet si inxhinier i Inteligjencës Artificiale në Amerikë

Në rrugën drejt suksesit, disa emra shkëlqejnë më shumë se të tjerët. Kjo falë mbështetjes dhe hapave të edukimit dhe arsimit. Histori e një suksesi të jashtëzakonshëm është edhe ish-studenti i Fakultetit Inxhinieri e Mekatronikës në UBT, Bardh

Rushiti, i cili dikur pa hezitim zgjodhi UBT-në për formësim profesional dhe akademik dhe sot na bën krenar me punësimin e tij si inxhinier i Vizionit Kompjuterik dhe Inteligjencës Artificiale në “Calvary Robotics” në Rochester të New York-ut. Vendimin për


të studiuar në UBT, Bardhi e bëri nga kurioziteti, përderisa gjeti një mjedis të stimulueshëm, një staf të përkushtuar dhe një kurrikulë të avancuar që i ka hapur dyert e njohurive dhe mundësive të shumta. “Vendimi për të zgjedhur UBT-në para institucioneve të tjera u nxit nga kurioziteti im dhe etja për një përvojë mësimore të thellë dhe interaktive.

UBT ishte i njohur për ndërlidhjen e fortë profesor-student. Atmosfera ish te inkurajuese. Kjo ishte thelbësore në zhvillimin e njohurive dhe në kultivimin e një mendësie kureshtare”, ka thënë ai.

Përkushtimi i Bardhit për të aplikuar dhe zgjeruar njohuritë e fituara në UBT në situata praktike është një provë e vërtetë e

përgatitjes së shkëlqyeshme që ai ka marrë. Çdo projekt i ri është një sfidë e re, duke i shtyrë kufijtë e mundshëm në fushën e inteligjencës artificiale dhe robotikës. Ai është një dëshmi e vërtetë e cilësisë së lartë të arsimit të ofruar nga UBT dhe një frymëzim për studentët e tjerë që ende ndjekin ëndrrat e tyre në UBT.

Studenti Atdhe Rexhaj punësohet në Kompaninë “Greenhouse Sh.P.K”



Suksesi i studentit të Arkitekturës dhe Planifikimit Hapësinor në UBT, Atdhe Rexhaj është një histori frymëzuese e përpjekjeve dhe ndjekjes së pasionit të tij për arkitekturën. Duke qenë student i UBT-së, ai ka arritur

të përfitojë nga një platformë e shkëlqyeshme për të zhvilluar dhe thëlluar njohuritë dhe aftësitë e tij.

Atdhe Rexhaj është punësuar tashmë në Kompaninë “Greenhouse Sh.P.K”, në Pejë, ku është duke punuar si Arkitekt dhe Menaxher i Projekteve.

Siç vërteton studentin Atdhe Rexhaj, një nga përvojat e tij më të vlefshme në UBT ishte komunikimi i mirëfilltë i tij me profesorët e kualifikuar. Ata kanë luajtur një rol të rëndësishëm në ndihmën dhe orientimin e tij për të arritur nivelin e suksesit. Profesorët e kualifikuar dhe të përkushtuar janë një burim i madh i motivimit dhe mbështetjes për studentët e tyre.

“Përvoja ime në UBT ishte shumë e suksesshme dhe më ka ofruar një platformë të shkëlqyeshme për të studiuar arkitekturën. Profesorët ishin të kualifikuar dhe më kanë ndihmuar shumë në zhvillimin e njohurive dhe aftësive të mia. Përgjatë rrugëtimit tim në UBT kam pasur lëndë praktike dhe teorike, të cilat më ndihmuan të zhvilloj njohuritë në fushën e arkitekturës”, ka thënë Rexhaj. Përpos leksioneve akademike, UBT është kujdesur të ofrojë ndihmë të vlefshme për tregun e punës. Ky është një aspekt i një universiteti modern, që siguron që studentët të jenë të gatshëm për t’i përballuar sfidat e karrierës së tyre pas përfundimit të studimeve.

Studentët e UBT-së pjesë në Akademinë Verore të “Anhalt University of Applied Sciences”



Lirak Dervishi dhe Loris Rexhepaj janë studentët e Arkitekturës dhe Planifikimit Hapësinor në UBT që po marrin pjesë në Akademinë Verore të “Anhalt University of Applied Sciences”, në Dessau të Gjermanisë.

Në aktivitete të ndryshme që kanë të bëjnë kryesisht me fushën e arkitekturës, projekte e punëtori, studentët e UBT-së po japin kontributin e tyre me njohuritë e fituara përgjatë studimeve. Liraku dhe Loris janë bërë pjesë e

aktiviteteve të ndryshme të kësaj akademie përmes partneritetit të UBT-së me “Anhalt University of Applied Sciences”.

Bashkëpunimi UBT dhe “Anhalt University of Applied Sciences” krijon mundësi unike dhe të shkëlqyera për studentët e fushave të ndryshme për t’u bërë pjesë jo vetëm e akademive verore, por edhe e shkëmbimit studentor dhe angazhimit në organizime të tjera akademike dhe profesionale.

Ish-studentja Elsa Demolli punësohet në kompaninë ndërtimore “ARSEKO”

Ish-studentja e Fakultetit Arkitekturë dhe Planifikim Hapësinor në UBT, Elsa Demolli është punësuar në kompaninë ndërtimore “ARSEKO”, në të cilën përveç aktiviteteve projektuese në zyrë, është e angazhuar edhe me mbikëqyrje dhe monitorim të punimeve në terren.

Elsa Demolli ka përfunduar suksesshëm edhe praktikën profesionale në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, saktësisht në Departamentin e Planifikimit Hapësinor, Ndërtimit dhe Banimit.

Elsa vlerëson që në UBT praktika e komunikimit student-profesor promovohet shumë dhe studentët kanë përkrahje kur duhet të sqarojnë çështje të ndryshme në lëndët e tyre. Kjo ka krijuar një mjedis të përshtatshëm në UBT,



duke dhënë studentëve ndjenjën se janë gjithmonë në plan të parë. Për Elsen, koha e studimeve në UBT ka qenë një nga periudhat më të mira të jetës së saj deri tani.

“Mënyra se si profesorët e dhuronin informacionin apo dijen, si e shtjellonin apo e përpunonin atë dhe se si na bënë të mendojmë që ajo dije mund të ndërveprojë në lëndët dhe problematikat e tjera profesionale, ishte një gjë shumë e veçantë dhe na bënte të qëndronim të koncentruar për shkak se na nxitte kureshtja për të marrë përgjigjet e pyetjeve që na sillshin në mendje ose që profesori i bënte”, ka thënë Demolli.

Sikurse Elsa, shumica e studentëve të Fakultetit Arkitekturë dhe Planifikim Hapësinor në UBT janë të angazhuar nëpër kompani të ndryshme, apo edhe institucione brenda dhe jashtë vendit.

Studenti Diar Thaqi është punësuar në kompaninë “EUROING”



Studenti i Fakultetit Inxhinieri e Ndërtimit (Ndërtimtari) dhe Infrastrukturë në UBT, Diar Thaqi është punësuar në kompaninë “EUROING” në Rahovec dhe njëkohësisht është mbikëqyrës mbi rrjedhjen e punimeve, krijimin e raporteve mbi vazhden e punimeve, mbajtjen e ditarëve ndërtimorë, librave ndërtimorë, llogaritjet dhe porosinë e materialeve. Studenti Diar Thaqi ka vlerësuar angazhimin e të gjithë profesorëve të Inxhinierisë së Ndër-

timit dhe Infrastrukturës, duke thënë se ata kanë krijuar një ambient frymëzues dhe mbështetës. “UBT për dallim nga universitetet e tjera përpos kuadrin profesional, ofron edhe mundësinë e vizitave, praktikave dhe punëtorive, pra me një fjalë familjarizimin me terrenin. Këtë e dëshmojnë edhe lëndët që përfshijnë praktikën në Inxhinieri të Ndërtimit dhe Infrastrukturë, duke na mundësuar të përjetojmë ndjenjën e të qenurit inxhinier që në studime”, ka thënë Thaqi.

Studentët e Fakultetit Inxhinieri e Ndërtimit (Ndërtimtari) dhe Infrastrukturë në UBT arrijnë të demonstrojnë dhe aplikojnë njohuritë e fituara dhe t’i zbërthejnë ato në terma praktik dhe të matshëm përmes punës planifikuese, projektuese dhe realizuese në lëminë e ndërtimit.

Studenti Butrint Kryeziu përfundoi praktikën në kompaninë e ndërtimit “INON sh.p.k”



Studenti i Fakultetit Inxhinieri e Ndërtimit (Ndërtimtari) dhe Infrastrukturë në UBT, Butrint Kryeziu ka përfunduar suksesshëm praktikën profesionale në kompaninë e ndërtimit “INON sh.p.k”. Butrinti përgjatë viteve të studimit ka patur rastin të jetë pjesëmarrës i një sërë testimesh laboratorike me shkallë reale si asistent teknik, ku ka bërë edhe përpunimin e të dhënave kompjuterike të programit Catman Easy.

Kjo eksperiencë studentit Butrint Kryeziu i ka dhënë një motiv shtesë për të avancuar dhe dashur edhe më shumë profesionin e inxhinierit.

Ai ka vlerësuar në UBT studimet akademike kanë qenë një eksperiencë e shkëlqyer, teksa i ka rekomanduar secilit të ri që ka dilemë për studime, të zgjedhin

UBT-në si një institucion lider i arsimit të lartë në Kosovë.

“Studimet akademike në UBT janë një eksperiencë e shkëlqyer. Profesorët e kualifikuar dhe ambienti i mrekullueshëm më ndihmuan të zhvillohem profesionalisht. Pra, për studentët e rinj që akoma janë në mëdysheje që ku do të studiojnë, u rekomandoj UBT-në! Ejani, sepse UBT ju ofron çdo gjë që ju keni nevojë dhe ju duhet për ta kthyer ëndrrën tuaj në realitet”, ka thënë Kryeziu.

Fakulteti Inxhinieri e Ndërtimit (Ndërtimtari) dhe Infrastruktura në UBT, është shkolla më e madhe për ndërtimtari në Kosovë, teksa studentët që dalin të diplomuar prej saj, janë tejet të kërkuar dhe të suksesshëm në tregun e punës.

Studentja Marigona Dobërluka kryen praktikën në “Centro Dante”

Fakulteti i Psikologjisë në UBT po vazhdon të nxjerrë kadro të reja e profesionale të cilat po e gjejnë veten lehtë në tregun e punës. Një sukses të tillë e shënoi edhe studentja e Fakulteti Psikologji, Marigona Dobërluka, e cila aktualisht po kryen praktikë në administratën e Centro Dantes, një kursi të gjuhës italiane.

Ajo vlerëson lartë eksperiencën në UBT, të cilin e përshkruan si institucion prestigjioz e me staf profesional. Marigona thotë se veçantia e UBT-së është ndjenja e ngrohtësisë, respektit dhe e mirëkuptimit që ja dhuron çdo



studenti. Sipas saj, UBT-ja ofron mundësi të ndërtimit të karrierës edhe jashtë vendit.

“UBT më ka ofruar njohuri të mjaftueshme për të qenurit një profesionaliste në fushën e psikologjisë, si dhe mundësi zhvillimi edhe jashtë vendit”, thotë Dobërluka. Fakulteti i Psikologjisë në UBT ka profesionistët më të njohur të kësaj fushe dhe është i hartuar sipas standardeve bashkëkohore dhe përmbush udhëzimet dhe kërkesat e përcaktuara nga EuroPsy (European Certificate in Psychology), themeluar nga një prej institucioneve me kredibilitetin më të lartë në Evropë për përcaktimin e standardeve në profesionin e psikologjisë.

Studentja Mynevere Hyseni është punësuar si zhvilluese softueri në “Raiffeisen Bank Kosovo”

Studentja e nivelit master në drejtimin Shkenca Kompjuterike dhe Inxhinieri në UBT, Mynevere Hyseni pas suksesit të arritur përgjatë studimeve është punësuar si zhvilluese softueri në kompaninë “Raiffeisen Bank Kosovo”.

Ajo gjithashtu kontribuon në projekte të ndryshme duke përdorur teknologji të avancuara për të zhvilluar zgjidhje inovative dhe funksionale që janë përshtatura për nevojat e

“Raiffeisen Bank Kosovo”.

Studentja Mynevere Hyseni ka theksuar se UBT ofronte cilësi të larta mësimi me profesorë të kualifikuar dhe të përkushtuar, si dhe kishte programe të përshtatshme për tregun e punës dhe lidhje të ngushta me industrinë.

“UBT inkurajonte mendimin kritik, zgjidhjen e problemeve dhe hulumtimin e pavarur, duke përmirësuar aftësitë analitike dhe akademike të

secilit student. Gjatë studimeve në UBT, profesorët ishin të qasshëm dhe përkrahës, gjithmonë të gatshëm për të na ndihmuar dhe udhëzuar në përpjekjet tona akademike”, ka thënë Hyseni.

Shumica e studentëve të UBT-së tashmë janë të punësuar në kompani dhe institucione të ndryshme në nivel vendi dhe rajoni, duke dëshmuar kështu cilësinë dhe mbështetjen e UBT-së.

Studentja Vita Radoniqi ka përfituar nga programi Erasmus+ për shkëmbim semestral në Holandë

Studentja e Fakultetit Shkenca të Ushqimit dhe Bioteknologji në UBT, Vita Radoniqi është njëra prej shumë studentëve të UBT-së që ka përfituar nga mundësia që ofrohet nga programi Erasmus+ për shkëmbim semestral.

Studentja Vita Radoniqi është përfituese e programit për shkëmbim semestral në "Hogeschool Van Hall - Larenstein" në Holandë.

"Programi Erasmus ka pasur një ndikim të jashtëzakonshëm në rritjen time personale dhe akademike. Ndërrimi i kulturave dhe përvoja e jetesës në një vend të huaj më ka ndihmuar të zhvillojë



aftësi të reja dhe të ndërtojë lidhje me studentë të tjerë nga vende të ndryshme. Ky ndikim ka pasur një përfitim të madh në rritjen e

vetëbesimit tim dhe në zgjerimin e njohurive akademike", ka thënë Radoniqi.

Programi Erasmus+ ka treguar se si mund të hapë dyert për studentët e interesuar për njohuri të reja, zhvillimin e tyre personal dhe bashkëpunimin ndërkom-bëtar, duke sjellë një përfitim të madh për të gjithë ata që marrin pjesë në të.

Vita Radoniqi është një shembull i shkëlqyer i një studente të suksesshme që ka përfituar nga ky program, duke e pasuruar rrugëtimin e saj akademik dhe profesional me një përvojë të paharrueshme.

Studentja e Aktrimit, Elvana Prendi, filloi angazhimin profesional në serialin "Ana"

Studentja e Fakultetit të Aktrimit në UBT, Elvana Prendi, pas vijimit të suksesshëm të studimeve në UBT, ka filluar angazhimin profesional të saj në serialin "Ana".

Vullneti i saj për të arritur sukses, profesionalizmi i profesorëve të këtij fakulteti, si dhe mundësitë që i ka dhënë UBT, kanë bërë që Elvana të fillojë angazhimin e saj dhe të vijojë suksesshëm rrugëtimin profesional të saj në karrierë.

"UBT më ka impresionuar me kualitetin dhe cilësitë që ka. Nuk kam menduar dy herë për të zgjedhur këtë institucion

të arsimit dhe jam shumë e lumtur me profesionistët dhe punën profesionale që është zhvilluar përgjatë kësaj kohe në fakultetin ku bëj pjesë", ka thënë Elvana.

UBT ka bërë bashkë në një vend, profesionistët dhe ekspertët më të mirë që njeh vendi në fushën e aktrimit, ndaj përmes një infrastrukture moderne dhe të gjitha kushteve të nevojshme për të zhvilluar veprimtarinë artistike, studentët e Fakultetit të Aktrimit në UBT do të korrrin suksese si brenda ashtu edhe jashtë vendit, me projekte të ndryshme artistike.

Studentja Anila Gashi në punë praktike në UBT



Studentja e Shkencave Komputerike dhe Inxhinierisë në UBT, Anila Gashi pas suksesit të dëshmuar përgjatë studimeve, tani po kryen punë praktike në departamentin e Marketingut

Digjital në UBT.

Për Anilën, kushtet dhe infrastruktura e ofruara nga UBT, së bashku me një staf ekspertësh dhe teknologjinë moderne, janë faktorët që e bënë këtë institucion një zgjedhje të duhur për të zhvilluar studimet e saj.

"UBT ishte zgjedhje ime e parë, duke marr parasysh kushtet, stafin akademik dhe teknologjinë moderne që ofron ky institucion. Në UBT jam rritur akademikisht dhe jam përgatitur për profesionin që tani ushtroj. UBT është vendi ideal për të gjithë të rinjtë", ka thënë Gashi.

Studenti Drin Lokaj është punësuar në kompaninë "Euro - Loni"



Studenti i Fakultetit Inxhinieri e Ndërtimit (Ndërtimtari) dhe Infrastruktura në UBT, Drin Lokaj është punësuar si menaxhues i projekteve në kompaninë "Euro - Loni".

Studenti Drin Lokaj ka thënë se ka përzgjedhur UBT-në dhe Fakultetin Inxhinieri e Ndërtimit (Ndërtimtari) dhe Infrastruktura për shkak të profesionalizmit të stafit, i cili gjithmonë është i disponueshëm për të ndihmuar dhe mbështetur studentët në arritjet e tyre akademike.

"UBT-në e zgjedha sepse është një universitet me një gamë të gjerë të drejtimeve dhe është i vetmi që ka drejtimin të cilin doja ta studioja, atë të Inxhinierisë së Ndërtimit dhe Infrastruktura. UBT ka një staf profesionalësh, të cilët asnjëherë nuk hezitojnë të na ndihmojnë dhe të na mbështesin në arritjet

akademike. Gërshetimi i teorisë me praktikën, kushtet moderne dhe njohja e diplomës në vende të ndryshme të botës, duke na dhënë mundësi të vazhdojmë studimet apo të bëjmë shkëmbim studentor, janë disa nga karakteristikat e veçanta të UBT-së", ka thënë Lokaj.

Të diplomuarit e programit Inxhinieri e Ndërtimit (Ndërtimtari) dhe Infrastruktura në UBT do të fitojnë të gjitha njohuritë dhe kompetencat për të punuar në të gjitha punimet ndërtimore dhe ndërtimet e infrastrukurës hidro dhe rrugore, brenda dhe jashtë kufijve të vendit tonë, në tregun evropian dhe botëror.

Ish-studenti Rinor Reka është punësuar në kompaninë "JV-GROUP"



Ish-studenti i Fakultetit Arkitekturë dhe Planifikim Hapësinor në UBT, Rinor Reka është punësuar në pozitën arkitekt në sisteme fotovoltaike në kompaninë "JV-GROUP".

Studenti Rinor Reka ka vlerësuar se UBT ka ofruar për studentët

e Arkitekturës dhe Planifikimit Hapësinor një mënyrë të përshtatshme të përgatitjes profesionale për tregun e punës në Kosovë dhe më gjerë.

"UBT më ofroi një mënyrë të përshtatshme të përgatitjes profesionale dhe një atmosferë të veçantë të përkushtimit gjatë studimeve. Ndihma e profesorëve të përkushtuar, së bashku me programet e ndërveprimit me industrinë, më dhanë mundësinë të fitojë njohuri të thella praktike në fushën time të studimit", ka thënë Reka.

Ai ka thënë që përmes projekteve të shumta të realizuara përgjatë studimeve ka arritur një nivel tjetër të lartë të besimit dhe profesionalizmit.

"Me kalimin e kohës dhe rrit-

jen e aftësive të mia, u arrit një nivel i lartë i besimit dhe profesionalizmit. Përmes projekteve të shumta në universitet, isha në gjendje t'i kaloja sfidat me të cilat u përballa në profesion dhe të gjejë zgjidhje kreative dhe inovative. Kjo përvojë më siguroi një kualifikim të mirëfilltë për tregun e punës dhe më dha vetëbesim për të ndjekur ëndrrat e mia profesionale", ka shtuar ai. Programi Arkitekturë dhe Planifikim Hapësinor në UBT ka për qëllim të ofrojë njohuri dhe të përgatisë ekspertë arkitektonikë për identifikimin dhe analizën e problemeve arkitektonike, hartimin dhe zhvillimin në arkitekturë dhe përmirësimin e aspekteve estetike, si dhe të efikasitetit.

Studentja Furtuna Gubetini, koordinatore në Fakultetin e Infermierisë



Studentja e Fakultetit Shkenca Politike në UBT, Furtuna Gubetini është punësuar në cilësinë e koordinatore në Fakultetin Infermieri në UBT, me ç'rast angazhohet në mbështetjen e studentëve në zhvillimin e tyre akademik, udhëzimin në projektet e tyre dhe koordinimin e lëndëve. Studentja Furtuna Gubetini vlerësoi ambientin e përkushtuar ndaj cilësisë së arsimit në UBT dhe

theksoi se universiteti ofron programe të veçanta që janë në përputhje me fushat e saj të interesit. Për të, UBT ishte zgjedhja e parë për studime dhe ka shprehur se studimet i kanë hapur një perspektivë të gjerë dhe i kanë dhënë mundësi për zhvillim të karrierës në fusha të ndryshme.

"UBT përfaqëson një ambient të përkushtuar ndaj cilësisë së arsimit dhe ofron programe të veçanta që lidhen me fushat që mua më interesojnë, andaj dhe ishte zgjedhja ime primare për studime. Studimet në UBT më kanë ofruar një perspektivë të gjerë dhe mundësi për zhvillim të karrierës në fusha të ndryshme", ka thënë Gubetini.

Studentja Yllka Suliqi në punë praktike për marketing digjital



Studentja e Fakultetit Juridik në UBT, Yllka Suliqi pas suksesit të dëshmuar përgjatë studimeve është angazhuar për punë praktike në UBT, në departamentin e Marketingut Digjital.

Ajo ka vlerësuar se UBT dallon nga institucionet e tjera për shkak të kushteve standarde për studime, infrastrukturën moderne dhe stafit akademik me përvojë

dhe mbështetësit kryesor për arritjet e studentëve.

"UBT si institucion i arsimit të lartë plotëson standardet e një universiteti të mirëfilltë. Rangimet dhe çmimet në nivel botëror të UBT-së e bëjnë të dallojë nga institucionet e tjera në Kosovë dhe të fitojë besimin e të rinjve për studime", ka thënë Suliqi.

Misioni i programit Juridik në UBT është të ofrojë cilësinë më të lartë të edukimit ligjor që çon në përsosmëri në performancën e kapaciteteve të ndryshme profesionale ligjore dhe të kontribuojë në avancimin e sundimit të ligjit, rritjen ekonomike dhe zhvillimin e qëndrueshëm përmes proceseve inovative, mësimdhënies, dhe ekselencë kërkimore për të mirën e njerëzve dhe komunitetit.

Studentja Rina Latifi vazhdon studimet master në "Hochschule Anhalt" në Desau të Gjermanisë



Studentja e Fakultetit Arkitekturë dhe Planifikim Hapësinor në UBT, Rina Latifi, përmes bursës së fituar po vazhdon studimet e nivelit master në Universitetin "Hochschule Anhalt" në qytetin Desau të Gjermanisë.

Pas përfundimit të studimeve në nivelin bachelor në drejtimin e Arkitekturës dhe Planifikimit Hapësinor në UBT, Rina për një periudhë dyvjeçare ka punuar

në kompaninë projektuese dhe ndërtimore "HProjekt" në Komunën e Gjilanit, si dhe ka qenë e angazhuar në projektin ideor për rigjenerimin urban të qendrës së Gjilanit.

Sipas studentes Rina Latifi, studimet në UBT i kanë mundësuar ngritjen në aspektin profesional dhe akademik, për shkak të përvojave të ndryshme që ka arritur t'i ketë përmes punës dhe

punës praktike që ofrohen në kuadër të Fakultetit Arkitekturë dhe Planifikim Hapësinor.

"Në UBT përveç studimeve na është ofruar edhe punë praktike dhe punëtori të shumta, të cilat janë zhvilluar në intervale të ndryshme kohore dhe kemi pasur rastin të punojmë me profesorë vendorë dhe ndërkom-bëtarë, për të thelluar njohuritë tona rreth fushës së arkitekturës, por edhe për të mësuar nga përvojat e tyre", ka thënë Latifi.

Sikurse Rina, edhe shumë studentë dhe ish-studentë të UBT-së, po vazhdojnë studimet në nivelin master në universitetet më prestigjioze në botë përmes bursave të ndryshme, duke dëshmuar kështu arritjet profesionale dhe akademike të fituara në UBT.

Studentja Jeta Domi në punë praktike në departamentin e marketingut digjital në UBT

Studentja e Shkencave Kompjuterike dhe Inxhinierisë, Jeta Domi pas suksesit të dëshmuar përgjatë studimeve ka filluar punën praktike në departamentin e marketingut digjital në UBT.

Studentja Jeta Domi ka vlerësuar se ndër aspektet kryesore të veçanta të UBT-së janë programi unik dhe i strukturuar mirë, profesorët që janë ekspertë të shkencave kompjuterike dhe inxhinierisë, si dhe mundësitë e hulumtimeve dhe projekteve inovative. "UBT nuk ofron vetëm një mësim të shkëlqyeshëm, por

gjithashtu inkurajon studentët për hulumtime dhe projekte të ndryshme. Me burime të avancuara dhe ndihmën e ekspertëve të fushës, kam pasur mundësinë të përfshihem në projekte që sfidojnë mendjen time dhe kontribuojnë në zhvillimin e teknologjisë dhe inovacionit", ka thënë Domi.

Shumica e studentëve të UBT-së tanimë janë duke punuar në institucione brenda dhe jashtë vendit, duke dëshmuar arritet e tyre përgjatë studimeve dhe mbështetjen e pazezervë të UBT-së në këtë drejtim.

Ish-studentja Dea Gërdovci punësohet në kompaninë "Pro Real Estate"



Historia e suksesit të Dea Gërdovcit, një ish-studente e Fakultetit të Menaxhimit të Patundshmërive dhe Infrastrukturës në UBT, është një shembull frymëzues se si një zgjedhje e mençur e programit të studimit mund të ndikojë në ndërtimin e një karriere të suksesshme.

Dea Gërdovci tanimë është pjesë e ekipit në kompaninë "Pro Real Estate", një industri e rëndësishme në botën e patundshmërive.

Ajo tregon se veçanërisht aftësitë e fituara përgjatë studimeve në fushën e menaxhimit të patundshmërive i kanë dhënë mundësinë për të aplikuar njohuritë e saj akademike në një kontekst praktik.

"Mund të them me besim se studimi në programin Menaxhim i Patundshmërive dhe Infrastrukturës në UBT ishte hapi më i mirë që kam bërë për të ndërtuar karrierën time profesionale. Jo vetëm që fitova njohuri akademike, por gjithashtu mora për-

gatitje të nivelit të lartë për tregun e punës. Falë aftësive të fituara në programin e patundshmërive, tani jam duke zbatuar njohuritë akademike me punën profesionale në industrinë e fuqishme të patundshmërive", ka thënë Gërdovci. Misioni i programit Menaxhim i Patundshmërive dhe Infrastrukturës në UBT është të ofrojë arsimim të cilësisë së lartë duke zhvilluar njohuri të zbatueshme dhe aftësi unike që u shërbejnë të diplomuarve dhe punëdhënësve në tregun e punës në industrinë e ndërtimit, duke kontribuar në frymën e ndërmarrësisë dhe rritjen e qëndrueshme të industrisë.

Studentja Eljesa Arifi punësohet në "Raiffeisen Leasing"



Studentja e Fakultetit Menaxhim i Patundshmërive dhe Infrastrukturës në UBT, Eljesa Arifi është punësuar si specialiste e vlerësimit të kolateralit në "Raiffeisen Leasing". Përvoja e fituar nga profesorët e kualifikuar dhe

programi i studimeve në fushën e Patundshmërive dhe Infrastrukturës i ka mundësuar të kuptojë se si të gjejë mënyra dhe të krijojë vlera në pasuritë e paluajtshme.

"Kosova mund të ketë një treg të vogël, por është i mbushur me entuziazëm, qëndrueshmëri, etikë të fortë pune dhe vlera të larta. Këto cilësi janë të rralla dhe unë kam pasur fatin t'i shfrytëzoj në karrierën time intensive dhe shpërblyese në vlerësimin e pasurive të paluajtshme. Profesorët me përvojë dhe programi i Patundshmërive më mësuam se në pasuri të paluajtshme mund të krijosh vlera, jo vetëm t'i gjesht

ato. Ky profesion kërkon shtytje, fleksibilitet dhe udhëheqje, dhe studimet e mia më kanë përgatitur të lulëzojë", ka thënë Arifi.

Eljesa gjithashtu thekson se studimet e saj i kanë dhënë bazën e duhur për të shkëlqyer në këtë fushë dhe për t'u përshtatur me sfidat që vijnë me të.


Qëllimi kryesor strategjik i programit është të zhvillojë aftësi dhe njohuri unike për një menaxhim efektiv dhe profesional të çështjeve ligjore, investimeve dhe transaksioneve të pasurive të patundshme duke u bërë shtytësit e ndryshimeve të industrisë së ndërtimeve.

Ish-studenti Bonart Osmani vazhdon studimet master në "Newcastle University", në Mbretërinë e Bashkuar

Pas përfundimit të suksesshëm të studimeve në nivelin bachelor në Fakultetin Arkitekturë dhe Planifikim Hapësinor në UBT, Bonart Osmani, është duke vazhduar studimet në nivelin master në "Newcastle University", në Mbretërinë e Bashkuar, me ç'rast është përzgjedhur edhe si përfaqësues i drejtim-it të Arkitekturës në Unionin e Studentëve të këtij universiteti. Bonarti ka shënuar suksese të njëpasnjëshme pas përfundimit të studimeve në Fakultetin Arkitekturë dhe Planifikim Hapësinor në UBT, ndër të cilat më e rëndësishmja është përfitimi i bursës prestigjioze "Chevening", të ndarë nga Ambasada e Mbretërisë së Bashkuar në Kosovë, përmes "Foreign, Commonwealth and Development Office". Ai ka thënë se ka vendosur pa hamendje të studiojë

në UBT, meqenëse ofron programin më të avancuar, atë të Arkitekturës dhe Planifikimit Hapësinor, duke theksuar se UBT ka mundësuar zhvillimin e aftësive dhe arritjeve profesionale. "Programi Arkitekturë dhe Planifikim Hapësinor në UBT ofron mësim të integruar në teori, struktura, sisteme mjedisore, teknologji ndërtimi, dizajn dhe softuer kompjuterik, duke siguruar që studentët të jenë të pajisur me njohuri vepruese dhe mbështetje për të frymëzuar ndryshimin. UBT më ofroi mundësinë për të zhvilluar aftësitë e mia dhe për arritje profesionale. Gjithashtu, mentorimi dhe mbështetja nga profesorët e UBT-së ka qenë gjithmonë e afërt dhe profesionale, për çka u jam shumë mirënjohës.", ka thënë Osmani.

Studentja e Fakultetit Anita Ymeri është punësuar në cilësinë e asistentes dhe koordinatores së Fakultetit në UBT



Studentja e Fakultetit Arkitekturë dhe Planifikim Hapësinor në UBT, Anita Ymeri është punësuar në cilësinë e asistentes dhe koordinatores së Fakultetit në UBT, ku angazhohet për mbështetjen e

studentëve në zhvillimin e tyre akademik, udhëzimin në projektet e tyre dhe koordinimin e lëndëve në nivelin bachelor.

Studentja Anita Ymeri thekson se UBT dallon nga institucionet e tjera arsimore pwr përfaqësen e tyre praktike dhe fokusimin e vazhdueshëm në projekte inovative. Kjo ka sjellë një përvojë të pasur dhe shumëdimensionale për të gjithë studentët, duke i përgatitur ata për sfidat reale të botës profesionale.

"Studimet e veçanta në UBT shquhen për cilësinë e arsimit dhe lidhjen me botën reale. Përfaqësen praktike dhe fokusi në projekte inovative ofrojnë një përvojë shumëdimensionale. Personalisht, historia ime e suksesit fillon me këtë qasje të shkëlqyer, duke më mundësuar zhvillimin e aftësive praktike në arkitekturë dhe planifikim hapësinor. Kjo më ka ndihmuar jo vetëm në studime, por edhe tani si pjesë e botës profesionale", ka thënë Ymeri.

Ish-studentja Klodina Krasniqi-Berisha punësohet në kompaninë "ABC Design"

Njohuritë e fituara përgjatë studimeve në nivelin bachelor dhe master në Fakultetin Arkitekturë dhe Planifikim Hapësinor në UBT, e kanë ndihmuar dhe i kanë shërbyer shumë në aspektin profesional ish-studentes, Klodina Krasniqi - Berisha, e cila është punësuar në cilësinë e arkitektes në kompaninë "ABC Design" në Gjilan.

Ajo ka theksuar se përzgjedhja e UBT-së për studime ka qenë e duhura, për shkak të kurri-

kulës së programit Arkitekturë dhe Planifikim Hapësinor dhe mundësive të shumta që ofron ky institucion për t'u zhvilluar profesionalisht. "Studimet në UBT i bëjnë të veçanta profesorët të cilët janë të gatshëm në çdo kohë për ndihmë dhe këshilla, hapësira të mira për studim dhe mundësi të shkëmbimit të eksperiencave edhe me universitetet brenda dhe jashtë Kosovës. UBT më ka ofruar ngritje akademike me ligjëratat më moderne

në rajon, si dhe më ka ndihmuar në aspektin profesional dhe jetësor", ka thënë Krasniqi - Berisha. Fakulteti Arkitekturë dhe Planifikim Hapësinor në UBT është një nga programet më të kërkuara nga të rinjtë, për shkak të një kurrikule të pasur dhe të bazuar në modelet më të mira evropiane dhe amerikane, si dhe me një infrastrukturë moderne të pajisur me teknologjisë më të sofistikuar të kohës.

Studentja Lyra Begolli në punë praktike në UBT



Pas një rrugëtimi të suksesshëm si studente e Fakultetit Juridik në UBT, historia e Lyra Begolli është një frymëzim për të gjithë. Ajo është angazhuar për punë praktike në departamentin e Marketingut Digjital në UBT.

Studentja Lyra Begolli ka vlerësuar se zgjedhja për të studiuar në UBT ishte një vendim i qëndrueshëm dhe i menduar mirë, meqenëse programi Juridik ishte një burim i njohurive të avancuara teorike dhe praktike. "Ishin dy arsye kryesore që zg-

jodha UBT-në: e para ishte programi i studimit, i cili ka një kurrikulë superiore dhe specifike nga universitetet e tjera në rajon, dhe e dyta është renditjet ndërkombëtare që ka UBT. Përgjatë studimeve kuptova se UBT ka një staf profesionistësh që ofrojnë leksione në një nivel tjetër dhe janë mbështetësit kryesor për arritjet tona profesionale", është shprehur Begolli.

Misioni i programit Juridik është të ofrojë cilësinë më të lartë të edukimit ligjor që çon në përsosmëri në performancën e kapaciteteve të ndryshme profesionale ligjore dhe të kontribuojë në avancimin e sundimit të ligjit, rritjen ekonomike dhe zhvillimin e qëndrueshëm përmes proceseve inovative, mësimdhënies, dhe ek-selencë kërkimore për të mirën e njerëzve dhe komunitetit.

Ish-studentja Erzana Beka në punë praktike në UBT



Ish-studentja e Fakultetit Dizajn i Integruar në UBT, Erzana Beka po kryen punë praktike në Zyrën e Qendrës së Karrierës në UBT, ku zhvillon kontaktin e përditshëm me studentët, dhënie e pasqyrave për çdo drejtim të universitetit dhe regjistrimin e tyre në degën që atyre ju pëlqen.

Sipas, ish-studentes Erzana Beka kjo nuk është thjesht një punë praktike, por një shans për të

ndërthurur dijen me përvojën dhe të ndihmojë të tjerët të gjejnë rrugën e tyre drejt qëllimeve akademike dhe profesionale.

Beka ka vlerësuar se studimet akademike në UBT kanë qenë të duhurat dhe e kanë ndihmuar që të përgatitet për fushën e saj të studimit. "Studimet akademike në UBT kanë qenë një gërshetim mes teorisë dhe praktikës. Drejtimi i dizajnit të integruar si përf-

shirje e dizajnit grafik, të modës, të produkteve dhe të interierit më kanë bërë që të thellohem në artin e dizajnit dhe të kuptoj në detaje nga secili segment i tij", ka thënë Beka.

Shumica e studentëve të UBT-së tashmë janë të punësuar në kompani dhe institucione të ndryshme në nivel vendi dhe rajoni, duke dëshmuar kështu cilësinë dhe mbështetjen e UBT-së.

UBT dhe EON startojnë me versionin e ri të inteligjencës artificiale, projekt ky që tejkalon shifrën e 30 milionë dollarëve

UBT dhe EON Reality po startojnë me versionin e ri të inteligjencës artificiale "SPATIAL AI and EON AI ASSISTANT", në një projekt ky që tejkalon mbi 30 milionë dollarë amerikan, e që është një prej investimeve më të mëdha në botë sa i përket shkencës dhe teknologjisë në fushën e arsimit, duke e bërë kështu Kosovën pjesë të lidershit botëror të teknologjive moderne. Në një konferencë për media, Presidenti i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, ka thënë se investimet në teknologji si kjo me inteligjencën artificiale janë mëse të nevojshme dhe shumë të rëndësishme për të rinjtë dhe studentët për një të ardhme e cila dita-ditës është në ndryshim e sipër.

"Jam shumë i lumtur që bashkë me EON Reality po sjellim një projekt që ndërlidhë teknologji të ndryshme, implementon dhe përdorë struktura të cilat sjellin një produkt apo sistem që bazohet në përbajtjen logjike në inteligjencën artificiale. Ky program stu-



dentëve dhe të rinjve të Kosovës përpos qendrës më të madhe dhe të vetme në Ballkanin Perëndimor për Realitet Virtual dhe të Shtuar, u ofron shërbime dhe mundësi të reja për kombinimet me Intelig-

jencën Artificiale, të cilat janë synimi ynë, dhe gjithnjë atyre do t'u ofrojmë përditësimet më të reja që bota e teknologjisë në tërë rruzullin tokësor i zhvillon", ka thënë rektori Hajrizi.

Përmes kësaj teknologjie UBT do t'i ndihmojë studentët e tij të studiojnë më me efikasitet dhe të ruajnë informacionin më gjatë me përbajtje të udhëhequr nga Inteligjencën Artificiale, në të njëjtën kohë kjo

do t'i ndihmojë edhe profesorët të krijojnë mësimet dhe kurset e tyre me shumë më pak kohë dhe përpjekje.

"Partneriteti me UBT-në ka qenë gjithmonë kënaqësi për të gjithë të përfshirët dhe mezi pres të shoh se si ata do të arrijnë të maksimizojnë funksionalitetin e Asistentit të EON AI", ka thënë presidenti i kompanisë gjigante të teknologjisë virtuale "EON Reality", Dan Lejerskar, në një artikull të publikuar nga EONReality.

Ai ka shtuar se UBT-ja ka qenë një nga krijuesit më produktiv në mesin e të gjithë partnerëve dhe se kjo teknologji veçse do të fuqizojë rolin e UBT-së në këtë drejtim.

Partneriteti i EON Reality me UBT-në do t'u sigurojë studentëve dhe programeve qasje në këto zgjidhje të mundësuar nga Inteligjenca Artificiale (AI), duke u mundësuar atyre të ofrojnë përvoja gjithëpërfshirëse që ta shtyjnë fushën e arsimit përpara në çdo nivel.

Xhim Xhema ofroi përkrahjen e tij të rezervë për të rinjtë e Kosovës - UBT emëron objektin kryesor "Jim Xhema Building"

Lobuesi më i madh i Pavarësisë së Kosovës në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Xhim Xhema, në vizitën e tij në Parkun Shkencor të UBT-së në Lipjan, gjatë konferencës shkencore "Kosova and New Urbanism: Resilience, Innovation, Technology, Sustainability and Investments", shprehu përkrahjen e tij të rezervë për studentët dhe të rinjtë e Kosovës.

Ai u shpreh shumë falënderues dhe mirënjohës për respektin dhe nderimin që iu bë në UBT, njëherit potencoi se do të vazhdojë të kontribuojë dhe angazhohet për studentët, të rinjtë shqiptarë dhe për të ardhmen e Kosovës dhe Shqipërisë. "Më duhet që të sigurohem që ju e dini se jeni ardhmëria dhe shpresa jonë. Pa ju nuk ka asgjë dhe nuk do të arrihet shumë. Ju duhet që të angazhoheni e studioni shumë për të punuar për sigurinë e vendit tonë dhe ardhmërinë. Duhet t'i merrni studimet shumë seriozisht. Unë



personalisht do të qëndrojë i kyçur me ju këtu dhe do të bëjë fonde me të cilat do të sigurohem që bashkërisht t'i arrijmë qëllimet tona", u shpreh ai.

Në praninë e atdhetarit Jim Xhema, rektorit të UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, përfaqësuesve të Federatës Panshqiptare "VATRA", përfaqësuesve të Rrjetit të Bizneseve Shqiptare në Diasporë, profe-

sorëve dhe studentëve të UBT-së, u zbulua pllaka me emrin "Jim Xhema Building".

Objekti kryesor në Parkun Shkencor Inovativ të UBT-së, në Lipjan, do të mbajë emrin "Jim Xhema Building", në nderim dhe respekt të veprimtarit të shquar për çështjen kombëtare dhe lobuesit më të madh shqiptar për lirinë dhe Pavarësinë e Kosovës, Jim Xhema.

Rektori Hajrizi në Forumin Ekonomik Kosova-Kroacia



Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi mori pjesë në Forumin Ekonomik Kosova-Kroacia - forcimi i partneriteteve, ku u diskutua për rolin e Universiteteve në R&D dhe në adresimin e nevojave të tregut të punës.

Në mesin e pjesëmarrësve të shumtë nga institucione të ndryshme publike e private, rektori Hajrizi ka folur rreth sipërmarrjes dhe nevojave për fuqi punëtore në vend. "Ne kemi disa iniciativa bashkëpunimi në mes Kosovës dhe Kroacisë për temat e digjitalizimit dhe inovacionit. Kroacia ka një zhvillim shumë të mirë

të ndërmarrësisë, sepse ka krijuar raste shumë të mira botërore inovative. Duke e lidhur konceptin e tyre të ndërmarrësisë me konceptin tonë krijohet një potencial shumë i mirë dhe gjenerohet një prodhim edhe më i madh i përgjigjes së tregut botëror", ka thënë rektori Hajrizi.

Rektori Hajrizi ka thënë se Kosova ka shumë shembuj të mirë të ndërmarrësisë dhe pozita unike në nivele botërore, duke theksuar se në aspektin e përgjithshëm duhet akoma zhvillim dhe mbështetje për këtë fushë.

Përurohet Shkolla Kombëtare për Doktoratë në ICT

06/03/2023. UBT, në bashkëpunim me Universitetin e Prishtinës, Universitetin "Ukshin Hoti", Universitetin Linneaus University, Norwegian University of Science and Technology, South-East European Research Centre, si dhe me Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, ka bërë përuroimin e Shkollës Kombëtare të Kërkimit në Teknologjinë e Informacionit dhe Komunikimit në Kosovë.

Me këtë rast, Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi në fjalën e tij përshëndetëse ka uruar të gjithë partnerët për zhvillimin dhe

finalizimin e gjithë këtij projekti, duke falënderuar në veçanti partnerët ndërkombëtarë për bashkëpunimin e ngushtë që Kosova të ketë një shkollë kombëtare për hulumtime në fushën e teknologjisë informative.

"Kjo shkollë do të jetë një nga nisimat më të mira për Kosovën, për shkak që do t'i japë mundësi të rinjve për t'u ngritur profesionalisht në një nivel më të lartë për fusha të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit në Kosovë. E veçanta e kësaj shkolle është se bënë bashkë disa institucione vendore dhe ndërkombëtare. Një falënder-



im i veçantë i takon Ambasadës së Suedisë dhe asaj të Norvegjisë në Kosovë për mbështetjen e rezervë në këtë nismë", tha rektori Hajrizi.

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti shprehu përkushtimin e Qeverisë

në përdorimin e teknologjisë për të rritur transparencën dhe llogaridhëniën në qeverisje, për të përmirësuar shërbimet për qytetarët dhe bizneset tona dhe për të rritur produktivitetin dhe konkurrencën e ekonomisë sonë.

"Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit në vendin tonë ka një potencial të madh. Këtë muaj do të arrijmë mbulimin e plotë të zonave të banuara me infrastrukturë të internetit broadband. Me një industri dhe komunitet të gjallë, TIK-u është një nga sektorët e paktë ku kemi një bilanc pozitiv tregtar. Pra, nuk është befasi që procesi i vazhdueshëm i vlerësimit të Strategjisë së Specializimit të Zgjuar e ka identifikuar tashmë TIK-un si një nga pesë sektorët prioritarë në

ekonominë tonë që kanë potencialin më të lartë për rritje dhe inovacion", u shpreh kryeministri.

Rektori i Universitetit të Prishtinës, Prof. Dr. Qerim Qerimi ka thënë se kjo shkollë është demonstrim i bashkëpunimit dhe partneritetit ndërmjet institucioneve.

"Kjo Shkollë e re Kombëtare Kërkimore në TIK demonstron fuqinë e bashkëpunimit dhe partneritetit ndërmjet institucioneve, organizatave dhe individëve që ndajnë një vizion dhe qëllim të përbashkët", tha rektori Qerimi.

Kjo shkollë për dy vitet e ardhshme do të jetë e pozicionuar në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina", ndërkaq pas dy viteve do të pozicionohet tek partnerët e tjerë, një prej të cilëve është edhe UBT.

Rektori Hajrizi në ceremoninë e shënimit të Suedisë si kryesuese e Këshillit të BE-së

Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, me ftesën e Këshillit Evropian të Investitorëve dhe Ambasadës së Suedisë në Kosovë, mori pjesë në ceremoninë për shënimin e marrjes së mandatit

për Presidencën e Këshillit të Bashkimit Evropian. Në këtë organizim, pjesëmarrës ishte Presidentja e Republikës së Kosovës, Vjosa Osmani, ambasadori i Suedisë në Kosovë, Jonas B. Westerlund, përfaqësues të

Bashkimit Evropian në Kosovë, si dhe pjesëmarrës të tjerë.

Në këtë ceremoni u diskutua për planet dhe prioritetet e Presidencës suedeze për Kosovën, forcimin e bashkëpunimit, si dhe për

mbështetjen dhe punën e përbashkët për tërheqjen e investitorëve të rinj në Kosovë.

Rektori Hajrizi duke përfaqësuar njërin prej institucioneve lider në vend, ka vlerësuar se parimet dhe

vlerat e gjashtëmuajorit të mandatit të Presidencës së Këshillit të Bashkimit Evropian të kryesuar nga Suedia janë parime të përbashkëta të cilat i ndjek edhe Kosova dhe UBT.

Rektori Hajrizi zhvilloi një takim konsultativ me rektorin e Universitetit "Fan S. Noli", Prof. Dr. Dhimitri Bello



Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi i shoqëruar nga profesora, Maria Dojçe, nga "Korça Innovation and Technology Hub", ka zhvilluar një takim konsultativ me rektorin e Universitetit "Fan S. Noli", Prof. Dr. Dhimitri Bello, ku u diskutua rreth hapjes së mundësive të reja për të rinjtë, si dhe zgjerimit të bashkëpunimit ndërmjet këtyre dy universiteteve.

Rektori Hajrizi dhe rektori Bello vlerësuan bashkëpunimin e deritanishëm të dy institucioneve asimore, teksa ritheksuan nevojën e thellimit të këtij partneriteti për

krijimin e hapësirave konkrete për zgjerimin e mëtejshëm të tij me prioritet në fushën e edukimit, teknologjisë së informacionit, infermierisë dhe ekonomisë.

Në këtë takim ishin të pranishëm edhe zëvendës-reaktorja për shkencën dhe projektet në Universitetin "Fan S. Noli", Benita Stavre, zëvendës-reaktorja për mësimin, Arto Adili, ku u fol për mundësitë e bashkëpunimit në programe të përbashkëta studimi, në zhvillimin e praktikave mësimore për studentët, si dhe për aplikime në projekte me interes të përbashkët.

Ngritja e partneriteteve të reja në nivel ndërkombëtar - temë diskutimi në takimin e rektorit Hajrizi me përfaqësues të Odës Ekonomike të Vjenës

Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi ka qëndruar për vizitë në Odën Ekonomike të Vjenës (WKO - Wirtschaftskammer Wien), ku është takuar me përfaqësues të lartë të këtij institucioni me të cilët ka diskutuar për bashkëpunime të reja në fushën e teknologjisë, inovacionit, edukimit, hulumtimeve dhe projekteve evropiane.

Në këtë vizitë, rektori Hajrizi ka ndarë përvojat e tij dhe të arriturat e UBT-së, duke prezantuar ekosistemin, i cili ndërthurë në vete standardet më të modernizuara në fushën e teknologjisë, inovacionit dhe shëndetësisë.

Rektori Hajrizi i shoqëruar nga Prof. Dr. Norbert Bachl, ka takuar zëvendëskryetarin e Odës Ekonomike të Vjenës, Dr. Alexander Biach dhe përfaqësuesen nga Politika Ekonomike në këtë institucion, DI Regina Plas, të cilët njëherit ia prezantuan të gjitha kapacitetet e institucionit për të krijuar mundësi



të reja bashkëpunimi me UBT-në. Ndër të tjera, rektori Hajrizi ka shprehur gatishmërinë për bashkëpunime të reja me kompani dhe biznese të ndryshme në Vjenë, të cilat do të mundësonin krijimin e hapësirave të reja për studentët dhe të rinjtë nga Kosova dhe Austria, teksa përfaqësuesit e Odës Ekonomike të Vjenës u ftuan të vizitojnë Parkun Shkencor In-

vativ të UBT-së. Vizita e rektorit Hajrizi në Odën Ekonomike të Vjenës (WKO - Wirtschaftskammer Wien) ishte e rëndësishme për ngritjen e partneriteteve të reja në nivel ndërkombëtar në fushën e inovacionit, teknologjisë dhe shëndetësisë, për të zhvilluar projekte të përbashkëta në këto drejtime dhe për të arritur një progres të qëndrueshëm.

Rektori Hajrizi theksoi rëndësinë e zhvillimit të marketingut digjital dhe Start-Ups në eventin "INFODAY"

Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, me ftesë të "Korça Innovation & Technology Hub" mori pjesë në eventin "INFODAY" ku së bashku me panelistë të tjerë, diskutuan rreth risive dhe sfidave në Start-ups, në marketingun digjital, si dhe rreth orientimit të të rinjve drejt modeleve inovative në fushën e teknologjisë kreative.

Duke përcjellë nga afër trendin që po zhvillohet në këto fusha, rektori Hajrizi theksoi rëndësinë e zhvillimit të marketingut digjital të biznesit të reja, por edhe ato aktuale, sfidat me të cilat përballen këto biznese, mundësinë për hapjen e vendeve të reja të punës, si dhe për përfshirjen e të rinjve në një treg pune jo vetëm lokal e kombëtar, por edhe ndërkombëtar.

"Është shumë e rëndësishme që të jemi pjesë e zhvillimeve të ndryshme rreth nesh dhe në të njëjtën kohë të përcjellim trendet e reja që na sjell



bota e zhvilluar. Kësisoj, marketingu digjital është një prej aspekteve të rëndësishme të zhvillimit të secilës kompani apo biznes, qoftë i ri apo aktual, pa marrë parasysh sfidat të cilat mund të hasen gjatë rrugës", ka thënë rektori Hajrizi.

Ky aktivitet është mbajtur në qytetin e bukur të Korçës dhe është zhvilluar nga Qendra e Teknologjisë dhe Inovacionit "Korça Innovation & Technology Hub", qendër të cilën UBT e ka zhvilluar së bashku me Bashkinë e Korçës.

Rektori Hajrizi në vizitë në Institutin Austriak për Mjekësinë Sportive në Vjenë

Në kuadër të vizitës dyditore në Austri, rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi ka vizituar institucione të ndryshme, ku është takuar me përfaqësues të tyre për të rritur nivelin e bashkëpunimit dhe për të krijuar ura të reja në dobi të studentëve dhe të rinjve.

Përgjatë qëndrimi të tij në Austri, rektori Hajrizi ka vizituar Institutin Austriak për Mjekësinë Sportive në Vjenë (ÖISM - Österreichisches Institut für Sportmedizin), ku ka parë nga afër laboratorët dhe klinikat, si dhe ka diskutuar me stafin në këtë institucion rreth bashkëpunimit në fushën e edukimit, hulumtimeve dhe projekteve evropiane.

Në këtë vizitë, Rektori Hajrizi ka ndarë eksperiencën e tij dhe të arriturat e UBT-së në fushën e teknologjisë dhe shkencës së sportit me stafin e institutit, në theks të veçantë ka diskutuar për



mundësitë e bashkëpunimit dhe zhvillimit të teknologjive të reja në sport, të mjekësisë sportive, si dhe rreth mundësisë së shkëmbimit të përvojave të përbashkëta. Kjo vizitë ishte një hap i rëndësishëm në zhvillimin e bashkëpunimeve mes UBT-së dhe institucioneve të tjera kërkimore dhe shkencore në nivel global, si dhe në përkrahjen e ndërkombëtarizimit të Kosovës.

Rektori Hajrizi vizitoi parkun e teknologjisë në Seibersdorf



Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, po qëndron për një vizitë dyditore në Austri, ku është duke zhvilluar disa takime të rëndësishme të nivelit të lartë me përfaqësues të institucioneve të ndryshme shkencore, edukative dhe përfaqësuesve të ekonomisë. Rektori Hajrizi fillimisht ka qëndruar për një vizitë në Seibersdorf, i shoqëruar nga Prof. Dr. Norbert Bachl, ku është pritur nga drejtori i laboratorit antidoping dhe i forenzikës, Dr. Günter Gmeiner. Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, i ka prezantuar përfaqësuesve të qendrës së hulumtimit Seibersdorf, aktivitetet që UBT i bënë në fushën e edukimit,

shkencës dhe inovacionet në fushën e forenzikës dhe laboratorëve të testimeve kimike, teksa nga ana tjetër drejtori Gmeiner ka prezantuar në detaje infrastrukturën moderne laboratorike dhe laboratorët e antidopingut, ku edhe mostrat e sportistëve kosovarë bëhen aty, duke qenë kështu një prej qendrave më të mëdha testuese në botë.

Në këtë takim, rektori Hajrizi së bashku me drejtorin Gmeiner, kanë diskutuar edhe për mundësitë e bashkëpunimit mes institucioneve në drejtim të hulumtimeve të përbashkëta, por edhe për aktivitetet e tjera me rëndësi.

Rektori Hajrizi nderohet me Medaljen e Artë për Merita nga Federata Panshqiptare "VATRA"

Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi është nderuar me Medaljen e Artë për Merita nga Federata Panshqiptare "VATRA".

Medalja e Artë për Merita i është dedikuar rektorit Hajrizi për kontributin e jashtëzakonshëm në ngritjen, reformimin, transformimin dhe progresin në kontinuitet për më tepër se dy dekada të arsimit të lartë në Kosovë.

Ndër të tjera, është theksuar edhe partneriteti i besueshëm me Federatën Panshqiptare "VATRA" dhe qasja inovative dhe kreative në shumë fusha të progresit shoqëror në Republikën e Kosovës dhe më gjerë.



Shoqata "KORABI" në Itali ndan mirënjohje për rektorin e UBT-së

Rektori i UBT-së, Edmond Hajrizi, ditë më parë, në Parkun Shkencor Inovativ të UBT-së, ka mirëpritur për vizitë përfaqësues të Shoqatës "KORABI" në Itali, të cilët në shenjë falënderimi dhe respekti ndaj UBT-së i ndanë mirënjohje për bashkëpunimin e mirëfilltë ndër vite.

Shoqata "KORABI" ka vlerësuar lartë bashkëpunimin me UBT-në, duke e parë shumë të rëndësishëm për gjeneratat e reja dhe për krijimin e hapësirave për ta, për të shkëmbyer dhe përfituar përvoja të reja. "UBT vlerëson partneritetin me shoqatën "KORABI", duke

konsideruar se partneritete të tilla u mundësojnë studentëve të UBT-së njohjen me kultura të reja, krijimin e përvojave të ndryshme, si dhe mundësi unike për të marrë praktikat më të njohura ndërkombëtare."

Rektori Hajrizi zhvilloi një diskutim të hapur me studentët dhe stafin akademik të Universitetin e Tiranës

Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi ka qëndruar për vizitë në Universitetin e Tiranës, gjegjësisht në Fakultetin e Historisë dhe Filologjisë, Departamentit mbi Humanitetet Digjitale, me çrast është zhvilluar "History Lab 12", një diskutim i hapur me studentët dhe profesorë të këtij fakulteti.

Në kuadër të këtij diskutimi, rektori Hajrizi ka folur rreth aplikimit të teknologjisë digjitale në shkencën e historisë, rreth rritjes së qasjes dhe përdorimit të burimeve historike, si dhe mundësive për të sjellë ndryshime në mënyrën e të studiuarit të historisë.

Ndër të tjera, rektori Hajrizi ka folur rreth projektit inovativ "History Lab 12", të drejtuar nga UBT,



ku përdoret teknologjia për të sjellë historinë në një mënyrë më të sofistikuar për nxënësit, studentët dhe profesorët, duke e bërë historinë më të qartë, të kuptueshme dhe të aksesueshme për të gjithë dhe duke krijuar mundësi të ndryshme për të mësuar dhe eksploruar atë.

Rektori Hajrizi njëherit ka zhvilluar një takim me dekanin e Fakultetit të Historisë dhe Filologjisë, Prof. Dr. Sabri Laçi, me zëvendësdëkanin, Andi Pinari dhe profesoren Valentina Duka, me të cilët ka folur rreth rritjes së bashkëpunimit, për të krijuar mundësi të reja për studentët dhe profesorët e këtyre dy institucioneve të arsimit të lartë.

Rektori Hajrizi priti gazetarin dhe botuesin e gazetës shqiptaro-amerikane "Illyria", Vehbi Bajrami

Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi mirëpriti në një vizitë në UBT gazetarin dhe botuesin e gazetës shqiptaro-amerikane "Illyria", Vehbi Bajrami, për nder të pesëmbëdhjetë vjetorit të Pavarësisë së Kosovës.

Rektori Hajrizi dhe gazetari Bajrami diskutuan për çështje të ndryshme që ndërlidhen me arsimin, shkencën dhe teknologjinë, teksa ky i fundit i dhuroi libri "Shqiptarët e Amerikës" rektorit Hajrizi, një libër voluminoz, në të cilin flitet për mërgatën shqiptare në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Rektori Hajrizi ka falënderuar gazetarin Bajrami për kontributin dhe lobimin e tij për çështjen kombëtare, duke theksuar se ky libër është një vlerë e shtuar për popullin shqiptar. Për më shumë se 30 vjet, Vehbi Bajrami ka qenë dhe është një ve-



primtar e udhëheqës i komunitetit shqiptaro-amerikan, i angazhuar në lobimin për çlirimin, pavarësinë dhe njohjen e Kosovës, si dhe për mbrojtjen e të drejtave të shqip-

tarëve në trojet e tyre amtare, teksa që nga viti 2006, është botuesi i tretë dhe më jetëgjatë i gazetës së njohur shqiptaro-amerikane "Illyria" në New York.

Rektori Hajrizi takon kryetaren e AMA-s në Tiranë, Armela Krasniqi

Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi ka takuar kryetaren e Autoritetit të Mediave Audiovizive në Shqipëri, Armela Krasniqi, me të cilën diskutuan për funksionimin e institucionit të AMA-s dhe për mundësitë e bashkëpunimit mes Kosovës dhe Shqipërisë në fushën e mediave. Rektori Hajrizi i shoqëruar nga zyrtarët e grupit të medias në UBT, Edonit Behluli dhe Elion Kollçaku, e njoftoi kryetaren Krasniqi me punën dhe angazhimin e UBT-së ndër vite në fushën e mediave dhe televizionit, zhvillimin medial brenda institucional dhe strategjinë e UBT-së për t'i ndihmuar kuadrot e reja në këtë fushë.

Rektori Hajrizi, nga ana e tij, ka theksuar rëndësinë e bashkëpun-

imit mes institucioneve akademike dhe mediatike në Shqipëri dhe në Kosovë dhe ka shprehur dëshirën për të vazhduar kontributin dhe të ndihmojë në zhvillimin e sektorit mediatik në rajon.

Kryetarja Krasniqi ka vlerësuar angazhimin e UBT-së në fushën e mediave dhe ka falënderuar Rektori Hajrizi për vizitën dhe diskutimet konstruktive, duke shprehur dëshirën për të vazhduar bashkëpunimin e dy institucioneve në të ardhmen.

Takimi mes Rektorit Hajrizi dhe kryetares Krasniqi u vlerësua si një mundësi e rëndësishme për të identifikuar fusha të reja bashkëpunimi dhe për të ndihmuar në zhvillimin e sektorit mediatik në rajon.

Rektori Hajrizi priti në takim profesorin e Universitetit Keio, Masahito Kawamori

Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, priti në takim profesorin e Universitetit Keio nga Japonia, Masahito Kawamori, me të cilin diskutuan për mundësitë e bashkëpunimit mes dy universiteteve.

Me mbështetjen e Ambasadës së Japonisë në Prishtinë, ky takim kishte për qëllim kultivimin e lidhjeve të forta mes dy vendeve, duke bashkëpunuar në fushën e arsimit, përmes shkëmbimeve akademike, përpjekjeve të përbashkëta kërkimore, si dhe nisma të ndryshme reciproke.

Rektori Hajrizi dhe profesori Kawamori, ndër të tjera diskutuan për potencialin e madh të dy institucioneve për projekte kërkimore



bashkëpunuese, të cilat mund të hapin rrugë për zbulime në fusha të ndryshme akademike

Rektori Hajrizi priti në takim një delegacion nga Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë



27/03/2023. Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, ka mirëpritur në Parkun Shkencor Inovativ të UBT-së, në Lipjan, një delegacion nga Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë, të prirë nga Presidenti i këtij universiteti, Prof.

Dr. Anastas Angjeli dhe Rektori Prof. Dr. Adrian Civici.

Në këtë vizitë, Rektori Hajrizi, delegacionit nga Shqipëria u ka prezantuar ekosistemin e UBT-së, laboratorët dhe mundësitë që ofron për studentët dhe të rinjtë, me

teknologjitë më të reja që ka zhvilluar institucioni.

Ndër të tjera, Rektori Hajrizi, ka shpalosur edhe inovacionet më të fundit me teknologjitë më moderne, duke përfshirë këtu Realitetin Virtual dhe të Shtuar, Intelligjencën Artificiale, si dhe bashkëpunimet e tjera ndërkombëtare të cilat janë në proces e sipër.

Delegacioni nga Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë u njoftua edhe me qendrat e UBT-së brenda dhe jashtë vendit, si dhe qendrat e teknologjisë dhe inovacionit që studentëve dhe të rinjve po u mundësojnë zhvillimin e tyre profesional bazuar në programet më moderne të universiteteve më me renome të botës.

Në mbledhjen e fundit të Rektoratit të UBT-së, në prag të përgatitjeve të fundit për fillimin e vitit të ri akademik, bazuar në raportin e Agjencisë së Statistikave të Kosovës, u konstatua se edhe këtë vit të gjitha lëndët mësimore në UBT mund dhe do të mbulojnë nga stafi i vet i rregullt akademik.

Kjo tregon se UBT mbetet ende institucioni më i pavarur akademik në Kosovë. Me mbi 1000 staf të rregullt, prej tyre rreth 400 doktorë shkence të fushave të ndryshme, UBT plotëson tërë nevojën me

UBT mbetet institucioni më i pavarur akademik në Kosovë

mësimdhënës për të gjitha fushat e veta dhe tërë vëllimin akademik. Kjo gjendje nuk është e rastësishme, por vjen si rezultat i strategjisë dhe punës së vazhdueshme të UBT-së që nga fillimi i ekzistimit në ngritjen dhe zhvillimin e kuadrove akademike në Kosovë konform standardeve evropiane dhe ndërkombëtare, duke bashkëpunuar në

këtë drejtim me qindra universitete prestigjioze në botë. Kjo ka bërë që UBT të jetë lider në raportin e numrit të stafit të rregullt dhe të studentëve.

Duke u bazuar në këtë indikator por edhe në komponentët tjera të cilësisë, UBT ka marrë çmime dhe rangime të ndryshme të larta ndërkombëtare. Në mesin e tyre

është radhitur edhe nga EFQM, në 9 institucionet më të vlerësuara për cilësi dhe ekselencë në botë.

UBT me stafin e tyre tanimë kanë krijuar një ekosistem inovativ me çka e ka ngritur arsimin e lartë në Kosovë në nivele të larta në botë. Përpos zhvillimit të stafit akademik për nevojat e veta, UBT ka ndihmuar dhe zhvilluar edhe staf akademik (studime të doktoratës, trajnime, e certifikime) për shumicën e institucioneve të tjera të arsimit të lartë në Kosovë.



Kosova bëhet me qendrën e parë në Ballkan për ekselencë dhe zhvillim të kompetencave të së ardhmes

Pas një investimi milionësh të bërë nga UBT, nga sot Kosova është bërë zyrtarisht me qendrën e parë ekselente për mësimdhënie që mbështetin kompetencat dhe aftësitë e së ardhmes "UBT Excellence Learning Center for Future Competences", duke e bërë kështu Kosovën me qendrën e parë të këtij lloji në Evropën Juglindore. Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, me rastin e hapjes së kësaj qendre, theksoi rëndësinë dhe angazhimin e UBT-së në krijimin e një mjedisi të përshtatshëm për mësimin e teknologjisë, inovacionit dhe kompetencave të reja, për një të ardhme më stabile dhe më prosperuese.

Përmes kësaj qendre ne do të bëjmë të mundur studimin, zhvillimin dhe praktikimin e aftësive dhe kompetencave që pritet të ndodhin, si dhe për zhvillimin e metodave të mësimin për të ardhmen.

Sipas Rektorit Hajrizi, është shumë e nevojshme të tregohen metodologji dhe praktika të reja për të mbështetur mësimdhënien që të jenë sa më efektive.

"Kjo është qendra e vetme e këtij lloji në regjion dhe investimet



e kësaj qendre arrijnë në miliona euro. Kemi parë që mësimdhënësit tanë dhe studentët tanë kanë gjeneruar projekteve të mira dhe kemi vërejtur që këtë element është mirë ta shpërndajmë edhe në Kosovë. Ne japim sinjale shumë të mira se Kosova nuk është më ajo që merr por edhe përcjell teknologji. Është e nevojshme të tregojmë metodologji dhe taktika të reja, që për mësimdhënien nuk janë më të vështira, por lehtësojnë mësimdhënien dhe praktikën", theksoi Rektori Hajrizi.

Presidenti i kompanisë së te-

knologjisë virtuale "EON Reality", Dan Lejerskar, u shpreh i lumtur për hapjen e kësaj qendre dhe falënderoi për bashkëpunimin e veçantë dhe të denjë të Rektorit, Prof. Dr. Edmond Hajrizi për të ndihmuar dhe krijuar gjëra të reja në aspektin e arsimit dhe teknologjisë.

Nga ana tjetër, udhëheqësja e projektit Alled 2, Erika Heder, tha se tranzicioni në shoqëritë digjitale nuk është më një ëndërr, por është duke ndodhur, dhe se Kosova është vendi i parë që zbaton dhe harton një qendër të tillë në rajon.

"Sot është një ditë e veçantë dhe jam shumë e lumtur sepse në Kosovë dhe në rajon po zbatohen teknologjia dhe kompetencat më të reja. Shkathtësitë gjatë tranzicionit 4.0 në ambientin global konkurrues, vetëm ekonomitë që mund të ndryshojnë sa më shpejt që është e mundur drejt teknologjive të reja, do të jenë jo vetëm ato të cilat do të mbijetojnë, por edhe ato që do të jenë konkurruese. Tranzicioni në shoqëritë digjitale nuk është më një ëndërr, por është duke ndodhur", tha Erika Heder. Në ceremoninë inauguruese të kësaj

qendre, drejtori i Departamentit për Edukim dhe Zhvillim Profesional në UBT, Prof. Dr. Besnik Skenderi, duke parë nga eksperiencia e tij në fushën e zhvillimit profesional, theksoi se kjo qendër do të jetë një mundësi e mirë dhe e shkëlqyer për të rinjtë në Kosovë dhe rajon për zhvillimin e kompetencave të tyre.

Përgjatë kësaj ceremonie, Rektori Hajrizi, prezantoi disa nga karakteristikat kryesore që do të zbatohen në këtë qendër, ku studentët pritet të marrin kompetencat e së tashmes dhe të ardhmes, por edhe mësimdhënësit do të kenë përparësi që teknologjitë më të reja dhe më të sofistikuar t'i përdorin në praktikë.

"UBT Excellence Learning Center for Future Competences" do të ofrojë mundësi për studentët dhe profesionistët, të ndërveprojnë me teknologjinë dhe të zhvillojnë aftësi të reja që ju përshtaten kërkesave të tregut të punës, bazuar në sfidat e së ardhmes, duke fituar kompetenca të reja në inteligjencën artificiale, inteligjencën emocionale, kreativitetin, si dhe ndërveprime të tjera të cilat janë të një rëndësie të lartë.

Me ftesë të komunitetit arbëresh, Rektori Hajrizi qëndroi për vizitë në Itali

Me ftesë të Shoqatës së Diasporës Shqiptare dhe Arbëreshe "Korabi", Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi për disa ditë qëndroi për vizitë në qytetën Firmo të Italisë, me çrast mori pjesë në një ceremoni të arbëreshëve të Italisë, ku u promovua busti i Nënës Terezë. Rektori Hajrizi përgjatë vizitës së tij në qytetën arbëreshe Firmo, mori pjesë në një konferencë që u organizua atje, ku u prit miqësisht nga shqiptarët që jetojnë dhe veprojnë atje.

"Jam i lumtur dhe i privilegjuar që ndodhem pranë jush dhe njëkohësisht dua të ju falënderojë për kontributin që keni dhënë në ruajtjen e traditës, kulturës, gjuhës dhe identitetit kombëtar shqiptar. Ne do të vazhdojmë që t'ju qëndrojmë afër dhe t'ju mbështesim në vazhdimësi në ruajtjen e këtyre traditave", ka thënë Rektori Hajrizi.

Në këtë vizitë, bërë disa fshatrave dhe qyteteve në Itali, Rektori Hajrizi takoi kryetarë të bashkive, klerikë fetarë, profesorë, përfaqësues të organizatave kulturore, si



dhe banorë arbëreshë të kësaj rrethine.

"Jemi të nderuar me ftesën për të marr pjesë në promovimin e bustit të Nënës Terezë në Qytezën Firmo, një vend i veçantë në regjionin e Kalabrisë dhe kryesisht i populluar nga arbëreshët që flasin gjuhën shqipe. Mikpritja e tyre ishte e ngrohtë, po aq sa dashuria e ruajtjes për gjatë shekujve për gjuhën, kul-

turën dhe traditat tona", ka thënë Rektori Hajrizi.

Promovimi i bustit të Nënës Terezë ishte një ngjarje e rëndësishme për këtë komunitet, duke vlerësuar lartë punën humanitare dhe dashurinë ndaj njerëzve. Pjesëmarrja e Rektorit Hajrizi në këtë ngjarje të rëndësishme, me ftesë nga Shoqata e Diasporës Shqiptare dhe Arbëreshe "Korabi", ishte një moment i veçantë që shpreh respektin dhe dashurinë ndaj bashkëkombësve përtej kufijve.

Gjatë qëndrimit disa ditë, Rektori Hajrizi, vizitoi manastire, muze, bizneset, si dhe shtëpinë ku ka jetuar shkrimtari shqiptar Jeronim De Rada, teksa mori pjesë në koncertin e organizuar enkas për vizitorët në qytezën Firmo.

Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, takoi edhe profesorë arbëreshë të Italisë, me të cilët diskutoi rreth fushës së arsimit dhe shkencës, teksa nga komuniteti i arbëreshëve u ftua që të bashkëpunojnë në të ardhmen për projekte të përbashkëta zhvillimore.

Rektori Hajrizi në diskutimin e VET Summit 2023



Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi mori pjesë në diskutimin e hapur të organizuar nga VET Summit 2023, rreth temës: "A është dialogu social thelbësor në suksesin e transformimit të AAP-së".

Në mesin e përfaqësuesve të shumtë të institucioneve të ndryshme në vend, rektori Hajrizi foli rreth rëndësisë së dialogut social në formësimin e së ardhmes së arsimit dhe aftësimin profesio-

al, duke potencuar se ekosistemi i UBT-së është duke u dëshmuar në rrugëtimin transformues të arsimit në Kosovë dhe rajon.

Rektori Hajrizi vlerësoi se partneritetet e shumta me institucionet arsimore më prestigjioze në Evropë dhe Amerikë, dëshmojnë ndarjen e praktikave më të mira dhe krijimin e zgjidhjeve inovative për avancim në arsimin dhe aftësimin profesional.

Rektori Hajrizi mori pjesë në takimin e dytë në kuadër të Projektit ALLED2



Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi mori pjesë në takimin e dytë të grupit punues për Formulën e Financimit të Arsimit dhe Aftësimin Profesional në Republikën e Kosovës në kuadër të Projektit ALLED2.

Ky takim ka qenë një platformë e

rëndësishme për diskutimin dhe hartimin e udhëzimeve administrative për grantin specifik në fushën e Arsimit dhe Aftësimin Profesional në Kosovë. Qëllimi i këtij udhëzimi administrativ është të përcaktojë parametrat dhe kriteret për grantin specifik për Arsimin dhe Aftësimin Profesional në Kosovë. Rektorit Hajrizi në këtë takim tregoi angazhimin dhe përkushtimin e UBT-së në përmirësimin dhe ofrimin e cilësisë së lartë në sektorin e arsimit dhe aftësimin profesional në Kosovë.

Kryetari i Shkodrës, Benet Beci dhe Ambasadori i Shqipërisë në Kosovë, Qemal Minxhozi vizituan UBT-në

Në Parkun Shkencor Inovativ të UBT-së në Lipjan, qëndruan për vizitë kryetari i Bashkisë së Shkodrës, Benet Beci, dhe Ambasadori i Shqipërisë në Kosovë, Qemal Minxhozi, të cilët u mirëpritën nga Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi.

Me vizitën e Kryetarit Beci dhe të Ambasadorit Minxhozi, u theksua rëndësia e investimeve në fushën e arsimit dhe inovacionit për të ndihmuar në përparimin e komuniteteve dhe zhvillimin e ekonomisë lokale.

Ky moment ishte një ndërthurje e rëndësishme midis personaliteteve të rëndësishme dhe u



shpreh rëndësia për thellimin e bashkëpunimit në të ardhmen.

Rektori Hajrizi shprehu gatishmëri të plotë për të bashkëpunuar me Bashkinë e Shkodrës në projekte të përbashkëta dhe iniciativa që do të sjellin përparim dhe do të

ndikojnë në zhvillimin e rajonit dhe vendit.

Kjo vizitë shërbeu si shembull i fuqisë së bashkëpunimit në realizimin e qëllimeve të përbashkëta në fushën e arsimit dhe inovacionit.

Rektori Hajrizi dhe Prof. Dr. Judithanne Scourfiled Mclauchlan zhvilluan takime të nivelit të lartë institucional në Shqipëri



Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi në vazhden e vizitave të tij, i shoqëruar nga Prof. Dr. Judithanne Scourfiled Mclauchlan, profesore dhe asociuar e shkencave politike në Universitetin e South Florida St. Petersburg, dhe Drejtori i Open Gov Hub Al-

bania, Edison Frangu, qëndruan në Shqipëri dhe zhvilluan takime të rëndësishme të nivelit të lartë institucional.

Rektori Hajrizi, Prof. Dr. Judithanne Scourfiled Mclauchlan dhe Edison Frangu zhvilluan takim konstruktiv me kryetaren e Kom-

sionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, si dhe vizituan Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, si dhe institucione të tjera me rëndësi ku u takuan me përfaqësues të lartë të tyre.

Këto takime ishin të fokusuar në shkëmbim të informacionit, ndërveprimin profesional dhe angazhimin në projekte të përbashkëta. Kjo përpjekje ndër-institucionale ka theksuar synimin e UBT-së për të ndërtuar lidhje të forta akademike dhe profesionale me partnerët strategjikë në Shqipëri.

Këto vizita kanë theksuar angazhimin e UBT-së në të përhapur njohuritë dhe eksperiencën e tyre me institucionet relevante në nivel ndërkombëtar, si dhe kontributin e tyre në fuqizimin e bashkëpunimit dhe zhvillimit të projekteve të rëndësishme në fushën e arsimit dhe shkencës.

Rektori Hajrizi foli për teknologjitë virtuale AR dhe VR në Konferencën EdTech 2023



Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, mori pjesë si folës në Konferencën EdTech 2023, organizuar nga SHPIK dhe Instituti Pedagogjik i Kosovës.

Rektori Hajrizi, shpali idetë dhe konceptet inovative të tij dhe institucionit që udhëheq, lidhur me mundësitë e pakufishme të teknologjive AR dhe VR, duke treguar se si ato po i riformësojnë klasat tradicionale në mjediset mësimore gjithëpërfshirëse, ndërvepruese dhe tërheqëse.

Ai mori shembull zbatimin e këtyre teknologjive në UBT, ku nxënësit

dhe studentët avancojnë njohuritë e tyre duke përdorur teknologji të sofistikuar, përmes AR, VR dhe AI. Ndër të tjera, Rektori Hajrizi potencoi se UBT është duke dhënë një kontribut të veçantë në adaptimin me teknologjitë virtuale të nxënësve dhe mësimdhënësve të shkollave të Republikës së Kosovës, ku së fundmi UBT në bashkëpunim me ALLED2 ka pajisur gjashtë shkolla publike me teknologji të këtij lloji, duke e çuar numrin në 600 të nxënësve që do të mësojnë me këtë teknologji.

Rektori Hajrizi mirëpriti në takim, Ministrin e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Faton Peci

Në Parkun Shkencor Inovativ të UBT-së, në Lipjan, Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, mirëpriti Ministrin e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Faton Peci.

Në këtë vizitë, Rektori Hajrizi e njoftoi ministrin Peci për zhvillimin e UBT-së, si dhe për interesimin e vazhdueshëm për të kontribuar në fushën e bujqësisë dhe zhvillimit rural përmes akademisë.

Ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Faton

Peci, falënderoi Rektorin Hajrizi për mikpritjen dhe shprehur gatishmërinë për bashkëpunim në të ardhmen në fushën e bujqësisë dhe agrikulturës, duke inkorporuar akademinë.

Rektori Hajrizi së bashku me Ministrin Peci, zhvilluan një diskutim të frytshëm me stafin profesional të fushës së Agrikulturës dhe Mjedisit, si dhe studentët e UBT-së për mundësitë e zhvillimit të këtij dikasteri dhe ofrimit të ndihmës për bujqit dhe fermerët.

Rektori Hajrizi mori pjesë në takimin më të madh mes shqiptarëve në Ditën e Arbëreshëve dhe në Samitin e III-të të Diasporës



23/11/2023. Mes personalitetesh të shumta nga politika, kultura, shkenca, arsimit dhe studiuesve të albanologjisë, Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi mori pjesë në takimin më të madh mes

shqiptarëve në Ditën e Arbëreshëve të organizuar në Pallatin e Kongreseve në Tiranë. Dita Arbëreshe u zhvillua me disa sesione shkencore, ku studiues të njohur të Shqipërisë dhe të komunitetit arbëresh shpaleshën

kërkimet e tyre mbi traditat, kulturën, artet dhe gjuhën arbëreshe sot dhe në histori. Me këtë rast, Rektori Hajrizi zhvilloi takime të rëndësishme me figura të larta me çrast diskutoi për mundësitë e rritjes së bashkëpunimit ndër-institucional për të krijuar mundësi të reja për të rinjtë në rajon.

Pas ditës Arbëreshe, Rektori Hajrizi mori pjesë edhe në Samitin e Tretë të Diasporës, i cili u zhvillua me pjesëmarrjen e mbi dy mijë shqiptarëve të regjistruar nga të gjithë shtetet ku ata jetojnë, në të cilin u diskutua mes të tjerash edhe mbi raportet e diasporës me politikën e jashtme të Shqipërisë.

Në UBT qëndroi për vizitë personaliteti i njohur në fushën e biznesit Lazim Destani

29/11/2023. Biznesmeni i njohur Lazim Destani qëndroi për vizitë në Parkun Shkencor Inovativ të UBT-së në Lipjan, me çrast u takua me Rektorin e UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi.

Përgjatë takimit Lazim Destani ndau mendimet e tij për sfidat dhe mundësitë e industri dhe rreth ndërlidhjes me nevojat e tregut të punës për kuadro të reja sidomos me theks të veçantë në teknologji dhe profesionet e reja.

Ai theksoi rëndësinë e bashkëpun-



imit me institucionet e arsimit për të përmirësuar cilësinë dhe ndikimin e arsimit në shoqëri.

Destani shprehur gatishmërinë e tij për të vazhduar kontributin e tij siç edhe ka bërë deri më tani në ndërtimin e një ambienti më të mirë për të rinjtë shqiptarë.

Në anën tjetër, Rektori Hajrizi falënderoi Lazim Destanin për kontributin e madh të tij për çështjen kombëtare, për përkrahjen e universiteteve dhe diasporës në përgjithësi.

Përkushtimi dhe mbështetja e vazhdueshme në promovimin e arsimit dhe hulumtimit shkencor në Kosovë, si dhe inkurajimi dhe motivimi i rinisë së vendeve të Ballkanit, duke u ofruar mundësi punësimi e duke i mbështetur iniciativat e tyre.

Gjatë takimit, Lazim Destani pati mundësinë të shoh nga afër ekosistemin inovativ dhe Qytetin e Mençur të UBT-së në Lipjan, me laboratorët e infrastrukturën moderne. Të dy palët shprehën

gatishmëri për një bashkëpunim më të ngushtë në të ardhmen.

Lazim Destani është sipërmarrës, investitor, filantrop, si dhe mbështetës entuziast i popullit shqiptar dhe i vendeve të Ballkanit në përgjithësi. Ai është gjithashtu një personalitet i njohur për mbështetjen e iniciativave që synojnë avancimin e vendeve të Ballkanit Perëndimor si pjesë integrale e idesë evropiane.

Rektori Hajrizi në organizimin e Ambasadës së Shqipërisë, në 111-vjetorin e pavarësisë

22/11/2023. Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi me ftesë nga Ambasadori i Shqipërisë në Kosovë, Petrit Malaj, mori pjesë në organizimin e Ambasadës, me rastin e 111-vjetorit të shpalljes së pavarësisë së Shqipërisë. Në mes të shumë personalitetëve nga politika, kultura, arsimit e shkenca, Rektori Hajrizi iu bashkua festës mbarekombëtare, në 111-vjetorin e pavarësisë së Shqipërisë.

Rektori Hajrizi falënderoi Ambasadorin Malaj për angazhimin dhe përkushtimin e tij në sferën e arsimit dhe shkencës, gjithash-



tu shprehur vlerësimin për rolin e rëndësishëm të tij në promovimin e arsimit dhe shkencës në Kosovë,

duke e bërë kështu një bashkëpunim të frytshëm dhe të vazhdueshëm në këtë drejtim.

Rektori Hajrizi merr pjesë në takimin e 22-të të "Garden Rotary Club Prishtina"



30/05/2023. Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi ka marr pjesë në takimin e 22-të të "Garden Rotary Club Prishtina", një klub Rotary më i ri në Kosovë, i cili vazhdon takimet e rregullta javore dhe promovimin e vlerave Rotary. Rektori Hajrizi në këtë takim mbajti një prezantim për

zhvillimin dhe të arriturat e UBT-së, një nga Universitetet më të suksesshme në Evropën Juglindore. Rotary është organizatë e cila inkurajon liderët në biznes që të bashkohen me Rotary dhe të konsiderojnë anëtarësimin në "Garden Rotary Club Prishtina".

Në UBT nis event i përmuajshëm “Meeting diplomats”



25.01.2023. Në UBT nisi event i përmuajshëm “Meeting diplomats”, ku i ftuari i parë ishte i Ngarkuari me Punë në Ambasadën e Japonisë në Kosovë, Keisuke Yamanaka.

Në këtë takim mori pjesë edhe rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, ku së bashku me studentët dhe profesorët të UBT-së, u diskutua rreth sistemit arsimor në Japoni, krahasimit midis këtij sistemi me atë në Kosovë, si dhe rreth kulturës japoneze.

Yamanaka prezantoi para të pranishmëve disa nga karakteristika e veçanta të kulturës japoneze, duke e ndërlidhur me sistemin arsimor, zhvillimin e qëndrueshëm, si dhe historinë e vendit.

Ndër të tjera, në këtë takim u diskutua edhe për të përbashkëtat në mes dy shteteve dhe partneriteteve në mes institucioneve arsimore, të cilat do t'u mundësonin të rinjve një eksperiencë të re dhe kualifikime profesionale.

Dr. Rudina Jasini zhvilloi një diskutim me studentët e UBT-së rreth udhëtimit të saj profesional në mbrojtje të drejtave të njeriut



Në Parkun Shkencor Inovativ të UBT-së në Lipjan, qëndroi për vizitë Dr. Rudina Jasini nga “Oxford University”. Në kuadër të vizitës së saj, ajo zhvilloi një diskutim të hapur me studentët dhe profesorët e UBT-së, për tema që ndërlidhen me mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe drejtësisë në përgjithësi.

“Një udhëtim akademik dhe profesional në mbrojtje të të drejtave të njeriut” ishte tema në të cilën u përqendrua diskutimi me Dr. Rudina Jasini, nga ku studentët patën

rastin të dëgjojnë dhe të marrin më shumë njohuri rreth ushtrimit të profesionit nga eksperiencia e saj. Dr. Jasini foli gjithashtu rreth përvojës së saj si avokate dhe studiuese së drejtës penale ndërkombëtare dhe të drejtave të njeriut, si dhe rreth angazhimit të saj në drejtimin e një projekti të Këshillit Kërkimor Ekonomik Social të Mbretërisë së Bashkuar.

“I qëndroj gjithmonë parimit se duhet të kesh një bindje dhe thirrje të brendshme pse ti duhet të

studiosh drejtësi. Për të kuptuar se si funksionon shteti dhe e drejta, për të kuptuar se si e pozicionin ti veten në një shoqëri, jo domosdoshmërisht për t'u bërë një avokat i ardhshëm, por mbi të gjitha duhet ta duash profesionin dhe të kesh një thirrje të brendshme. Dhe, kjo të shtynë pastaj që në një moment të caktuar të japësh kontributin tënd dhe të avancosh disiplinën ku punon”, tha Jasini.

Ajo gjithashtu foli edhe rreth angazhimit të saj si anëtare e Komitetit të së Drejtës Penale Ndërkombëtare të Shoqatës për të Drejtën Ndërkombëtare, si dhe rreth punës së saj si avokate në Tribunalin Penal Ndërkombëtar të Kombeve të Bashkuara për ish-Jugosllavinë në Hagë dhe në përfaqësimin e viktimave të Khmerit të Kuq në Dhomat e Jashtëzakonshme në Gjykatat e Kamboxhias në çështjen e Kaing Geuk Eav.

UBT dhe Ambasada e Suedisë në Kosovë nisin eventin e përbashkët për të rinjtë “Youth talks”

08/03/2023. Në Shtëpinë e Evropës në Prishtinë, UBT bëri hapjen e diskutimeve “Youth talks”, me temën: “Kosova, Evropa dhe Federalizmi: Çfarë mund të mësojmë nga njëra – tjetra”, një bashkëpunim i mirëfilltë me Ambasadën e Suedisë në Kosovë, për të sjellë ide dhe mendime kritike rreth problematikave dhe ngjarjeve që na rrethojnë.

Panelistë në këtë event ishin: Robin R. Mudry nga JEF Europe – Young European Federalists, Taulant Ferati si Young European Ambassador dhe Maja Otterstedt nga Ambasada e Suedisë.

Pjesë e këtij event i ishin edhe ambasadori i Suedisë në Kosovë, Jonas Westerlund dhe rektori i UBT-



së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, teksa e pranishme virtualisht ishte edhe eurodeputetja suedeze, Arba Kokalari.

Rektori Hajrizi falënderoi të pranishmit për pjesëmarrje në këtë ngjarje të rëndësishme, teksa kon-

sideroi të nevojshme zhvillimin e diskutimeve për tema të ndryshme me të rinjtë, dhe studentët.

“E konsiderojmë si shumë të rëndësishme diskutimin me të rinjtë, studentët dhe gjeneratat e reja për tema të ndryshme, pasi që ata

janë personat kyç që do të bëjnë ndryshimet e mëdha në të ardhmen. Falënderoj për zemërsisht Ambasadën e Suedisë në Kosovë dhe Shtëpinë e Evropës për bashkëpunimin drejt kësaj nisme që mendojmë se do të sjell diskutime të frytshme për temat që e preokupojnë shoqërinë tonë”, tha rektori Hajrizi.

Ambasadori i Suedisë në Kosovë, Jonas Westerlund shprehu falënderimet e tij të përzemërta për gatishmërinë për të organizuar ngjarje të tilla me rëndësi për shoqërinë në Kosovë.

“Targeti i Suedisë janë të rinjtë, me çrast Kosova ka një përparësi meqenëse ka mbi 50 për qind të

popullsisë rini, gjë që është një e veçantë që duan ta kenë të gjithë”, potencoi Ambasadori Westerlund. Robin Mudry nga JEF Europe – Young European Federalists theksoi rëndësinë e zgjerimit të Bashkimit Evropian, ku potencoi se Kosova patjetër duhet të jetë pjesë, teksa përmendi përvojën e udhëtimit të tij nga Praga për në Kosovë. Në kuadër të këtij event, panelistët diskutuan tema të ndryshme, që nga edukimi, arsimimi, shkëmbimi i kulturave të ndryshme mes të rinjve e deri te politikat publike, për të cilat u dakorduan se duhet më tepër angazhim dhe vetëdijësim për të pasur zgjidhje të problemeve që preokupojnë shoqëritë.

Fatjona Mejdini diskutoi me studentët e UBT-së rreth medias dhe aktivizmit social



23/01/2023. Në UBT ishte prezente drejtorja për Evropën Juglindore e “Global Initiative against

Transnational Organized Crime”, Fatjona Mejdini, me të cilën, studentët dhe profesorët patën rastin të diskutonin rreth temës: “Media dhe aktivizmi social – Kontributi i të rinjve kundër krimit dhe korrupsionit”.

Studentët e Fakulteteve Shkenca Politike, Studime të Sigurisë dhe Media dhe Komunikim në UBT, si dhe profesorët të këtyre drejtimeve, patën rastin të kenë një diskutim të hapur me Fatjona Mjedi-

nin rreth aktivizmit shoqëror dhe rëndësisë së pjesëmarrjes në organizime të ndryshme me karakter social, edukativ dhe kulturor.

Ndër të tjera, Mejdini diskutoi me studentët rreth Shqipërisë në periudhën e komunizmit, duke treguar edhe mbi eksperiencën e saj për raportimin e ngjarjeve që kishin të bënin me atë kohë, si dhe u vu theksi tek krahasimi i sigurisë në atë kohë me kohën e tashme në këtë vend.

Eksperti Arsim Zeka zhvilloi ligjëratë tematike me studentët e UBT-së

23.01.2023. Pronari i kompanisë “Expert pro”, Arsim Zeka zhvilloi ligjëratë tematike me studentët e Fakultetit Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi në UBT, në kuadër të lëndës “Hyrje në kontabilitetin financiar” nën udhëheqjen e profesoreshës, Fidane Spahija – Gjilkolli.

Tema e ligjëratës ishte “Praktikë në kontabilitet”, ku për qëllim kishte angazhimin e studentëve dhe mundësinë që ata të shohin për së afërmi përdorimin e softuerit të kontabilitetit, në mënyrë që të përfitojnë dhe përforcojnë njohuritë e tyre, si dhe të jenë më të për-

gatitur për tregun e punës. Ndër të tjera, studentët e Fakultetit Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi, patën rastin të shohin edhe prezantimin e softuerit “Expert”, si një ndër softuerët e kontabilitetit më të sofistikuar në treg.

Të flasim për Bashkimin Evropian - nis event i përmuajshëm i UBT-së me Ambasadën e Finlandës në Kosovë



28/02/2023. UBT së bashku me Ambasadën e Finlandës në Kosovë filluan takimet e përmuajshme “Let's talk about the European Union” (Të flasim për Bashkimin Evropian).

Tema e parë që studentët e UBT-së diskutuan bashkë me Ambasadorin e Finlandës, Matti Nissinen, ishte “Roli i Finlandës në Bashkimin Evropian”, duke përfshirë historinë e

hyrjes së BE, rolin e institucioneve në përgatitjen e politikave të BE-së, si dhe hierarkinë e komunikimit institucional. U theksuan dhe prioritetet e Finlandës në Bashkimin Evropian, si shtet proaktiv dhe bashkëpunues, duke shprehur dhe përkrahjen e rrugëtimit të Kosovës në BE. Takimi i parë u mbajt në rezidencën e Ambasadorit të Finlandës, Matti Nissinen.

“Smart City” dhe Zhvillimi i Qëndrueshëm - temë diskutimi ndërmjet rektorit Hajrizi dhe kryetarit të Vushtrrisë, Ferit Idrizi

05/01/2023. Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi i shoqëruar nga drejtori i Institutit për Studime Urbane në UBT, Shqiprim Ahmeti dhe profesori Hazer Dana, kanë zhvilluar një takim me kryetarin e Komunës së Vushtrrisë, Ferit Idrizi, me të cil-

in kanë diskutuar rreth konceptit të qytetit “Smart City”. Temë diskutimi në këtë takim ishte koncepti i qytetit “Smart City”, projekt i UBT-së përmes të cilit synohet procesi i transformimit digjital – përmes teknologjisë – drejt qytetit të

mençur dhe ekologjik. Ndër të tjera, rektori Hajrizi dhe kryetari Idrizi kanë folur edhe rreth mundësisë së rritjes së bashkëpunimit në fusha të ndryshme me qëllim të përafrimit të përvojave akademike dhe komunale.



UBT përmbyll suksesshëm të Konferencës Ndërkombëtare për

29/10/2023. Suksesshëm UBT ka përmbyllur edicionin e dymbëdhjetë të Konferencës Ndërkombëtare për Shkencë, Teknologji, Biznes dhe Inovacion, ku shumë ekspertë dhe profesionistë nga vendi, rajoni dhe bota, kishin si pikëtakim të dijes dhe shkencës Parkun Shkencor Inovativ të UBT-së.

Më shumë se 24 konferenca në fusha të ndryshme të jetës i dhanë kahje interesante Konferencës Ndërkombëtare të UBT-së, ku ekspertët e universiteteve më prestigjioze ndërkombëtare, duke përfshirë edhe Universitetin e Harvardit i thurrën lavde organizimit të një konference të tillë nga një institucion gjigant i arsimit në Kosovës, siç është UBT.

Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Harjizi, përgëzoi të gjithë ata që kontribuan në organizimin e konferencës, teksa i vlerësoi të gjitha konferencat si të sukseshme, duke thënë se kjo është një vazhdimësi e kontributit të UBT-së për shkencën dhe dijen, si një institucion që ka për detyrë për të dhënë kontributin e tij në pjesën akademike dhe shkencore.



edicionin e dymbëdhjetë Shkencë, Teknologji dhe Inovacion



“Jam jashtëzakonisht i lumtur dhe krenar që edhe këtë vit suksesshëm organizuam Konferencën Ndërkombëtare të UBT-së, duke bërë bashkë në një vend shumë shkencëtarë dhe profesionistë të fushave të ndryshme. Kjo i bën mirë shkencës, gjetjeve të reja, studentëve të rinj, për të mësuar nga shkencëtarët më të mirë që ka bota e që sot si vend për t’u takuar e diskutuar e zgjedhën UBT-në dhe konferencën tonë”, ka thënë rektori Hajrizi.

Të veçantë këtë konferencë e bëri edhe organizimi i Konferencës për Leadership, ku morën pjesë ekspertë të leadershipit nga Universiteti i Harvardit, si dhe ekspertë nga Kosova, duke ngritur diskutimin e konferencës në një nivel që Kosova nuk e kishte më parë.

Organizimi i Konferencës Ndërkombëtare për Shkencë, Teknologji, Biznes dhe Inovacion nga UBT, dëshmon fuqishëm angazhimin institucional jo vetëm për nxjerrjen e kadrove të reja, por edhe për zhvillimin e shkencës në Kosovë përmes hulumtimeve shkencore nga ekspertë dhe profesionistë ndërkombëtarë të cilët prezantojnë në konferencat përkatëse në UBT.



Profesori i UBT-së, Petrit Ahmeti certifikohet si trajner për EPC Software Kosovo, mbështetur nga Qeveria Gjermane


23/02/2023. Pas trajnimit disa mujorë të 15 ekspertëve vendorë të eficientës së energjisë dhe testimit final, u certifikuan me sukses trajnerët e parë të softuerit EPC Software Kosovo për certifikimin e performancës energjetike të ndërtesave në Kosovë, ku njëri ndër ta është profesori i Fakultetit të Arkitekturës dhe Planifikimit Hapësinor dhe programit të Eficiencës së Energjisë në kuadër të UBT-së, Dr. Sc. Petrit Ahmeti. Për herë të parë në Kosovë, do të fillojë rangimi dhe certifikimi i ndërtesave bazuar në nivelin e tyre të performancës energjetike. Kjo do të ndihmojë në identifikimin e gjendjes aktuale të performancës energjetike të ndërtesave ekzistuese dhe atyre të cilat do të ndërtohen në të ardhmen, duke



lehtësuar aplikimin e masave renovuese sipas kërkesave aktuale për eficientë të energjisë. Krahas saj, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës është duke përgatitur Regjistrin Kombëtar të ndërtesave të trajtuara dhe certifikuar nga ky proces i rëndësishëm. Trajnerët, do të jenë të angazhuar që të trajnojnë dhe certifikojnë profesionistët e

ardhshëm, në përdorimin e këtij softueri dhe përgatitjen e ekipeve të vlerësuesve të performancës energjetike të ndërtesave në Kosovë. Trajnimi dhe certifikimi i ekspertëve u realizua nga Fraunhofer Institute for Building Physics, kurse u mundësua nga Qeveria Gjermane përmes GIZ Kosovo dhe Banka Gjermane për Zhvillim KfW.

Profesoresha e UBT-së, Jeta Kiseri Kubati prezantoi në Kongresin Evropian të Ortodontisë në Oslo të Norvegjisë



Profesoresha nga Fakulteti i Stomatologjisë në UBT, Dr. Sci. Jeta Kiseri Kubati, prezantoi në Kongresin Evropian të Ortodontisë në Oslo të Norvegjisë, projektin e fundit të bërë në bashkëpunim me profesorin Burim Kiserin, dhe ekspertët e tjerë vendorë. Prezantimi kishte të bënte rreth ndryshimeve në harkun mandibular një vit pas retencionit, me titull: "Changes in mandibular arch in growing subjects twelve months post retention". Kongresin Evropian të Ortodontisë mbledh së bashku profesionistë nga e gjithë bota dhe mbahet çdo vit në vende të ndryshme evropiane.

Profesori i UBT-së, Blerton Abazi mori pjesë në konferencën BalkanSecure



Profesori Blerton Abazi mori pjesë në konferencën BalkanSecure, në panelin ku u trajtua tema kritike e Forcimit të Partneriteteve të Sigurisë Kibernetike në Ballkanin

Perëndimor. Me këtë rast, profesori Abazi prezantoi rëndësinë e krijimit të partneriteteve publike, private dhe akademisë, duke u fokusuar tek transformimi i edukimit dhe rritja e kompetencës përmes ndjekjes së trendeve të teknologjisë.

Profesori Abazi vuri theks të veçantë tek ndërlidhja dhe kontributi i industrisë në edukim, përmes angazhimit si trupa këshilluese nga industria gjatë hartimit të kurrikulave.

Kjo konferencë është organizuar nga Sense Cyber Research Center dhe Chevening Alumni Kosovo (CAK), financuar nga Fondi i Programit Chevening Alumni i Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar.

Profesorë të UBT-së morën pjesë në punëtorinë e Pilotimit të Sistemit Informativ të Kosovës për Kërkime Shkencore - KRIS



18/01/2023. Profesorë të UBT-së morën pjesë në punëtorinë e Pilotimit të Sistemit Informativ të Kosovës për Kërkime Shkencore - KRIS Profesorët e UBT-së, Visar Hoxha, Visar Krelani dhe Izet Kelmendi morën pjesë në punëtorinë e Pilotimit të Sistemit Informativ të Kosovës për Kërkime Shkencore - KRIS, ku Ministria e Ar-

sim, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit në Kosovë, në bashkëpunim me "Heras Plus" dhe "Researchcult" prezantuan konceptin, vizionin dhe qëllimet afatgjata dhe afatshkurtra të sistemit KRIS.

Kjo punëtori mbledhi së bashku përfaqësues të institucioneve të përzgjedhura, sikurse: anëtarë të grupit punues të KRIS dhe zyrtarë

nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit në Kosovë, për të marrë trajnime dhe për të dhënë reagime mbi sistemin. Sistemi Informativ i Kosovës për Kërkime Shkencore apo KRIS (Kosova Research Information system), është një platformë që do të shërbejë në mbledhjen dhe ruajtjen e të dhënave për kërkime shkencore, por edhe si një mekanizëm rregullator për ofrimin e informacionit më të standardizuar në hulumtim.

UBT ka qenë ndër pionierët e këtij sistemi me sistemin RIIMS që nga viti 2015, ndërsa tani MASHTI me përkrahje të Erasmus+ do të krijojë sistemin KRIS për nivel të Kosovës.

Profesorë të UBT-së morën pjesë në trajnimet rreth betonit të organizuara nga kompania "PENETRON" në Greqi

28/03/2023. Në kuadër të inovacioneve në fushën e ndërtimitarisë nga aplikimi për përmirësimin e vetive të betonit deri te riparimi i strukturave, janë duke u prezantuar në detaje si pjesa teorike, aplikative dhe metodat e testimeve në laboratorët që janë krijuar për testimin e të gjitha këtyre produkteve në Athinë të Greqisë, ku është edhe qendra për trajnime të vazh-



dueshme rreth betonit nga kompania "PENETRON". Si përfaqësues të UBT-së në këto trajnime po marrin pjesë dekani i Fakultetit Ndërtimtar dhe Infrastrukturë, Prof. Muhamet Ahmeti, prodekan Prof. Visar Krelani dhe profesori Driton Kryeziu, të cilët të njëjtat eksperiencë do t'i prezantojnë në Kosovë në kuadër të ligjëratave dhe ushtrimeve laboratorike.

Kompania "PENETRON" dhe dega në Kosovë "Penetech" po realizojnë studime dhe hulumtime rreth jetëgjatësisë dhe cilësisë së betonit në laboratorin e materialeve në UBT dhe po ashtu kanë përkrahur aktivitetet e Akademisë Verore dhe të Panairit të Materialeve në UBT.

Profesorët e UBT-së morën pjesë në aktivitete dyditore në Shqipëri në kuadër të projektit dypalësh Kosovë - Shqipëri



15/03/2023. Profesorët nga Departamenti i Shkencave të Ushqimit dhe Bioteknologjisë dhe Agrikulturës në kuadër të projektit dypalësh Kosovë - Shqipëri me qëllim "Vlerësimi i Indikatorëve të Monitorimit të Cilësisë së Ujërave të Shkarkimit që Gjenerohen nga Industria Agro - Ushqimore", projekt ky i financuar nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit në Kosovë dhe Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKK-SHI) morën pjesë në aktivitete

dyditore në Shqipëri. Me këtë rast grupi i UBT-së i përbërë nga dekani i Fakultetit Shkencë të Ushqimit dhe Bioteknologjisë dhe Agrikulturës, Fidan Feka, profesoresha njëherit koordinatoreja e projektit për Kosovë, Emine Daci - Zejnullahu dhe profesoresha Luljeta Ajdini, vizituan industri ushqimore si industri të përpunimit të mishit, vajit të ullirit dhe kompaninë "Cola - Cola Bottling Shqipëria".

Përgjatë kësaj vizite, në ambientet e Universitetit Bujqësor të Tiranës u organizua punëtorja e dytë

në kuadër të projektit dypalësh Shqipëri - Kosovë, ku të pranishëm ishin edhe studentët e ciklit të dytë master profesional "Analizat e Ushqimit", teksa fokusi i kësaj punëtorie ishte prezantimi i rezultateve të arritura në vitin e parë të implementimit të projektit dhe rëndësia në menaxhimin e mbetjeve industriale ushqimore përmes zbatimit të praktikave të mira të prodhimit.

Gjatë këtij aktiviteti studentët shfaqën interes në lidhje me "Valorizimin e mbetjeve të gjeneruara nga industria ushqimore dhe rëndësinë e aplikimit të tyre si përbërës funksional në produkte ushqimore", si dhe u diskutuan edhe format konkrete të bashkëpunimit për aktivitetet në të ardhmen si në mes dy institucioneve arsimore në pjesën akademike dhe në mes të studentëve.

Stafi i UBT-së ishte për vizitë në "Technical University of Sofia" - temë diskutimi mobiliteti në kuadër të Erasmus+ dhe Cepus



14/03/2023. Stafi i UBT-së, gjegjësisht i Zyrës Ndërkombëtare i përbërë nga Lirigzona Morina, Elinda Krasniqi dhe profesorët: Lavdim Menxhiqi dhe Blerim Zylfiu, ishte për vizitë në "Technical University of Sofia" në Sofia të Bullgarisë, për të diskutuar për mobilitet në kuadër të Erasmus+ dhe Cepus. Në kuadër të kësaj vizite, stafi i UBT-së dhe ai "Technical University of Sofia" kanë diskutuar për zhvillimin e mëtejshëm të

bashkëpunimit ndërmjet dy institucioneve, duke u ofruar mundësi të reja studentëve dhe stafi. Ndër të tjera, përfaqësuesit e UBT-së: Lirigzona Morina, Elinda Krasniqi, Lavdim Menxhiqi dhe Blerim Zylfiu, i kanë njoftuar stafin e "Technical University of Sofia" rreth mundësive që ofron UBT për studime, si dhe kanë theksuar nevojën e bashkëpunimeve ndërkombëtare si pikë kyçe të zhvillimit të përbashkët.

Profesori i UBT-së, Skender Kosumi vlerësohet me çmimin e arkitekturës “Gebaut 2022”



Për projektin inovativ të tij smart, me cilësi të lartë dhe stimulues, profesori të UBT-së, Skender Kosumi, i është dhënë nga qyteti i Vjenës, çmimi i arkitekturës “Gebaut 2022”.

Së bashku me kompaninë HNP Architects, profesori Kosumi, ka projektuar kompleksin e gjerë me përmbajtje banimi e komerciale në Aspern, njohur tashmë si pjesë e

qytetit Smart të Vjenës.

Në këtë projekt vihen në pah potencialet urbane në shërbim të një qëndrueshmërie me cilësi të lartë. Pamjet dhe tejkushmëritë promovojnë orientim, siguri dhe rehati në hapësirën e brendshme gjysmë-publike, me ndihmën e një niveli të dytë të përdhësës.

Përmes një ngritjeje të butë me shkallë-rampa, tërhiqet parku i afërt

publik i një niveli më privat në brendi të kompleksit, skajet hermetike të së cilës gjallërohen përmes një ndërhyrjeje në mes të objektit e quajtur “dritarja e qytetit”. Dizajni i hyrjeve ofron reflektim urban, butësi pranë parkut dhe lozonjar si një tribunë në liqen.

Kontaktet sociale mbështeten nga dizajni i hapësirës për qëndrim në hapësira që sigurojnë aktivitete krijuese, ndërsa jeta dhe puna gërshetohen me kompleksin komercial. Sistemi ngrohjes dhe ftohjes funksionon me energji autonome gjeotermike dhe asaj solare.

Qyteti i Vjenës u jep çmime projekteve inovative, me cilësi të lartë dhe shembuj stimulues që kontribuojnë gjithashtu në qëndrueshmërinë sociale dhe në mbrojtje të klimës.

Profesori i UBT-së, Besnik Skenderi mori pjesë në takimin fillestar të projektit për “TUCEP” në kuadër të Erasmus+



10/03/2023. Drejtori i Departamentit për Edukim dhe Zhvillim Profesional në UBT, njëherit profesori Besnik Skenderi, mori pjesë në takimin fillestar të projektit për

“TUCEP” në Perugia të Italisë, projekt ky në kuadër të Erasmus+. Projekti për “TUCEP” ka të bëjë me ndërtimin e kapaciteteve në fushën e arsimit dhe trajnimeve, ku UBT së bashku me dy universitete nga Shqipëria dhe me universitete nga Perugia, do të punojnë kurrikula dhe platforma për sektorin e turizmit dhe hotelierisë për Ballkanin Perëndimor.

“Tiber Umbria Comett Education Programme – International network for knowledge and job”, është një prej shumë projekteve që UBT po merr pjesë në kuadër të Erasmus+, e që përmes tyre po synon që studentëve dhe të rinjë t’ju ofroj shkëmbime studentore.

Profesoresha e UBT-së, Miranda Sejdiu Abazi prezantoi në Kongresin Ballkanik 26th BASS Congress



Profesoresha e UBT-së nga Fakulteti i Stomatologjisë në UBT, Dr. Sci. Miranda Sejdiu Abazi, prezantoi në Kongresin Ballkanik 26th BASS Congress - “Current Trends and Advances in Dentistry”, e mbajtur në Shkup.

Profesoresha Miranda Sejdiu Abazi prezantoi rreth temës: “Assessment of palatoscopy among adolescents of South East Kosovo and their reproducibility in Stomatology”. Prezantimi i studimit të profesoreshës Miranda Sejdiu Abazi në këtë kongres krijon mundësi për ndarjen e njohurive dhe përvojave të reja në fushën e stomatologjisë me kolegët e tjerë të profesionit.

Pjesëmarrja në kongreset dhe konferencat e tilla ndërkombëtare ndihmon në përmirësimin e praktikave dhe në njohjen e trendeve të reja në stomatologji, duke e bërë kështu profesionin më të përparuar dhe të përshtatshëm për nevojat e pacientëve.

Profesoresha e Inxhinierisë së Agrikulturës dhe Mjedisit në UBT, Besa Veseli ligjëron në “Sapienza University of Rome” në Itali



Nga marrëveshja e “Dual Degree” përmes “Sapienza University of Rome” dhe UBT-së, profesoresha

e Fakultetit Inxhinieria e Agrikulturës dhe Mjedisit, Besa Veseli ka zhvilluar ligjëratat në “Sapienza University of Rome” në Itali.

Në kuadër të marrëveshjes për bashkëpunim ndërinstitucional për shkëmbimin e stafit akademik dhe studentëve të fushës së mjedisit është një e mirë e ndarjeve të njohurive në treg evropian dhe bashkëpunim korrekt me këtë Universitet.

Përgjatë qëndrimi të saj në Itali, Prof. Asoc. Dr. Besa Veseli ka takuar dhe ka zhvilluar diskutime me stafin e këtij institucioni, ku ka parë nga afër laboratorët dhe punën hulumtuese të studentëve dhe stafit në përgjithësi.

Në “Sapienza University of Rome”,

profesoresha Veseli ka ndarë eksperiencën e saj dhe të arriturat e UBT-së në fushën e teknologjisë, shkencës së ushqimit dhe inxhinierisë së agrikulturës dhe mjedisit me stafin e këtij institucioni. Në theks të veçantë ka mbajtur ligjëratë për pjesën e mjedisit në përgjithësi në pjesën e ajrit, ujit, tokës dhe ndërlidhjen me ushqimin dhe pjesën e zhvillimit të qëndrueshëm në aspektin e energjisë së rinovueshme.

Ky bashkëpunim mes UBT-së dhe institucioneve të tjera kërkimore dhe shkencore në nivel global, ishte një hap i rëndësishëm në zhvillimin si dhe në përkrahjen e ndërkombëtarizimit të Kosovës.

Stafi i UBT-së mori pjesë në takimin punues për hartimin e planit zhvillimor komunal të Klinës për periudhën 2023/31



10/11/2023. Përfaqësues nga Instituti për Studime Urbane dhe Planifikim Hapësinor në UBT ishin pjesë e takimit në cilësinë e konsulentit të angazhuar nga Komuna

e Klinës për hartimin e draftit për profilin e komunës dhe vlerësimin e gjendjes ekzistuese të planit zhvillimor komunal 2023/31.

Në këtë takim, nga Instituti për

Studime Urbane dhe Planifikim Hapësinor në UBT ishin: Prof. Hazer Dana, Prof. Visar Baxhuku, Prof. Medin Zeqiri dhe Medina Shalaku, ndërsa nga Komuna e Klinës, kryetari i Komunës së Klinës, Prof. Dr. Zenun Elezaj, bashkë me drejtorët e drejtorive dhe zyrtarët komunal.

Kryetari Elezaj theksoi se hartimi i PZHk-së për vitet vijuese është shumë i rëndësishëm për komunën e Klinës dhe kërkoi angazhim maksimal si nga zyrtarët e komunës ashtu edhe nga operatori ekonomik i angazhuar për hartimin e planit.

UBT është duke përkrahur disa komuna të Kosovës në hartimin dhe implementimin e politikave zhvillimore për zhvillim të qëndrueshëm dhe rritjen e cilësisë së jetës.

Profesoresha e UBT-së, Denis Celcima mori pjesë në Konferencën e Federatës për Paqe Universale



20/11/2023. Dekania e Fakultetit Psikologji, Dr. Denis Celcima si përfaqësues e UBT-së mori pjesë në Konferencën e Federatës për Paqe Universale, ku u diskutua rreth temës: “Funksioni ekonomik i familjes sot – Ekuilibrimi i përgjegjësi sociale dhe individuale”. Në fokus të konferencës ishin vlerat e familjes dhe roli i saj në krijimin e një mjedisi të qëndrueshëm dhe të harmonizuar. Profesoresha Celcima ka ndarë pikëpamjet dhe rezultatet e studimeve më të fundit nga fusha e

psikologjisë, duke argumentuar se familja ka një ndikim thelbësor në zhvillimin personal dhe shoqëror të individëve.

Përfaqësuesja e UBT-së ka shpalosur kontributet specifike të universitetit në këtë drejtim dhe ka prezantuar inovacionet dhe projektet e fundit që kanë lidhje me këtë temë.

Ky angazhim thekson vizionin dhe misionin e UBT-së për të ndikuar pozitivisht në sfidat aktuale shoqërore dhe për të përcjellë njohuri të reja në këtë fushë.

Profesori nga UBT, Petrit Ahmeti pjesë e vlerësimit të doktoratës në kuadër të “Marcel Breuer Doctoral School - University of Pécs”

Me ftesë zyrtare nga “Marcel Breuer Doctoral School - University of Pécs”, profesori i UBT-së, Dr. Sc. Petrit Ahmeti, ishte pjesë e procesit të vlerësimit të tezës së doktoratës, në cilësinë e vlerësuesit të jashtëm.

Disertacioni i titulluar: “A Systematic Approach of Energy Efficiency and Thermal Comfort

Strategies for a Prototype of Residential Building Design Using Energy Simulation Tool”, është një hulumtim disavjeçar në kuadër të Fakultetit të Inxhinierisë dhe Teknologjisë Informativë të Universitetit të Pécs-it në Hungari, i cili pas vlerësimit të komisionit, ku bënte pjesë si vlerësues i jashtëm edhe profesor Ahmeti dhe pas

mbrojtjes së suksesshme, mori vlerësimin maksimal.

Angazhimi i stafit akademik të UBT-së në procese vlerësuese të doktoratës në kuadër të Universiteteve ndërkombëtare është tregues se UBT përfaqëson nivel të lartë të përgatitjes shkencore dhe akademike edhe jashtë kufijve të Republikës së Kosovës.


Edicioni i dymbëdhjetë i “Global UBT Fest 2023”

02/08/2023. Festivali tradicional më i madh i dijes dhe shkencës në Kosovë dhe Evropë “Global UBT Fest 2023” suksesshëm ka përmbyllur edicionin e dymbëdhjetë me të gjitha aktivitetet e parapara për këtë vit.

30 shkolla verore gjatë 31 ditëve të korrikut, mbledhën studentë, profesorë, ekspertë dhe profesionistë të fushave të ndryshme, nga Kosova, rajoni dhe bota, për të organizuar debate e ligjërata tematike rreth temave specifike, të cilat u trajtuan me qëllim që studentët dhe pjesëmarrësit e tjerë të avancojnë dhe të përfitojnë njohuri të reja rreth profesionit të tyre.



Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi theksoi se “Global UBT Fest 2023” ka shërbyer si një platformë e fuqishme për të nxitur ndarjen e dijes dhe për të frymëzuar rininë në ndjekjen e pasionit të tyre për dije dhe shkencë. Rektori Hajrizi vuri në dukje se angazhimi i pjesëmarrësve dhe profesionalizmi i tyre në prezantimet e tyre ka kontribuar në një eksperiencë të pasur edukative për të gjithë.

“Festivali u shënuar me aktivitete të ndryshme, duke përfshirë prezantime të akademikëve të shquar, punëtori kreative, sesione dhe takime për të shkëmbyer idetë dhe njohuritë e tyre. Shkolla ver-



ore ofroi një gamë të gjerë temash dhe disiplina shkencore, duke dhënë mundësi pjesëmarrësve të zgjedhin ato që i interesonin më shumë”, tha Rektori Hajrizi. Ky festival mbledhi pjesëmarrës nga Kosova, rajoni dhe bota, për të trajtuar tema specifike që kanë të bëjnë me fushat e tyre të studimit, si dhe ishte një mundësi unike për

të zgjeruar dijen dhe për të eksploruar aspekte të ndryshme të profesionit të tyre. Pjesëmarrja aktive dhe angazhimi i të gjithë pjesëmarrësve, si dhe shkëmbimi i përvojave dhe ideve, bënë që ky festival të jetë një nga evenimentet më të suksesshme në fushën e dijes dhe shkencës në Kosovë dhe Evropë.



Në UBT u organizua konferenca “Kosova and New Urbanism: Resilience, Innovation, Technology, Sustainability and Investments”

16/02/2023. Në Parkun Shkencor Inovativ të UBT-së, në Lipjan, u mbajt konferenca “Kosova and New Urbanism: Resilience, Innovation, Technology, Sustainability and Investments”, e cila po organizohet në prag të shënimit të 15-vjetorit të Pavarësisë së Kosovës, nga UBT, Rrjeti i Bizneseve të Diasporës Shqiptare dhe Federata Panshqiptare e Amerikës “VATRA”.

Në hapje të kësaj konference morën pjesë personalitete të shquara nga politika, kultura dhe arsimit në Kosovë, të cilët i dhanë madhësinë kësaj konference dhe rëndësinë e trajtimit të temës që e karakterizon atë, duke u përqendruar në reziliencë, inovacion, teknologji, zhvillim të qëndrueshëm dhe investime strategjike.

Konferencën “Kosova and New Urbanism: Resilience, Innovation, Technology, Sustainability and Investments” e karakterizoi pjesëmarrja e veprimtarit të shquar të çështjes së Kosovës në Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe njërit ndër lobuesit më të mëdhenj të lirisë dhe pavarësisë së Republikës së Kosovës, Jim Xhema, kryeministrit të Republikës së Kosovës, Albin Kurti, rektorit të UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi,



Prof. Dr. Edmond Hajrizi, presidentit të Federatës Panshqiptare në Amerikë “VATRA”, Elmi Berisha, presidentit të Rrjetit të Bizneseve Shqiptare në Diasporë, Nazar Mehmeti, themeluesit të “Christopher Hyland Inc.” dhe drejtorit të “Hylandtown”, Christopher Hyland, kryetarit të Komunitetit të Prishtinës, Përparim Rama, presidentit të AESOP-së, Thomas Dillinger, si dhe të Mark Barrett nga Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ).

Në fjalën e tij, kryeministri Kurti tha se është nder prania e tij sot në prag të 15-vjetorit të shpalljes së Pavarësisë së Republikës së

Kosovës dhe të merrte pjesë në këtë konferencë të rëndësishme për të diskutuar, në frymë shkencore e profesionale, për të ardhmen e qëndrueshme të qyteteve tona, dhe për të ardhmen e qëndrueshme të shoqërisë sonë.

“Krahas punëve dhe planeve tona si Qeveri, bashkëpunimi me akademinë, me universitetet, me fakultetet, me institutet e hulumtimit është jashtëzakonisht i rëndësishëm. Ai nuk është vetëm synim i yni i njëanshëm. Por është domosdoshmëri për të ndërtuar një të sotme stabile dhe një të ardhme të qëndrueshme dhe prosperuese, për të gjithë. Prandaj edhe jemi sot

dhe jo vetëm sot këtu me juve”, tha kryeministri Kurti.

Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi duke falënderuar të pranishmit për pjesëmarrjen e tyre, ai ritheksoi se planifikimi hapësiror dhe urbanizimi janë fusha tejet të rëndësishme për të cilat UBT ka punuar gjatë, fusha për të cilat UBT ka krijuar programe të posaçme studimi, e që i kanë dhënë karakter tjetër nivelit të studimeve akademike në këtë fushë.

“Kur shohim se çka është bërë për këto 24 vite, jemi dëshmitar të një rimëkëmbjeje të shpejtë-megjithëse fragjile, ri-orientimi socio-ekonomik, si dhe dëshmitarë

të një pune të palodhshme për të qar përpara proceset transformuese dhe zhvillimore. E për gjithë këtë duhet të jemi krenarë, edhe ne, por edhe miqtë tanë të cilët kanë qenë edhe përkrahësit, por edhe motivuesit tanë përgjatë gjithë këtij rrugëtimi”, theksoi rektori Hajrizi.

Veprimtari i shquar i çështjes së Kosovës në Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe lobuesi më i madh për lirinë dhe pavarësinë e Republikës së Kosovës, Jim Xhema u shpreh mirënjohës dhe falënderues për mikpritjen duke theksuar nevojën për angazhimin e të rinjve për të studiuar dhe punuar në drejtim të sigurisë dhe ardhmërisë së Kosovës.

“Më duhet që të sigurohem që ju e dini se jeni ardhmëria dhe shpresa jonë. Pa ju nuk ka asgjë dhe nuk do të arrihet shumë. Ju duhet që të punoni e studioni shumë për të punuar për sigurinë e vendit tonë dhe ardhmërinë. Duhet t’i merrni studimet shumë seriozisht. Unë personalisht do të qëndrojë i kyçur me ju këtu dhe do të bëjë fonde me të cilat do të sigurohem që bashkërisht t’i arrijmë qëllimet tona”, u shpreh Jim Xhema.

Në UBT u hap ekspozita mbarëkombëtare e Kolonisë Artistike “Vizioni 2023 UBT”



13/11/2023. Parku Shkencor Inovativ i UBT-së në Lipjan u bë pikëtakimi i artistëve nga vendi dhe rajoni për të hapur edicionin e parë të ekspozitës së Kolonisë Artistike “Vizioni 2023 UBT”, e cila zhvilloi aktivitetet e saja nga 10 deri 13 nëntori me mbështetjen e UBT-së nën qiellin e Alpeve shqiptare, në Bogë të Rugovës.

Në këtë ngjarje artistike, ku krijimtaria dhe talenti vinin në përputhje me natyrën dhe bukurinë e zonës, mori pjesë edhe Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi.

Rektori Hajrizi në shenjë falënderimi dhe respekti për angazhimin

dhe punën e secilit artistë pjesëmarrës në Koloninë Artistike “Vizioni 2023 UBT”, ndau nga një mirënjohje nga ana e UBT-së.

Boga e Rugovës, nën qiellin e Alpeve shqiptare, u bë ambienti perfekt për punimet e artistëve, duke ofruar jo vetëm një sfond natyror të mrekullueshëm, por edhe një burim frymëzimi për ta. Shumë prej tyre gjetën një atmosferë të veçantë, ku imazhet më artistike u krijuan dhe u shpalosën në mënyrë autentike.

Elementi i rëndësishëm i kësaj ngjarjeje krijuese ishte kuratori i Kolonisë Artistike, Hivzi Muharre-

mi, i cili udhëhoqi me pasion dhe ekspertizë, duke e bërë atë një përvojë të paharrueshme për të gjithë pjesëmarrësit dhe vizitorët.

Shfaqja e punimeve të cilat u realizuan në Bogë të Rugovës në ambientet e Parkun Shkencor Inovativ të UBT-së në Lipjan, shënoi një ngjarje të rëndësishme, ku bëri bashkë artistë, kuratorë, studentë e profesorë.

Ata panë nga afër punimet e mbi 24 artistëve nga vendi dhe rajoni, si dhe u frymëzuan nga perspektivat e tyre për natyrën e bukur të Bogës dhe Rugovës në përgjithësi.

Në UBT hapet ekspozita e titulluar “SHIFT, the perspective”



01/06/2023. Studentët e vitit të parë, dytë dhe të tretë të Fakultetit Art dhe Media Digjitale në UBT hapën ekspozitën e titulluar “SHIFT, the perspective” në Parkun Shkencor Inovativ të UBT-së në Lipjan, një ekspozitë që përmban një gamë të larmishme veprash arti, instalacionesh dhe shfaqjesh.

Përmes kësaj ekspozite, synimi i artistëve ishte kërkimi i mundësisë për një ndryshim në perspektivë, duke tërhequr vëmendjen mbi rëndësinë e procesit krijues. Duke parë prapaskenat e çdo veprë dhe çdo artisti, ata synojnë të

nxjerrin në pah aspektet unike dhe të papërsëritshme të punës së tyre dhe t’u ofrojnë shikuesve një kuptim më të thellë të rrugëtimit krijues që qëndron pas çdo krijimi artistik.

Ekspozita u jep mundësinë të gjithë të interesuarve, përfshirë studentë, artistë, përkthyes, kritikë arti dhe publikun e gjerë, për të eksploruar botën e artit dhe e krijimtarisë së studentëve të Fakultetit Art dhe Media Digjitale në UBT.

Ekspozita është mbështetur nga: Stone Castle, Olive Bakery and Coffee dhe Ujë Rugove.

Profesori portugez, Jorge de Brito zhvilloi një punëtori rreth hulumtimeve shkencore me studentë dhe profesorë të UBT-së

14/02/2023. Në Parkun Shkencor Inovativ të UBT-së, në Lipjan, qëndroi për vizitë profesori portugez, Jorge de Brito – João Ramôa Correia, me çrast zhvilloi një punëtori rreth botimeve shkencore në revista, si dhe metodave për kërkime shkencore.

“Some Reflections about the Publication of Papers in International Journals”, ishte tema të cilën e trajtoi profesori Jorge de Brito, duke u shtjelluar detaje të pranishmëve rreth llojeve të revistave dhe përzgjedhjes

së tyre, planifikimit dhe përgatitjes së dokumenteve, si dhe rekomandimeve për hartimin e dokumenteve.

Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi e falënderoi për pjesëmarrjen profesorin portugez, Jorge de Brito, duke theksuar nevojën e trajtimit të temave të tilla, që do t’i ndihmonin studentët dhe profesorët për përfitim e njohurive të reja.

Për punimet shkencore dhe botimin e tyre në revista, profesori Jorge de Brito, kishte disa rekomandime për të pranishmit, ndër të



cilat ishin: përfundime interesante dhe të shkurtra, të dobishme por jo spekulative, mos-përsëritja e përshkrimeve të mëparshme të përfshira në seksionet e tjera, identifikimi i qartë i kontributit në punim, si dhe shmangja e referimit të rezultateve që janë të njohura.

Jorge de Brito është profesor në Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit në Universitetin e Lisbonës në Portugali. Ai ka mbi 600 botime në revista shkencore, duke përfshirë 11 libra si autor.

Konferenca e Dytë Globale e Tolerancës Ndërkulturore në UBT

Studiues, pedagogë, diplomatë nga vende të ndryshme të botës, si dhe përfaqësues të Fondacionit Ndërkombëtar për Tolerancë u mbledhën në Parkun Shkencor Inovativ të UBT-së, në Lipjan, për të bërë hapjen e Konferencës së Dytë Globale të Tolerancës Ndërkulturore.

Objektivi kryesor i konferencës është të shërbejë si një platformë për studiuesit, pedagogët, drejtuesit, diplomatët dhe të gjithë praktikuesit e tjerë për të nxjerrë në pah kërkimet, mendimet, shqetësimet dhe përvojat e tyre mbi ndikimin e teknologjisë në vlerat dhe normat kulturore.

Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi në fjalën e tij hyrëse falënderoi përfaqësuesit e Fondacionit Ndërkombëtar për Tolerancë për organizimin e Konferencës së Dytë Globale të Tolerancës Ndërkulturore në UBT, në një institucion lider të inova-



cionit dhe teknologjisë në Kosovë dhe rajon.

“Kjo konferencë sjell diskutimin në nivel profesional dhe akademik për çështjen e tolerancës ndërkulturore. Është një çështje shumë e rëndësishme, e vështirë, por dhe shumë e nevojshme. Është shumë

më e nevojshme të shprehen, le të themi, njohuritë në këtë drejtim, sepse mendoj se bota ka nevojë për konferenca të tilla. Toleranca është të jesh i hapur dhe pranues ndaj dallimeve, si dhe të respektosh dhe vlerësosh kulturën e tjetrit”, tha rektori Hajrizi.

H.E. Eng. Sheikh Salem bin Sultan bin Saqr Al Qasimi shprehu mirënjohje dhe përshëndetje të ngrohta për të pranishmit në këtë konferencë nga Emiratet e Bashkuara Arabe, duke thënë se është një simbol i mishërimit të paqes dhe tolerancës.

“Në të gjithë botën kulturat, ideologjitë dhe toleranca janë virtyte, që kontribuojnë në vendosjen e urave midis anëtarëve të një shoqërie apo një shteti”, u shpreh Eng. Salem Alqasim.

Drejtori Ekzekutiv i Fondacionit Ndërkombëtar për Tolerancë, Dr. Abdulhamied Alromaithy falënderoi rektorin Hajrizi dhe UBT-në, të cilët mundësuar organizimin e kësaj konference me karakter ndërkombëtar në Kosovë, duke u dhënë një mundësi studiuesve dhe pedagogëve të shfaqin perspektivat e tyre në aspektin e tolerancës ndërkulturore.

Në këtë ngjarje u bë ndarja e mirënjohjeve për kontribuuesit të cilët mundësuan organizimin e Konferencës së Dytë Globale të Tolerancës Ndërkulturore, si dhe u shfaqën performanca me motive kulturore nga Emiratet e Bashkuara Arabe.

Në UBT u mbajt Konferenca “Elementet e Sigurisë në Rrugë dhe Auditimi i tyre”



Në qendrën e UBT-së në Prishtinë, është mbajtur konferenca: “Elementet e Sigurisë në Rrugë dhe Auditimi i tyre”, organizuar nga Fakulteti Inxhinieri e Ndërtimit dhe Infrastruktural në UBT. Paneli ishte i përbërë nga rektori i

UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, profesorët: Nol Dedaj, Beni Kizolli, Visar Baxhuku, nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastruktural, Milaim Ahmetaj, si dhe përfaqësuesit nga

Policia e Kosovës, Nazmi Zogaj dhe Naim Latifi.

Në fjalën e tij, rektori Hajrizi vlerësoi organizimin e kësaj konference dhe trajtimin e temave të tilla, të cilat janë me karakter sensibilizues dhe informues, teksa theksoi nevojën për siguri më të shtuar në komunikacionin rrugor.

Panelistët e tjerë me ekspertizën e tyre të thellë dhe përvojën në fushën e sigurisë rrugore, kontribuan në trajtimin e temave dhe prezantuan informacione të rëndësishme për audiencën.

Në këtë konferencë u prezantuan edhe gjetje të një hulumtimi shkencor lidhur me sigurinë në komunikacion, shkaqet e aksidenteve, si dhe statistika të tjera të cilat lidhen me komunikacionin rrugor.

Në Shtëpinë e Evropës u mbajt një diskutim i hapur për prioritetet, sukseset dhe sfidat e BE-së



Në Shtëpinë e Evropës u organizuan një diskutim i hapur në mes Ambasadorit të BE-së në Kosovë, Tomas Sunjog, Ambasadorit të Suedisë në Kosovë, Jonas Westerlund dhe studentëve të UBT-së, për prioritetet, sukseset dhe sfidat e BE-së.

Në këtë ngjarje u shpallën dhe u shkëmbyen pikëpamje të ndryshme

në mes studentëve, Ambasadorëve të Rinj Evropianë, Ambasadorit të BE-së dhe atij të Suedisë.

Vendimi i fundit për liberalizimin e vizave për Kosovën, Pakoja e BE-së për mbështetje të energjisë, solidariteti i BE-së në funksion të agresionit rus kundër Ukrainës, si dhe Dialogu Kosovë - Serbi ishin disa ndër temat e folura.

Ish-ambasadori i Holandës në Kosovë, Robert Bosch qëndroi për vizitë në UBT



Në Parkun Shkencor Inovativ të UBT-së në Lipjan, qëndroi për vizitë ish-ambasadori i Holandës në Kosovë, Robert Bosch, me të cilin u organizua një diskutim i hapur rreth zhvillimeve në Kosovë dhe rreth mundësisë së bashkëpunimit në të ardhmen.

Ish-ambasadori Bosch u shpreh me kënaqësi për suksesin dhe kontributin e UBT-së në fushën e arsimit të lartë dhe inovacionit në

Kosovë. Ai vuri në dukje rëndësinë e investimeve në arsimin dhe inovacionin e vendit për të avancuar zhvillimin e tij ekonomik dhe social.

Vizita e ish-ambasadorit Bosch në Parkun Shkencor Inovativ të UBT-së ishte një ngjarje e rëndësishme që theksoi rolin e universitetit në promovimin e dialogut të hapur dhe në krijimin e bashkëpunimeve të reja.

Përfaqësues të UBT-së dhe “Linnaeus University” zhvilluan një takim konstruktiv - temë diskutimi zgjerimi i bashkëpunimit përtej fushës së TIK-ut



Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi i shoqëruar nga profesorët: Fitim Alidema, Valon Ejupi, Shpend Dragusha, Diellor Rizaj, Agon Hoti, Fisnik Laha, Arianit Jakupi, drejtoresha e Kampusit, Lirigzona Morina dhe koordinatoreja e Zyrës Ndërkombëtare, Elinda Krasniqi u takuan me përfaqësuesit e “Linnaeus University”, Arianit Kurti, Anita Mirijjamdotter, Ian Nicholls dhe Karina Adbo.

Zyrtarë nga “Linnaeus University” në Suedi qëndruan në UBT për të eksploruar mundësitë për zgjerimin e bashkëpunimit të tyre përtej fushës së Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit. Dy universitetet kanë marrëveshje prej disa kohësh, por tani po kërkojnë të bashkëpunojnë në fusha të reja kërkimi, duke përfshirë biokiminë dhe shkencën e ushqimit.

Gjatë vizitës u diskutua për bash-

këpunimet e mundshme në shkëmbimin e stafit, mësimin në distancë, projektet e përbashkëta kërkimore dhe projektet Erasmus. Të dy universitetet tashmë janë duke punuar së bashku në disa projekte nga fusha e TIK-ut (ICT), duke përfshirë projektin PhDICT-KES në kuadër të Erasmus +.

Gjatë takimit u diskutua edhe mundësi për shkëmbime studentore dhe programe të përbashkëta diplomash, të cilat do t'u ofrojnë studentëve një përvojë unike ndërkombëtare dhe do të rrisin perspektivat e tyre për karrierë.

Në përgjithësi, vizita u pa si një hap pozitiv drejt zgjerimit të bashkëpunimit midis dy universiteteve dhe forcimit të partneritetit të tyre në kërkim dhe arsim.

Përfaqësues të UBT-së morën pjesë në Seminarin e Kontaktit me Institucionet Holandeze të Arsimit të Lartë

Përfaqësues të Zyrës Ndërkombëtare në UBT, Lirigzona Morina dhe Elinda Krasniqi së bashku me prodekanen e Fakultetit Shkencë Politike, Hajdi Xhixha, morën pjesë në Seminarin e Kontaktit me

Institucionet Holandeze të Arsimit të Lartë, i organizuar së bashku me Agjencinë Kombëtare Erasmus+ të Holandës dhe Zyrat Erasmus+ të Ballkanit Perëndimor.

Ky seminar i mbajtur në Tiranë

krijoi mundësi të reja bashkëpunimi mes institucioneve të arsimit të lartë të Kosovës dhe atyre holandeze. Seminari ofroi një mundësi të vlefshme për të diskutuar sfidat, mundësitë dhe përvojat në fushën e arsimit të lartë dhe për të gjetur mënyra konkrete për të forcuar lidhjet e arsimit të lartë midis dy vendeve.



Studentët e UBT-së dhe Ambasadori i Finlandës në Kosovë, Matti Nissinen, diskutojnë rreth rolit të BE-së në rrugëtimin e Kosovës drejt Evropës



02/06/2023. Në kuadër të eventit të përmuajshëm "Let's talk about the European Union" (Të flasim për Bashkimin Evropian), është zhvilluar takimi i parafundit i studentëve me Ambasadorin e Finlandës në Kosovë, Matti Nissinen.

Në këtë takim, diskutimi kryesor u fokusua në temën "Roli i BE-së në rrugëtimin e Kosovës drejt Evropës", me një vëmendje të veçantë te roli i Finlandës në këtë proces. Studentët kishin mundësinë të shprehin mendimet dhe pyetjet

e tyre mbi integrimin e Kosovës në Bashkimin Evropian, si dhe të mësonin më shumë rreth përvojës së Finlandës në këtë kontekst.

Ambasadori Nissinen ndau përvojën dhe perspektivën e tij në lidhje me rolin e BE-së dhe rëndësinë e vlerave evropiane për Kosovën. Ai theksoi se Finlanda mbështet plotësisht procesin e integritetit të Kosovës në Bashkimin Evropian dhe se është e gatshme të ndihmojë në këtë rrugëtim.

Diskutimet e zhvilluara kontribuuan në zgjerimin e informacionit dhe ndërgjegjësimin të studentëve rreth sfidave dhe mundësive që lidhen me integrimin evropian të Kosovës.

Në UBT u mbajt një ligjëratë tematike rreth rolit të përfaqësuesve të ligjit në sigurinë kombëtare



27/11/2023. Në kuadër të Fakultetit Studime të Sigurisë në UBT u realizua një ligjëratë tematike me James A. Houston, JAG i U. S. KFOR.

Në kuadër të kësaj ligjërate tematike u fol rreth temës: "The important role of Law representatives for National Security".

Gjatë kësaj ngjarjeje, Houston shqyrtoi thellë rolin e rëndësishëm të përfaqësuesve të ligjit në kontekstin e Sigurisë Kombëtare.

Diskutimi u përqendrua në sfidat dhe detyrat që këta përfaqësues të ligjit hasin në sigurinë kombëtare dhe si ata mund të kontribuojnë në forcimin e saj.

Pjesëmarrësit kishin mundësinë të bënin pyetje dhe të shkëmbenin pikëpamje mbi temën, duke krijuar një debat të pasur dhe një shkëmbim të vlefshëm të ideve në lidhje me rolin kritik të ligjit në mbrojtjen e sigurisë kombëtare.

Arkitektja Debora Ibrahim zhvilloi një diskutim të hapur rreth renovimit të banimeve publike me studentët e Dizajnit të Integruar në UBT

Arkitektja Debora Ibrahim zhvilloi një sesion të veçantë bashkëbisedimi me studentët e Dizajnit të Integruar në UBT, rreth renovimit të banimeve publike (Social Housing), duke ndarë gjithashtu dhe përvojat e saj përgjatë studimeve.

Së bashku me profesorin Ajhan Bajmaku, gjatë diskutimit studentët shfaqën interes për mundësitë e bashkëpunimit dhe vazhdimin e studimeve të tyre në shtete të ndryshme të Bashkimit Evropian. Debora dhe studentët shkëmbyen ide dhe përvoja,

duke përqafuar një atmosferë të hapur dhe frymëzuese. Ky sesion bashkëbisedimi shërbeu si një platformë e rëndësishme për të ndarë njohuri dhe përvoja të cilat mund të jenë frymëzim për të gjithë ata që kanë synime për vazhdimin e studimeve të larta në institucione akademike të njohura ndërkombëtare.

Debora Ibrahim është një arkitekte e diplomuar në Universitetin e SUPSI në Lugano të Zvicrës, në drejtimin e Arkitekturës së Brendshme – Enterier.

"Youth Talk" në Pejë: Promovimi i Qëndrueshmërisë Kulturore dhe të Turizmit në Kosovë



Në Mullirin e Haxhi Zekës në Pejë u mbajt event i përmuajshëm "Youth Talk" në bashkëpunim me Ambasadën e Suedisë në Kosovë, ku u fol rreth "Sustainable tourism and culture" (Qëndrueshmërinë kulturore dhe të turizmit), me çrast u promovua edhe Agjenda 2030.

Panelistët e këtij eventit ishin: Drejtoresha e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport në Pejë, Xhenet Syka, udhëheqësja e Sektorit të

Turizmit në Swisscontact, Blerina Batusha Xërxa, si dhe nga "Regional Development Agency – West", Sokol Luta.

Me përvojën e saj në drejtimin e sektorit të kulturës dhe sportit në qytetin e Pejës, Drejtoresha e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, Xhenet Syka, solli perspektivën lokale dhe adresoi sfidat dhe mundësitë e qëndrueshme në fushën e turizmit.

Udhëheqësja e Sektorit të Turizmit në Swisscontact, Blerina Batusha Xërxa, kishte njohuri të thella dhe përvojë në fushën e turizmit dhe ofroi një perspektivë të gjerë dhe ndërkombëtare mbi rëndësinë e qëndrueshmërisë në zhvillimin e turizmit.

Përvoja dhe njohuritë e Sokol Lutës nga organizata "Regional Development Agency – West" siguruan një perspektivë të vlefshme dhe praktike për të arritur qëllimet e qëndrueshme në turizëm.

Ky panel diskutimi ishte një rast i rëndësishëm për të promovuar ndërgjegjësimin rreth qëndrueshmërisë kulturore dhe të turizmit në Kosovë, dhe për të inkurajuar të rinjtë të angazhohen në ndryshimin e qëndrueshëm të vendit të tyre.

UBT dhe OSCE mbajtën një diskutim të hapur "Liri, Barazi dhe Drejtësi për të gjithë"

Në Parkun Shkencor Inovativ në Lipjan u organizua një diskutim i hapur rreth temës: "Liri, Barazi dhe Drejtësi për të gjithë" nga UBT dhe OSCE. Në këtë organizim morën pjesë: Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, këshilltarja për të Drejtat e Njeriut në OSCE, Valbona Dermaku, dekania e Fakultetit



Psikologji në UBT, Denis Celcima, përfaqësuesi i Bashkësisë Islame në Kosovë, Vedat ef. Sahiti, përfaqësuesi i Kishës Ortodokse Serbe në Kosovë, Srdjan Stanković, përfaqësuesi i Kishës Katolike në Kosovë, Don Mikel Sopi, si dhe përfaqësuesi i Kishës Protestane Ungjillore, Nazmi Berisha.

Të pranishmit kontribuuan në diskutim duke shpjeguar perspektivat e tyre dhe rolin që institucionet fetare mund të luajnë në promovimin e lirisë, barazisë dhe drejtësisë.

Kjo ngjarje përcolli një frymë të pasur të shkëmbimit të pikëpamjeve në lidhje me vlerat thelbësore të shoqërisë së drejtë dhe të barabartë.

Fakulteti Juridik në UBT organizoi debat rreth zhvillimeve dhe ndryshimeve të nevojshme në legjislacionin civil të Kosovës



Në Parkun Shkencor Inovativ të UBT-së në Lipjan, Fakulteti Juridik ka zhvilluar një debat të hapur rreth temës: "Zhvillimet dhe ndryshimet e nevojshme në legjislacionin civil në Kosovë".

Paneli i përbërë nga zyrtari i lartë ligjor në Ministrinë e Drejtësisë, Isuf Jahmurataj, kryetari i Gjykatës Komerciale, Mahir Tutuli dhe profesoresha e te drejtës civile në UBT, Jorida Xhafaj, trajtoi zhvillimet e reformës në drejtësi, shtyllën e ndryshimeve legjislative, si dhe

çështje të tjera që ndërlidhen me fushën e drejtësisë në vend.

Studentët dhe pjesëmarrësit e tjerë në këtë ngjarje patën mundësi të përfitojnë njohuri të reja rreth njohjes së thellë të instituteve, për të cilat u analizuan edhe vështirësitë që krijohen për zbatuesit e ligjit si kontrata paramartesore, martesat e të miturve mbi 16 vjeç, trashëgimi dhe zbatimi i parimit të barabarësisë së trashëgimtarëve, si dhe shprehja e të miturve në proceset gjyqësore.

Në UBT u mbajt një ligjëratë tematike për rëndësinë e ndërhyrjes së hershme të fëmijët me çrregullime neurozhvillimore

27/11/2023. Në kuadër të lëndëve Psikologji Abnormaliteti dhe Psikologji Klinike, që ligjërohen nga profesoresha Violeta Zefi, u organizua një ligjëratë tematike me Fatime Sahiti – Bekteshi, specializante e psikologjisë klinike, njëkohësisht udhëheqëse e Klinikës Emos. Kjo ligjëratë u realizua në kuadër të Fakultetit të Psikologjisë në UBT dhe kishte për qëllim që studentët të njoheshin për së afërmi me çrregullimet neurozhvillimore të fëmijët, rëndësinë e ndërhyrjes së hershme, si dhe teknikat bashkëkohore të trajtimit të këtyre problemeve.

Duke u mbështetur në rastet e saj klinike Sahiti – Bekteshi sjelli për studentët përvojën e saj mbi 10-vjeçare në trajtimin e fëmijëve me çrregullime neurozhvillimore.

Hulumtues të shumtë prezantuan punimet e tyre në Konferencën e Dytë Globale të Tolerancës Ndërkulturore



UBT ishte nikoqir i edicionit të dytë të konferencës Globale të Tolerancës Ndërkulturore, që është organizuar në bashkëpunim me Fondacionin Ndërkombëtar për Tolerancë.

Sesioni i parë i kësaj konference u zhvillua me prezantimin e hulumtimeve dhe punimeve të shumta shkencore. "Toleranca në vendin e punës në Emiratet e Bashkuara Arabe", nga Dr. Ali Al Obaidli, "Toleranca dhe sistemet kulturore", nga Allah Naser Foad, "Koncepti i tolerancës", nga Abdullah El-Amiri, dhe "Perspektiva Fetare dhe Njerëzore – Maqedonia e Veriut si model", nga

Nusrat Ramadani.

Sesioni i dytë i konferencës përfshiu punimet: "Identiteti kulturor nëpërmjet teknologjisë", nga Dr. George Simons, "Teknologjia dhe edukimi: e kaluara, e tashmja dhe e ardhmja", nga Dr. Robert Crane, si dhe "Diversiteti fetar dhe ndikimi i religjionit te shqiptarët gjatë etapave të ndryshme të historisë", nga Dr. Veton Zejnullahu. Dita e parë e konferencës u përmbyll me interaktivitet mes pjesëmarrësve të cilët parashtruan pyetje të shumta lidhur me tolerancën ndërkulturore. Konferenca do të vazhdojë edhe nesër.

Punimi i profesorit Ferid Selimi rreth sfidave të gazetave të shkruara në Kosovë është publikuar në revistën “Studies in Media and Communication”



Studies in Media and Communication
Vol. 11, No. 1; March 2023
ISSN: 2325-8071 E-ISSN: 2325-808X
Published by Redfame Publishing
URL: <http://smc.redfame.com>

Challenges of Print Newspapers in Kosovo in the Period 1999 to 2020

Ferid Selimi

Correspondence: Ferid Selimi, Faculty of Media and Communication; University of Business and Technology, Pristina, Kosovo.

Received: October 26, 2022 Accepted: January 18, 2023 Online Published: January 23, 2023
doi:10.11114/smc.v11i1.5753 URL: <https://doi.org/10.11114/smc.v11i1.5753>

Abstract

The research objective is to examine the challenges faced by newspapers in Kosovo from 1999 to 2020. By using qualitative methods, the study aims to identify the factors that have led to the discontinuation of daily printed newspapers in Kosovo. The main drivers of this trend have been identified as the speed at which news can reach readers through electronic media, as well as the financial burden of unsold newspapers on the editorial offices, rather than on distribution networks. The findings of the study indicate that, as of March 2020, Kosovo has been left without daily newspapers due to the Covid-19 pandemic, as the government implemented measures that resulted in the temporary closure of business that newspapers. This has led to the accelerated closure of four daily print newspapers in Kosovo, which now only continue to publish in an electronic format. The pressure caused by these circumstances ultimately led to the discontinuation of printing and the shift to electronic version, which have a much lower financial cost.

24.01.2023. Punimi shkencor i profesorit të Fakultetit Media dhe Komunikim në UBT, Ferid Selimi, me titull: “Challenges of Print Newspapers in Kosovo in the Period 1999 to 2020”, është publikuar në revistën “Studies in Media and Communication” e indeksuar në

Scopus. Objektivi i hulumtimit ka qenë shqyrtimi i sfidave me të cilat janë ballafaquar gazetaret në Kosovë nga viti 1999 deri në vitin 2020, duke përdorur metoda cilësore, ky studim ka pasur për synim të identifikojë faktorët që kanë çuar në

ndërprerjen e gazetave të shtypura ditore në Kosovë. Gjetjet e studimit tregojnë se Kosova që nga marsi i vitit 2020 ka mbetur pa gazeta ditore për shkak të pandemisë COVID-19, pasi qeveria zbatoi masat që rezultuan me mbylljen e përkohshme të biznesit të gazetave, kjo ka çuar në mbylljen e përshtypur të katër gazetave të shtypura ditore në Kosovë, të cilat tani vazhdojnë aktivitetin e tyre vetëm në platformat elektronike. Sipas autorit, problemi me të cilat përballet gazetaria në Ballkanin Perëndimor, veçanërisht në Kosovë, përfshijnë aspekte të ndryshme të funksionimit social, politik, juridik dhe ekonomik, të cilat mund të dëmtojnë qëndrueshmërinë e lirisë së mediave dhe mbrojtjen e përgjithshme të lirisë së fjalës, qasjen në informacion dhe përfaqësimin publik të opinioneve.

Punimi i profesorit të UBT-së, Demokrat Nuha, rreth komponimeve të reja të derivateve të oksadiazolit dhe triazolit, publikohet në revistën “Journal of Molecular Structure”

[View PDF](#) [Access through your institution](#) [Purchase PDF](#)

Outline

Highlights

Abstract

Graphical abstract

Keywords

1. Introduction

2. RESULTS and discussion

3. Conclusion

4. Materials and methods

CRediT authorship contribution statement

Declaration of Competing Interest

Acknowledgements



Journal of Molecular Structure
Volume 1282, 15 June 2023, 135213



New oxadiazole/triazole derivatives with antimicrobial and antioxidant properties

Sam Dawbaa^{a, b, c}, Demokrat Nuha^{a, d, e}, Asaf Evrim Evren^{a, f}, Meral Yilmaz Cankilic^g, Leyla Yurttag^g, Güllhan Turan^g

Show more ↓

+ Add to Mendeley [Share](#) [Cite](#)

<https://doi.org/10.1016/j.molstruc.2023.135213>

Get rights and content

21/03/2023. Punimi shkencor i profesorit të Fakultetit të Farmacisë në UBT, Demokrat Nuha, me disa profesorë ndërkombëtarë, me titull: “New Oxadiazole/Triazole Derivatives with Antimicrobial and Antioxidant Properties”, është publikuar në revistën “Journal of Molecular Structure”, e indeksuar në Scopus.

Ky punimi përshkruan sintezën e një seri të komponimeve të reja të derivateve të oksadiazolit dhe triazolit, si dhe vlerësimin e tyre

për aktivitetin antimikrobiale dhe antioksidant. Mënyra e lidhjes së komponimeve aktive me enzimën oksiduese janë studiuar nëpërmjet lidhjes molekulare (Molecular docking) dhe simulimeve të dinamikës molekulare (Molecular dynamics simulation), të cilat sigurojnë informacion në lidhje me mekanizmin e ndërveprimit të enzimës, si dhe llogaritjet DFT janë aplikuar për komponimet aktive.

Punimi i profesorëve dhe studentëve të UBT-së rreth kultivimit të mollëve ‘Jonagold’ në Kosovë publikohet në revistën “Turkish Journal of Agriculture and Forestry - TUBİTAK”



Turkish Journal of Agriculture and Forestry

<http://journals.tubitak.gov.tr/agriculture/>

Research Article

Turk J Agric For
(2023) 47: 57-66
© TÜBİTAK
doi:10.55730/1300-011X.3064

Investigation of the effects of pesticides on ‘Jonagold’ apple (*Malus x domestica*) polyphenol oxidase enzyme activity

Cengiz ÇESKO^{1*}, Sami GASHI¹, Gülnur ARABACI¹, Hatice PALUZAR¹, Berat DURMISHI¹, Era BRUÇI¹, Fjolla VLLASALIU¹, Nedim ÖZDEMİR²

¹Food Science and Biotechnology, Agriculture and Environmental Engineering, University of Business and Technology, Pristina, Kosovo
²Department of Chemistry, Sakarya University, Sakarya, Turkey
³Department of Chemistry and Chemical Processing Technology, Trakya University, Edirne, Turkey
⁴Faculty of Fisheries, Muğla Sıtkı Koçman University, Muğla, Turkey

Received: 22.03.2023 Accepted/Published Online: 05.12.2022 Final Version: 08.02.2023

Abstract: In this study, the effects of a number of commonly used pesticides on the activity of the polyphenol oxidase (PPO) enzyme from pesticide-free and pesticide-applied ‘Jonagold’ apples were comparatively evaluated. Substrates 4-methylcatechol, pyrocatechol,

mol oxidase”. Rezultatet përmbajnë informacion të rëndësishëm për përdorimin e ardhshëm të Jonagold apple PPO si një agjent bioaktiv në biosensorët e krijuar për për-

aktimin e pesticideve. Të dhënat e marra hedhin dritë mbi vetitë e reja funksionale të pesticideve që kanë tërhequr interes të madh në qarqet mjekësore, agrokimike dhe mjedisore.

Punimi shkencor i profesorëve të UBT-së: Cengiz Çesko, Sami Gashi dhe Berat Durmishi bashkë me studentet e masterit Era Bruçi dhe Fjolla Vllasaliu, me titull: “Investigation of the effects of pesticides on ‘Jonagold’ apple (*Malus x domestica*) polyphenol oxidase enzyme activity”, është publikuar në revistën “Turkish Journal of Agriculture and Forestry - TUBİTAK”, revistë kjo e indeksuar në Scopus.

Ky punimi përshkruan zonën e kultivimit të mollëve ‘Jonagold’ në Kosovë, molla me trajtimin e pesticideve dhe pa trajtimin e pesticideve janë kultivuar në një zonë të veçantë. Në këtë punim u ekzaminuan efektet e pesticideve në enzimën “Jonagold Polyphen-

Punimi i profesorëve të UBT-së, Afrim Zeqiraj dhe Zafer Gashi, rreth hepatitit viral, publikohet në revistën “Open Access”



Incidence of Presenting Hepatitis A in the Peja Regional Hospital during 2019–2020

Afrim Zeqiraj¹, Zafer Gashi¹, Shkelzen Elezaj², Dafina Zeqiraj², Melisa Zogaj³, Florjana Zogaj³, Zenel Shatri³, Agim Shabani⁴

¹Department of Biochemistry, UBT - Higher Education Institution, Pristina, Kosovo, ²Department of Urology and Infectious Diseases, Regional Hospital of Peja, Peja, Kosovo, ³Department of Biotechnology, University of Prishtina, Prishtina, Kosovo, ⁴Department of Chemistry, University of Tetovo, Tetovo, Republic of Macedonia

Abstract

BACKGROUND: Hepatitis is a very common inflammation of the cells of the liver. Hepatitis can be temporary (acute) or long-term (chronic) depending on whether it lasts less than or more than 6 months. The hepatitis A virus (HAV) infects humans and some primates and is the cause of infectious hepatitis.

AIM: Viral hepatitis infections are also present in our country, so the purpose of working on this topic is to expand knowledge in terms of viral hepatitis A, their epidemiology, and preventive measures.

MATERIALS AND METHODS: In the realization of this paper, the method of the literature review was used, in addition, information was presented on the number of patients with viral hepatitis A in the regional hospital of Peja, the Republic of Kosovo for the period 2019/2020.

17/01/2023. Punimi shkencor i profesorëve të UBT-së, Afrim Zeqiraj dhe Zafer Gashi, në bashkëpunim me profesorë të universiteteve të tjera, me titull: “Incidence of Presenting Hepatitis A in the Peja Regional Hospital during 2019–2020”, është publikuar në revistën e shkencave mjekësore në Maqedoni të Veriut “Open Access” e indeksuar nga Scopus.

Ky studim tregon se hepatiti viral është përgjegjës për rritjen e sëmundshmërisë dhe vdekshmërisë, sidomos hepatiti A, B dhe C. Sipas të dhënave në këtë punim të siguruar nga Organizata Botërore e Shëndetësisë, hepatiti viral prek rreth 400 milionë njerëz botëror, teksa rreth 257 milionë njerëz jetojnë me HBV infeksion dhe rreth 71 milionë kanë hepatit kronik C – infeksion në mbarë botën. Në bazë të të gjeturave në këtë

punim, autorët kanë vlerësuar se masat e rekomanduara për parandalimin e viruseve hepatitit janë: sigurimi i duhur sanitar dhe personal higjienës, pirja e ujit të kontrolluar, shmangia e pirjes së alkoolit, duke ngrënë më pak, dhe ushqim më i shpeshtë, me shumë karbohidrate, dhe më pak yndyrë.

Nga rezultatet e marra në Spitalin Rajonal të Pejës, është e qartë se numri i pacientëve me hepatit A është i ulët dhe në vlera jo të rëndësishme. Megjithatë, fakti që numri i të sëmurëve me Hepatit B është në rritje, dhe veçanërisht në rritje të numrit të rasteve të hepatitit C, mbetet një çështje shqetësuese, dhe vlen të theksohet se duhet pasur kujdes për të parandaluar përhapja e këtyre viruseve në një shkallë shumë të lartë.

Punimi i profesorëve të UBT-së publikohet në revistën “International Journal on Minority and Group Rights”



Publications Subjects Imprints Services

Factors Leading to Primary School Dropout in Community Families – the Case of Kosovo

In: International Journal on Minority and Group Rights

Authors: Shejnazë Gagica, Ejona Icka, Hajrullah Fejza, and Xhevat Uka

Online Publication Date: 23 Dec 2022

Abstract Full Text PDF Metadata References Figures Metrics

Abstract

Introduction – Education remains the major tool by which people become empowered; unfortunately, the education industry has suffered low completion rates due to several factors exposed in various studies.

Punimi shkencor i profesorëve të UBT-së, Shejnazë Gagica, Ejona Icka, Hajrullah Fejza dhe Xhevat Uka nga Ministria e Shëndetësisë, me titull: “Factors Leading to Pri-

mary School Dropout in Community Families – the Case of Kosovo”, është publikuar në revistën shkencore “International Journal

on Minority and Group Rights”, e indeksuar në platformën Web of Science dhe SCOPUS.

Sipas autorëve, qëllimi i këtij studimi ka qenë që të hulumtohen faktorët që kontribuojnë në braktisjen e shkollës fillore nga fëmijët në komunitetet e Kosovës, ku sipas rezultateve të marra nga ky punim del se ndër faktorët kryesor që ndikojnë në këtë braktisje janë: largësia nga shkolla në shtëpi, bullizmi nga nxënësit, pamundësia për t'u regjistruar dhe neglizhenca e prindërve.

Autorët në këtë hulumtim kanë theksuar se arsimit mbetet mjeti kryesor me të cilin njerëzit fuqizohen, teksa industria e arsimit ka pësuar shkallë të ulët të përfundimit për shkak të disa faktorëve të ekspozuar në studime të ndryshme.

Në UBT promovohet libri i profesorit, gazetarit dhe publicistit, Musa Sabedini

10/02/2023. Me praninë e rektorit të UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, profesorëve, studentëve, miqve dhe familjarëve, profesori, autori, gazetari dhe publicistit, Musa Sabedini, promovoi librin voluminoz "Mediet, etika, raportimet për situatat e ndjeshme, hetimet dhe nocionet juridike në gazetari", i cili është një libër profesional që shtjellon, trajton e studion raste nga më të ndryshmet, bazuar e nisur edhe nga përvoja e vet autorit.

Në fjalën përshëndetëse, rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi e përgëzoi profesorin Musa Sabedini për botimin e këtij libri, duke e konsideruar një ndër librat më të mira dhe me vlerë të madhe për fushën e gazetarisë.

"Është një libër me një qasje interesante. Është një angazhim i madh i autorit që të sjellë tek studentët këtë libër profesional, që ata të kenë një literaturë të mirë dhe t'i ndihmojë edhe gazetaret e lexuesit e tjerë. Ky libër është shkruar nga një autor që edhe vet ka vazhduar të jetë aktiv në profesionin e gazetarisë. Duke sjellë edhe përvojën e tij personale edhe angazhimin e tij, autori e ka bërë një libër shumë të mirë, i cili do të ketë edhe vlerë të madhe", tha rektori Hajrizi.

Dekani i Fakultetit Media dhe Komunikim në UBT, Ferid Selimi e përgëzoi profesorin Musa Sabedini për angazhimin dhe profesionalizmin e tij për të sjellë një libër në fushën e gazetarisë, duke theksuar se është mungesë e librave të tillë në Kosovë, për t'i ndihmuar studentët e kësaj fushe drejt profesionalizmit. "Së pari ju përgëzoj për përfundimin e këtij misioni që ka marrë autori, ky libër që vërtetë e mbush një boshllëk në gazetarinë kosovare. Në Kosovë ka shumë pak libra për gazetari, autorë vendorë janë shumë të rrallë dhe kemi nevojë për libra të tillë. Për ata që e konsiderojnë veten të fushës, është vet titulli që tregon shumë. Autori është përpjekur të ngërthejë të gjitha ngjarjet si nga



aspekti profesional ashtu edhe nga përvoja e tij, duke i plotësuar të gjitha kriteret që të quhet një libër i gazetarisë dhe për gazetarinë" u shpreh dekan Selimi.

Recensenti i parë profesori Ahmet Maloku ka thënë se libri ofron përgjigje për shumë pyetje të teorisë dhe praktikës metodologjike, e cila ka në fokus mediat përballë raportimeve për krimet, dhunën dhe situatat e ndjeshme.

"Në parathënie, autori jep një shpjegim të arsyeve të shkrimit të kësaj veprë dhe çfarë e shtyu atë të zgjedhë këtë lloj veprë. Gjithashtu, ai thekson probleme të rëndësishme që dalin gjatë shtjellimit të temës që ka të bëjë me problemet në terren që has çdo gazetar, me etikën që mbetet si problemi më delikat i mënyrës së raportimit në gazetari. Për më tepër, në kapitullin e parë autori shqyrton parimet bazë të gazetarisë, etikën në gazetari, flet për rastet e vrasjeve, vetëvrasjeve, vrasjet e rënda, veprat penale të të gjitha kategorive, dënimet, armët, shkeljet ligjore, etika gjatë raportimit, vdekjet, tragjeditë, privatësia, lajmet e rrejshme, vrasjet, plagosjet, aksidentet, zjarret, personat me aftësi të kufizuara, të miturit", potencoi recensenti Maloku.

Teksa, recensenti Safet Zejnullahu në fjalën e tij në recension ka vlerë-

suar se autori ka një përvojë të gjatë në fushën e gazetarisë dhe ky libër është një punë voluminoze e autorit duke treguar përkushtimin e madh të tij për të kontribuar në këtë fushë. "Autori Musa Sabedini ka një përvojë të gjatë të punës së drejtpërdrejtë nga raportimi nga terreni, si në kohë pushtimi, në kohë aparteidi në median e Kosovës, në kohë lufte, në kohë të gazetarisë së kontrolluar të pasluftës dhe në epokën e internetit. Këtë përvojë ai e ka përdorur për të mbledhur brenda kopertinave të këtij libri shembuj të panumërt të gabimeve e të shkeljeve etike të bëra në media, qoftë qëllimshëm, qoftë padashat. Një punë shumë voluminoze e autorit tregon përkushtimin e tij, pikë së pari, për të bërë vetë gazetari profesioniste, por edhe për t'u ndihmuar të tjerëve për ta bërë të njëjtën gjë. Qofshin ata gazetarë fillestarë, qofshin me përvojë", është shprehur profesori Safet Zejnullahu. Profesori, gazetari, publicisti, autori i librit "Mediet, etika, raportimet për situatat e ndjeshme, hetimet dhe nocionet juridike në gazetari", Musa Sabedini, falënderoi të gjithë të pranishmit në këtë promovim të këtij libri, njëherit rektorin e UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizin, dekanin e Fakultetit Media dhe Komunikim, Ferid Selimi, recensentët Ahmet Maloku dhe Safet Zejnulla-

hu, duke besuar se ky libër do të jetë gjatë dhe do të shërbejë shumë për studentët, gazetaret dhe profesionistët e medias.

"Unë flas shkurt sepse flet libri, i cili është i veçantë për shkak të angazhimit, korrektesisë dhe profesionalizmit. Libri është një lloj kombinimi i ngjarjeve të ndryshme dhe i përvojës të cilën e kam ndërtuar tash e sa vite në fushën e gazetarisë. Gazetarët duhet të kuptojnë se gazetaria është shumë sfiduese. Ky libër është ABC-ja, është udhëzues e manual i secilës dilemë në fushën e gazetarisë. Gazetaria dëshiron saktësi, vërtetësi. Ky libër do të jetë gjatë, meqenëse është i qartë për të gjithë lexuesit dhe njëherit është shumë praktik për ata që duan të merren me gazetari", tha Sabedini. "Mediet, etika, raportimet për situatat e ndjeshme, hetimet dhe nocionet juridike në gazetari", u dedikohet studentëve të gazetarisë, studiuesve të medias, gazetarëve e humlumtues, redaktorëve të profesionalizuar, hetuesve, prokurorëve e gjyqtarëve me etikë profesionale.

Ndryshe botues i librit është UBT dhe i ka 532 faqe, teksa recensenti të librit janë profesorët Ahmet Maloku dhe Safet Zejnullahu, sipas të cilëve libri është kontribut i rëndësishëm në studimin dhe zhvillimin e shkencës së gazetarisë për studimin e asaj dukurie, si dhe do të shërbejë për si literaturë profesionale për një kohë të gjatë.

Libri përbëhet nga shembuj të shumtë, raste konkrete për të gjitha kategoritë e ndjeshme, duke filluar me Kapitullin e parë, që flitet për rastet e vrasjeve, vetëvrasjeve, vrasjet e rënda, veprat penale të të gjitha kategorive, dënimet, armët, shkeljet ligjore, etika gjatë raportimit, vdekjet, tragjeditë, privatësia, lajmet e rrejshme, vrasjet, plagosjet, aksidentet, zjarret, personat me aftësi të kufizuara, të miturit, të sëmurët mentalë, dhunimet, krimet e luftës, raportimet nga gjyqet, raportimi për pandemitë, raportimi për as-

pektet fetare, trafikimi me qenie njerëzore, prostitucioni, kontrabandimi i migrantëve, raportimi për kronikën e zezë, personat e zhdukur, dhuna në familje, dhunimi, vrasjet e grave shtatzëna, vetëvrasjet, ngacmimi seksual, shantazhi, kanosja, shtrëngimi, detyrimi, hakmarrja, korrupsioni, ryshfeti, skemat piramidale dhe bixhozi, vjedhja, vjedhjet e rënda, grabitja, mjediset konfliktuozë, raportimi për protestat, trazirat, demonstratat, raportimi mbi konfliktet, trazirat sociale, siguria e gazetarëve dhe rreziqet, trazirat e marsit 2004, gjenocidi, sulmet terroriste, rrëmbimet, pengjet, spiunazhi, sabotimi, krimet kundër njerëzimit, pornografia, pedofilia, bigamia, krimet kibernetike.

Në Kapitullin e dytë libri trajton dhe analizon më shumë raportet media, polici, prokurori dhe gjykatë, pastaj termet juridike, i ndaluar i përkohshëm, i dyshuar, i burgosur, i akuzuar, i dënuar, i dëmtuar, hetimet policore, veprimet policore, kallëzimi penal i policisë, obduksioni i kufomës, ngritja e aktakuzës, raportet media - prokuror, përkufizimet juridike, dilemat e gazetarëve, udhëzues, manual e agjenda për të shkruarit nga gjykatat, avokatët mbrojtës, publiku, i pandehuri, organogrami i gjykatave, roli i Gjykatës së Apelit, Gjykatës Supreme të Kosovës, Gjykatës Kushtetuese, Këshillit Prokurorial të Kosovës, udhëzues praktik për shkrimet për mediet online, TV e Radio, njohja me seancat gjyqësore, trupin gjyqësor, fjalët përfundimtare gjatë një seance gjyqësore, llojet e aktgjyqimeve dhe aktgjyqimet e Gjykatës së Apelit.

Kurse në Kapitullin e tretë janë dhënë informacione më koncize për përkufizimet, termet dhe nocionet juridike, veprat penale të terrorizmit, krimeve të rënda si dhe nocionet më shpesh të përdorura në gazetari.

Në UBT hapen ekspozitat "Portrete nën shkallë" dhe "Shkrimet nën shkallë"



27/03/2023. Në Parkun Shkencor Inovativ të UBT-së, në Lipjan, u hapën ekspozita "Portrete nën shkallë", e organizuar nga studentët e vitit të dytë të Fakultetit Media dhe Komunikim dhe "Shkrimet nën shkallë" e studentëve të nivelit master në programin Dizajn i Integruar i Avancuar në UBT, me kurator profesor Orhan Kerkezi. Në kuadër të lëndës "Kamera dhe Fotografia" në Media dhe Komunikim dhe lëndës "Laboratori i Shkrimit dhe Publikimit" në Dizajn i Integruar i Avancuar, të udhëhequr nga profesori Orhan Kerkezi, studentët patën mundësi të shfaqin punimet e tyre, me ç'rast rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi i përgëzoi për punën dhe angazhimin e tyre për

të sjellë në UBT ekspozita të tilla. Ekspozitat në UBT kishin si qëllim të prezantonin një koleksion të portreteve dhe shkrimeve të shfaqura nën shkallë. Ky koleksion i veçantë përmban një varg të gjerë të imazheve dhe shkrimeve që shfaqin njerëz dhe situata të ndryshme, të cilat u kanë shërbyer studentëve si burim inspirimi në krijimin e veprave të tyre.

Ky koleksion ishte një shembull i shkëlqyeshëm i kreativitetit dhe imagjinatës së artistëve. Nëpërmjet portreteve dhe shkrimeve të tyre nën shkallë, ata kanë arritur të përcjellin ndjenjat dhe emocionet e tyre në mënyrë të veçantë dhe të japin një pamje të thellë në botën e tyre kreative.

"Kryemjeshtri" - promovohet në UBT libri dedikuar mjeshtrit të xhudos, Driton Kuka

27/02/2023. Në Parkun Shkencor Inovativ të UBT-së në Lipjan, në një ceremoni u bë promovimi i librit "Kryemjeshtri" nga autori Arsim Maxhera, dedikuar trajnerit mjeshtrë të xhudos, njëherit profesorit të UBT-së, Driton Kuka.

Në mesin e pjesëmarrësve të shumtë në këtë promovim, ishte edhe rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, i cili në fjalën e tij përshëndetëse, falënderoi autorin e librit, Arsim Maxhera dhe trajnerin mjeshtrë të xhudos, Driton Kuka, për përkushtimin për të sjellë në Kosovë një libër voluminoz, në të cilin përshkruhet roli i një modeli mjeshtrë, siç është Kuka.

"Libri është një mesazh shumë i rëndësishëm për të rinjtë se si duhet të krijohet një perceptim për krijimin e një heroi dhe kampioni të sportit. Ne e kemi një rast të një trajneri se si është një rol model. Për neve dhe për Kosovën, është një rol model me të cilin ne duhet ta promovojmë dhe gjeneratën e tjera ta marrin si bazë. Autori ka bërë një punë shumë të mirë, e cila besoj që nuk do të jetë botimi i parë dhe i vetëm, sepse njëherit si Driton Kuka duhet të promovohet. Besoj se ekziston një lloj modeli i mjeshtrësisë, talentët kanë predispozita për të qenë të tillë, mirëpo, modeli e organizimi ndërtohen nga



trajnerë. Ne, si UBT e kemi vlerësuar Driton Kukën para disa viteve me "Leadership Excellence Award". Përmes xhudos, Kosova ka krijuar një lloj eliminimi të inferioritetit, me këtë pritjet tona nuk janë më në nivelin e pritjes së kualifikimit, por tani janë për të qenë më të mirët në botë", tha rektori Hajrizi.

Autori, njëherit gazetari i sportit, Arsim Maxhera vlerësoi lartë pjesëmarrjen e studentëve dhe të profesorëve të UBT-së, në këtë promovim të librit, për të cilin tha se është një libër që shfaq punën kolosale të Driton Kukës dhe sfidat me të cilat është përballur ky i fundit përgjatë jetës dhe karrierës së tij.

"Libri është një shfaqje e punës kolosale që ka bërë Dritoni Kuka, rreth sfidave të cilat i ka kaluar ai. Një rrugëtim i veçantë që nuk besoj se

mund të përsëritet. Nga ky rrugëtim mund të mësojnë gjeneratat e reja. Dijen që e ka Driton Kuka duhet të shpërndahet më shumë te punëtorët e tjerë të sportit në nivel vendi", u shpreh Maxhera.

Trajneri mjeshtrë i xhudos, njëherit profesorit të UBT-së, Driton Kuka, u shpreh falënderues për promovimin e librit në UBT, si dhe tha se është i lumtur që është pjesë e UBT-së.

"UBT më ka vlerësuar pak më ndryshe, duke më dhënë çmimin "Leadership Excellence Aëard". Jam shumë i lumtur që jam në mesin tuaj dhe pjesë e UBT-së. E vlerësoj punën e Arsimit rreth librit, i cili në mënyrë kronologjike ka përshkruar secilën ngjarje që kam përjetuar", ka thënë trajneri Kuka.

U përrua këndi i xhudos në Parkun Shkencor Inovativ të UBT-së

28/02/2023. UBT ka përruar këndin e xhudos, tashmë të pozicionuar në Parkun Shkencor Inovativ të UBT-së, në Lipjan, ku krahas hapësirave të tjera sportive që përfshin fitnesin, gjimnastikën, këndin e pingpongut, edhe këndi i xhudos do të plotësojë ekosistemin inovativ të UBT-së.

Në përrimin e këndit të xhudos, në prani të trajnerit më të mirë në botë në xhudo, Driton Kuka dhe kampiones së parë olimpikë në Kosovë, Majlinda Kelmendi, rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi theksoi rëndësinë e madhe që ka ky kënd për studentët e Fakultetit të Shkencave të Sportit dhe të Lëvizjes, si dhe



për studentët e tjerë të UBT-së. Dyshekët e këndit të xhudos janë dhuruar nga Komiteti Olimpik i Kosovës, e që tashmë do të jenë në dispozicion të studentëve të UBT-së, të cilët do të marrin mësim rreth këtij sporti nga ekspertët dhe profesionistët më të mirë që ka fusha e xhudos, specifikisht nga kampionë olimpik e botëror. UBT me zhvillimin e Fakultetit Shkencave të Sportit dhe të Lëvizjes synon që studentëve dhe të rinjë t'u sjell një qasje komplet tjetër për sa i përket fushës së sportit, shëndetit dhe lëvizjes, përmes një kurrikule të bazuar në universitetet më prestigjioze në botë.

Në UBT u mbajt një diskutim i hapur rreth shëndetit publik me Prof. Pashko R. Camaj, Dr. PH



07/03/2023. Në Parkun Shkencor Inovativ të UBT-së, në Lipjan, qëndroi për vizitë Prof. Pashko R. Camaj, Dr. PH, me të cilin u organizua një diskutim i hapur rreth ekspozimit mjedisor ndaj plumbit në Kosovë dhe implikimet në shëndetin publik.

Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi falënderoi për ardhjen në Kosovë profesor Camaj, duke theksuar nevojën e trajtimit të temave rreth shëndetit publik dhe angazhimin e gjithsecilit drejt zgjidhjes së problematikave që

ndërlidhen me këtë fushë.

“Është kënaqësi e veçantë që të kemi Pashko Camajn këtu në UBT. Ai është një patriot i madh shqiptar, nga vet mënyra që ka qenë edhe para dhjetë dite këtu dhe është kthyer prapë. Ne e falënderojmë shumë për angazhimin e tij. Në kuadër të kësaj ligjërate, ne kemi ftuar profesor Camaj të flet për shëndetin publik dhe epidemiologjinë, duke na treguar detaje mbi rëndësinë e ruajtjes së ambientit dhe vendit tonë”, tha rektori Hajrizi.

Në kuadër të këtij diskutimi, Prof.

Pashko R. Camaj trajtoi temën: “The legacy of environmental exposure to lead in Kosovo and public health implications”, duke shtjelluar detaje të rëndësishme rreth ekspozimit mjedisor ndaj plumbit në Kosovë dhe implikimet në shëndetin publik, duke marr si shembull dy qytete të Kosovës, Mitrovicën dhe Prishtinën.

Gjatë prezantimit të tij, profesor Camaj tregoi studime të veçanta që kanë hulumtuar problematikën në këto dy qytete dhe ekspozimin mjedisor ndaj plumbit, si dhe rreth shëndetit publik dhe masave të marra nga vende të ndryshme të botës për parandalimin e ndotjes së ambientit.

Pashko R. Camaj është anëtar i Federatës Panshqiptare “VATRA”, njëherit profesor asistent në Universitetin “William Paterson” në New Jersey, me fokus në fushat: shëndet publik, shëndet global dhe epidemiologji.

Fakulteti i Muzikës mbajti koncert për nder të 15-vjetorit të Pavarësisë së Republikës së Kosovës



21/02/2023. Në kuadër të aktivitetëve të ndryshme që u shënuan për nder të Ditës së Pavarësisë së Republikës së Kosovës, Fakulteti i Muzikës Moderne, Prodhimi Digjital dhe Menaxhimi në UBT, në bashkëpunim me bendin e UBT-së, të udhëhequr nga profesora Ulpiana Aliaj, organizoi një koncert me këngë shqipe.

Në prani të mikut të madh amerikan të shqiptarëve, Christopher Hyland, Presidenti i Rrjetit të Bizneseve të Diasporës Shqiptare,

Nazar Mehmeti, si dhe Rektorit të UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, koncerti nisi me himnin e Kosovës, e më pastaj vazhdoi me këngët e përzgjedhura nga studentët: Ervis Hyseni, Meriton Heta, Arnesa Kadriaj, Diana Mehmetaj, Elvana Prendi, Lavdim Elezi, Anjeza Gashi e Engjull Blaku.

Bendi i UBT-së është bërë nga instrumentistët: Engjull Blaku, Ron Surdulli, Olti Perjuci, Erblin Kadrija, Edion Limani, Dukagjin Muhaxheri dhe Lavdim Elezi.

Realizohet me sukses intervenimi i parë kirurgjik në Klinikën Specialistike të Stomatologjisë në UBT



12/01/2023. Është kryer me sukses intervenimi i parë kirurgjik në Klinikën Specialistike të Stomatologjisë në UBT, nga kirurgu oral dhe asistenti në Kirurgjinë Oralë pranë Fakultetit Stomatologjik në UBT, Vullnet Fazliu, në bashkëpunim me studentët e vitit të gjashtë të Stomatologjisë në UBT. Procedura operative ka qenë “Op. Frenectomia labi superior”, e kryer nga Katedra e Kirurgjisë Orale te pacienti për arsye ortodontike, në

bashkëpunim me katedrën e Ortopedisë së Nofullave me në krye profesoren Jeta Kiseri – Kubati. Përmes Klinikës Specialistike të Stomatologjisë, UBT është duke zhvilluar punën klinike, laboratorike dhe imazherike me pajisjet e teknologjisë së fundit me një infrastrukturë moderne mjekësore sipas standardeve ndërkombëtare, duke iu ofruar të gjithë qytetarëve shërbime kualitative me çmime promovionale.

UBT në bashkëpunim me “VATRA” dhe Rrjetin e Bizneseve të Diasporës Shqiptare mbajti koncertin madhështor me Filharmoninë e Kosovës

16/02/2023. UBT në bashkëpunim me Federatën Panshqiptare “VATRA” dhe Rrjetin e Bizneseve të Diasporës Shqiptare, nën patronatin e veprimtarit të shquar të çështjes kombëtare dhe lobuesit më të madh në ShBA për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës, Jim Xhema, mbajti koncertin madhështor me Filharmoninë e Kosovës.

Në këtë koncert morën pjesë personalitete të ndryshme nga politika, akademja, arti e kultura, në mesin e të cilëve ishte: Presidentja e Republikës së Kosovës, Vjosa Osmani, Presidenti i Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj, Veprimtari i shquar i çështjes shqiptare në Amerikë, Jim Xhema, mik i madh i shqiptarëve, Christopher Hyland, kryetari i Komunitetit të Prishtinës, Perparim Rama, Presidenti i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, Presidenti i Federatës Panshqiptare “VATRA”, Elmi Berisha, Presidenti i Rrjetit të Bizneseve të



Diasporës Shqiptare, Nazar Mehmeti, profesorë e staf nga UBT, si dhe personalitete të tjera. Koncerti madhështor që bashkoi figura të shquara dhe kontribuuesit e shtetësisë së Kosovës, u drejtua nga dirigjenti i njohur amerikan David Hayes.

Në këtë koncert u interpretua vepra “Hyland Mass Op. 130” e kompozitorit nga Malta Joseph Vella në di-

rigjimin e mjeshtrit amerikan David Hayes.

Në rolin e solistëve u prezantuan solistë nga Filharmonia e Kosovës dhe Teatri Kombëtar i Operës dhe Baletit në Tiranë (Shqipëri); sopranoja Adeline Paloja, altoja Françeska Pjetri, tenori Klodian Kaçani, baritoni Erion Sheri, basi Xhieldo Hyseni, sopranoja Arta Jashari dhe Nard Gllavurda (nga kori i fëmijëve “Okarina”).


Në UBT mbahet “Studio Practice - Experimentation” nga Fakulteti Art dhe Media Digjitale

06/03/2023. Në Parkun Shkencor Inovativ të UBT-së, në Lipjan, u organizua “Studio Practice - Experimentation”, nga Fakulteti Art dhe Media Digjitale në UBT, përmes së cilës u ekspozua puna dhe angazhimi i studentëve të këtij

fakulteti si një mundësi për të promovuar kreativitetin dhe aftësitë e tyre në artin dhe median digjitale. “Studio Practice - Experimentation” kishte për qëllim promovimin e veprave artistike të studentëve të Fakultetit Art dhe Media Digji-

tale, të cilat gërshtojnë pikëpamje të ndryshme dhe kanë për synim shfaqjen e talentit dhe kreativitetit të studentëve.

Studentët e Fakultetit Art dhe Media Digjitale në UBT përmes veprave të tyre sollën një pikëpamje tjetër të realitetit në të cilin po jetojmë, duke përcur mesazhe të ndërgjegjësimit, solidaritetit dhe bashkëpunimit ndërmjet njerëzve.



UBT bëri hapjen solemne të Qendrës për Leadership

Në një ceremoni solemne, në Parkun Shkencor Inovativ të UBT-së në Lipjan, u bë hapja e Qendrës për Leadership, një inovacion i rëndësishëm në fushën e arsimit të lartë me synim për ndërtimin e kapaciteteve të lider-shipit në sektore të ndryshëm në Kosovë, rajon dhe më gjerë duke ju ofruar individëve dhe organizatave mekanizma për të zhvilluar strategji veprimi.

Në fjalën e tij, Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, vlerësoi hapjen e Qendrës për Leadership si një hap të rëndësishëm drejt arsimit të lartë modern dhe inovativ në vend. Ai theksoi se kjo qendër do të ofrojë mundësi të jashtëzakonshme për studentët dhe të rinjtë për të zhvilluar aftësitë e tyre dhe për të ndikuar pozitivisht në përparimin e shoqërisë.

“Kjo Qendër është me fokus për leadership, është në vij të plotë me vizionin e UBT-së që lidhet me leadershipin dhe inovacionin. Do të shërbejë shumë mirë si një hap për mundësi të reja. Do të krijojë një do të promovojë një benefit shume te mire për Kosovën. Dëshirojmë që përmes partneriteteve të tanishme dhe të ardhshme me industri të fuqishme botërore të ofrojmë perspektiva të



reja, si dhe t'i përfshijmë ato për të krijuar politika të mira dhe për të shtyrë procese përpara”, u shpreh rektori Hajrizi.

Përfaqësuesi i Zyrës së Presidencës, Vehbi Miftari, përcolli përshëndetjet dhe mirënjohjen e Presidentes së Kosovës, Vjosa Osmani – Sadriu, për hapjen e Qendrës për Leadership në UBT. Ai u shpreh se Kosova ka nevojë për liderë të rinj të aftë që të marrin përgjegjësi për vendin në një mënyrë pozitive dhe të kontribuojnë në zhvillimin e qëndrueshëm social, ekonomik dhe politik.

“Po hapni edhe një dritare të re me synimet tuaja si institucion i cili ka një peshë të madhe për zhvillimin e arsimit në Kosovë. Është një

qendër e mundësive të shumta për zhvillim. Ne e shohim UBT-në si një faktor të rëndësishëm që vazhdon të jap kontribut në zhvillimin dhe përparimin e arsimit dhe edukimit në Kosovë. Hapja e një Qendre të tillë krijon mundësi për zhvillim të qëndrueshëm, duke e ditur se UBT ka një infrastrukturë të modernizuar, por edhe përshkak që është pjesë e rëndësishme e rrjetit të universiteteve ndërkombëtare”, tha Miftari.

Profesori Faton Limani, një pedagog i apasionuar në aplikimin e kornizës të leadershipit adaptiv dhe soft-skills të ndryshme në të gjithë sektorët, foli në lidhje me vizionin dhe synimin e kësaj qendre. Ai theksoi se liderët nuk lin-



din, por mësohen dhe kjo qendër do të përqendrohet në përgatitjen e liderëve të rinj, duke u fokusuar në zhvillimin e aftësive të tilla si komunikimi, menaxhimi i kohës, ekipi dhe inovacioni.

“Kjo ngjarje shënon një moment të rëndësishëm për zhvillimin e kapaciteteteve të lider-shipit në Kosovë, rajon dhe më gjerë. Individët dhe organizatat operojnë në një mjedis që ndryshon në një mënyrë konstante. Ata përballen me sfida të ndryshme, si në nivelin lokal, regional dhe global. Për t'u përballur me këto sfida nevojitet më shumë se kurrë aftësi lider-shipi. Përmes kësaj qendre do të kemi mundësi të bashkërendojmë kornizat, modelet dhe përvojat,

për t'ju ofruar ndihmë individëve dhe organizatave, për t'u përballur me sfida komplekse”, potencoi Limani.

Me hapjen e Qendrës për Leadership në UBT, Kosova bën një hap të rëndësishëm drejt të ardhmes së edukimit të lartë dhe zhvillimit të liderëve të ardhshëm. Ky projekt shënon një investim të rëndësishëm në formimin e brezave të rinj, që do të kenë potencialin për të ndikuar pozitivisht në rrugën e ardhshme të vendit. Përmes krijimit të një mjedisi stimulues dhe inovativ, Qendra për Leadership në UBT do të bëjë ndryshimin që është i domosdoshëm për të krijuar një shoqëri më të zhvilluar dhe të qëndrueshme.

Në UBT u ndan certifikata për anëtarët e ekipit përfaqësues të Kosovës në garën ndërkombëtare të robotikës “FIRST Global Challenge”



Leona Hajrizi, Eda Palushi, Muhamed Shala, Gjin Gojani, dhe Elita Hajrizi, u certifikuan nga UBT për përfaqësimin dinjitoz dhe të jashtëzakonshëm të Kosovës në garën më të madhe të robotikës “FIRST Global Challenge”, e cila u mbajt në Singapor.

Në ceremoninë e organizuar nga

UBT, mori pjesë Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, si dhe studentë, nxënës, familjarë dhe profesorë.

Rektori Hajrizi shprehu mirënjohje të thellë për angazhimin dhe përkushtimin e këtyre të rinjve për të garuar me shumë të rinj nga 150 vende të ndryshme të botës në

robotikë, duke e përfaqësuar në mënyrë dinjitoze dhe të jashtëzakonshme në arenën ndërkombëtare jo vetëm UBT-në por tërë Kosovën.

Në fjalën e saj, mentorja e ekipit të First Kosova, Elita Hajrizi falënderoi të gjithë të pranishmit dhe të gjithë ata që kontribuuan për arritjet e përgjithshme të tyre, si dhe anëtarët e ekipit të cilët nuk u ndalën asnjëherë së punuari si ekip. Gjatë viteve garuese, ekipi i UBT-së ka arritur që secilën herë të kthehet me çmime të ndryshme, për të cilat, një falënderim i jashtëzakonshëm shkon për UBT-në, institucionin lider të arsimit në vend, i cili ka qenë gjithmonë përkrahës ndaj ekipit, duke u siguruar garuesve infrastrukturë moderne për përgatitje dhe përkrahje maksimale në arritjen e sukseseve.

Rektori Hajrizi: Martti Ahtisaari ishte promovues i dialogut dhe ndërtimit të paqes



Në emër të UBT-së, Rektori Prof. Dr. Edmond Hajrizi ka shprehur ngushëllime për ndarjen nga jeta të kryenegociatorit për statusin e Kosovës, ish-presidentit të Finlandës, Martti Ahtisaari.

Presidenti Martti Ahtisaari ishte njeriu i cili kontribuoi një jetë të tërë në ndërtimin e paqes, demokracisë dhe të mirës së njerëzimit. Ai ishte

një promovues i dialogut, i zgjidhjes së konflikteve dhe i respektimit të të drejtave të njeriut.

Kujtimi për të do të jetojë përjetë në zemrat dhe mendjet e secilit prej nesh, dhe trashëgimia e tij do të vazhdojë të frymëzojë të gjithë ata që punojnë për një botë më të drejtë dhe më paqësore.

Në UBT shënohet Dita Botërore e Turbekulozit



Në Parkun Shkencor Inovativ të UBT-së, në Lipjan, Shkollat e Mesme të UBT-së organizuan një ligjëratë tematike me Dr. Adnora Nurboja, në shënim të Ditës Botërore të Turbekulozit.

Motoja e këtij viti e Ditës Botërore të Turbekulozit është “PO, Ne mundemi t'i japim fund Tuberkulozit!”, duke ritheksuar nevojën për trajtimin dhe parandalimin

e turbekulozit, si një sëmundje ngjitëse, që shkaktohet nga bacili Mycobacterium tuberculosis. Dr. Adnora Nurboja prezantoi para nxënësve të Shkollave të Mesme rreth mënyrës se si përhapet turbekulozi, personat që mund të preken me këtë sëmundje, rreth shenjave, statistikave dhe rreth parandalimit të përhapjes së turbekulozit.

Në UBT shënohet 1 qershori - Dita Ndërkombëtare e Fëmijëve



01/06/2023. Shkëlqim, energji e shumë dashuri, këto janë disa nga gjërat që karakterizuan 1 qershorin – Ditën Ndërkombëtare të Fëmijëve në Qytetin e Mençur, në Parkun Shkencor Inovativ të UBT-së në Lipjan.

Në këtë ditë të veçantë, UBT u bë vendi i gëzimit dhe shfaqjes së talentit të fëmijëve. Shumë aktivitete të këndshme dhe argëtuese u organizuan për të krijuar një ambient të lumtur dhe frymëzues për të

gjithë fëmijët. Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi dhe drejtoresha e Shkollës Filllore dhe të Mesme të Ulët UBT, Hajrije Devetaku, theksuan rëndësinë e arsimit cilësor dhe zhvillimit të aftësive të fëmijëve, duke thënë se kjo ditë është një mundësi e shkëlqyer për të nxitur ndërgjegjësimin dhe për të promovuar një mjedis shoqëror të sigurt dhe mbështetës për të gjithë fëmijët.

Në kuadër të aktiviteteve të shumta, për vizitë në Poliklinikën e UBT-së qëndruan edhe fëmijët e Shkollës “Mileniumi i Tretë”. Me këtë rast, Katedra e Pedodoncisë dhe Stomatologjisë Preventive së bashku me Katedrën e Ortopedisë së Nofullave, gjegjësisht Spec. Dr. Afërdita Gashi – Rizaj, Spec. Dr. Merita Sadiku, Spec. Dr. Vesel Rustemaj, ekzaminuan klinikisht fëmijët duke e marr statusin dentar, identifikuan karies në dhëmbët e qumështit dhe të përherëshëm, si dhe nevojën për masat preventive dhe indikacionet për terapi ortodontike.

Me stafin e mrekullueshëm të UBT-së, fëmijët kaluan një ditë të paharrueshme me lojëra, punëtori, prezantime artistike dhe shumë aktivitete të tjera që i sollën buzëqeshjen dhe kënaqësinë në fytyrat e tyre.

Shkollat e Mesme në UBT dhe Shkolla Fillore dhe e Mesme e Ulët UBT shënuan Ditën e Flamurit dhe Pavarësinë e Shqipërisë

27/11/2023. Për nder të 28 nëntorit – Ditës së Flamurit dhe 111-vjetorit të Pavarësisë së Shqipërisë, Shkollat e Mesme në UBT së bashku me Shkollën Fillore dhe të Mesme të Ulët UBT, organizuan një manifestim kulturor.

Në këtë organizim morën pjesë Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi dhe drejtoresha e Shkollave të Mesme të UBT-së dhe ShFMU-së, Hajrije Devetaku, të cilët shprehën rëndësinë e krenimit të kësaj date historike, duke trashëguar kështu brez pas brezi atdhetdashurisë.

Në fjalën e tij, Rektori Hajrizi përcolli ndjenjat e krenarisë dhe nderimit për këtë datë të madhe, duke theksuar rëndësinë e trashëgimisë së atdhetdashurisë nga një brez në tjetrin. Ai vlerësoi se një pjesë e theksuar e detyrës së shkollave është të forcojnë ndjenjën e identitetit kombëtar dhe kulturor tek nxënësit.



“Në këtë ditë të 28 nëntorit, ne përkujtojmë me nder dhe respekt personalitetet e shquara të kombit shqiptar të cilët jetësuan lirinë dhe pavarësinë e Shqipërisë. Kjo është një ngjarje që na nxit të reflektojmë mbi trashëgiminë tonë historike dhe detyrimin tonë për trashëguar atë me nder dhe përkujtim.”

Edukimi dhe arsimimi i brezave të rinj është krenaria jonë, dhe kujtesa për ditët e lavdishme të shqiptarëve është një burim frymëzimi për ta dashur edhe më shumë vendin dhe kombin. Nëpërmjet arsimit, ne shpërbëjmë barrierat dhe hapim dyert për një të ardhme më të ndritur për kombin dhe shtetet tona”, tha Rektori Hajrizi.

Nga ana tjetër, Drejtoresha Devetaku theksoi përkushtimin për kultivimin e vlerave kombëtare dhe përforcimin e identitetit shqiptar. Ajo inkurajoi nxënësit për angazhim më të madh, si dhe cilësoi shkollën si institucionin

kryesor për zhvillimin e vlerës së atdhetdashurisë.

“Sot, është një ditë feste për ne, është një ditë frymëzimi dhe motivimi për të vazhduar rrugëtimin tonë për kultivimin e identitetit kombëtar e kulturor përmes rrugës së edukimit dhe arsimimit të nxënësve. Muaji nëntor në shkollat e UBT-së ishte muaji i kultivimit të atdhetdashurisë si vlerë e rëndësishme e shoqërisë dhe shtetit, prandaj të dashur nxënës, rruga më e mirë për ta zhvilluar këtë vlerë është rruga institucionale dhe shkolla është institucioni më kompetent për të zhvilluar vlera të tilla”, ka thënë Devetaku.

Kjo ngjarje e mbushur me emocion dhe krenari u shënuar si një moment i rëndësishëm në hulumtimin dhe përforcimin e ndërgjegjes historike dhe patriotike të brezave të rinj shqiptarë.

Në UBT u promovua libri “Teoria e Muzikës” e profesoreshës Leutrina Pireva - Hyseni

Profesoresha e Fakultetit Muzika Moderne, Prodhimi Digjital dhe Menaxhimi në UBT, Leutrina Pireva - Hyseni bëri promovimin e librit “Teoria e Muzikës” në Parkun Shkencor Inovativ të UBT-së në Lipjan.

Studentë, profesorë dhe ekspertë të fushës së muzikës u bënë pjesë e këtij promovimi, duke shfaqur interesin e tyre për librin dhe për kontributin e profesoreshës Leutrina Pireva - Hyseni në fushën e muzikës moderne, prodhimit digjital dhe menaxhimit.

Ky libër është i pari i këtij lloji duke përfshirë mbi 80% të librit në ushtrime praktike, si dhe gjitha ushtrimet janë në bashkëveprim me mësimdhënësit, ndërkaq recensentët e tij janë: Prof. Bajr Berisha dhe Akademik Prof. Rauf Dhomi.

Recensenti i librit, Prof. Bajr Berisha vlerësoi lartë kontributin e profesoreshës Pireva - Hyseni, si dhe potencoi se libri voluminoz do të jetë në shërbim të nxënësve dhe studentëve të kësaj fushe.

Autorja e librit, profesoresha Leutrina Pireva - Hyseni tha se detyrat dhe ushtrimet të cilat i ka prezantuar në libër janë të dobishme dhe shërbejnë për të përmirësuar të nxënësit e mësimëve nga nxënësit e fushës së muzikës.



“Gjatë mësimdhënies, kam parë ngecjet dhe problematikat, që janë paraqitur gjatë të nxënësve të mësimëve nga nxënësit në lëndën e solfezhit, të instrumentit muzikor, dhe e gjithë kjo për shkak të mosnjohjes së tekstit notal, apo të shkrimit dhe leximit muzikor. Improvizimi i detyrave dhe ushtrimeve, të cilat shërbejnë për të përmirësuar të nxënësve nga nxënësit ishte arsyeja për botimin e këtij libri teoriko-praktik të muzikës, për të gjitha nivelet e arsimit profesional muzikor”, tha Pireva - Hyseni.

Përmes këtij libri, autorja ka synuar t’ju mësoj leximin e notave, njëjtë

si në gjuhë që mësohen shkronjat, rrokjet dhe pastaj lexohen fjalët. Libri është i ndarë në tri pjesë: Pjesa e parë – punohet dhe mësohet gjatë klasës së parë të shkollës fillore profesionale muzikore, pjesa e dytë – punohet dhe mësohet nga klasa e dytë e shkollës fillore profesionale muzikore, si dhe pjesa e parë e dytë dhe e tretë – punohet dhe mësohet gjatë klasës së X-të të shkollës së mesme profesionale muzikore gjatë vitit të parë të studimeve në drejtimin e muzikës për studentët të cilët nuk kanë pasur më parë njohuri dhe mësim profesional muzikor.

UBT mbyll vitin 2023 me suksese të jashtëzakonshme - ndër to edhe pesë marrëveshje me universitete ndërkombëtare për diploma të dyfishta

Në kuadër të bashkëpunimeve me rreth 500 universitete botërore, UBT këtë vit ka bërë marrëveshje për programe të reja me diploma të dyfishta në fusha të ndryshme studimi: biznes, ekonomi, shkenca kompjuterike, inxhinieri dhe teknologji, shkenca politike, mekatronikë, agrikulturë, psikologji, arkitekturë, si dhe shëndetësi.

Të gjitha programet ndërkombëtare që i ofron UBT mundësojnë që studimet të ndiqen nga Kosova, pa pasur nevojë që studentët të udhëtojnë në vendet që dëshirojnë të studiojnë, por edhe mundësinë që pas dy apo tri vite studimi, vitin e fundit ta mbarojnë në universitetin partner. Kjo mundëson që studentët e UBT-së të mund të zhvillohen në një mjedis vërtetë ndërkombëtar. Këto marrëveshje vijnë si një rezultat dhe konfirmojnë punën e madhe që bëhet në UBT me vite për të ofruar cilësi të lartë të programeve, infrastrukturë inovative dhe staf me kompetenca, por edhe çmimet dhe rangimet që UBT ka marr në vitet e fundit.

Kjo ka rritur besueshmërinë dhe kërkesën për bashkëpunime edhe më shumë në arenën ndërkombëtare.

“Çdo vit po rritet numri i studentëve ndërkombëtarë të cilët kanë interesim për diplomat e UBT-së dhe ato të dyfishta. UBT është bërë vendi ideal për shumë studentët ndërkombëtarë për studime dhe për punë praktike. Çmimi i arsyeshem i studimeve dhe ekosistemi inovativ e bën UBT-në institucion të konkurrueshem në arenën ndërkombëtare”, tha Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi.

UBT nisi programin e tij të parë të përbashkët para 20 vite, më 2003, së bashku me Universitetin e Vjenës për Teknologji dhe me Universitetin Oakland nga ShBA. Ky ka qenë edhe programi i parë në Kosovë me studime të përbashkëta dhe i ofruari i tjeri në gjuhën angleze.

UBT natyrisht ka vazhduar mandej me universitete të tjera dhe me marrëveshje në Evropë, ShBA, Azi, Australi, Afrikë e Amerikë Latine.

Në UBT u shfaq filmi dokumentar për veprën e historianit Sir Noel Malcolm

Në prani të shumë studentëve, profesorëve dhe pjesëmarrësve të tjerë, në UBT u shfaq filmi dokumentar kushtuar jetës dhe veprës së historianit britanik Sir Noel Malcolm, si dhe angazhimit të tij ndaj çështjes së Kosovës.

Në shfaqje të dokumentarit, i pranishëm ishte rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, ambasadori Mal Berisha, i cili është njëkohësisht skenaristi dhe regjisor i këtij dokumentari, gjenerali Giuseppe Morabito, si dhe inxhinieri Pierangelo Panozoz.

Noel Malcolm shpërfaqti një ndikim të madh me veprën e

tij në ndërgjegjësimin e diplomacisë botërore për shtetin e Kosovës. Përveç sensibilizimit të botës perëndimore, ai gjithashtu përmes zbulimit të fakteve dhe të vërtetave kundër propagandës së aparaturës shtetërore serbe, synonte të informonte drejt dhe saktë rreth çështjes së Kosovës dhe shqiptarëve.

Libri i Malcolm “Kosova: një histori e shkurtër” u kthye në një dokumentar nga ambasadori Berisha për të qenë më afër secilit që dëshiron të njoh dhe të dijë më tepër rreth historisë së Kosovës dhe shqiptarëve në përgjithësi.

UBT hap Institutin e Forenzikës - një ndër institutet e para të këtij lloji në Ballkan



UBT ka shënuar një hap të rëndësishëm në fushën e shkencës dhe hulumtimeve me hapjen e Institutit të Forenzikës, një ndër institutet e para të këtij lloji në Ballkan. Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, ka thënë se ky institut është i nevojshëm dhe do të jap një kontribut të jashtëzakonshëm. “Qasja ndërdisiplinore sot në fushën e forenzikës është më se e nevojshme. Duke marrë parasysh

infrastrukturën, stafin dhe ambientin inovativ dhe ndërdisiplinor të UBT-së, ky institut mund të jepë një kontribut të jashtëzakonshëm”, ka thënë Rektori Hajrizi. Ky institut i cili është shkencor dhe ndërdisiplinor do të mbulojë një gamë të gjerë temash në aspektin akademik, shkencor dhe profesional, duke përfshirë mjekësinë, kriminologjinë, teknologjinë, ushqimin, ekonominë, sigurinë, inx-

hinierinë, teknologjinë, artin, dhe shumë fusha të tjera.

UBT posedon laboratorë dhe personel të kualifikuar, por ka edhe partnerë ndërkombëtarë që bëjnë këtë institut inovativ dhe shumë të kërkuar në nivelin vendor dhe atë ndërkombëtar.

Këtë vit UBT ka qenë bashkë organizator i Konferencës Ndërkombëtare në Izmir të Turqisë, ndërsa në vitin që vjen kjo konferencë do të organizohet në Kosovë.

Ky institut do të jetë një qendër që ofron trajnime, studime, hulumtime dhe zhvillim për të gjitha fakultetet dhe fushat e jetës që ofron UBT në ekosistemin e vet.

Bashkëpunimi në mes UBT-së dhe IAYSP-së sjell suksese të mëdha në veprimtari qytetare

Asociacioni Ndërkombëtar i Studentëve për Paqe, i njohur ndryshe si IAYSP, ka shënuar një sukses të jashtëzakonshëm gjatë dy viteve të fundit me programin e trajnimit ndërkombëtar "Peace Designer", të zhvilluar në bashkëpunim të ngushtë me UBT-në.

Ky inovacion bazohet në 17 Qëllimet e Zhvillimit të Qëndrueshëm të Kombeve të Bashkuara (SDGs), duke ofruar një platformë për të rinjtë për të studiuar, analizuar dhe marrë pjesë në veprimtari qytetare për hartimin dhe zbatimin e projekteve që ndihmojnë në zhvillimin e tyre dhe të komunitetit.

Pas arritjeve dhe përfshirjes së të rinjve gjatë trajnimit të ofruar në vitin akademik 2022-2023, UBT dhe IAYSP kanë nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi. Kjo marrëveshje shërben si një platformë institucionale, sho-



qërore dhe rajonale për të rinjtë në Ballkan, duke u mundësuar pjesëmarrjen e tyre në trajnime dhe konkurse në nivel ballkanik.

Grupet fituese që dalin nga kjo marrëveshje do të gëzojnë asistencën e nevojshme për zbatimin e projekteve të tyre.

Në këtë kontekst, grupet fituese nga viti i kaluar janë aktualisht në fazën e implementimit. Grupi i parë, përbëhet nga studentët e Fakultetit të Psikologjisë: Anila Shala, Anjeza Gashi, Elmedina Cimili, Liburn Krrabaj dhe Olti Gjonbalaj, kurse anëtarët e grupit të dytë të Gjimnazit UBT janë: Eda Palushi, Bind Ahmetaj, Gjin Gojani, Harisa Haziri dhe Muhamed Shala.

Të dy grupet janë në procesin e zbatimit të projekteve nën drejtimin e trajneres dhe drejtores ekzekutive të IAYSP Balkan, Ejo-na Icka, dhe menaxheres së projekteve Mikaela Ljalla. Në bashkëpunim me UBT, kanë siguruar mbështetjen e nevojshme për të garantuar suksesin e përditshëm të projektit gjatë fazës së implementimit.

Përveç tjerash, studentët që kanë kryer trajnimin vitin e kaluar po

ndihmojnë grupet e reja këtë vit, duke kontribuar në realizimin e vizionit të IAYSP për të krijuar një brez të ri aktiv dhe model. Grupet e reja kanë filluar trajnimet që nga muaji tetor dhe këtë vit janë pjesë e trajnimit 64 pjesëmarrës.

Ky bashkëpunim shërben si një shembull frytdhënës i përfshirjes së studentëve në ndërtimin e paqes dhe zhvillimin e komunitetit, duke i inkurajuar ata të marrin pjesë në ndryshimet pozitive dhe të krijojnë impakt në shoqëri.

Asociacioni Ndërkombëtar i Studentëve për Paqe dhe UBT vazhdojnë të jenë udhëheqës në mbështetjen dhe promovimin e iniciativave të tilla, duke kontribuar në krijimin e një mjedisi të përshtatshëm për rritjen dhe zhvillimin e një brezi të përgjegjshëm dhe aktiv.

Në UBT u shënuar Dita Ndërkombëtare e Sistemit të Informacionit Gjeografik (GIS)



15/11/2023. Këtë vit, UBT ishte nikoqire për shënimin e ditës ndërkombëtare të Sistemit të Informacionit Gjeografik (GIS), nën organizimin e Fakultetit të Sisteme të Informacionit, me ç'rast u mbajt një diskutim i hapur me ekspertë dhe hulumtues me temën: "Përdorimi i GIS në vendimmarrje hapësinore në Kosovë".

Hapjen e këtij diskutimi e bëri Dekani i Fakultetit të Sisteme të Informacionit, Dr. Blerton Abazi, i cili theksoi nevojën e rritjes së rëndësisë së GIS-it, por edhe fushave që janë të ndërlidhura dhe që ndikojnë në pjesën e gjeografisë. Në fjalën e tij, Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi theksoi se tema për GIS-in duhet të bëhet temë e përditshme dhe të përdoret më shumë duke e parë pjesën e zhvillimeve dhe se si GIS është bërë bazament shumë i rëndësishëm për të ardhmen.

"GIS është një temë e përditshme, si dhe do të përdoret edhe më shumë duke e parë pjesën e zhvillimit dhe se si GIS është bërë bazament i rëndësishëm për të ardhmen. Për kompleksitetin e problemeve, mendoj që përgjigja vjen prej një koncepti të tillë. Në kuadër të ekosistemit të UBT-së ku kemi gjeneruar mbi 30 koncepte inovative, kemi menduar që edhe GIS duhet të vendoset edhe të merr peshën e rëndësishme që ka dhe reflektimin e të rinjve që të përdorin sa më shumë dhe të kenë kompetencë të punës së tyre në të ardhmen", u shpreh Rektori Hajrizi. Panelistët e ftuar ishin: Dr. Binak Beqaj nga Fakulteti i Arkitekturës dhe Planifikimit Hapësinor në UBT, Msc. Gresa Neziri, urbaniste njëherit bashkë-themeluese dhe drejtoare ekzekutive në SpaceSyntaKs, Msc. Murat Hoxha, kryetar i Shoqatës së Gjeode-

tëve të Kosovës, Dr. Edon Maliqi, profesor i Gjeoinformatikës dhe Hartografisë në UBT dhe Msc. Rizah Murseli nga Divizioni i GIS-it në Institutin për Planifikim Hapësinor në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.

Ata diskutuan për aspekte të ndryshme të implementimit të GIS, duke theksuar rolin e tij në proceset e marrjeve të vendimeve hapësinore në Kosovë. Ekspertët ndanë shqyrtimet e tyre në lidhje me sfidat dhe mundësitë lidhur me përdorimin e GIS në kontekstin e informacionit gjeografik dhe marrjes së vendimeve.

Diskutimi përfundoi me një angazhim të përbashkët për të promovuar më tej përdorimin e GIS në fusha të ndryshme dhe për të përmirësuar nismat arsimore. Pjesëmarrësit theksuan rëndësinë e dialogut të vazhdueshëm midis akademisë, industrisë dhe qeverisë për të përfutur plotësisht nga potenciali i GIS për zhvillimin e qëndrueshëm të Kosovës.

Në këtë ngjarje ishin të ftuar përfaqësues nga institucionet, universitetet, industria, përdorues, profesorë dhe studentë me qëllim që të ndajnë përvojat e tyre shkencore, akademike, industriale dhe profesionale.

UBT mori pjesë dhe mbështeti Turneun Memorial "Fadil Vokrri"

UBT mori pjesë dhe mbështeti turneun më të madh të futbollit në Republikën e Kosovës, i cili kushtohet ish-kryetarit të Federatës së Futbollit të Kosovës dhe ish-legjendës së futbollit kosovar, Fadil Vokrri.

Pjesëmarrja e UBT-së në këtë ngjarje tregon përkushtimin e insti-

tucionit ndaj zhvillimit të sportit. Përmes programit Shkenca të Sportit dhe të Lëvizjes, UBT po investon në trajnimin dhe zhvillimin e talenteve sportive, duke krijuar një mjedis ku studentët mund të zhvillojnë njohuri të thella dhe aftësi të specializuara në fushën e sportit.

UBT shpërndan dhurata për fëmijët e komunitetit rom në Gadime të Lipjanit



Në këtë periudhë festash, UBT ka ndërmarrë një nismë të veçantë për të sjellë gëzim dhe ngrohtësi në zemrat e fëmijëve të komunitetit rom në Gadime të Lipjanit. Këto dhurata u ndanë në prag të festave të fundvitit, me qëllim që këta

fëmijë të kenë vazhdimisht përkrahje dhe mbështetje nga shoqëria. Shpërndarjen e dhuratave e kanë bërë përfaqësues të UBT-së, në krye me drejtoreshën e Parkut Shkencor Inovativ të UBT-së në Lipjan, Lirigzona Morina.

Takimet e Qendrës së Karrierës në UBT me industrinë luajnë rol thelbësor në zhvillimin profesional të studentëve

20/11/2023. Përfaqësues nga Qendra e Karrierës dhe Fakultetit Inxhinieri e Mekatronikës në UBT, kanë realizuar një vizitë në kompaninë "Automita", e cila operon në tregun vendor si një kompani e fuqishme në sektorin automotive. Kompanitë shpesh kërkojnë të zgjedhin të rinjtë të talentuar nga ambientet universitare, dhe bashkëpunimi universitet-industri



është një mjet i shkëlqyeshëm për të krijuar lidhje dhe për të bërë njohje që mund të çojnë në mundësi konkrete.

Nëpërmjet takimeve me industrinë, studentët mund të ndërtojnë një rrjet profesional të fuqishëm për të ardhmen, duke sjellë mundësi të reja, praktike e punësimi, dhe mbështetje në rrugën e tyre drejt një karriere të suksesshme.

Gjithashtu, roli i Qendrës së Karrierës është të rrisë konkurrueshmërinë e studentit në tregun e punës, e cila shpesh shërben si një formë e njohjes së konkretizuar dhe e ndërthurjes së teorisë me praktikën, duke e përgatitur studentin për sfidat dhe mundësitë e botës së punës.

Qendra e Karrierës në UBT ka vazhduar me organizimin e trajnimeve në shkathhtësitë e buta

07/11/2023. Qendra e Karrierës ka vazhduar organizimin e trajnimeve në shkathhtësitë e buta, në kuadër të trajnimeve të karrierës me qëllim përgatitjen e sa më shumë studentëve me këto shkathhtësi që do t'i mundësonin atyre të përgatiteshin për punë. Trajnimet në shkathhtësitë e buta, si ato në të shkruarit e letrës mo-

tivuese, një CV-je profesionale, si dhe intervistave të punës, janë të domosdoshme për një karrierë të suksesshme, dhe punësim të shpejtë menjëherë pas diplomimit. Gjithashtu, vlen të theksohet se UBT e ka numrin e punësimit më të madh të studentëve pas diplomimit në nivel vendi.

UBT prin për aktivitetin në mediat sociale nga universitetet në Kosovë

UBT në Kosovë ka dalë si lider në përdorimin e fuqisë së mediave sociale për të komunikuar me studentët dhe komunitetin e gjerë. Në një kohë kur teknologjia dhe digjitalizimi luan një rol kyç në arsim, UBT ka vendosur një standard shembullor për universitetet e tjera në Kosovë.

Përmes një përmbajtjeje kreative dhe të mirinformuar në platformat Facebook dhe Instagram, raporti i



nxjerrë nga Terra World ka ranguar UBT-në të parin nga universitetet në Kosovë, duke dëshmuar kështu an-

gazhimin e përditshëm të tij për të qenë sa më afër audiencës në Kosovë dhe më gjerë.

Për më tepër, përfshirja aktive e UBT-së në platforma, si: Facebook, Instagram, Twitter, LinkedIn, YouTube dhe TikTok, ka bërë që ndarja e lajmeve, përditësimet akademike, pikat e forta të kërkimit dhe sukseset, të dëshmojnë transparencën dhe të kontribuojnë në ndërtimin e besimit dhe kredibilitetit të audiencës.

UBT mbajti mbledhje komemorative në nderim të jetës dhe veprës së profesorit Fetah Jagxhiu



24/11/2023. Studentë, familjarë, profesorë, kolegë e miq të shumtë u mbledhën sot në UBT, në mbledhjen komemorative të organizuar në nderim të veprës dhe kontributit të pashuar të profesorit Fetah Jagxhiu.

Profesori Jagxhiu dha një kontribut të veçantë në themelimin e Fakultetit të Inxhinierisë Ndërtimore (Ndërtimtarisë) dhe Infrastrukturës në UBT, teksa për 50 vjet me radhë u angazhua në fushën e arsimit. Ai u nderua me një çmim nga UBT për kontributin e tij në arsim.

Po ashtu, kontributi i tij ka qenë i madh në vitet e 90-ta, ku ka qenë kryetar i Senatit të Universitetit të Prishtinës. Ishte pjesëmarrës edhe i Lëvizjes Studentore të 1997.

Në emër të UBT-së foli Dekani i Fakultetit Arkitekturë dhe Planifikim Hapësinor në UBT, Prof. Dr. Binak Beqaj, ndërsa në emër të familjes Jagxhiu foli e bija e profesori, profesoresha Besa Jagxhiu. Biografia e Profesorit Fetah Jagxhiu:

Profesor Fetah (Selman) Jagxhiu është lindur me 25 dhjetor 1937 në Prizren. Shkollën Fillore dhe Gjimnazin e ka kryer në vendlindje me sukses shembullor.

Në vitin shkollor 1957/58 regjistrohet në Fakultetin AGG në drejtimin e Ndërtimtarisë, në

Universitetin e Zagrebit. Studimet i përfundon si ndër të parët e gjeneratës së vet në prill të vitit 1963. Si inxhinier i parë i ndërtimtarisë i qytetit të Prizrenit, punësohet në ndërmarrjen shtetërore ndërtimore "Sharr", ku punon deri në muajin tetor të po atij viti 1963, kur me kërkesën e disa kolegëve të studimeve të Zagrebit dhe me lejen e drejtorit të ndërmarrjes "Sharr", Gani Demiri, i cili ka qenë luftëtar dhe patriot dhe largpamës, në tetor të vitit 1963 punësohet si asistent në Shkollën e Lartë Teknikë në Prishtinë, të posa themeluar me tri drejtime: Ndërtimtari, Elektroteknikë dhe Makineri.

Në drejtimin e Ndërtimtarisë dhe të Makinerisë nuk ka pasur asnjë shqiptar, ndërsa në drejtimin e Elektroteknikës ishin disa inxhinier të diplomuar me përvojë dhe atëherë u kuptua pse ishte ftesa e atyre kolegëve të elektroteknikës, që edhe ky inxhinier i ri i diplomuar i Ndërtimtarisë të vjen në SHLT në Prishtinë, t'i bashkëngjitet atyre kolegëve, që atëherë ishin asistent në drejtimin e elektroteknikës.

Në tetor të vitit 1965 themelohet Fakulteti Teknik në Prishtinë si dega e Fakultetit të Ndërtimtarisë të Universitetit të Beogradit me vetëm një drejtim, atë të Ndërtimtarisë ngase në atë drejtim ishin

më shumë kadro (inxh. të dipl.) serbë, edhe vetë drejtori i SHLT ishte serb, i cili u zgjodh edhe dekan i parë i Fakultetit Teknik. Prej komisionit Amë të Fakultetit të Ndërtimtarisë u zgjodh, atëherë inxh. i dipl. Fetah Jagxhiu, asistent i parë shqiptar i Fakultetit Teknik në Prishtinë ku mbaheshin ligjëratat vetëm në gjuhën Serbokroate. Në tetor të vitit 1965 Fetah Jagxhiu regjistrohet në studime pasdiplomike posa të themeluara, në Universitetin e Zagrebit.

Në vitin 1970, ishte ndër të parit në gjeneratën e vet që diplomoi, kështu që ishte magjistr i parë i shkencave teknike në Kosovë. Po atë vit, sipas ligjit të asaj kohe u zgjodh në thirrjen universitare Docent për dy lëndë: Mekanika dhe Rezistenca e materialeve.

Në tetor të vitit 1971 u zgjodh dekan i Fakultetit Teknik (dekan i parë shqiptar i Fakultetit Teknik) me pesë drejtime (3 në Prishtinë – Ndërtimtaria, Elektroteknika dhe Makineria dhe 2 drejtime në Mitrovicë – Hehtaria dhe Metalurgjia).

Në vitin 1977 paraqet tezën e Doktoratës në Prishtinë, UP. Në vitin 1978 qëndroi në studime shkencore në Universitetin Politeknik të Krakovit në Republikën e Polonisë. Në vitin 1982 mbron tezën e Doktoratës në Prishtinë.

Në po të njëjtin vit zgjedhet në thirrjen Prof. inordiner, ndërsa në vitin 1987 zgjedhet në thirrjen Prof. ordiner. Në vitin 1991 nga ana e organeve të dhunshme të asaj kohe së bashku me pedagogët dhe studentët shqiptar largohet nga Universiteti. Në Tetor të po atij viti ky et në grupin organizativ të pedagogëve të Universitetit të Prishtinës për organizimin e mësimin në shtëpia private (sistemi i arsimit paralel). Në atë kohë të sistemit paralel, zgjedhet Dekan i Fakultetit të Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës.

Detyrën e dekanit të Fakultetit të Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës e kryen në dy mandate deri në tetor të vitit 1994. Derisa ishte dekan i FNA në tetor të vitit 1992 në protestat e atij viti burgoset dhe maltrohet nga policia serbosllave e asaj kohe. Posa e përfundon mandatin e dekanit të FNA (tetor 1994), nga Senatit i Universitetit të Prishtinës zgjedhet Kryetar i parë i Senatit të Universitetit të Prishtinës me mandat 4 vjeçar deri në vitin 1998.

Deri sa ishte dekan i FNA organizon studimet pasdiplomike në

vitin 1994/95 në degën e Ndërtimtarisë – drejtimi konstruktiv, të cilat studime edhe i udhëheq prej vitit 1995 deri në vitin 2003 (kur është pensionuar).

Paralel punës si pedagog universitar ka dhënë kontributin e madh në përpilimin e teksteve universitare.

Disa nga tekstet e botuara të tij të cilat do të shërbejnë edhe për shumë gjenerata në të ardhmen janë:

“Mekanika I (Statika)”

“Përmbledhje detyrash të zgjidhura nga Mekanika I”

“Mekanika II (Kinematika)”

“Mekanika III (Dinamika)”

“Rezistenca materialeve pjesa e I”

“Përmbledhje detyrash të zgjidhura nga Mekanika II (Kinematika)”

“Rezistenca e materialeve – pjesa e dytë”

“Teoria e elasticitetit”

“Teoria e plasticitetit”


“Teoria e zvarritjes”



Ndahet nga jeta profesoresha Valdeta Rexhepi-Dobra

Pas një sëmundje të rëndë, është ndarë nga jeta profesoresha e UBT-së, Valdeta Rexhepi-Dobra. Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, i ka shprehur ngushëllime familjes së të ndjerës, duke thënë se kjo është një humbje e madhe jo vetëm për familjen por edhe për të gjithë komunitetin e arsimit dhe shëndetësisë.

“Profesoresha Valdeta Rexhepi-Dobra do të jetojë gjithnjë mes nesh përmes veprës dhe profesionalizmit që ka treguar. Në emrin tim dhe të institucionit që udhëheq u shpreh ngushëllimet më të sinqerta gjithë kolegëve, miqve, studentëve dhe atyre që e njohën”, ka thënë Rektori Hajrizi.



Ndërron jetë studenti i UBT-së, Molos Delija

Është ndarë nga jeta studenti i Fakultetit Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi në UBT, Molos Delija.

Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi ka ngushëlluar familjen Delija, duke vlerësuar lartë personalitetin e Molosit, përkushtimin dhe seriozitetin e tij.

“Me pikëllim të thellë morëm lajmin për ndarjen nga jeta të studentit tonë, Molos Delija. Shembulli që Molos ka dhënë për shokët dhe kolegët e tij me përkushtimin që kishte për të studiuar dhe punuar tregon shumë për personalitetin e tij. Në emrin tim dhe të institucionit që



drejtoj, ju shpreh ngushëllime të sinqerta gjithë familjes, shokëve dhe atyre që e njohën Molosin”,

thuhet në telegramin e ngushëllimit të rektorit Hajrizi, drejtuar familjes Delija.

UBT vendi ideal për zhvillimin profesional të vajzave dhe grave në shkencë

11/02/2023. Në Ditën Ndërkombëtare të Grave dhe Vajzave në Shkencë, rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi ka përgëzuar të njëjtat për përkushtimin, angazhimin dhe vendosmërinë për të arritur qëllimet e tyre në zhvillimin e shkencës në Kosovë dhe më gjerë. "Si UBT, angazhimin për fuqizimin e grave e kemi treguar dhe dëshmuar gjatë gjithë kohës, duke pasur kështu shifra shumë të mira të barazisë gjinore në punë. Çfarë na motivon dhe na bën krenar në të njëjtën kohë, është fakti se numri i studenteve që zgjedhin për të studiuar në sektorin e ICT-së është në rritje të vazhdueshme. UBT është institucioni që i mbështet vajzat të cilat zgjedhin për të studiuar në këtë sektor, me bursa studimi e me mundësi të tjera që ua lehtësojnë studimet", ka thënë rektori Hajrizi. UBT përmes programeve të shum-



ta, me theks të veçantë ato të teknologjisë ka arritur të ngjallë interesimin dhe t'i inkurajojë vajzat dhe gratë të inkuadrohen dhe të studiojnë në fushat inxhinierisë kompjuterike, sistemeve të informacionit e menaxhimit të mekatronikës. UBT për 20 vite punë ka promovuar vazhdimisht vlerat që vajzat dhe gratë kanë në shoqëri edhe

në profesione ku zakonisht numri i tyre është i vogël. Për këtë, me kalimin e viteve në UBT numri i studenteve që kanë studiuar dhe janë duke i vazhduar studimet në sektorin e ICT-së është rritur dukshëm, duke shkuar numri i përgjithshëm i tyre në mbi 2500 studente femra që kanë zgjedhur për të vazhduar rrugëtimin e tyre akademik në këtë fushë. Në sajë të zhvillimit të ekosistemit të UBT-së dhe rritjes së partneriteteve të reja, njëherit duke u angazhuar edhe për të krijuar hapësira të reja për gratë dhe vajzat, UBT së bashku me UN Women për Kosovë ka nënshkruar deklaratën e përkushtimit për Parimet e Kombeve të Bashkuara për Fuqizimin e Grave, përmes së cilës dëshmohet angazhimi dhe promovimi i barazisë gjinore në nivele akademike, menaxheriale dhe administrative.

Robin Mudry nga bordi ekzekutiv i JEF Europe zhvilloi një diskutim të hapur me studentët dhe gjimnazistët e UBT-së

11/03/2023. Në Parkun Shkencor Inovativ të UBT-së, Robin Mudry nga bordi ekzekutiv i JEF Europe (Federalistëve të Rinj Evropianë) pati një diskutim me studentët dhe gjimnazistët e UBT-së mbi federalizmin, demokracinë, aktivizmin dhe aktivitetet e JEF Europe. Mudry theksoi se "JEF", ose Federalistët e Rinj Evropianë, është organizata më e madhe rinore politike jopartiake me mbi 10,000 anëtarë në të gjithë Evropën. JEF po punon drejt një kontinenti evropian të bashkuar dhe të organizuar në mënyrë federale që do të përfshijë dhe integrojë plotësisht Ballkanin Perëndimor. Ai shtoi po ashtu se aktivizmi është në qendër të aktiviteteve të JEF-it kur të rinjtë takohen me

njëri-tjetrin, organizojnë fushata dhe seminare ndërkombëtare dhe angazhohen në diskutime pan-evropiane për të formuluar kërkesat e tyre politike dhe programin politik të JEF Europe. Premtimi i demokracisë, sipas Mudry, është shumë më tepër sesa thjesht votimi – është ajo që i motivon dhe i orienton JEFers në kërkimin e tyre për një Evropë të demokracisë, lirisë, solidaritetit, respektit, sundimit të ligjit dhe të drejtave të njeriut. Mudry për Bibliotekën e UBT-së, dhuroi librin "Textile Manifestoes" ku ai është autor dhe redaktor.

Ambasadori i Italisë në Kosovë, Antonello De Riu vizitoi UBT-në - përgëzoi studentët për nisjen e mësimit të gjuhës italiane



10/11/2023. Në UBT qëndroi për vizitë Ambasadori i Italisë në Kosovë, Antonello De Riu, i cili në

praninë edhe të Rektorit të UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, përgëzoi studentët për fillimin e Kursit të Gjuhës Italiane, me mentore profesore nga Italia, Rafaella Rittucci. Kursi është në kuadër të Institutit të Gjuhëve të Huaja në UBT, tekta është mbështetur nga Ambasada e Italisë në Kosovë dhe Qeveria Italiane.

Rektori Hajrizi dhe Ambasadori De Riu vlerësuan se kjo nisje do të jetë në dobi të studentëve si dhe të rinjve të Kosovës dhe rajonit, të cilët duan të përmirësojnë dhe përvetësojnë gjuhën italiane, por edhe të përfitojnë nga njohja e kulturës dhe historisë së kësaj gjuhe.

Elita Hajrizi ishte pjesëmarrëse në samitin e njohur të teknologjisë "Web Summit 2023", në Lisbona të Portugalisë

20/11/2023. Inxhinieria e IT-së, Elita Hajrizi ishte pjesëmarrëse në samitin e njohur të teknologjisë, i cili mbahet në Lisbona të Portugalisë, "Web Summit 2023", ku ka ofruar njohuritë, përvojën dhe angazhimin e saj si vullnetare. Elita Hajrizi ka sjell në këtë forum njohuri të avancuara në fushën e inxhinierisë së IT-së dhe ka ndarë eksperiencën e saj në zhvillimin dhe përdorimin e teknologjive të fundit. Ajo ka shkëmbyer, ka marr informacione dhe është socializuar me pjesëmarrës nga e gjithë bota, si dhe ka përfituar përvojën për t'a sjellur këtë samit në një të ardhme edhe në Kosovë.

"Ka qenë një mundësi e mirë për të parë nga afër se si organizohet një ngjarje e tillë, e cila këtë vit ka



bashkuar rreth 70 mijë pjesëmarrës. Gjithashtu, përvoja e fituar në këtë ngjarje është një mundësi

për të menduar që të realizohet e njëjta edhe në Kosovë", ka thënë Hajrizi.

Pjesëmarrja e Elita Hajrizi në "Web Summit 2023" është një shembull i përkushtimit të profesionistëve të fushës së IT-së nga UBT në shpërndarjen e njohurive dhe përfaqësimin e një standardi të lartë në skenën ndërkombëtare. Kjo ngjarje ka mundësuar shkëmbimin e ideve, bashkëpunimin ndërkombëtar dhe njohjen e arritjeve të inxhinierisë së IT-së në nivel global. Përfaqësimi i Elita Hajrizi ka rritur profilin e UBT dhe ka theksuar rolin e saj si një universitet i cili promovon dhe kontribuon në fushën e teknologjisë në skenën botërore.

Studentë nga Gjermania qëndruan për punëtori në UBT

Në UBT kanë qëndruar një grup i studentëve dhe mësimeve nga TH Lubeck (Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Lubeck) nga Gjermania.

Studentët dhe mësimeve kanë qenë pjesë e mobilitetit një-javor, pjesë e projektit Erasmus + dhe kanë trajtuar temën "Hapësirat publike të Prishtinës".

Për studentët nga Gjermania janë organizuar vizita në hapësirat publike të Prishtinës, në Parkun



Shkencor Inovativ të UBT-së në Lipjan, ku janë prituri nga Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, dekani i Fakultetit Arkitekturë dhe Planifikim Hapësinor, Binak Beqaj, si dhe profesorë dhe studentë të këtij drejtimi.

Pjesëmarrës në këtë punëtori pesë ditore kanë qenë edhe studentët e Fakultetit Arkitekturë dhe Planifikim Hapësinor në UBT. Moduli është krijuar dhe udhëhequr nga profesori Michael Locher dhe

zëvendës presidenti i TH Lubeck, Frank Scwartz, dhe profesorët e UBT-së, Lulzim Beqiri dhe Bekim Ceko.

Moduli është mbështetur edhe nga Drejtori e Urbanizmit në Komunën e Prishtinës, derisa ky bashkëpunim do të vazhdojë me punëtori të përbashkëta dhe projekte me interes për të dy institucionet.

Studentë dhe profesorë të UBT-së në takim dhe organizuar në kuadër të projektit IoT-ECO në TU Graz në Austri



17/11/2023. Në kuadër të projektit "Transformimi i Gjelbër IoT për shoqërinë akademike dhe ekosistemin e orientuar drejt biznesit" (IoT-ECO), po mbahet takimi i radhës në TU Graz, Austri, ku po marrin pjesë edhe studentët dhe profesorët nga UBT.

Projekti IoT-Eco synon të nxisë

integrimin e teknologjive të Internetit të Gjërave (IoT) në fushën e gjelbër. Ky projekt për ndërtimin e kapaciteteve është i fokusuar në mbështetjen e institucioneve të arsimit të lartë (IAL) në rajon për të rritur aftësitë dhe ekspertizën e tyre në efikasitetin e energjisë, përmirësimin e cilësisë së ajrit dhe apli-

kimet industriale të IoT. IoT-ECO ka përcaktuar disa objektiva, duke përfshirë krijimin e një qendre IoT-ECO brenda rrjetit të IAL-ve të Ballkanit Perëndimor për të promovuar projekte inovative. Për më tepër, nisma do të shohë zhvillimin e prototipeve virtuale që përfaqësojnë modelet e ekosistemit të transformimit të gjelbër për kampusin e UBT-së.

Takimi i cili po mbahet në Campus Inffeldgasse TU Graz, nga UBT, tre profesorë dhe katër studentë po marrin pjesë në takim, duke signalizuar një bashkëpunim të fortë midis akademisë dhe aplikacioneve praktike, me synimin për të drejtuar Ballkanin Perëndimor drejt një të ardhme më të qëndrueshme dhe më të avancuar teknologjike.

Përfaqësues të kampit Bondsteel zhvilluan ligjëratë tematike me studentët e Stomatologjisë



Përfaqësues të kampit Bondsteel zhvilluan një ligjëratë tematike rreth "TMJ and Oral Health" dhe "Dental Trauma in Pediatric Dentistry", për studentët e Stomatologjisë në UBT.

Në kuadër të lëndës: "Okkluzioni Funkcional dhe Stomatologjia e Fëmijëve", studentët patën rastin

të marrin njohuri të reja rreth shëndetit oral. Përmes prezantimeve të rasteve praktike dhe diskutimeve, studentët kanë pasur rastin të përdorin njohuritë e tyre të fituara në një kontekst real dhe të zhvillojnë aftësitë e tyre në përdorimin e teknikave të avancuara stomatologjike.

Një delegacion nga “University of Northern Iowa” dhe qyteti Cedar Falls, vizituan Parkun Shkencor Inovativ të UBT-së në Lipjan

Në Parkun Shkencor Inovativ të UBT-së në Lipjan ka qëndruar për vizitë një delegacion nga “University of Northern Iowa” dhe nga qyteti Cedar Falls nga shteti i Iowa-s, të cilët vizituan ekosistemin inovativ dhe me këtë rast zhvilluan një diskutim të hapur me studentë dhe profesorë të UBT-së.

Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi mirëpriti delegacionin nga Iowa, me çrast shprehu mirënjohje dhe nderim për mbështetjen dhe partneritetin korrekt që po vazhdon të rritet dhe të sjell benefite për të rinjtë nga të dy vendet.

“Së pari, ne shohim vlera dhe vizione të përbashkëta me Universitetin e Iowa-s Veriore, me këtë rast kemi ndërtuar një partneritet strategjik për të ngritur nivelin e zhvillimit dhe për krijuar mundësi të reja për të rinjtë e të dyja vendeve. Së dyti, ne kemi ndërtuar partneritetin me një universitet që vjen nga një shtet si Iowa që



ka ndihmuar dhe ka kontribuar shumë në zhvillimin politik, ekonomik dhe sigurisë në Kosovë. Prandaj, i falënderojmë për kontributin e vazhdueshëm për ta bërë një Kosovë më të sigurt dhe të qëndrueshme”, ka thënë rektori Hajrizi.

Presidenti i “University of Northern Iowa”, Dr. Mark A. Nook,

theksoi nevojën e krijimit të partneritetit në mes institucioneve arsimore dhe me këtë rast vlerësoi lartë bashkëpunimin e parë në Kosovë, me UBT-në, duke u ofruar edukim cilësor dhe mbështetje të rinjve nga të dy vendet.

“Është kënaqësi të jesh në Kosovë dhe veçanërisht të jesh në UBT. Ka qenë vërtetë partneriteti i parë

këtu në Kosovë me UBT-në për të punuar në fusha si: biznesi, planifikimi, inxhinieria dhe inteligjenca artificiale. Udhëtimin tonë këtu në Kosovë e nisëm duke vizituar Kompleksin Memorial të Familjes Jashari në Prekaz. Është shumë e rëndësishme të fillojmë nga atje, sepse është vendi ku fillon gjithçka për Kosovën. Është e rëndësishme për ne që të kemi partner në mbarë botën, dhe me këtë rast ndihemi të kënaqur që kemi partneritet edhe këtu në Kosovë, me UBT-në. Të mund të dërgojmë studentin tonë dhe të mund të presim studentët tuaj, duke i mbështetur ata në edukimin dhe arritjen e qëllimeve të tyre akademike e profesionale”, tha Dr. Mark A. Nook.

Në fjalën e tij, kryebashkiaku i Cedar Falls, Rob Green vlerësoi bashkëpunimin ndërmjet dy institucioneve dhe njëherit potencoi se ajo çfarë ka gjetur në kulturën e Kosovës dhe ka dëshirë të marrë në Iowa është ruajtja dhe dashuria

në familje. “Është nder të jem këtu me ju. Unë me profesion jam zhvilluesi i uebit, kjo ishte puna ime para se të bëhem kryetar bashkie. Por, unë do të doja t’ju them se në qeveritë tona ne kemi nevojë për të gjithë pavarësisht profesioneve. Sa e rëndësishme është të dihet se qeveria është për të gjithë. Ajo çfarë do të doja të merrja me vete kur të kthehem në Iowa, është lidhja që mbani në familjet tuaja. Sa është e rëndësishme të doni familjen. Atë e shohim në kulturën tuaj dhe kjo është një gjë shumë e mrekullueshme”, u shpreh kryebashkiaku i Cedar Falls, Rob Green.

Delegacioni nga “University of Northern Iowa”, ditëve në vijim pritet që të vizitohet edhe degët e tjera të UBT-së në Kosovë, për të parë nga afër zhvillimin e institucionit dhe mundësitë që po ofron UBT në qendra të ndryshme të Kosovës.

UBT modeli i suksesit në WURI 2023 - Rektori Hajrizi vuri në dukje ndërtimin e ekosistemit inovativ brenda universitetit



Si një nga modelet më të mira, më inovative dhe më të suksesshme UBT është prezantuar nga rektori Prof. Dr. Edmond Hajrizi, në konferencën e World’s Universities with Real Impact – WURI 2023.

Në këtë konferencë, rektori Hajrizi, prezantoi ndërtimin e një ekosistemi inovativ dhe konceptet e reja që përfshijnë inovacionin,

sipërmarrjen, përgjegjësinë dhe menaxhimin e krizave, duke u bazuar në vlerat sociale që ka institucioni.

Në konferencën e WURI 2023, rektori Hajrizi prezantoi UBT-në si një nga modelet më të mira, më inovative dhe më të suksesshme në fushën e arsimit dhe zhvillimit të shoqërisë në Kosovë dhe rajon.

Ai vuri në dukje ndërtimin e një ekosistemi inovativ brenda universitetit, i cili inkorporon koncepte të reja dhe vlera sociale.

Rektori Hajrizi shpali konceptin e inovacionit në kontekstin e UBT-së, duke treguar se si universiteti promovon kulturën e kreativitetit, hulumtimin të avancuar dhe zhvillimit të teknologjisë. Ai theksoi përpjekjet e UBT-së për të krijuar një mjedis të përkrahjes së ideve të reja dhe për të inkurajuar studentët dhe stafin akademik të shprehin potencialin e tyre inovativ.

Sipërmarrja, përgjegjësia sociale dhe menaxhimi i krizave ishin aspekte të tjera për të cilat rektori Hajrizi theksoi se, UBT si mision ka edhe ndikimin e tij në zhvillimin e shoqërisë dhe angazhohet në projekte sociale dhe ndërkombëtare që kanë impakt pozitiv në jetën e njerëzve dhe në zgjidhjen e sfidave të shoqërisë.

Përfaqësues të KFOR Regional Command East u bënë pjesë e Konferencës Ndërkombëtare të Shkencave Politike dhe Studimeve të Sigurisë në UBT



Në edicionin e sivjetshëm të Konferencës Ndërkombëtare të Shkencave Politike dhe Studimeve të Sigurisë në UBT, ishin prezent përfaqësues të KFOR Regional Command East, të cilët prezantuan rreth rrolit të partneriteteve ndërkombëtare në sigurinë globale. Ndër të tjera, ata folën edhe rreth rëndësisë që luan KFOR në ruajtjen e paqes dhe stabilitetit.

Në këtë konferencë gjithashtu morën pjesë edhe shumë pjesëmarrës vendorë e ndërkombëtarë, të cilët në mënyrë grupore e individuale prezantuan punime e hulumtime cilësore dhe profesionale.

UBT falënderon pjesëtarët e KFOR-it për angazhimin dhe mbështetjen e tyre të pazërvë për të ruajtur paqen dhe stabilitetin në Kosovë dhe rajon.

Profesorë të UBT-së zhvilluan një vizitë në “The Masaryk Institute of Advanced Studies” në Pragë

Profesorët e UBT-së, Lulzim Beqiri, Bekim Çeko dhe Zejnulla Rexhepi, zhvilluan një vizitë në “The Masaryk Institute of Advanced Studies” në Pragë, në Republikën Çeke. Në kuadër të kësaj vizite u realizua konferenca “Zhvillimi rajonal në mes të teorisë dhe praktikës”, ku mori pjesë në mënyrë virtuale edhe koordinatoreja e Fakultetit Arkitekturë dhe Planifikim Hapësinor në



UBT, Zana Prelvukaj. Gjatë vizites është realizuar edhe takim me drejtoreshën e zyrës së Institutit Masarik për studime të avancuara. Në këtë takim është shtjelluar aplikimi në projektin V4 dhe mundësitë e bashkëpunimit në mes të UBT dhe MIAS.

Rekomandimet që janë nxjerrë nga ky takim janë: të analizohen mundësitë për bashkëpunim real,

jo vetëm në marrëveshje dhe të folohet me aktivitete të vogla; të analizohet mundësia e mobilitetit për studentë me programin Erasmus+; të bëhet ftesa për vizitë në UBT për disa përfaqësues të Fakulteteve nga “Anhalt University”; të ftohen mësimdhënës nga MIAS CTU për punëtori njëjavore në UBT (përmes Erasmus+) me studentë të UBT-së.

Studentët e UBT-së u certifikuan dhe përfunduan suksesshëm eventin “Let’s talk about the European Union”

Studentët e Fakultetit Shkencë Politike dhe të Psikologjisë në UBT, Anila Shala, Drenushë Krasniqi, Valon Ismaili, Dea Selimi, Elsa Llaloshi dhe Liburn Krrabaj, përfunduan suksesshëm eventin e përmuajshëm me Ambasadorin e Finlandës në Kosovë “Let’s talk about the European Union” (Të flasim për Bashkimin Evropian). Ata u certifikuan për angazhimin e tyre të vazhdueshëm, duke treguar përkushtim ndaj temave politike dhe evropiane, si dhe duke demonstruar aftësitë e tyre të komunikimit dhe debatit.

Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi dhe Ambasadori i Finlandës


në Kosovë, Matti Nissinen, shprehën gëzimin e tyre për arritjen dhe përfundimin e suksesshëm të eventit “Let’s talk about the European Union”. Pjesëmarrja e këtyre studentëve dhe përpjekjet e tyre janë vlerësuar thellësisht nga Rektori Hajrizi dhe Ambasadori Nissinen.

UBT mbetet një institucion lider në Kosovë për ofrimin e mundësive të reja të arsimit dhe zhvillimit të studentëve. Suksesi i studentëve të Shkencave Politike dhe të Psikologjisë në këtë event thekson kualitetin e lartë të arsimit dhe angazhimit të studentëve në UBT.

“Të flasim për Bashkimin Evropian” - studentët e UBT-së dhe Ambasadori i Finlandës në Kosovë, Matti Nissinen diskutojnë rreth zgjerimit të BE-së

Studentët e UBT-së dhe Ambasadori i Finlandës në Kosovë, Matti Nissinen zhvilluan takimin e radhës në Parkun Shkencor Inovativ të UBT-së në Lipjan, në vazhdim të aktivitetit “Let’s talk about the European Union” (Të flasim për Bashkimin Evropian).

Zgjerimi i Bashkimit Evropian, përfitimet e Kosovës në anëtarësimin e Bashkimit Evropian dhe liberalizimi i vizave, ishin disa nga temat të cilët studentët dhe Ambasadori Nissinen trajtuan përgjatë takimit në UBT. Studentet Dea Selimi dhe Elsa Llaloshi prezantuan perspektivat e tyre rreth këtyre temave përmes punimit të tyre: “Horizontet e zgjeruara: Zgjerimi i Bashkimit Evropian dhe nd-



ikimi i tij”, duke ofruar informacione dhe detaje të reja. Studentët Anila Shala dhe Liburn Krrabaj prezantuan punimin e tyre: “Integrimi i Kosovës në BE”, duke folur mbi rëndësinë e integritetit të Kosovës në Bashkimin

Evropian, përfitimet kulturore dhe trashëgiminë e historinë e Kosovës, teksa Valon Ismaili dhe Drenusha Krasniqi folën për procesin e zgjerimit të BE-së, si dhe rrugën e anëtarësimit të Kosovës në BE.

UBT suksesshëm përmbyll një nga organizimet më madhështore të ceremonisë së gradimit të studentëve

UBT suksesshëm ka mbyllur pjesën e dytë të ceremonisë së gradimit të studentëve, me një organizim madhështor, në "Klan Arena", ku Kosovës i dha gjeneratën e njëzetë të profesionistëve dhe ekspertëve të fushave të ndryshme të jetës.

Me emocione të veçanta, studentët e programeve: Arkitekturë dhe Planifikim Hapësinor, Inxhinieri e Ndërtimit (Ndërtimtari) dhe Infrastrukturë, Zhvillim dhe Urbanizëm, Inxhinieri e Energjisë dhe Menaxhment, Menaxhment i Mekatronikës, Art dhe Media Digjitale, Muzika Moderne, Prodhimi Digjital dhe Menaxhimi, Shkenca Politike, Politika Publike dhe Menaxhimi, Infermieri dhe Shkencat Mjekësore, Farmaci, Stomatologji dhe Juridik, i dhanë fund një rrugëtimi të suksesshëm akademik në dy nivele të ndryshme të studimit: bachelor dhe master, duke treguar përkushtimin e tyre të lartë për dijen, shkencën, teknologjinë e inovacionin.



Për gjithë këtë arritje të studentëve në institucionin që udhëheq, Presidenti i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, ka thënë se kjo ditë shënon në kalendar një rrugëtim të veçantë dhe special për studentët dhe karrierën e tyre profesionale.

"Është nder dhe privilegj që të qëndroj para jush, një gjeneratë e cila me përkushtim të madh ka arritur që sot të ketë një momentum

të veçantë. Këtë vit Kosovës i shtohet një gjeneratë me kompetenca dhe aftësi. Gjatë kësaj periudhe ka pasur edhe procese e individ që na kanë mbështetur për të realizuar këtë momentum, prandaj dëshirojmë që t'i falënderojmë të gjithë ata që kanë kontribuar në mënyrë direkte apo indirekte në suksesin tuaj. Diplomimi nuk është vetëm një moment reflektimi për të kaluarën, por edhe një

moment pritjeje për të ardhmen", ka thënë Presidenti i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi.

Dita e dytë e ceremonisë së gradimit të studentëve u përcoll me betimin e studentit, të cilin e udhëhoqën studentja Edi Alidema dhe Tringa Thaqi, si dhe me betimin e hipokratit, të cilin e udhëhoqi studentja Donika Berisha, duke u betuar të gjithë studentët njëzëri që me vetëdije dhe vullnet

të plotë do t'i shërbejnë dhe do të japin kontributin në shkencë, edukim, e në vend.

Për argëtimin e studentëve u përkujdesën me disa pika muzikore studentit e Fakultetit Muzika Moderne, Prodhimi Digjital dhe Menaxhimi, Agnesa Vishesella dhe Anjeza Gashi, përderisa dita e sotme kulmoi me momentin madhështor dhe të rëndësishëm për të gjithë studentët, atë të hedhjes së kapelave, si simbol i përfundimit të një periudhe plot përkushtim dhe sakrificë dedikuar dijes dhe avancimit akademik.

Ceremonia e gradimit të studentët këtë vit ishte e ndarë në dy ditë për shkak të numrit të madh të studentëve (dita e parë më 8 shtator dhe e dyta më 9 shtator 2023), duke përmbyllur kështu suksesshëm një nga organizimet më madhështore dhe më emocionuese të institucionit më të madh të arsimit të lartë në Kosovë, të UBT-së.

Studentët e zhvilluan vizitë studimore në kompaninë "Gjirafa"



18/01/2023. Studentët e vitit të tretë të Fakultetit Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi në UBT, në kuadër të lëndës "Ndërmarrësi dhe Menaxhim i Inovacionit", të shoqëruar nga profesoresha Emira Shehu, kanë zhvilluar një vizitë studimore në kompaninë "Gjirafa". Qëllimi i kësaj vizite studimore ishte që studentët përveç shtjellimit teorik të temës "Ndërmarrësi dhe Inovacioni", si dhe të

njoftohen me zhvillimet praktike që aktualisht aplikohen nga kompania "Gjirafa". Vizita është realizuar në objektin qendror në Magjistralen Prishtinë – Ferizaj, ku studentët janë mirëpritur nga stafi kompetent, të cilët kanë shpalosur historikun e zhvillimit të kompanisë, produktet dhe shërbimet inovative, ambientin e punës, përfitimet e stafit, si dhe zhvillimin e tyre profesional.

Studentët e vizituan Qendrën Logjistike "Viva Fresh Store"

11/01/2023. Studentët e vitit të tretë të Fakultetit Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi në UBT, në kuadër të lëndës "Ndërmarrësi dhe Menaxhim i Inovacionit", të shoqëruar nga profesoresha Ermira Shehu, kanë realizuar një vizitë studimore në Qendrën Logjistike "Viva Fresh Store".

Qëllimi i kësaj vizite studimore ishte që studentët përveç shtjellimit teorik të temës: "Menaxhimi i Inovacionit, Qeveria, Shkenca Inovacion dhe Politika e Ndërmarrësisë", të njoftohen edhe me zhvillimet praktike që aktualisht aplikohen nga ndërmarrja.

Vizita ka filluar në Qendrën Logjistike ku studentët janë udhëhequr nga përfaqësuesit e "Viva Fresh Store", Berat Shala dhe Çiljeta Fejzullahu, të cilët i njoftuan me të gjitha proceset që ndërmarrja ka zhvilluar me qëllim pranimit, përgatitjes dhe dërgesave në mënyrë



sa më të mirë të produkteve ushqimore dhe higjienike.

Takimi ka vazhduar në vizitë të Administratës, ku studentët u njoftuan me departamentet të cilat funksionojnë brenda kompanisë, për të vazhduar më pas një ligjëratë tematike me drejtorin e HoReCa dhe Online, Lorik Kusari, i cili i njoftoi studentët rreth projektit të implementuar idenë e projektit,

kohën e implementimit, sfidat dhe përparësitë.

Gjatë këtij diskutimi u fol edhe për aspektin e digjitalizimit të proceseve dhe benefiteve të përdorimit të sistemeve të integruara teknologjike, të cilat mundësojnë që të pranohet porosia dhe në kohë reale të mbikëqyret dërgesa.

Studentët e Fakultetit Shkenca të Ushqimit dhe Bioteknologji vizituan kompaninë "Me Agro" në Lipjan

06/01/2023. Studentët e Fakultetit Shkenca të Ushqimit dhe Bioteknologji në UBT, të shoqëruar nga profesoresha Arbnora Berisha, kanë realizuar një vizitë studimore në kompaninë "Me Agro" në Lipjan, e cila merret me prodhimin dhe ruajtjen e produkteve bimore, me fokus të veçantë prodhimin e mollës, dredhëzës dhe specave. Studentët patën mundësinë të shohin plantacionet e pemëve dhe perimeve që kultivohen në këtë kompani, depot frigoriferike, si dhe të shohin makinat sortuese të molave, për klasifikimin e tyre në bazë të madhësisë dhe cilësisë.

Kompania "Me Agro" është një nga prodhuesit më të mëdhenj të specave, ku shumicën e prodhimit të tyre ajo edhe e eksporton, njëra ndër shtetet kryesore është Suedia, ku bëhet eksportimi i sasisë më të madhe të prodhimit të specave. Studentët e UBT-së zhvilluan një vizitë në kompaninë "Euroлона" 06/01/2023. Studentët e Fakultetit Shkenca të Ushqimit dhe Bioteknologji në UBT, të shoqëruar nga profesori Mërgim Mestani, kanë zhvilluar një vizitë studimore në kompaninë për prodhimin dhe përpunimin e qumështit "Euroлона", në Fushë Kosovë.

Përgjatë kësaj vizite, studentët u mirëpritën nga pronari i kompanisë Milazim Berisha dhe teknologu Blertan Kalanderi, me ç'rast u njoftuan më gjerësisht për punën dhe angazhimin e punëtorëve në këtë kompani, si dhe për cilësinë dhe sigurinë e produkteve. Vizitat e tilla në kuadër të Fakultetit Shkenca të Ushqimit dhe Bioteknologji në UBT u ndihmojnë studentëve të përfitojnë dhe të përforcojnë njohuritë e tyre rreth fushës, duke u përgatitur për të qenë të gatshëm për tregun e punës.

UBT mori pjesë dhe mbështeti Turneun Memorial "Fadil Vokri"



UBT mori pjesë dhe mbështeti turneun më të madh të futbollit në Republikën e Kosovës, i cili i kush-

tohet ish-kryetarit të Federatës së Futbollit të Kosovës dhe ish-legjendës së futbollit kosovar, Fadil Vokri. Pjesëmarrja e UBT-së në këtë ngjarje tregon përkushtimin e institucionit ndaj zhvillimit të sportit. Përmes programit Shkenca të Sportit dhe të Lëvizjes, UBT po investon në trajnimin dhe zhvillimin e talenteve sportive, duke krijuar një mjedis ku studentët mund të zhvillojnë njohuri të thella dhe aftësi të specializuara në fushën e sportit.

Studentët zhvilluan një sërë vizitash në kompanitë ushqimore në Gjilan

12/01/2023. Studentët dhe profesorët e Fakultetit Shkenca të Ushqimit dhe Bioteknologji në UBT, kanë realizuar disa vizita studimore në kompanitë "Floil", "Jaffa Plus", "Fleksograf" dhe "RC Cola", në Gjilan, me ç'rast kanë parë nga afër proceset e prodhimit të ushqimeve.

Në kompanitë "Floil" dhe "Jaffa



Plus", studentët përcollën nga afër të gjithë procesin e prodhimit të lëngjeve dhe vajit që nga lënda e parë e deri te menaxhimi i mbetjeve, si dhe u informuan për risitë në prodhimin e vajit të kolzës dhe parapërgatitjen e daljes në treg të vajit për fërgesë.

Në kompaninë "RC Cola" studentët u priten nga udhëheqësi i

procesit të prodhimit të lëngjeve teknologu Enis Buca, ish-student i UBT-së i punësuar në këtë kompani, duke i informuar studentët edhe mbi pikat kritike të kontrollit dhe ato mikrobiologjike, teksa në kompaninë "Fleksograf", ata u informuan për rëndësinë e pakëtimin në ruajtjen e ushqimit.

Studentët e UBT-së zhvilluan vizitë studimore në kompaninë telekomunikuese IPKO

11/01/2023. Studentët e vitit të tretë në Fakultetin Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi në UBT, në kuadër të lëndës "Menaxhment Bashkëkohor", të udhëhequr nga profesoresha Ermira Shehu, kanë zhvilluar një vizitë studimore në kompaninë telekomunikuese IPKO.

Qëllimi i kësaj vizite studimore ishte që studentët përveç njohjes me menaxhimin bashkëkohor të marrëdhënieve ndërpersonale dhe procesit të komunikimit, të njoftohen edhe me zhvillimet

praktike që aktualisht aplikohen nga IPKO, kompani e cila është e njohur në vend për menaxhimin bashkëkohor të burimeve njerëzore.

Vizita është realizuar në objektin qendror në Prishtinë, ku studentët janë mirëpritur nga stafi i burimeve njerëzore, të cilët kanë shpalosur historikun e zhvillimit të IPKO-s, si dhe kanë prezantuar detaje të rëndësishme rreth qasjes dhe trajtimit të burimeve njerëzore në aspektin e përgjithshëm të korporatës.

Studentët e UBT-së zhvilluan një vizitë studimore te ura në afërsi të objektit Dukagjini në Prishtinë



24.01.2023. Studentët e vitit të tretë në Fakultetin Inxhinieri e Ndërtimit dhe Infrastruktura në UBT, në kuadër të lëndës "Urat", të udhëhequr nga profesorët Arsim Ra-

puca dhe Naser Morina, kanë realizuar një vizitë studimore pranë urës të rrethit për Fushë Kosovë, në afërsi të objektit Dukagjini në Prishtinë. Studentët u njoftuan për së afërmi

më shumë me elemente të urave, rreth ndërtimit të kësaj ure dhe elementet e saj, ku janë të përfshira, si: sistemi i mbështetjes, mbështetësit elastomer, gardhi mbrojtës, si dhe fugat e dilatimit pahit elastike.

Ndër të tjera, u sqarua edhe mënyra sesi do të vazhdohet kjo urë duke ndërlidhur pjesën e rrethit qendror në Prishtinë me lagjen e Arbërisë (ish Dragodani).

Studentët e Inxhinierisë së Ndërtimit dhe Infrastruktura në UBT përveç pjesës studimore vazhdojnë të jenë prezent në projektet e rëndësishme të Kosovës, ashtu siç kanë qenë prezent gjatë ndërtimit të autostradës për Shkup dhe për Shqipëri.

Studentët e Fakultetit Muzikë Moderne, Prodhimi Digjital dhe Menaxhimi zhvilluan një performancë në skenë



Në Parkun Shkencor Inovativ të UBT-së në Lipjan, studentët e Fakultetit Muzikë Moderne, Prodhimi Digjital dhe Menaxhimi në UBT, të udhëhequr nga

profesoresha Fatlume Bunjaku, kanë zhvilluar një performancë në skenë, me pjesë nga muzikali "Mamma Mia".

Kjo shfaqje ishte pjesë e provimit

në lëndën "Performancë në skenë", të udhëhequr nga profesoresha Fatlume Bunjaku, ku studentët e vokalit në Fakultetin Muzikë Moderne, Prodhimi Digjital dhe Menaxhimi në UBT, patën rastin të tregojnë talentin e tyre përpara një komisioni vlerësues.

Kostumografia për këtë shfaqje është realizuar nga studentët e vitit të tretë të Fakultetit Dizajn i Integruar në UBT, në bashkëpunim me profesoreshat: Ariana Gjoni dhe Laura Ymeri, teksa profesori Artan Hasani ishte bashkëpunëtor me piano.

Studentët e programit Shëndeti Publik dhe Menaxhimi në UBT zhvilluan një vizitë studimore në Prizren

23/01/2023. Studentët e nivelit master në programin Shëndeti Publik dhe Menaxhimi në UBT, në kuadër të lëndës "Epidemiologjia", të shoqëruar nga dekani Fitim Alidema, zëvendësdekani Shqipe Agushi dhe profesori Hajrullah Fejza, ishin në vizitë studimore në Qendrën Rajonale të Shëndetit Publik në Prizren.

Përgjatë kësaj vizite, studentët u mirëpritën nga drejtori Fadil

Kryeziu, i cili i njoftoi ata me punët dhe aktivitetin e kësaj qendre.

Fokusi kryesor i kësaj vizite ishte roli i shëndetësisë publike dhe menaxhimi në këtë fushë, duke u ndihmuar studentëve të njohin procese të ndryshme të cilat ndërlidhen me fushën, si dhe të zhvillojnë njohuritë e tyre rreth profesionit.

165 studentë të UBT-së përfunduan euro-tripin e sivjetshëm

Fakultetet: Arkitekturë dhe Planifikim Hapësinor, Dizajn i Integruar dhe Inxhinieri e Ndërtimit (Ndërtimtari) dhe Infrastruktura në UBT, organizuan një vizitë studimore në vende të ndryshme evropiane. Nga Kroacia në Slloveni, Itali, Zvicër, Francë, Holandë, Gjermani dhe Austri, studentët dhe stafi i fakultetit kanë zhvilluar një rrugëtim të pasur me eksperiencë të shumta.

165 studentë të udhëhequr nga profesorët: Dr. Muhamet Ahmeti, Dr. Ajhan Bajmaku dhe MSc. Bard Bajčinovci, filluan udhëtimin me vizitën e parë në Slloveni, në qytetin Lubjana. Atje, studentët kanë vizituar Muzeun e Arteve dhe janë pritur nga drejtoresha e muzeut, e cila i ka udhëzuar ata në fazat e ndërtimit të muzeut dhe ekspoziti-



tat e tij të veçanta. Gjatë vizitës, studentët janë njohur me modele artistike, vegla pune historike dhe zhvillimin e koncepteve të artit ndërkombëtar.

Vazhdimi i rrugëtimin i ka sjellë studentët në qytetin e ujit, në Venecia, ku kanë pasur mundësinë

të studiojnë arkitekturën gotike në ndërtesat dhe monumentet e tij të njohura si Bazilika e San Markut dhe Ura Rialto. Në këtë qytet magjik, ata kanë parë gjurmët e historisë dhe arkitekturës së vjetër.

Në Itali, rrugëtimi ka vazhduar drejt Milanos, ku studentët kanë

vizituar Duomo di Milano, Galleria Vittorio Emanuele II dhe shumë objekte të tjera arkitektonike. Pastaj, ata kanë shkuar në Paris, ku kanë eksploruar muzeun e arkitekturës, Kullën e Eiffel-it, Muzeun Louvre, Katedralen Notre-Dame, Arc de Triomphe dhe shumë objekte të tjera të rëndësishme.

Roterdami dhe Amsterdami iu është dedikuar një faze tjetër të rrugëtimin të tyre, ku studentët kanë vizituar objekte arkitektonike moderne si Cube Houses dhe Market Hall në Rotterdam dhe muzeume të njohura në Amsterdam si EYE Filmmuseum dhe Rijksmuseum. Në vizitat e tyre në Berlin dhe Dessau në Gjermani, studentët kanë njohur historinë e murit të Berlinit, muzetë e Bauhaus dhe shumë objekte të tjera të cilat kanë

shënuar periudhën e ndryshme arkitektonike dhe historike.

Vizita ka përfunduar në Pragë, ku studentët kanë vizituar Fakultetin e Arkitekturës, kryeqytetin e vjetër, dhe objekte të njohura si Kulla e Pragës dhe Katedralja Vitus. Pastaj, ata kanë vazhduar drejt Vjenës, duke vizituar objekte të rëndësishme arkitektonike dhe institucione si Universiteti i Ekonomisë dhe Biznesit, MAK - Muzeu i Arteve të Aplikuara, dhe Pallati Belvedere.

Vizita studimore ka përfunduar me sukses, duke i dhënë studentëve një eksperiencë të pasur arkitektonike dhe kulturore në disa nga qytetet më të njohura të Evropës. UBT vazhdon të kontribuojë në zhvillimin profesional të studentëve të saj përmes organizimit të këtyre vizitave stimuluese dhe edukative.

Studentët e UBT-së zhvilluan një takim me Ambasadorën e Kroacisë në Kosovë, Danijela Barišić



09/02/2023. Në kuadër të eventit "Meeting diplomats", studentët e UBT-së u takuan me Ambasadorën e Kroacisë në Kosovë, Danijela Barišić, ku së bashku diskutuan tema të ndryshme, duke filluar nga edukimi, arsimimi, kultura, politika e deri tek marrëdhënia mes Kroacisë dhe Kosovës.

Ambasadorja Barišić potencoi se edukimi është çelësi i suksesit për çdo shtet dhe se Kosova ka kom-

pani shumë të suksesshme të teknologjisë, me ç'rast u jep mundësi të rinjve të zhvillojnë talentin e tyre.

Ajo i njoftoi studentët rreth kulturës kroate, sistemit arsimor në Kroaci, si dhe politikës, duke përfshirë edhe eksperiencën e saj si ambasadore në Kosovë.

Ajo porositi studentët të mësojnë fort dhe të udhëtojnë për t'u njohur me kultura të ndryshme.

Në UBT u zhvillua punëtorja mbi Mësimin e Thellë (Deep Learning)

13/02/2023. Në UBT, Fakulteti Juridik në bashkëpunim me Fakultetin e Psikologjisë dhe Kolegjin ESLG kanë organizuar një punëtori mbi Mësimin e Thellë (Deep Learning).

Në këtë trajnim, profesori i Fakultetit Juridik në UBT dhe i Kolegjit ESLG, Visar Hoxha trajtoi para të pranishmëve konceptet e mësimin të thellë, duke shtjelluar në detaje metodat e të mësuarit të cilat mund të jenë: i mbikëqyrur, gjysmë i mbikëqyrur ose i pambikëqyrur.

Në kuadër të këtij trajnimi, profesoresha e Fakultetit të Psikologjisë, Deniz Celcima, trajtoi temën: "Si të



nxitit motivimi i brendshëm dhe ai i jashtëm i studentëve (Intrinsic and Extrinsic Motivation)", duke u shpjeguar të pranishmëve nevojën dhe rëndësinë e motivimit të studentëve për të mësuar.

Profesoresha e Fakultetit të Psi-

kologjisë, njëherit psikologe klinike, Vjollca Shahini, ka diskutuar rreth nxitjes së koncentrimin të studentëve (Attention regulation), si dhe rreth ngarkesave kongnitive (Cognitive Load) për një mjedis nxitës të mësimin të thellë.

Zhvillohet ligjëratë e përbashkët e studentëve të UBT-së dhe University of Northern Iowa (UNI) në ShBA

24/03/2023. Në kuadër të bashkëpunimit në mes UBT-së me University of Northern Iowa (UNI) nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, studentët e Fakultetit Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi në UBT, filluan mbajtjen e ligjëratave

të përbashkëta me studentët e UNI. Këto ligjëratë të përbashkëta do të zgjasin tetë javë në kuadër të lëndës "Digital Marketing Fundamentals and Google Ads", të udhëhequra nga profesoresha e UBT-së, Nora Sadiku - Dushi dhe profesori Mat-

thew Wilson nga UNI. Gjatë këtyre ligjëratave studentët do të kenë mundësi të shkëmbejnë njohuri dhe përvoja të ndryshme nga fusha e Marketingut Digjital, si dhe në fund do të kenë mundësi të certifikohen nga Google Ads.

Në UBT përmes një diskutimi të hapur shënohet Dita Botërore e Ujit



22/03/2023. Në Parkun Shkencor Inovativ të UBT-së, në Lipjan, në Ditën Botërore të Ujit, nën organizimin e Fakultetit Inxhinieri e Ndërtimit dhe Infrastruktura në UBT u zhvillua një diskutim i hapur me temën: “Përsheptimi i ndryshimeve për të zgjidhur krizën e ujit dhe kanalizimit”. Mekëtë rast dekani, njëherit Drejtori për Çështje Akademike, Prof. Dr. Muhamet Ahmeti, shprehu mirëseardhje për të gjithë pjesëmarrësit, ndërsa për pjesëmarrësit në këtë

ngjarje profesorët e Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit; Hazir Çadraku, Ilir Avdullahu dhe Ibush Luzha nga Fakulteti i Inxhinierisë së Mjedisit dhe Teknologjisë Ushqimore, prezantuan dhe folën rreth temave: “Gjendja e ujërave në Kosovë”, “Monitorimi i Burimeve të Ujit”, “Furnizimi me ujë në regjionin e Prishtinës”, si dhe “Roli, rëndësia dhe kuadri ligjor për ruajtjen dhe mbrojtjen e ujërave”. Në vijim të shënimit të Ditës Botërore të Ujit pjesëmarrësit;

gjimnazistë, studentë dhe profesorë patën rastin të japin mendimet, komentet, sugjerimet dhe të bënin pyetje në lidhje me prezantimet dhe në përgjithësi me ujërat në Republikën e Kosovës.

Të gjithë pjesëmarrësit u pajtuan se duhet të bëhet më shumë në të gjitha nivelet me qëllim që burimet ujore të ruhen, mbrohen dhe të shfrytëzohen sa më racionalisht në mënyrë që të kemi një mirëqenie më të sigurtë për veten tonë dhe brezat e ardhshëm.

Në përmbyllje profesori Hazir Çadraku, shprehu falënderimin dhe respektin për të gjithë pjesëmarrësit duke theksuar pjesëmarrja aktive në këto ditë të ngjashme si kjo japin një kontribut të madh në përcjelljen e mesazheve për rëndësinë dhe nevojën që kanë burimet ujore për tu ruajtur, mbrojtur dhe kujdesuar për to përmes një modeli të menaxhimit të integruar të tyre.

Studentët e vitit të pestë të Fakultetit të Stomatologjisë vizituan Institutin e Mjekësisë Ligjore



31/03/2023. Studentët e Fakultetit të Stomatologjisë në UBT, kanë realizuar një vizitë studimore në Institutin e Mjekësisë Ligjore në Ministrinë e Drejtësisë, të shoqëruar nga profesori Arsim Gërxhalii. Në kuadër të kësaj vizite, studentët patën mundësi që të njoftohen nga afër me punën dhe angazhimin e stafit dhe profesionistëve që vijnë nga ky institucion, në laboratorin e toksikologjisë, histopatologjisë, si dhe në pjesën e nxjerrjes dhe publi-

kimit të rezultateve përfundimtare të rasteve që iu nënshtrohen autopsisë forenzike.

Studentët e vitit të pestë të këtij programi në UBT, panë nga afër edhe disa shembuj të ekzaminimit të mbetjeve mortore të rasteve të ndryshme të luftës në Kosovë, si dhe rasteve të tjera, duke thelluar kështu njohuritë e tyre që do t'iu shërbejnë në zhvillimin e profesionit.

Në UBT u organizua një diskutim i hapur me kuratorët dhe artistët: Hana Halilaj, Shkëlqim Qestaj dhe Diellza Azemi

15/03/2023. Në Parkun Shkencor Inovativ të UBT-së, në Lipjan, Fakulteti Art dhe Media Digjitale organizoi një ligjëratë tematike me të ftuar kuratoren e Galerisë Kombëtare, Hana Halilaj, kuratorin e ekspozitës së fundit: “Një vend pa mure”, Shkëlqim Qestaj, si dhe njëra nga artistet pjesëmarrëse, Diellza Azemi.

Studentët, profesorët dhe pjesëmarrësit e tjerë, patën rastin që në kuadër të lëndës: “Praktika në studio – Projekt individual dhe Instalacion”, të udhëhequr nga profesori Burim Berisha, të njihen dhe të mësojnë nga përvojat e ndryshme

në fushën e artit nga Hana Halilaj, Shkëlqim Qestaj dhe Diellza Azemi. Në kuadër të kësaj ngjarje, të ftuarit folën rreth përvojave të tyre, projektet dhe punët të cilat i kanë realizuar dhe janë në procedurë realizimi, si dhe rreth mundësive që ofrohen për të vepruar në Kosovë për studentët e artit dhe medias digjitale.

Hana Halilaj është kuratore dhe studiuese. Ajo ka kuruar ekspozita duke përfshirë “Space for Memories Unmade” (2022) në Galeria Qafa, “Clubbing Insistence: After a Party” (2022) në Doza Gallery dhe “Toplocentrala, Informator” (2022) në Muzeun e Artit Hessel. Ajo ak-



tualisht është kuratore e Galerisë Kombëtare të Kosovës dhe Asistent Kurator në “CuratorLab” në Universitetin e Arteve “Konstfack” në

Stokholm. Shkëlqim Qestaj studion për artin pamor në “L'École cantonale d'art de Lausanne” (ECAL) në Lozanë të Zvicrës. Praktika e

tij artistike artikulohe me skulpturës, fotos, videos dhe tekstit. Puna e tij është e lidhur thellësisht me letërsinë dhe çështjet e identitetit. Ai punon dhe jeton në mes të Zvicrës dhe Kosovës.

Vepra e Djellza Azemi në ekspozitën e fundit të Shkëlqim Qestajt “Një vend pa mure”, eksploron dimensionin poetik të shtëpisë dhe strehës përmes prizmit të identitetit. Me skulpturën dhe objektet e gjetura, ajo ndërton marrëdhënie dhe rrëfime rreth nocioneve të transmetimit, traditës dhe shkeljes. Djellza Azemi jeton dhe punon në Lozanë të Zvicrës.

Në UBT u shënuar Dita Botërore e Shëndetit Oral



20/03/2023. Sikurse në mbarë botën, nën moton: “Be Proud of your Mouth”, në Parkun Shkencor Inovativ të UBT-së, në Lipjan është shënuar Dita Botërore e Shëndetit Oral, në kuadër të Klinikës Specialistike Stomatologjike.

Nxënësit e klasës së dytë të Shkollës Fillore të Mesme të Ulët “Ismail Qemali” në Prishtinë, vizituan ambientet e Poliklinikës së UBT-së, nga ku u njoftuan me infrastrukturën moderne të klinikës, si dhe panë nga afër punën që bëhet në këtë ambient. Profesionalistët e stomatologjisë që

janë pjesë e kësaj klinike dhe UBT-së, nxënëseve u bënë një ekzaminim rreth shëndetit oral, si dhe u dhanë këshilla të shumta rreth mirëmbajtjes së higjienës orale, ngrënies së ushqimit të shëndetshëm, dhe rreth nevojës së vizitave të rregullta stomatologjike.

Nxënësit u ndanë të kënaqur dhe tejet të lumtur me atë që panë në Parkun Shkencor Inovativ të UBT-së, në Lipjan dhe në Poliklinikën e UBT-së, gjegjësisht në katedrën e Pedodontisë dhe Stomatologjisë Preventive.

Studentët e UBT-së u takuan me Ambasadorin e Zvicrës në Kosovë, Thomas Kolly



14/03/2023. Në kuadër të eventit “Meeting Diplomats”, studentët e UBT-së, patën rastin të takonin Ambasadorin e Zvicrës në Kosovë, Thomas Kolly, me të cilin diskutuan për tema të ndryshme që ndërlidhin kulturën, sistemin e arsimit dhe politikat publike në Zvicër dhe Kosovë.

Ambasadori Kolly duke vlerësuar organizimin e takimeve të til-

la, theksoi se të rinjtë në këto dy vende duhet të punojnë shumë, të fokusohen në punë dhe angazhimet e tyre, si dhe të jenë më fleksibil. “Ju duhet të punoni më shumë, të fokusoheni në punët dhe angazhimet tuaja, si dhe të jeni më fleksibil”, u shpreh Ambasadori Kolly.

Studentët u shprehën entuziast dhe aktiv, duke parashtruar py-

etje nga më të ndryshmet, teksa ambasadori foli edhe për përvojën e tij si diplomat, por edhe rreth sistemit arsimor në Zvicër dhe atë çfarë ka parë në Kosovë. “Sistemi i edukimit në Zvicër është mjaft i ndryshëm nga ai në Kosovë dhe vendet e rajonit të Ballkanit. Në Kosovë kam parë shumë shkolla që praktikojnë sistemin – profesori flet, nxënësi shkruan dhe dëgjon, teksa në Zvicër ky sistem i edukimit ka qenë në kohën kur unë kam qenë ndoshta nxënësi, teksa sot është i ndryshëm, meqenëse nxënësit dhe studentët janë më sfidues me pyetje karshi profesorëve”, tha ai. Ndër të tjera, në këtë takim me ambasadorin, studentët patën rastin të njihen edhe me gjërat që përfaqësojnë kulturën zvicerane, me literaturën dhe filmat, si dhe me kapacitetet e Zvicrës për zhvillimin e teknologjisë.

Studentët e programit Shëndeti Publik dhe Menaxhimi në UBT zhvilluan një vizitë studimore në Spitalin “Hygea” në Tiranë

13/03/2023. Studentët e nivelit master në programin Shëndeti Publik dhe Menaxhimi në UBT, të prirë nga profesori Naser Rugova, kanë zhvilluar një vizitë studimore në Spitalin “Hygea” në Tiranë.

Përgjatë kësaj vizite, studentët u mirëpritën nga Drejtori Ekzekutiv i Spitalit “Hygea”, njëherit ish-ministri i Shëndetësisë së Re-



publikës së Shqipërisë, Leonard Solis, ku u njoftuan me aspektet e funksionimit, organizimit dhe nivelin e ofrimit të shërbimeve shëndetësore të këtij spitali.

Ndër të tjera, studentët patën rastin të shohin nga afër punën dhe angazhimin e stafit në këtë spital, si dhe mjetet teknologjike me të cilat punohet, duke u njoftuar gjerësisht për trajtimin e pa-

cientëve. Shkëlqim Qestaj “Një vend pa mure”, eksploron dimensionin poetik të shtëpisë dhe strehës përmes prizmit të identitetit. Me skulpturën dhe objektet e gjetura, ajo ndërton marrëdhënie dhe rrëfime rreth nocioneve të transmetimit, traditës dhe shkeljes. Djellza Azemi jeton dhe punon në Lozanë të Zvicrës.

Shtëpia e të Moshuarve “Jetimat e Ballkanit” - destinacioni i studentëve të UBT-së në Ditën Ndërkombëtare të Gruas



08/03/2023. Në Ditën Ndërkombëtare të Gruas, studentët e Fakultetit Psikologji në UBT të

shoqëruar nga Fisnete Hajrizi, dekania e Fakultetit, Denis Celcma, si dhe profesoret: Vjollca Pllana, Diana Sejdiu – Shala dhe Anita Sadikaj, kanë realizuar një vizitë në një vend të veçantë – në Shtëpinë e të Moshuarve “Jetimat e Ballkanit”, në Suharekë.

Përgjatë kësaj vizite, studentët u mirëpritën nga Halil Kastrati, dhe banorët e Shtëpisë së të Moshuarve “Jetimat e Ballkanit”.

Kjo vizitë e studentëve u bë me qëllim për të festuar dhe nderuar

fuqinë dhe rëndësinë e gruas në shoqëri, duke u përkushtuar që përmes disa dhuratave simbolike të tregojnë ngrohtësinë njerëzore me njerëzit që meritojnë respektin dhe përkrahjen e gjithsecilit.

Vizita e studentëve në Shtëpinë e të Moshuarve “Jetimat e Ballkanit” ishte frymëzuese, meqenëse panë dhe dëgjuan histori të rralla dhe emocionuese nga njerëzit që janë në shtëpi, të cilët kanë përjetuar të gjitha sfidat e jetës dhe kanë kaluar kohëra të vështira.

Studentët e Arkitekturës dhe Planifikimit Hapësinor në UBT kanë realizuar një vizitë studimore në punishte

Studentët e vitit të tretë të Fakultetit Arkitekturë dhe Planifikim Hapësinor në UBT, në kuadër të lëndës “Puna Praktike”, kanë realizuar vizitë studimore në punishte, për të parë nga afër organizimin dhe mbarëvajtjen e punëve të ndërtimit. Qëllimi i kësaj vizite ishte që studentët të njoftohen dhe të informohen më gjerësisht rreth organizimit dhe mbarëvajtjes së

punëve të ndërtimit, duke përforcuar njohuritë e fituara përgjatë lëndëve teorike.

Vizitat e tilla në kuadër të lëndëve praktike në Fakultetin Arkitekturë dhe Planifikim Hapësinor në UBT, shërbejnë që studentët të përforcojnë njohuritë e tyre rreth profesionit, si dhe për të qenë më të përgatitur në të ardhmen.

Studentët e Ndërtimtarisë dhe Infrastrukturës në UBT vizituan Ndërmarrjen Publike Lokale “Prishtina Parking”

Studentët e nivelit master në Fakultetin Ndërtimtarisë dhe Infrastrukturë në UBT, në kuadër të lëndës: “Komunikacioni Urban”, të udhëhequr nga profesori, Beni Kizolli, zhvilluan një vizitë studimore në Ndërmarrjen Publike Lokale “Prishtina Parking”.

Studentët u mirëpritën nga kryeshefi ekzekutiv i Ndërmarrjes Publike Lokale “Prishtina Parking”, Sokol Havolli, i cili prezantoi vizionin dhe misionin e ndërmarrjes, si dhe në kuadër të bashkëbisedimit u diskutua edhe përvoja, potenciali dhe prioritetet e ndërmarrjes.

Vizita studimore u vlerësua si



një mundësi e rëndësishme për studentët për të njohur më mirë praktikën e një ndërmarrjeje publike lokale dhe për të kuptuar se si komunikacioni urban ndikon në zhvillimin dhe menaxhimin e infrastrukturës. Kjo përvojë e arritur do të ndihmojë studentët në zhvillimin e aftësive të tyre në fushën e ndërtimit dhe planifikimit urban.

Studentët e Shkencave të Ushqimit dhe Bioteknologjisë në UBT realizuan një vizitë studimore në KRU “ Hidroregjioni Jugor” Sh.A, në Prizren

Studentët e vitit të dytë të Fakultetit Shkenca të Ushqimit dhe Bioteknologjisë në UBT, dega në Prizren, në kuadër të lëndës: “Mbrojta e ambientit jetësor nga industritë ushqimore”, të shoqëruar nga profesori Sami Gashi, realizuan një vizitë studimore në Impiantin e trajtimit të ujërave të ndotura KRU “ Hidroregjioni Jugor” Sh.A, në Prizren.

Menaxhmenti i këtij institucioni i njoftoi studentët rreth infrastrukturës dhe investimeve të bëra në Impiantin e trajtimit të ujërave të ndotura në Prizren, për kapacitetet e mundshme të trajtimit të ujërave të ndotura, si dhe për problemet e mundshme gjatë punës.

Studentët nga kjo vizitë përfituan



njohje themelore mbi proceset e trajtimit: fizik, kimik, biologjik të ujërave të ndotura, panë se si bëhet monstimi në hyrje të Impiantit dhe mbase që ujërat të jenë trajtuar pra në dalje të Impiantit në momentin e derdhjes në lumë. Studentët panë nga afër edhe lab-

oratorin modern, teksa u njoftuan nga udhëheqja e laboratorit mbi parametrat që analizoheshin në ujërat sipërfaqësore të ndotura siç janë: shpenzimi biokimik i oksigjenit (ShBO₅), shpenzimi kimik i oksigjenit (ShKO), materiet e tretura suspensive (MTS).

Studentët e UBT-së realizuan një vizitë studimore në kompaninë “InstaBuilt”

Studentët e vitit të tretë të Fakultetit Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi në UBT, në kuadër të lëndës “Projekt i Ndërmarrjes”, të udhëhequr nga profesori Enver Krasniqi, kanë realizuar një vizitë studimore në Kompaninë “InstaBuilt” në Milloshevi (Balshaj).

Gjatë kësaj vizite studentët janë mirëpritur nga stafi i “InstaBuilt”, një mikpritje e ngrohtë e shoqëruar me prezantimin informues mbi kompaninë, duke gërshetu-



ar historikun e saj, veprimtarinë, vizionin, dhe më e rëndësishmja

vizitën nga afër të Qendrës Inovative dhe të ndërtimeve modulare,

më konkretisht shtëpive modulare. Pas prezantimit informues, studentët patën rastin të jenë pjesë e tryezës së diskutimit me stafin e “InstaBuilt”, ku u zhvillua teknika ‘Q & A (Question & Answer)’, me ç’rast studentët ishin të lirë të inkuadrohen me pyetje relevante rreth kompanisë “InstaBuilt”, më konkretisht rreth shtëpive modulare me fokus aspektin biznesor, të shprehnin njohuritë e tyre, si dhe të ndanin eksperiencën e tyre

nga mbajtja e ligjëratave tematike e studimore të realizuara nga lënda “Projekt Ndërmarrjes” dhe ligjëratave të përbashkëta me Universitetin Iowa-USA.

Realizimi i kësaj vizite studimore aludon në rëndësinë e avancimit të njohurive të studentëve dhe në ndihmën e kuptimit të mirëfilltë të mënyrës së funksionuarit të planifikimit të procesit biznesor përmes një plani të biznesit.

Studentët e Ndërtimtarisë dhe Infrastrukturës në UBT zhvilluan vizitë studimore në fabrikat “Sharrcem” dhe “Silcapor”

Studentët e vitit të dytë dhe të tretë të Fakultetit Ndërtimtarisë dhe Infrastrukturë në UBT, nën udhëheqjen e profesorëve: Ibush Luzha, Visar Krelani dhe Driton Kryeziu, zhvilluan një vizitë studimore në fabrikat “Sharrcem” dhe “Silcapor”.

Studentët vizituan ambientet e fabrikave, duke parë nga afër

pjesën e infrastrukturës dhe pajisjeve teknike me të cilat punohet në këto fabrika, si dhe laboratorët e shumtë të cilët përdoren për sektorin e prodhimit.

Qëllimi i kësaj vizite ishte që studentët të përfitojnë njohuri të reja rreth fushës, si dhe të përforcojnë ato që kanë zhvilluar përgjatë ligjëratave.

Studentët e UBT-së zhvilluan aktivitete sportive me ekspertin ndërkombëtare Aleksandra Gülçiçek



Në kuadër të lëndës “Sportet Individuale”, studentët e Fakultetit Shkenca të Sportit dhe të Lëvizjes në UBT zhvilluan aktivitete me

eksperten e vallëzimit, plates dhe vallëzimit aerobik, Aleksandra Gülçiçek, e kualifikuar nga institute ndërkombëtare.

Ekspertja Aleksandra Gülçiçek zhvilloi edhe një ligjëratë tematike dhe praktike në lidhje me aktivitetet fizike të gratë shtatzëna në kuadër të lëndës “Aktiviteti Fizik në Shëndet dhe Çrregullime”. Gjatë qëndrimit të saj në Kosovë ajo organizoi edhe aktivitete jashtë kurrikulare me studentët e Muzikës Moderne, Prodhimit Digital dhe Menaxhimit dhe të Artit dhe Medias Digjitale në UBT.

Nxënësit dhe studentët e UBT-së u certifikuan dhe fituan mbështetje financiare për implementimin e projekteve të propozuara në konferencën ballkanike “Pristina Forum 2023”



Studentët e vitit të dytë dhe të tretë të Fakultetit Ndërtimtarisë dhe Infrastrukturë në UBT, nën udhëheqjen

e profesorëve: Ibush Luzha, Visar Krelani dhe Driton Kryeziu, zhvilluan një vizitë studimore në fabri-

kat “Sharrcem” dhe “Silcapor”. Studentët vizituan ambientet e fabrikave, duke parë nga afër pjesën e infrastrukturës dhe pajisjeve teknike me të cilat punohet në këto fabrika, si dhe laboratorët e shumtë të cilët përdoren për sektorin e prodhimit.

Qëllimi i kësaj vizite ishte që studentët të përfitojnë njohuri të reja rreth fushës, si dhe të përforcojnë ato që kanë zhvilluar përgjatë ligjëratave.

Studentët e UBT-së zënë vendin e parë në Garën Ndërkombëtare të Sigurisë Kibernetike



Studentët e UBT-së: Abian Morina, Ardit Byqmeti, Blend Braha, Dion Mulaj, Dionis Shabani, Edmond Ahmeti, si dhe Yll Berisha, të udhëhequr nga profesori i lëndëve të

Sigurisë Kibernetike, Dr. Blerton Abazi, zënë vendin e parë në Garën Ndërkombëtare të Sigurisë Kibernetike ku morën pjesë universitetet nga Kosova dhe ekipet e ndryshme nga “Iowa State University”.

Përgjatë gjithë garës që zgjati më shumë se 8 orë ekipi i UBT-së ishte në avantazh duke treguar shkathësi të lojës ekipore dhe angazhim maksimal për të arritur rezultatin e vendit të parë.

Kjo garë organizohet nga “Iowa State University” në bashkëpunim me universitetet në Kosovë.

Studentët e Inxhinierisë së Ndërtimit dhe Infrastrukturës në UBT zhvilluan një vizitë studimore në kompaninë e ndërtimit “Mendi Sh.P.K”



Studentët e Fakultetit Inxhinieri e Ndërtimit dhe Infrastrukturë në UBT, në kuadër të lëndës “Gjeomekanika”, të shoqëruar nga profesori Hysen Ahmeti, kanë zhvilluar një

vizitë studimore në kompaninë e ndërtimit “Mendi Sh.P.K” në Fushë Kosovë.

Në kuadër të kësaj vizite, studentët zhvilluan punë në terren në dy ob-

jekte ndërtimi: në objektin e parë të studimit panë për së afërmi thellësinë e fondimit të themelit, i cili është realizuar nga parametrat gjeomekanike, ndërsa në objektin e dytë panë drejtpërdrejt hapjen e themelit dhe përforcimin e aftësisë mbajtëse të tyre për ndërtimin e kompleksit banesor.

Qëllimi dhe rëndësia e kësaj vizite ishte njohja me realizimin e shpimeve gjeologjike – gjeomekanike për nxjerrjen e parametereve fiziko – mekanike, aplikimi i tyre në terren për llogaritjen e aftësisë mbajtëse të themelit në bazë të eurocodeve gjeoteknike të projektimit.

Studentët e UBT-së realizuan një vizitë studimore në Fabrikën “Ahikos Furniture”



Studentët e Fakultetit Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi në UBT, të shoqëruar nga profesori Rajan Arapi kanë realizuar një vizitë studimore në Fabrikën “Ahikos Furniture”.

Gjatë vizitës, studentët kanë pasur mundësinë të shohin procesin e prodhimit të mobilie dhe kanë

mësuar më shumë rreth teknologjive dhe strategjive të biznesit që përdoren në industrinë e mobilie. Kjo vizitë studimore ka qenë e rëndësishme për të ndërtuar njohuritë e studentëve dhe për t'i ndihmuar ata të kuptojnë më mirë se si funksionon industria e mobilie në Kosovë.

Sfidat aktuale në mjekësi - tema që diskutuan përfaqësuesit e AMFE-s me studentët e UBT-së

Në Parkun Shkencor Inovativ të UBT-së në Lipjan u organizua një diskutim i hapur me përfaqësues të Federatës së Mjekëve Shqiptarë në Evropë (Albanian Medical Federation for Europe), rreth çështjeve që ndërlidhin fushën e mjekësisë.

Paneli i diskutimit ishte i përbërë nga: Kryetarja e AMFE-s, Dr. Aurora Dollenberg, mjeku gjinekolog njëherit nënkryetari i AMFE-s në Danimarkë, Dr. Negjyp Sopa, ek-



sperti i shëndetit publik dhe sekretari i përgjithshëm i AMFE-s për vendet shqipfolëse, Gjergji Pashaj, kryetarja e AMFE-s në Danimarkë, Bernarda Radonci dhe dekani i Shkencave Mjekësore në UBT, Dr. Fitim Alidema.

Diskusimi fillimisht u fokusua në sfidat aktuale të mjekësisë, si dhe në inovacionet dhe zhvillimet më të reja në këtë fushë, ku përfaqësuesit e Federatës së Mjekëve Shqiptarë në Evropë ndanë përvo-

jat e tyre si mjekë dhe prezantuan iniciativat dhe projektet e kësaj federate.

Diskusimi ishte i frytshëm dhe solli pikëpamje të ndryshme rreth problemeve specifike që përballon mjekësia sot, si përdorimi i teknologjisë në shërbimin shëndetësor, qasjet e reja në trajtimin e sëmundjeve, si dhe rritja e ndërgjegjësimit për rëndësinë e promovimit të shëndetit dhe parandalimit të sëmundjeve.

Studentët e Muzikës Moderne, Prodhimit Digjital dhe Menaxhimit në UBT organizuan një koncert

Studentët e Fakultetit Muzika Moderne, Prodhimi Digjital dhe Menaxhimi në UBT, nën udhëheqjen e profesoreshës Besa Llugiqi, organizuan një koncert në Parkun Shkencor Inovativ të UBT-së në Lipjan.

Studentët që performuan janë: Auron Deva me këngët: “Moon river” dhe “The show must go on”; Dea Berisha me këngët: “Part of your world” dhe “Still into you”; Elona Alshiqi këndoi këngën “Never enough” dhe në

bashkëpunim me Meriton Hetën kënduan “Think of me”; Meriton Heta me këngën: “Blinding lights”; Edisona Bujupi me këngët: “Caruso” dhe “Dashurinë ku e kam”; Vjollcë Osmani me këngët: “I surrender” dhe “Ku je”. Koncerti ishte një sukses për studentët e Muzikës Moderne, Prodhimit Digjital dhe Menaxhimit në UBT, duke demonstruar talentin e tyre të jashtëzakonshëm dhe aftësitë në skenë.

Studentët e UBT-së vizitojnë Kompleksin Memorial “Adem Jashari” në Prekaz



Studentët e Fakultetit Media dhe Komunikim në UBT, në kuadër të lëndës: “Punë Praktike në Media të Shkruara”, të shoqëruar nga profesori Ejup Gojnovci kanë re-

alizuar një vizitë studimore në Kompleksin Memorial “Adem Jashari” në Prekaz.

Gjatë vizitës, studentët e Fakultetit Media dhe Komunikim patën

mundësinë të njihen me historinë e lavdishme të familjes Jashari. Ata shprehën admirimin e tyre për sakrificën e Adem Jasharit dhe familjes së tij, si simbol të rezistencës dhe pavarësisë së Kosovës. Studentët shkëmbyen shënime, bashkëbiseduan me qytetarë nga vende të ndryshme të cilët kishin ardhur të vizitonin Kompleksin Memorial “Adem Jashari” në Prekaz.

Qëllimi i kësaj vizite ishte që studentët të njohin nga afër sakrificën e familjes Jashari dhe njëherit të përgatisin artikuj për vizitën e tyre në mënyrë profesionale.

Studentët e Inxhinierisë së Agrikulturës dhe Mjedisit vizituan Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural



Studentët e vitit të tretë të Inxhinierisë së Agrikulturës dhe Mjedisit në UBT, në kuadër të lëndëve: “Menaxhimi i projekteve në Agrokulturë dhe Mjedis” dhe “Menaxhimi dhe mbrojtja e tokave”, të udhëhequr nga profesorët: Afete Musliu, Besa Veseli dhe Vezir Januzi kanë vizituar Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

Gjatë kësaj vizite studentët janë pritur nga zyrtarët e Programit për Bujqësi dhe Zhvillim Rural: Lulzim Shamolli, Nysrete Doda dhe Bajram Imeri, së bashku me bashkëpunëtorë të tjerë në këtë departament.

Studentët u informuan për së afërmi për përgatitjen, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e program-

it vjetor dhe afatgjatë të Zhvillimit Rural.

Zyrtarët prezantuan para studentëve edhe investimet e bëra të MBPZHR gjatë strategjisë 2014-2020 dhe numrin e projekteve të realizuara për shtatë vitet e kaluara, si dhe për politikën e ndërmarrja me strategjinë e re për shtatë vitet e ardhshme dhe orientimet e programeve për grante në asete fizike në bazë të strategjisë zhvillimore.

Në fund të vizitës u kërkua nga palët që këto vizita të vazhdojnë edhe në të ardhmen pasi që i kontribuojnë në masë të madhe institucioneve dhe zhvillimit të qëndrueshëm të Bujqësisë si shtyllë kryesore e zhvillimit ekonomik të vendit tonë dhe gjenerimit të vendeve të reja të punës.

Studentët e Dizajnit të Integruar në UBT realizuan një punëtori me themeluesin e kompanisë “Tri të katërtat”, Ardian Bytyqi



Studentët e Fakultetit Dizajn i Integruar në UBT, në kuadër të lëndës: “Dizajn Studio 4”, të udhëhequr nga profesori Uran Krasniqi, kanë realizuar një punëtori me themeluesin e kompanisë për printim “Tri të katërtat”, Ardian Bytyqi.

Në kuadër të kësaj punëtorie, studentët dhe Ardian Bytyqi diskutuan për printin kreativ, duke përdorur materiale nga më të

ndryshme të punuara të gjitha handmade, screen printin, printimin digjital dhe offset, përdorimin e foljeve, kombinimin e materialeve të tekstit në materiale grafike. Ligjërata ishte shumë e frytshme pasi që studentët ishin shumë të interesuar se si brendet e tyre që janë duke i krijuar të kenë mundësi t'i konvertojnë apo edhe t'i kombinojnë në materiale të prekshme.

Studentët e UBT-së zhvilluan një vizitë studimore në Agjencinë Shtetërore të Arkivave të Kosovës dhe në Institutin e Historisë “Ali Hadri” në Prishtinë

Studentët e Fakultetit Shkenca Politike në UBT, të shoqëruar nga profesori Ilir Zylfiu, zhvilluan një vizitë studimore Agjencinë Shtetërore të Arkivave të Kosovës dhe në Institutin e Historisë “Ali Hadri” në Prishtinë.

Studentët patën mundësi të sho-



hin mjediset e ndryshme të punës, ku nga stafi i ASHAK-së patën rastin të dëgjojnë për përvojën dhe praktiken e punës, duke theksuar rëndësinë e ruajtjes së pasurisë dokumentare, me të vetmin qëllim që vet ata dhe brezat e ardhshëm të kenë mundësi t'i shfrytëzojnë

ato për qëllime hulumtuese dhe studimore.

Në Institutin e Historisë “Ali Hadri” në Prishtinë, studentët u informuan lidhur me punën kërkimore dhe shkencore, si dhe më veprimtarinë botuese të Institutit.

Vizita studimore në Turqi: Eksplorimi i trashëgimisë kulturore dhe historike nga studentët e UBT-së

Stambolli dhe Edirne ishin destinacioni kryesor i vizitave studimore të studentëve të Fakulteteve Arkitekturë dhe Planifikim Hapësinor, Inxhinieri e Ndërtimit dhe Infrastruktura dhe Dizajn i Integruar në UBT.

Studentët e këtyre drejtimeve, të shoqëruar nga profesorët: Dr. Muhamet Ahmeti, Dr. Beni Kizolli, Bard Bajqinovci dhe Dr. Ajhan Bajmaku, patën rastin të shohin nga afër vende, objekte të trashëgimisë kulturore, monumente historike dhe institucione arsimore në Turqi. Vizita në Edirne

Studentët të shoqëruar nga profesorët vizituan objektin e projektuar nga arkitekti Mimar Sinan, si dhe u realizua një shëtitje nëpër sheshin kryesor të Edirnes, duke eksploruar objekte të ndërtuara në periudha të ndryshme historike. Vizita e Hamameve dhe e objekteve të tjera të cilat tani janë të shndërruara në tregje të mallrave



të ndryshme, ishte një eksperiencë e shkëlqyeshme për studentët, të cilët u informuan më gjerësisht për trashëgiminë kulturore dhe historike të këtij qyteti.

Vizita në Stamboll

Universiteti "Mimar Sinan", shëtitje me anije në Bosfor, "Shopping

Center Venecia", Pallati "Top Kapi", "Ayasofya", "Dolmabahçe", "Gallataport", Panair i 45-të i materialeve dhe Akuariumi "Aqua Florya", ishin vendet më interesante të cilat u vizituan nga studentët dhe profesorët e UBT-së, duke u informuar më gjerësisht rreth infrastrukturës

dhe planifikimit urban dhe krijuar një eksperiencë të re e cila do t'ju ndihmojë në aspektin profesional. Vizita në Universitetin "Mimar Sinan" u zhvillua me mundësinë e studentëve për të ndjekur procesin mësimor në disa lëndë, teksa këta të fundit u mirëpritën nga stafi përg-

jegës në këtë universitet, të cilët njëherit shprehën gatishmërinë për të thelluar bashkëpunimin me UBT.

Pastaj u vazhdua me vizitën në "Shopping Center Venecia" – një kompleks i dizajnit arkitektonik përbëhet nga njësi rezidenciale luksoze, zyra dhe tregje të ndryshme tregtare, duke e bërë atë një mjedis rezidencial vërtetë të integruar. Studentët patën mundësinë të inspirohen me këtë objekt, si nga përzgjedhje e materialeve, harmonizimi i materialeve në mes veti dhe një llojllojshmëri të interierit dhe eksterierit.

Është vizituar edhe panairi i materialeve ndërtimore i 44 me radhë që mbahet një herë në vit, si një nga panairët më të mëdha dhe më të rëndësishmit në Evropë. Gjatë kësaj vizite studentët patën mundësi të njihen me materialet e ndryshme inovative të cilat janë duke u aplikuar në projekte të ndryshme.

Studentët e Studimeve të Sigurisë në UBT realizuan një vizitë studimore në Ministrinë e Mbrojtjes



Studentët e Fakultetit Studime të Sigurisë në UBT, të udhëhequr nga profesori Bahri Gashi, kanë realizuar një vizitë studimore në Ministrinë e Mbrojtjes.

Studentët u takuan me ministrin Armend Mehaj, cili i mirëpriti ata duke i njoftuar për së afërmi për rolin, misionin dhe polit-

kat strategjike të mbrojtjes dhe zbatimin e Planit Gjithëpërfshirës të Tranzicionit.

Në prani të Shefit të Kabinetit të ministrit Mehaj, kolonelit Hasan Hoxha, Gjeneralmajor Gëzim Hazrolli, drejtor i operacioneve dhe inteligjencës në Ministrinë e Mbrojtjes, në emër të ministrisë,

bëri një prezantim gjithëpërfshirës mbi të arriturat në adresimin e çështjeve specifike që e karakterizojnë Ministrinë e Mbrojtjes dhe Forcën e Sigurisë së Kosovës, duke iu përgjigjur disa pyetjeve tematike të studentëve.

Përmes kësaj vizite studimore, studentët u njoftuan drejtpërdrejtë dhe bashkëbiseduan rreth politikave të Ministrisë së Mbrojtjes, për arritjet dhe sfidat që e kanë shoqëruar MM-në gjatë vitit 2022 dhe planifikimet për vitin 2023, përkatësisht sfidat e shtetit të Kosovës në rrugën drejt anëtarësimin në NATO.

Studentët e UBT-së zhvilluan një vizitë në kompaninë "SACH Corporation"



Studentët e Fakultetit Sisteme të Informacionit në UBT, në kuadër të lëndës "Marketing", të shoqëruar nga profesori Agim Zuzaku, kanë zhvilluar një vizitë studimore në kompaninë "SACH Corporation". Studentët u mirëpritën nga pronari Shpend Thaqi, i cili prezantoi kompaninë, historinë e themelimit të saj, sfidat që është përballur përg-

jatë këtyre viteve, si dhe rëndësinë e marketingut në rritjen dhe impaktin që mund të ketë në arritjen e suksesit. Kjo vizitë ishte një mundësi e shkëlqyer për studentët për të ndjekur në terren praktikën e asaj që kanë mësuar në klasë dhe për të fituar njohuri të reja të lidhura me fushën e marketingut.

Studentët e Inxhinierisë së Agrikulturës në UBT implementojnë protokollin e të ushqyerit të sallatës së gjelbër të kultivuar në sistem të kultivimit në hidroponi NFT



09/11/2023. Studentja e vitit të tretë Sihana Bokshi së bashku me grupin e studentëve të Fakultetit Inxhinieri e Agrikulturës dhe Mjedisit në UBT, në kuadër të lëndës "Të ushqyerit e bimëve", me bartësin e lëndës Prof. Ismet Babaj dizajnuan dhe implementuan protokollin e të ushqyerit të sallatës së gjelbër të kultivuar në sistem të kultivimit në hidroponi NFT (Nutrient Film Technique).

Ky projekt inovativ është zhvilluar me sukses në serrat e Parkut

Shkencor Inovativ të UBT-së në Lipjan. Përmes kësaj pune, studentët kanë demonstruar aftësitë e tyre në përdorimin e teknologjisë së hidroponisë për të rritur sallatën e gjelbër në mënyrë efikase. Gërshetimi i teorisë dhe praktikës është theksuar si një element kyç në këtë projekt, dhe rezultati final tregon një sukses të vërtetë. Kjo dëshmon se studentët e UBT-së janë të aftë të integrojnë njohuritë teorike në fushën e inxhinierisë dhe mjedisit me aftësitë praktike, duke krijuar një lidhje të fortë midis studimit dhe aplikimit të dijeve në praktikë.



Studentët e Medias dhe Komunikimit në UBT zhvilluan një vizitë studimore në Top Channel

Studentët e Fakultetit Media dhe Komunikim në UBT, të shoqëruar nga dekani, Ferid Selimi, profesorët: Musa Sabedini, Votim Hanoli dhe koordinatoresha e fakultetit, Marigona Xhigoli, qëndruan për një vizitë studimore në Tiranë, me ç'rast panë nga afër punën në televizionin Top Channel.

Përgjatë kësaj vizite, studentët patën rastin të shohin nga afër punën dhe angazhimin e gazetarëve dhe stafit të Top Channel, duke përfutur dhe përforcuar njohuritë e tyre mbi politikën redaktoriale që përdor ky televizion



në Shqipëri. Nga kjo vizitë studentët e UBT-së u njoftuan edhe me ambientet e televizionit, si dhe me teknolog-

jinë që përdor për transmetime të emisioneve të ndryshme, nga e cila përfutur një eksperiencë të re dhe ndryshe nga herët tjera.

Studentët dhe stafi i UBT-së dhurojnë gjak

Dhjetëra studentë dhe stafi akademik e administrativ i UBT-së i janë përgjigjur aksionit "Dhuro gjak, shpëto një jetë", organizuar në Parkun Shkencor Inovativ të UBT-së në Lipjan.

Aksioni është organizuar në bashkëpunim me Qendrën e Transfuzionit të Gjakut të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës. Dozat e gjakut të mbledhura në UBT, do t'i shërbejnë QKUK-së, në raste emergjente të kërkesave për gjak. Gjatë këtij organizimi, gjak kanë mundur të dhurojnë të gjithë ata që janë në gjendje të mirë shën-



detësore. UBT ndër vite dhuron gjak, madje në vitet e kaluara ka

shënuar edhe shifra rekorde të dhurimit të gjakut në Kosovë.

Studentët e UBT-së fituan garën “Young Innovators” me StartUp-in e tyre “PikPik”

Përmes “PikPik”, një aplikacion ku kompanitë e taksive mund të regjistrojnë makinat e tyre dhe klienti mund të gjejë taksinë më të afërt, studentët e UBT-së kanë fituar garën “Young Innovators”, në Qendrën e Trajnimeve dhe Inovacionit ITP Prizren.

Studentët e vitit të dytë të Shkencave Kompjuterike dhe Inxhinierisë në Prizren, Ramazan Morina, Florian Morina dhe Jeton Kameri kanë fituar garën me aplikacionin “PikPik” që do të jetë një aplikacion në dobi të qytetarëve.

Me këtë fitore të shkëlqyer, studentët tregojnë se janë pjesë e brezit të ri të inovatorëve dhe sipërmarrësve shqiptarë.

Ky sukses i madh i studentëve të UBT-së tregon potencialin dhe talentin e tyre në fushën e teknologjisë dhe inovacionit. Ata përfaqësojnë një shembull fry-



mëzues për të gjithë studentët e tjerë dhe tregojnë se me përkushtim dhe punë të palodhshme,

është e mundur të arrish suksese të jashtëzakonshme në botën e teknologjisë.

Studentët e UBT-së ofruan shërbime për qytetarët në Ditën Botërore të Diabetit



20/11/2023. Matja e nivelit të sheqerit në organizëm, si dhe dhënia e këshillave mjekësore për parandalim e trajtim të sëmundjes së diabetit, kanë qenë aktivitetet që studentët e Infermierisë në UBT i kanë ofruar në Ditën Botërore të Diabetit për dhjetëra qytetarë të Kosovës.

Ky aktivitet për shënimin e kësaj

dite është organizuar dhe përkrahur nga UBT dhe Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare në Prishtinë. UBT në vijimësi ka iniciuar dhe përkrahur një varg iniciativash për shënimin me aktivitete të ditëve vetëdijesuese që shënohen në mbarë botën, duke ofruar për orë të tëra shërbime falas për qytetarë.

Studentët e Media dhe Komunikimit vizituan hapësirat e Media Grupit të UBT-së



08/11/2023. Studentët e vitit të parë të Fakultetit Media dhe Komunikim në UBT, në kuadër të lëndës “Zhanret e Gazetarisë”, të shoqëruar nga bartësi i lëndës, Prof. Musa Sabedini, vizituan hapësirat e Media Grupit të UBT-së.

Profesori Musa Sabedini foli mbi rolin dhe funksionimin profesional të Media Grupit si njëra nga shtyllat kryesore prej nga plasohen me

shumë përgjegjësi dhe precizitet lajmet dhe zhvillimet që ndodhin brenda UBT-së dhe jashtë saj.

Kjo vizitë u ka ofruar studentëve një mundësi të vlefshme për të njohur më mirë ambientin dhe proceset që ndodhin në një redaksi mediatike, si dhe kjo përvojë do t'i ndihmojë ata në zhvillimin e tyre të ardhshëm si gazetarë dhe profesionistë të medias.

Nxënësit e “International Maarif Schools Of Kosova” vizituan Parkun Shkencor Inovativ të UBT-së

03/11/2023. Nxënësit e klasës së 12-të, të Shkollës “International Maarif Schools Of Kosova”, dega në Prishtinë, në kuadër të programit për orientim profesional në karrierë, vizituan UBT-në.

Profesorët dhe stafi i UBT-së i mirëpritën nxënësit në Qytetin e Mençur të UBT-së në Lipjan, me çrast i njoftuan me ambientet frymëzuese dhe motivuese të UBT-së, laboratorët, sallat, bibliotekën dhe hapësirat e tjera të cilat shfrytëzohen nga nxënësit dhe studentët e UBT-së.

Në kuadër të kësaj vizite, nxënësit e “International Maarif Schools Of Kosova” u njoftuan gjithashtu edhe për punën dhe angazhimin e stafit të UBT-së, si dhe programet e UBT-së të cilat janë unike dhe me kurrikulat më bashkëkohore.



Drejtori i kompanisë “Expert pro”, Arsim Zeka zhvilloi një ligjëratë tematike me studentët e Menaxhmentit, Biznesit dhe Ekonomisë në UBT



21/11/2023. Drejtori i kompanisë “Expert pro”, Arsim Zeka zhvilloi ligjëratë tematike me studentët e Fakultetit Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi në UBT, në kuadër të lëndës “Hyrje në kontabilitetin financiar” nën udhëheqjen e profesoreshës, Fidane Spahija – Gjilkolli.

Tema e ligjëratës ishte “Praktikë në kontabilitet”, ku për qëllim kishte angazhimin e studentëve dhe mundësinë që ata të shohin për së afërmi përdorimin e softuerit të kontabilitetit, në mënyrë që të përfitojnë dhe përforcojnë njohuritë e tyre, si dhe të jenë më të për-

gatitur për tregun e punës. Ndër të tjera, studentët e Fakultetit Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi, patën rastin të shohin edhe prezantimin e softuerit “Expert”, si një ndër softuerët e kontabilitetit më të sofistikuar në treg.

Përfaqësues të ASK-së zhvilluan diskutim të hapur me studentët e UBT-së rreth Regjistrimit të Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe Banesave



09/11/2023. Përfaqësues të Agjencisë së Statistikave të Kosovës qëndruan në Parkun Shkencor Inovativ të UBT-së në Lipjan, me çrast organizuan një diskutim të hapur me studentët e UBT-së për Regjistrimin e Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe Banesave.

Diskusimi i hapur u ofroi studentëve mundësinë të zbulojnë detaje të rëndësishme rreth Regjistrimit të Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe Banesave, duke i afruar ata me proceset dhe sfidat e

fushës statistikore në Kosovë. Gjatë diskutimit, studentët patën mundësinë të bënin pyetje, të shprehnin shqetësime dhe të ndanin idetë e tyre me përfaqësuesit e Agjencisë së Statistikave. Ky ndërveprim i drejtpërdrejtë kontribuoi në një kuptim më të thellë të rolit të statistikave në zhvillimin e vendit, si dhe në sensibilizimin e studentëve në lidhje me përdorimin dhe rëndësinë e të dhënave statistikore në vendimmarrje.



DEPARTMENT FOR PROFESSIONAL PRODUCTS AND SERVICES

WHAT ARE WE OFFERING?

- Trainings
- Certifications
- Professional Education
- Business Consulting

TRAININGS

- IT Trainings
- Soft Skills Trainings
- Language Trainings

QUALITY AUSTRIA

qualityaustria Succeed with Quality SOCIAL ACCOUNTABILITY (CSR)	qualityaustria Succeed with Quality EXCELLENCE (EFQM)
qualityaustria Succeed with Quality HEALTH, SOCIAL SERVICES & HEALTH TOURISM	qualityaustria Succeed with Quality OCCUPATIONAL HEALTH & SAFETY
qualityaustria Succeed with Quality CONSTRUCTION	qualityaustria Succeed with Quality PUBLIC ADMINISTRATION
qualityaustria Succeed with Quality FOOD SAFETY	qualityaustria Succeed with Quality OCCUPATIONAL HEALTH & SAFETY
qualityaustria Succeed with Quality ENVIRONMENT & ENERGY	qualityaustria Succeed with Quality AUTOMOTIVE
qualityaustria Succeed with Quality INTEGRATED MANAGEMENT SYSTEM	qualityaustria Succeed with Quality QUALITY
qualityaustria Succeed with Quality CUSTOMIZED PRODUCTS FOR SPECIAL INDUSTRIES	qualityaustria Succeed with Quality MEDICAL DEVICES

MICROSOFT CERTIFICATIONS

Aviable Certifications

Azure Fundamentals (AZ-900)	Microsoft 365 Fundamentals (MS-900)	Microsoft Azure AI Fundamentals (AI-900)	Microsoft Azure Data Fundamentals (DP-900)	Microsoft Power Platform Fundamentals (PL-900)	Microsoft Dynamics 365 Fundamentals CRM (MB-910)	Microsoft Dynamics 365 Fundamentals ERP (MB-920)	Microsoft Security, Compliance, and Identity Fundamentals (SC-900)
-----------------------------	-------------------------------------	--	--	--	--	--	--

PROFESSIONAL TRAININGS

BAZAT E PROGRAMIMIT NE C#	JAVA PROGRAMMING	PYTHON FUNDAMENTALS	UJHQMIMI (DASHUR)	AUTODESK INVENTOR	UJH-QHEDHJET E EKSPERTVE VIRTUALE DHE PUNA NE DISTANCE	INTELIGJENCE ARTIFICIALE, MACHINE LEARNING	FULL STACK DEVELOPMENT .NET CORE & REACTJS	INTERNET MARKETING & E-MARKETING
FULL STACK DEVELOPMENT (JAVA SPRING BOOT & ANGULARJS)	AUGMENTED AND VIRTUAL REALITY	MBROHTJA E TE DHENAVE NE EUROPE (IGDR)	MENASHIMI (BURIMEVE NJEZORE)	ARC GIS - ARCMAP	DIGITAL MARKETING	SPSS STATISTICAL PACKAGE FOR SOCIAL SCIENCES	ORACLE DATABASE 11G	ORACLE DATABASE 11G
ZYRTAR PER SHITE	MARSHENJE ME PUBLIKUN	BAZAT E SIGURISE SE INFORMACIONIT	METODAT STATISTIKOCHE PER VENDIMARRJE NE BIZNES	KOMUNIKIM I LIDERIVE	MEDIA DIGITALE DHE SOCIALE	ADMINISTRATOR T'NDERTESIVE TE BANIMIT NE BASHKIPROESIE	FERRILIMI I RAPORTEVE	MENASHIMI I PROJEKTEVE
SHKATHITESITE E NEGOCIMIT	E-DEVERISIA	SIELLA ME BASHKIPROESITORE TE VESHITRE	MENASHIMI I FINANCAVE PER JOFINANCIER	SHKATHITESITE E INTERVISTIMIT	GIS FOR SOCIETY	AUTOCAD CIVIL 3D		

IC3 Certifications

IC3 DIGITAL LITERACY

Digital Literacy is the foundation of employability in today's digital economy.

IC3 is a globally recognized certification that validates an individual's ability to use technology effectively in the workplace. It is based on three core competencies: Basic Skills, Digital Literacy, and Problem Solving.

Partners and Providers:

- intuit: QuickBooks, Sage, Xero, NetSuite, Acumatica
- Swift: iOS Developer, Mobile Applications, iOS Engineer
- Adobe Certified Professional: Marketing, Arts, AVI Technology & Communications, Business Management & Administration
- Microsoft: Information Technology, Software Engineering, Business Development
- Project Management Institute: Project Management, Product Management, Management Consulting
- ESB: Agriculture & Food, Hospitality & Tourism, Business Administration
- AUTODESK: Architecture & Construction, Manufacturing, Engineering
- TECHNOLOGY: Cybersecurity, Information Technology, Data Science
- ORACLE: Mobile Applications, Software Engineer
- SEMPER PARATI: Administrative & Secretarial, Customer Service & Human Resources, Retail & IT

CISCO Trainings and Certifications

Cisco Certified Support Technician NETWORKING EXAM	Cisco Certified Support Technician CYBERSECURITY EXAM
<ul style="list-style-type: none"> Network Support Technician IT Support Technician Help Desk Technician IT Support Specialist 	<ul style="list-style-type: none"> Cybersecurity Technician Junior Cybersecurity Analyst Help Desk Support Security Operations Analyst
<ol style="list-style-type: none"> Cisco Certified Support Technician Networking Cisco Certified Network Associate (CCNA) Certification Cisco Professional Certifications 	<ol style="list-style-type: none"> Cisco Certified Support Technician Cybersecurity Cisco Certified CyberOps Associate Cisco Professional Certifications

CERTIFICATIONS

qualityaustria Succeed with Quality	CompTIA	IPC International Professional Evaluation & Certification	psi	ETS	CERTIPORT
Pearson VUE	CISCO	Azure Microsoft Azure Fundamentals	PeopleCert	EC-COUNCIL ACADEMIA PARTNER	

FOREIGN LANGUAGES

REKURSE PER FOREIGN LANGUAGES

DO YOU SPEAK DEUTCH?	DO YOU SPEAK FRENCH?
DO YOU SPEAK TURKISH?	DO YOU SPEAK ITALIAN?
DO YOU SPEAK SPANISH?	

IPMA

IPMA International Project Management Association

- IPMA Level D Certified Project Management
- IPMA Level A Certified Projects Director
- IPMA Level B Certified Senior Project Manager
- IPMA Level C Certified Project Manager

CERTIPORT

Microsoft CERTIFIED EDUCATOR	Microsoft OFFICE SPECIALIST	Microsoft TECHNOLOGY ASSOCIATE
IC3	intuit QuickBooks	AUTODESK Certified User
AUTODESK Certified Professional	ESB Entrepreneurship and Small Business	EU-Council Associate

CompTIA

CompTIA Network+	CompTIA Cloud+
CompTIA Security+	CompTIA PenTest+
CompTIA CySA+	CompTIA Project+
CompTIA Linux+	CompTIA Server+
CompTIA CASP+	CompTIA Cloud Essentials

PROFESSIONAL SCHOOLS

Tani me UBT ofron edhe Shkolle Profesional e cila eshte akredituar nga Autoriteti Kombetar i Kualifikimeve per organizimin dhe mbajtjen e mesimit per pese (13) profile profesionale si meposhtem:

- Gjuha Angleze
- Ti dhe Komunikim, niveli 3 sipas Kornizes Kombetare te Kualifikimeve (nuk e kemi vazhduar me klerkesen tone)
- Asistent Administrativ, niveli 3 sipas Kornizes Kombetare te Kualifikimeve
- Zhvillues i Aplikacioneve, niveli 5 sipas Kornizes Kombetare te Kualifikimeve
- Administrator i Sistemit dhe rrjetit Kompjuterik, niveli 5 sipas Kornizes Kombetare te Kualifikimeve
- Gjuha Gjermane
- Instalues Elektrik ne banesa civile, niveli 3 sipas Kornizes Kombetare te Kualifikimeve
- Shitja dhe kujdesi ndaj klientit, niveli 3 sipas Kornizes Kombetare te Kualifikimeve
- Teknik i laboratorit mjekesor niveli 3 dhe 4 sipas Kornizes Kombetare te Kualifikimeve
- Teknik i farmaciae niveli 3 dhe 4 sipas Kornizes Kombetare te Kualifikimeve
- Bashkëpunëtor profesional i infermierisë niveli 3 dhe 4 sipas Kornizes Kombetare te Kualifikimeve
- Asistent Dentar niveli 3 dhe 4 sipas Kornizes Kombetare te Kualifikimeve
- Teknologji Informative dhe Elektronike
- Teknik i Optikës / Opticien

UBT Projects

- Regional Challenge Found
- GIZ Digital Boot Camp
- Employment Agency of Republic of Kosovo
- Austrian Development Agency
- EON Reality USA
- Ministry of Education
- Korca Innovation and Technology HUB
- Kosovo Municipalities, Gjilan, Viti, Istog and Vushtrri
- UNDP Kosovo
- Infosoft

CENTERS

Center for Statistics, Data Processing and Forecasting
Center for Modelling and Simulation
Center for Software Development and Innovation
Center for Incubation and Start Ups
Center for Arts, Multimedia and Culture
Career Center
Center for Cyber Security and Privacy
Center for Professional Development and Lifelong Learning – Executive Academy
Center for Technology Transfer, IPR and Innovation
Center for Knowledge Management and Library

CENTERS

Center of Enterprise Resources Planning – UBT SAP University Alliance
INSPIRE – Center for Social Innovation – UNICEF
Center for Leadership
Center for Resilience and Sustainable Development
Governance Innovation Center (GIC)
The Student Counselling Centre
Social Innovation Center

UBT Institutes

IEME Institute for Enterprise Management and Engineering
RIED Institute of Research Innovation and Entrepreneurship Development
IDEAA Institute of Development of Education and Academic Affairs
IFL Institute of Foreign Languages and Intercultural Competence
Institute of Politics and International Relations
Institute of Life Sciences and Innovation
Institute of Medicine Sciences and Innovation
Institute of Rule of Law and Justices
Institute of Media and Communication
Institute for Urban Studies and Spatial Planning